



**GENDER AND  
THE JUDICIARY**  
in the Western Balkans



**THE AIRE CENTRE**  
Advice on Individual Rights in Europe

# Barazia Gjinore dhe Diskriminimi mbi Bazën e Seksit

Udhërrëfyes mbi Jurisprudencën e Gjykatës  
Evropiane të të Drejtave të Njeriut





# **Barazia Gjinore dhe Diskriminimi mbi Bazën e Seksit**

Udhërrëfyes mbi Jurisprudencën e Gjykatës  
Evropiane të të Drejtave të Njeriut

## Redaktorë

**Biljana Braithwaite**, Drejtoreshë e Programit për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE  
**Catharina Harby**, Konsulente e Lartë Ligjore, Qendra AIRE

## Autorë

**Prof. Dr. Ivana Jelić**, Gjyqtare e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut  
**Hannah Smith**, Avokate dhe Menaxhere Ligjore e Projektit, Qendra AIRE

Gjithashtu u jemi mirënjohës **Ed Millet** dhe  
**Naomi Sirrs** për kontributin e tyre në këtë publikim.

© 2022 AIRE Centre

Kopje e shtypur: 450

Ky version origjinal në anglisht është përkthyer gjithashtu në gjuhët  
boshnjake / kroate / malazeze / serbe, shqipe dhe maqedone

Dizajni nga  
Kliker Dizajn

Shqypur nga  
Kuća Štampe



Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer – Programi i Shtetit të së Drejtës SEE dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në publikim jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

# PËRMBAJTJA

Parathënie .....	9
<b>Fjalë hyrëse nga gjyqtarja Ivana Jelić – Aspekti gjinor dhe Ballkani Perëndimor .....</b>	<b>12</b>
<b>Tabela e shkurtesave .....</b>	<b>18</b>
<b>Hyrje.....</b>	<b>20</b>
a) Rreth këtij Udhërrëfytesi .....	20
b) Terminologjia.....	22
<b>Pjesa I – Shikim i përgjithshëm i standardeve legjislativ dhe jurisprudencës përkatëse të KEDNj-së .....</b>	<b>24</b>
(1) Standardet legjislativ.....	24
a) Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut .....	24
b) Parimet kyçe të së drejtës së mos-diskriminimit sipas KEDNj-së .....	29
c) Instrumente të tjera të Këshillit të Evropës .....	32
d) Organet monitoruese .....	33
e) Legjislacioni i BE-së.....	34
f) Instrumentet ligjore ndërkombëtare .....	36
(2) Dhuna shtëpiake, femicidi dhe dhuna e bazuar në gjini .....	40
a) Shikim i përgjithshëm mbi detyrimet procedurale dhe ato substanciale sipas Konventës.....	40
b) Detyrimet procedurale sipas neneve 2, 3 dhe 8 .....	47
c) Detyrimi procedural sipas nenit 13 – e drejta për zgjidhje efektive .....	49
d) Dhuna shtëpiake dhe ajo e bazuar në gjini si diskriminuese sipas nenit 14.....	50
(3) Stereotipizimi gjinor në vendimet gjyqësore .....	54
a) Gjuha seksiste ose diskriminuese .....	54
b) Arsyetimet, prezumimet dhe insinuatat stereotipike .....	55
c) Diversiteti gjinor i gjyqësorëve kombëtarë .....	57

(4) Diskriminimi mbi bazën e seksit në lidhje me të drejtën për respekt të jetës private dhe familjare.....	58
a) Të Drejtat e Prindërimit .....	58
b) Kujdestaria e fëmijëve dhe kontakti me fëmijët .....	60
c) Adoptimi .....	62
d) Leja prindërore nga puna .....	63
e) Të drejtat për vënien e emrit .....	64
f) Të drejtat transgjinore.....	65
g) Të drejtat seksuale dhe riprodhuese, përfshirë sterilizimi i detyruar ....	67
(5) Diskriminimi mbi bazën e seksit në punësim dhe në jetën publike.....	72
a) Neni 1, Protokoli 1 i Konventës – e drejta e pronës .....	72
b) Qasja në punësim .....	74
c) Bullizimi dhe ngacmimi në punë .....	75
d) Shtesat dhe rroga .....	76
e) Leja prindërore nga puna .....	78
f) Pjesëmarrja femërore në jetën publike .....	78
g) Veprimet afirmative .....	79
(6) Diskriminimi mbi bazën e seksit – qasja në mallra dhe shërbime, shërbime publike, ndihmë sociale/shtesa .....	80
a) Sigurimet shoqërore, ndihma sociale dhe shtesat.....	80
b) Shtesat për aftësitë e kufizuara .....	82
c) Të drejtat e lidhura me pronën .....	83
(7) Diskriminimi mbi bazën e seksit – liria e shprehjes, ngacmimi seksual, krimet e urrejtjes .....	84
a) Mbulesat fetare të kokës për gratë.....	84
b) Krimet e urrejtjes .....	86
(8) Diskriminimi mbi bazën e seksit – gratë rome .....	88
(9) Diskriminimi mbi bazën e seksit – gratë refugjate / migrante / azilkërkuese .....	91
(10) Veprimet afirmative / dallimet e justifikuara në trajtimin mbi bazën e seksit.....	96
a) Dallimi i justifikuar në trajtim: Shtatzania .....	97
b) Dallimi i justifikuar në trajtim: Dënimi me burg dhe leja nga burgu .....	98

c) Dallimi i justifikuar në trajtim: Pensioni, skemat e sigurimeve shoqërore dhe ato tatimore .....	99
d) Dallimi i justifikuar në trajtim: pakicat etnike .....	100
e) Dallimi i justifikuar në trajtim: Personat me aftësi të kufizuara .....	101
f) Dallimi i justifikuar në trajtim: gratë si grup i cenushtëm .....	101

(11) Impakti i Covid-19 mbi të drejtat e grave	
– impakti tek dhuna shtëpiake, rolet gjinore .....	102
a) Dhuna e bazuar në gjini dhe dhuna shtëpiake .....	103
b) Papunësia .....	106
c) Masat e mbrojtjes sociale .....	108

(12) Përfundim .....	110
----------------------	-----

## Pjesa 2 – Përmbledhje e çështjeve sipas rendit kronologjik ..... 112

VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN CHRISTINE GOODWIN k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	112
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN LEYLA ŞAHİN k. TURQISË.....	117
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN STEC DHE TË TJERË k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	120
VENDIMI NË ÇËSHTJEN OPUZ k. TURQISË.....	123
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KONSTANTIN MARKIN k. RUSISË.....	128
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN S.A.S. k. FRANCËS.....	133
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KHAMTOKHU DHE AKSENCHIK k. RUSISË.....	136
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MOLLA SALI k. GREQISË.....	139
VENDIMI NË ÇËSHTJEN VOLODINA k. RUSISË .....	143
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN S.M. k. KROACISË....	147
VENDIMI NË ÇËSHTJEN TËRSHANA k. SHQIPËRISË .....	151
VENDIMI NË ÇËSHTJEN B. k. ZVICRËS .....	155
VENDIMI NË ÇËSHTJEN SABALIĆ k. KROACISË.....	159
VENDIMI NË ÇËSHTJEN JURČIĆ k. KROACISË .....	163
VENDIMI NË ÇËSHTJEN J. L. k. ITALISË .....	167
VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KURT k. AUSTRISË .....	172

VENDIMI NË ÇËSHTJEN E GALOVIĆ k. KROACISË.....	178
VENDIMI NË ÇËSHTJEN VOLODINA k. RUSISË (Nr. 2).....	183
VENDIMI NË ÇËSHTJEN ŠPADIJER k. MALIT TË ZI.....	188
VENDIMI NË ÇËSHTJEN A DHE B k. GJEORGJISË .....	191



# Parathënie

Avancimi i barazisë së sekseve është qëllim madhor i shteteve në tërë Evropën. Megjithatë, ka shumë faktorë shoqërorë në Ballkanin Perëndimor që tregojnë se kjo çështje ka rëndësi të veçantë për rajonin. Dhuna e përhapur kundër grave, shfaqja e shpeshtë e stereotipeve gjinore, nënpërfaqësimi i grave në politikë dhe në punë prestigjioze, si dhe impakti i pandemisë Covid-19 tek gratë që kanë qenë edhe përpara në dizavantash social janë vetëm disa prej faktorëve që tregojnë se është e domosdoshme që të ndërmerren më shumë veprime për të avancuar pozitën e grave në rajon.

Gratë gëzojnë barazi sipas ligjit, por jo në realitet. Vendet e rajonit kanë futur korniza të shumta ligjore, institucionale dhe politike për të përmirësuar barazinë gjinore. Megjithatë, zbatimi i masave të barazisë gjinore, drejtësisë së barabartë dhe shtetit të së drejtës mbetet sfidë serioze.

Gjykatat vendase dhe profesionistët ligjorë në të gjithë rajonin kanë një rol jetik për të luajtur në kapërcimin e kësaj sfide. Ato duhet të mbrojnë dhe fuqizojnë në mënyrë efektive zbatimin e të drejtave dhe lirive që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, të cilat përmbahen në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në instrumente të tjera ndërkombëtare përkatëse. Shpresohet se ky Udhërrëfyes do të jetë një mjet i vlefshëm për të kuptuar më mirë të drejtat dhe liritë që u garantohen grave sipas Konventës; ai do t'i ndihmojë avokatët për të identifikuar bazat mbi të cilat mund të kontestojnë veprimet diskriminuese kundër grave, dhe do të inkurajojë gjykatat vendase që të inkorporojnë në mënyrë të vazhdueshme arsyetimet e Gjykatës së Strasburgut në vendimet e tyre në lidhje me këto çështje.

Gjithashtu, njihet se avancimi i kuptimit dhe implementimit të praktikës gjyqësore të analizuar në këtë Udhërrëfyes, i vetëm, nuk mjafton për të ndryshuar në mënyrë domethënëse pozitën e grave në shoqëri. Promovimi i barazisë gjinore në rajon kërkon ndryshime gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë, përfshirë futjen e aspektit gjinor si rrymë qendrore në shkolla, media, në politikë dhe në gjyqësor.<sup>[1]</sup> Është me rëndësi jetike që të

---

[1] Këshilli i Evropës e përkufizon përcaktimin e aspektit gjinor si rrymë qendrore si: "(Ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të inkorporohet në të gjitha politikat në të gjitha nivelet dhe në të gjitha

ndryshohen qëndrimet ndaj rolit të burrave dhe grave në shoqëri, si dhe të ndryshohen ligjet dhe politikat.

Duke qenë se shpesh nuk vihen re dhe shpesh ndodhin në mënyrë të pavetëdijshme, njëanshmëria dhe diskriminimi gjinor kanë pasoja dëmtoese për të gjithë, duke nisur nga profesionistët ligjorë e deri tek gratë e burrat që kërkojnë të realizojnë të drejtat e tyre në gjykatë. Njëanshmëria gjinore mund të manifestohet në gjykatore në mënyrën se si prezantohen çështjet, se si gjyqtarët vendosin në lidhje me to, e madje edhe në faktin nëse çështja arrin apo jo deri në gjyq.

Në këtë aspekt, ky publikim është pjesë e iniciativës më të gjerë të Qendrës AIRE për Aspektin Gjinor dhe Gjyqësorin në Ballkanin Perëndimor. Kjo iniciativë afatgjatë do të përfshijë, mes aktivitetëve të tjera, trajnimet për vetëdijësim gjinor mes hisedarëve në sistemin gjyqësor, hulumtime të gjera për të kontribuar në avancimin e legjislacionit dhe praktikave, shpërndarjen e më shumë publikimeve të synuara në lidhje me të drejta të veçanta që kanë të bëjnë me aspektin gjinor, dhe organizimin e ngjarjeve që bashkojnë përfaqësues nga GjEDNj me gjyqtarë dhe profesionistë nga gjykatat e tërë rajonit, me qëllim të inkurajimit të ndarjes së praktikave më të mira. Çka është më me rëndësi, iniciativa gjithashtu do të përfshijë ngritjen e një rrjeti rajonal ku bëhen bashkë kampionët/et e çështjeve gjinore në gjyqësor dhe krijohen mundësi për mentorim, mbështetje të ndërsjellë dhe shkëmbim të praktikave të mira mes gjyqtarëve e gjyqtareve të rajonit. Shpresohet se rrjeti do të ofrojë një qendër në fokus të së cilës do të ngrihen çështjet gjinore dhe do të adresohen në mënyra praktike.

Rrjeti gjinor do të shpallet formalisht në Forumin për Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor që do të zhvillohet në pranverën e vitit 2022, ku gjyqtarët/et dhe profesionistët/et ligjorë/e nga tërë rajoni do të takohen me gjyqtarët/et e GjEDNj-së për të diskutuar praktikën ligjore të përshkruar në këtë Udhërrëfyes dhe për të ndarë praktikat më të mira të kapërcimit të sfidave gjatë implementimit dhe mbrojtjes së të drejtave të përshkruara në këtë publikim.

I jemi mirënjohës Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Fondacionit Konrad Adenauer për njohjen e rëndësisë së punës sonë dhe për mbështetjen në realizimin e këtij Udhërrëfyesi. Shpresojmë se shpërndarja e këtij Udhërrëfyesi, së bashku me formimin e rrjetit gjyqësor rajonal dhe aktivitetet e gjera të planifikuara në vazhdimësi, do të arrijë të godasë njëanshmërinë dhe diskriminimin kundër grave,

---

fazat, nga aktorët normalisht të përfshirë në politikëbërje; Shih: <https://www.coe.int/en/web/genderequality/what-is-gender-mainstreaming>.

një dukuri e cila shpërfaqet në shumë aspekte të shoqërisë në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe gjyqësorin. Më tej, shpresojmë se qasja jonë shumëplanëshe do të ndihmojë në avancimin e një nocioni të barazisë për gratë i cili fokusohet jo vetëm në lirinë nga detyrimi, diskriminimi dhe abuzimi, por i cili garanton që gratë të mund ta jetojnë jetën me potencialin e tyre maksimal me dinjitet, drejtësi dhe përfshirje të garantuar për gratë në shumë aspektet e jetës që diskutohen në këtë Udhërrëfyes.

**Biljana Braithwaite**

Drejtoreshë e Programit për Ballkanin Perëndimor  
Qendra AIRE

# Fjalë hyrëse nga gjyqtarja Ivana Jelić – Aspekti gjinor dhe Ballkani Perëndimor

Ekziston nevoja urgjente që të ndërmerren veprime për promovimin e barazisë gjinore dhe të goditen njëanshmëria dhe diskriminimi kundër grave dhe vajzave në Ballkanin Perëndimor. Statusi i grave dhe vajzave në vendet e rajonit, në aspekte të panumërta, është më keq se ai i burrave dhe djemve. Gratë dhe vajzat përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës shtëpiake dhe formave të tjera të dhunës së bazuar në gjini, të cilat shumicën e rasteve kryhen nga burrat. Hulumtimet e zhvilluara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në vitin 2019 vunë këmbanat e alarmit për shtrirjen e gjerë të dhunës kundër grave në të gjitha shtetet e rajonit. Për shembull, gati 70% e grave kanë përjetuar një formë apo një tjetër të dhunës nga një partner ose jo-partner që nga mosha 15-vjeçare, ndërsa 23% e grave kanë përjetuar dhunë intime fizike dhe/ose seksuale nga një partner.<sup>[2]</sup>

Mungesa e përcaktimit të aspekteve gjinore si rrymë qendrore<sup>[3]</sup> në arsim çon në kurrikula stereotipike gjinore, ndërkohë që stereotipet gjinore i kontribuojnë një pozicioni të pafavorshëm të grave në tregun e punës. Gratë në përgjithësi kanë nivele më të larta arsimimi por janë më pak të punësuar; ato që janë të punësuar kanë më shumë gjasa të kryejnë punë informale ose të përkohshme dhe paguhen shumë më pak. Komisioni Evropian i të Drejtave Sociale (ang. ECSR) gjeti shkelje të Kartës Sociale Evropiane (ang. ESC) në lidhje me të drejtën për pagë të barabartë dhe të drejtën për mundësi të barabarta në vendin e punës në 14 prej 15 vendeve,

[2] Shih [https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/413237\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/413237_0.pdf) "Sondazhi i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën kundër grave: Raporti kryesor", Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 6 mars 2019.

[3] Në vitin 1998, Këshilli i Evropës e përkufizoi përcaktimin e aspekteve gjinore si rrymë qendrore si "(Ri)Organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të jetë e inkuorpuar në të gjitha politikat në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët që normalisht janë të përfshirë në politikëbërje". Në kontekstin e arsimit kjo do të nënkuptonte se, gjatë hartimit dhe realizimit të përbajtjes dhe formatit të programeve arsimore, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat, nevojat dhe kushtet e jetesës së burrave dhe grave. Shih: <https://www.coe.int/en/web/genderequality/what-is-gender-mainstreaming>.

të cilat zbatojnë ankesat kolektive të ESC.<sup>[4]</sup> Gratë në tërë rajonin diskriminohen në tregun e punës, veçanërisht në lidhje me shtatzaninë dhe amësinë, si gjatë procesit të marrjes në punë, ashtu edhe kur janë në vendin e punës. Shumë gra janë viktima të ngacmimit seksual dhe bullizmit.

Sadoqë të gjitha shtetet e rajonit kanë futur kuotat gjinore (kryesisht në parlament), gratë ende janë jashtëzakonisht të nënpërfaqësuar në politikë dhe në organet vendimmarrëse. Shëndeti dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese të grave, e sidomos e drejta e tyre për abort, shpesh janë të rrezikuara. Gratë kanë shumë më pak pasuri në pronësi të tyre sesa burrat, dhe tradicionalisht ende heqin dorë nga e drejta e tyre e trashëgimisë në favor të anëtarëve meshkuj të familjes së tyre, ndërkohë që pronat e blera gjatë martesës ose partneriteteve civile kryesisht regjistrohen në emër të bashkëshortit / partnerit mashkull. Mediat shumë shpesh i portretizojnë gratë si objekte dhe simbole seksi, nuk promovojnë gratë e suksesshme dhe arritjet e tyre, dhe rrallë i ftojnë gratë për të diskutuar çështje të rëndësishme sociale. Artikujt dhe shkrimet sensacionale të dhunës kundër grave mbizotërojnë kudo; media shpesh i portretizon këto ngjarje si "tragjedi familjare" duke gjetur arsyetime për kryesit dhe duke e zhvendosur fajin për dhunën tek gratë.<sup>[5]</sup>

Pandemia Covid-19 e ka bërë edhe më të ngutshme nevojën për të vepruar në rajon. Pandemia ka vënë në dukje dhe ka përkeqësuar pabarazitë ekzistuese në rajon, duke i dhënë shkas formave të reja të diskriminimit kundër grave, dhe duke penguar mundësinë e tyre për të realizuar të drejtat e tyre dhe/ose për të ikur nga situata diskriminuese. Shifrat e rasteve të dhunës shtëpiake kundër grave në rajon janë alarmante. Për shembull, disa ngjarje tragjike kanë ndodhur shpesh në zonat rurale të Malit të Zi në vitin 2021.<sup>[6]</sup>

[4] Shih [https://search.coe.int/directorate\\_of\\_communications/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016809ed61b](https://search.coe.int/directorate_of_communications/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016809ed61b) "E drejta për pagë të barabartë: Komisioni Evropian për të Drejtat Sociale gjen shkelje në 14 vende", Këshilli i Evropës, 29 korrik 2020.

[5] Shih për shembull: <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2018/04/CSF-PB-04-Gender-Issues-in-the-Western-Balkans.pdf> "Çështjet Gjinore në Ballkanin Perëndimor", nga Ana Marjanović Rudan, Dokumenti Përmbledhës i Politikave (policy brief) Nr. 04 i Forumit të Shoqërisë Civile në Serinë e Samiteve të Ballkanit Perëndimor, prill 2018; <https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2018/11/WRWB2018.pdf> "Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor", nga Stana Tadić, Violeta Anđelković dhe Sofija Vrbaški, Fondacioni Kvinna till Kvinna, nëntor 2018; Evie Browne "Normat gjinore në Ballkanin Perëndimor", Raporti Kabinetik (helpdesk) K4D, Instituti i Studimeve Zhvillimore në Brighton, 2017.

[6] <https://www.coe.int/en/web/podgorica/-/-how-to-protect-family-from-domestic-violence-human-rights-day-marked-in-montenegro>, "Si të mbrohet familja nga dhuna shtëpiake:

Vendet e rajonit kanë ratifikuar dy prej traktateve më të rëndësishme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave: Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (ang. CEDAW) dhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës shtëpiake (Konventa e Stambollit).<sup>[7]</sup> Konventa e Stambollit është dokumenti i parë ndërkombëtar ligjërishit detyruar me rëndësi në kontekstin e dhunës së përhapur kundër grave dhe dhunës shtëpiake të pranishme në të gjitha vendet e rajonit që rrjedh nga njëanshmëria dhe stereotipet gjinore si dhe nga diskriminimi kundër grave në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor. Me ratifikimin e kësaj Konvente, këto vende kanë marrë përsipër detyrimin për të harmonizuar legjislacionin e tyre në përputhje me dispozitat e saj me qëllim që të lehtësojnë parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna kundër grave dhe dhuna shtëpiake. Megjithatë, nuk mjafton thjesht harmonizimi i kornizave ligjore vendase me standardet ligjore ndërkombëtare dhe ato evropiane, në qoftë se ato standarde ndërkombëtare nuk zbatohen saktë ose në masë të mjaftueshme në nivel vendi. Në kontekstin e luftës kundër pabarazisë gjinore në rajon, është thelbësore që çdo pjesë e shoqërisë të vetëdijesohet për aspektin gjinor dhe që gjykatat të fillojnë të marrin vendime që janë më të ndjeshme ndaj aspektit gjinor.

Është e qartë se në realitet gratë nuk gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mbrojtje që gëzojnë në ligj. Në thelb të adresimit të dhunës kundër grave dhe të promovimit të barazisë qëndron nevoja për të goditur njëanshmëritë e thella gjinore në sistemet gjyqësore të rajonit në mënyrë që grave t'u mundësohet realizimi i efektiv i të drejtave dhe mbrojtjeve që u takojnë me ligj. Pasojat e stereotipeve dhe njëanshmërive gjinore në sistemin gjyqësor i prekin të gjithë, prej profesionistëve ligjorë e deri tek gratë dhe burrat që përpiqen të ushtrojnë të drejtat e tyre me anë të gjykatave. Impakti i kësaj njëanshmërie shihet në dy mënyra të dallueshme.

Shënimi i Ditës së të Drejtave të Njeriut në Malin e Zi", Këshilli i Evropës, 10 dhjetor 2021.

- [7] CEDAW është ratifikuar nga Shqipëria (1994), Bosnje dhe Hercegovina (1993), Kroacia (1992), Serbia (2001), Maqedonia e Veriut (1994) dhe Mali i Zi (2006), mund të gjendet tek: [https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=IV8&chapter=4&lang=en](https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=IV8&chapter=4&lang=en); Konventa e Stambollit është ratifikuar nga Shqipëria (2013), Bosnje dhe Hercegovina (2013), Kroacia (2018), Serbia (2013), Maqedonia e Veriut (2018) dhe Mali i Zi (2014), mund të gjendet tek: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures>. Për shkak të statusit të saj sipas rezolutës 1244 të OKB-së, Kosova nuk i ka ratifikuar këto Konventa, por neni 22 i Kushtetutës së saj e rendit CEDAW në mesin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që janë direkt të zbatueshme në Kosovë. Mund të gjendet tek: <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>.

Së pari, njëanshmëria është e artikuluar në përbërjen e gjyqësorit, në numrin e gjyqtarëve e gjyqtareve, stafi gjyqësor, ndihmësgjyqtarët/et etj., si dhe në numrin e grave që mbajnë pozita të larta drejtuese. Faktikisht, në shumë gjyqësorë të Ballkanit Perëndimor, gratë përbëjnë shumicën e gjyqtarëve/eve, dhe numri i grave në gjyqësor, sidomos në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, është rritur pothuaj në të gjitha shtetet e rajonit në 20 vitet e fundit. Shumica e gjyqtarëve/eve janë gra në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Kroaci, dhe shumica e gjyqtarëve/eve të Gjykatës Supreme janë gra në Bosnje dhe Hercegovinë, në Mal të Zi dhe në Serbi.<sup>[8]</sup>

Megjithatë, goditja e problemeve rreth gjinisë dhe sistemit gjyqësor, arritja e barazisë për gratë dhe dhënia fund njëanshmërisë gjinore duhet të shkojë përtej çështjeve të thjeshta të përfaqësimit. Studimet tregojnë se vetëm përfaqësimi i shtuar femëror brenda vendit nuk e ka përmirësuar shumë barazinë gjinore në sistemin gjyqësor. Stereotipet dhe njëanshmëritë gjinore vazhdojnë të ndikojnë në vendimet e gjykatave, diku më shumë e diku më pak, e rrjedhimisht edhe në mbrojtjen e të drejtave të grave, pavarësisht nga gjinia e gjyqtarit apo gjyqtares.

Impakti i dytë kyç i të menduarit gjyqësor të njëanshëm është rreziku i konsiderueshëm i stereotipeve dhe njëanshmërive gjinore që ndikojnë në vendimeve e gjykatave. Gjyqtarët/et, prokurorët/et, avokatët/et, ekspertët/et e

[8] Shih: <http://www.instat.gok.al/media/7376/burra-dhe-gra-2020.pdf>, "Gratë dhe burrat në Shqipëri 2020", INSTAT, 2020; Shih [https://arsbih.gok.ba/wp-content/uploads/2020/02/Muškarci-i-žene-u-BIH\\_2020.pdf](https://arsbih.gok.ba/wp-content/uploads/2020/02/Muškarci-i-žene-u-BIH_2020.pdf), "Burrat dhe gratë në Bosnje dhe Hercegovinë", Buletini Tematik Nr. 3 i Agjencisë së Statistikave të Bosnje dhe Hercegovinës, Sarajevë, 2020; Shih [https://www.monstat.org/uploads/files/publikacije/Žene\\_i\\_muškarc\\_i\\_u\\_Crnoj\\_Gori.pdf](https://www.monstat.org/uploads/files/publikacije/Žene_i_muškarc_i_u_Crnoj_Gori.pdf), "Burrat dhe gratë në Mal të Zi", Zyra e Statistikave e Malit të Zi, Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave e Malit të Zi, Podgoricë, 2020, f. 64; Shih [https://www.unece.org/fileadmin/DAM/Gender/Beijing\\_20/Republic\\_of\\_North\\_Macedonia.pdf](https://www.unece.org/fileadmin/DAM/Gender/Beijing_20/Republic_of_North_Macedonia.pdf), Raporti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi zbatimin e Deklaratës së Pekingut dhe Platforma e Veprimit (1995) dhe rezultatet e sesionit të dytë special të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (2000) – Beijing +25", Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, prill 2019; Shih <https://www.stat.gok.rs/en-us/oblasti/stanovnistvo/statistika-polova/>, "Burrat dhe gratë në Republikën e Serbisë 2020", Zyra e Statistikave r Republikës së Serbisë, Beograd, 2021; Shih [https://www.dzs.hr/eng/publication/men\\_and\\_women.htm](https://www.dzs.hr/eng/publication/men_and_women.htm), "Burrat dhe gratë në Kroaci 2020", Zyra e Statistikave e Republikës së Kroacisë, Zagreb, 2020; Shih <https://rm.coe.int/comparative-assessment/1680939684>, "Shikim krahasues i sistemit gjyqësor në Kosovë nga viti 2014 në vitin 2017: bazuar mbi metodologjinë e Komisionit Evropian për Drejtësi Efektive për vlerësimin e sistemeve gjyqësore", Këshilli i Evropës, shkurt 2019.

gjykatave dhe pjesëmarrës/e të tjerë/a në procedurat gjyqësore kanë njëanshmëri dhe stereotipe gjinore për të cilat mbase nuk janë të vetëdijshëm/shme. Njëanshmëria gjinore mund të ndikojë tek mënyra se si prezantohen çështjet, si vendosin gjyqtarët/et rreth tyre, e madje edhe faktin nëse çështjet eventualisht përfundojnë në gjykatë ose jo. Për shembull, në çështje të dhunës së bazuar në gjini, stereotipizimi mund të komprometojë paanshmërinë e vendimeve të gjyqtarëve; të ndikojë të kuptuarit e tyre të natyrës së veprës penale; të ndikojë në pikëpamjet e tyre rreth besueshmërisë së kapacitetit ligjor të dëshmitarëve; dhe të pengojë gjyqtarët nga shpallja ligjërishit fajtor e përgjegjësve. Po ashtu, ato mund të ndikojnë tek mënyra se si gratë merren në pyetje dhe trajtohen në gjykata si nga gjyqtarët ashtu edhe nga avokatët.<sup>[9]</sup> Më gjerësisht, stereotipet gjinore cenojnë direkt mbrojtjen ligjore të grave dhe qasjen e tyre në drejtësi, duke bërë që ato të përpiqen më pak që të realizojnë të drejtat e tyre ose të bëjnë ankesa në gjykatë si pasojë e mungesës së besimit që sistemi mund të japë rezultate efektive ose për shkak të frikës së trajtimit që do t'u bëhet gjatë procedurave. Në qoftë se këto paragjykime reduktohen dhe hiqen, sistemet gjyqësore të rajonit kanë potencialin për t'u bërë më efektive, demokratike dhe të drejta.

Krahas luftimit të paragjykimeve dhe stereotipeve gjinore në gjyqësor, është gjithashtu e nevojshme që gjyqtarët dhe ushtruesit e profesionit ligjor në rajon të kuptojnë dhe të zbatojnë gjerësisht mbrojtjet ligjore ndërkombëtare përkatëse në lidhje me të drejtat e grave, përfshirë CEDAW, Konventën e Stambollit, dhe KEDNj-në. Barazia gjinore ka të bëjë me pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës publike dhe private. Kjo ka rëndësi të barabartë për realizimin e shtetit të së drejtës i cili ka të bëjë me pjesëmarrjen në proceset vendim-marrëse, përfshirë miratimin e ligjeve, nga të gjitha grupet e qytetarëve/eve, si grupet shumicë ashtu edhe ato pakicë. Megjithatë, gratë tradicionalisht janë parë si grup politikisht jo-dominues dhe ekonomikisht inferior, pavarësisht nga fakti se në shumë shoqëri ato janë numerikisht grup më i madh. Dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare të lartcekura dhe jurisprudenca e GjEDNj-së e zbatojnë këtë parim dhe caktojnë detyrime tek shtetet e rajonit, jo vetëm për të mbrojtur gratë nga abuzimi dhe diskriminimi, por edhe për t'u mundësuar grave

[9] Simone Cusack, "Eliminimi i stereotipeve gjyqësore: Qasja e barabartë në drejtësi për gratë në rastet e dhunës së bazuar në gjini", dokumenti final dorëzuar në Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, 9 qershor 2014; Lynn Hecht Schafran, "Besueshmëria në gjykata: Përse ekziston hendeku gjinor", Gazeta e Gjyqtarëve, vol. 34, dimër 1995; Majda Halilović, Callum Watson, Heather Huhtanen dhe Mylene Socquet Juglard (red.), "Njëanshmëria gjinore dhe e drejta: Kornizat dhe praktikatat ligjore nga Bosnje dhe Hercegovina e përtej", AI / DCAF, Sarajevë, 2017.



që të jetojnë jetën e tyre me maksimumin e potencialit të tyre, duke garantuar dinjitet, drejtësi, përfaqësim dhe përfshirje të grave në të gjitha aspektet e jetës së tyre.

Ka ardhur koha që rajoni vërtet ta adresojë barazinë gjinore në mënyrë gjithëpërfshirëse, të luftojë seksizmin, dhunën dhe diskriminimin në mënyrë efektive, dhe të ndërmarrë hapa të domosdoshëm drejt ngritjes së vetëdijes që kërkohet. Prandaj, shpresohet se ky Udhërrëfyes do të shërbejë si mjet i dobishëm për gjyqtarët, ushtruesit e profesionit ligjor dhe OJQ-të në rajon që punojnë me çështje të lidhura me barazinë dhe diskriminimin gjinor, e gjithashtu si shtytës për hapjen e dialogut dhe nxitjen e veprimeve shumë të nevojshme në rajon për luftimin e njëanshmërisë gjinore në gjyqësor dhe përtej tij.

**Ivana Jelić**

Gjyqtare e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

## Tabela e shkurtesave

Shkurtesa (ang.)	Përkufizimi
CEDAW	Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
CJEU / GjDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
CoE / KE	Këshilli i Evropës
ECAT	Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
ECSR	Komisioni Evropian i të Drejtave Sociale
ESC	Karta Sociale Evropiane
EU / BE	Bashkimi Evropian
EU Charter / Karta e BE-së	Karta e BE-së për të Drejtat Themelore
Directive / Direktiva 2011/36/EU	Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij
GBV	Dhuna e bazuar në gjini
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës Shtëpiake – organ i pavarur ekspert përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit
OSCE / OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
State / Member State / Shtet / Shtet Anëtar	Shtetet Kontraktuese Palë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
TEU	Traktati mbi Bashkimin Evropian
TFEU	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian

Shkurtesa (ang.)	Përkufizimi
The Convention / ECHR Konventa / KEDNj	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj)
The Court / ECtHR	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj)
The Gender Equality Directive (recast)	Direktiva 2006/54/EC (e rishikuar)
The Istanbul Convention / Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës Shtëpiake. Ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2014.

### **Shënime për citimet, shënimet në fund të faqeve dhe përmbledhjeve të çështjeve**

Për çështjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, referencat përfshijnë emrin me shkronja të pjerrëta, datën e vendimit gjyqësor, dhe numrin e kërkesës. Gjithashtu tregohet se cilat çështje që përmenden në tekst janë të përmbledhura në Pjesën 2 të këtij Udhërrëfyesi.

### **Referencat ndaj neneve dhe protokolleve**

Të gjitha referencat për nene dhe protokolle bëjnë fjalë për nenet dhe Protokollin e KEDNj-së, përveç rasteve kur sqarohet ndryshe.

# Hyrje

Kur bëhet fjalë për diskriminimin mbi bazën e seksit, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se avancimi i barazisë gjinore sot është objektiv madhor i Shteteve të Këshillit të Evropës, dhe se, në parim, do të duhet të kishte “arsye me shumë peshë” para se dallimet në trajtim mbi bazën e seksit të konsideroheshin në pajtueshmëri me Konventën.<sup>[10]</sup>

Jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me diskriminimin gjinor, e cila mbështetet mbi një sërë instrumentesh ligjore krahas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është burim thelbësor i frymës dhe teorisë gjyqësore bashkohore për sa i përket çështjes së barazisë gjinore. Vendimet e Gjykatës vitet e fundit kanë treguar se barazia gjinore është fushë në zhvillim e sipër, për sa kohë që opinioni publik në shoqëritë e Shteteve anëtare rreth rolit të grave – në shtëpi, në punë, në jetën publike – vazhdon të zhvillohet. Për më tepër, jurisprudenca e Gjykatës paraqet një qasje elegante ndaj një çështjeje që është mjaft komplekse, ka shumë aspekte, dhe po zhvillohet me shpejtësi. Për shembull, në disa raste Gjykata e ka vlerësuar të përshtatshme të lejojë dallime në trajtim mbi bazën e seksit me qëllim të korigjimit të pabarazive historike – një qasje proaktive për të realizuar barazinë. Po kështu, në disa raste të tjera Gjykata ka njohur se barazia gjinore është e dyanshme dhe mund të prekë edhe burrat po aq sa edhe gratë.

## a) Rreth këtij Udhërrëfyese

Pjesa I e këtij Udhërrëfyese paraqet një sintezë të përgjithshme të jurisprudencës së Gjykatës në lidhje me çështjen e barazisë gjinore dhe diskriminimin mbi bazën e seksit.

Sinteza është e ndarë sipas tematikave, përfshirë diskriminimin mbi bazën e seksit në lidhje me: dhunën e bazuar në gjini, respektin për jetën private dhe familjare, punësimin, gratë rome, refugjatet dhe azilkërkuet etj. Gjithashtu Udhërrëfyese mbulon çështje të stereotipeve gjinore në vendimet gjyqësore dhe diskriminimin gjatë procedurave gjyqësore. Në lidhje me këtë, Robert Spano, Kryetari aktual i Gjykatës, ka folur rreth nevojës për diversitet në përbërjen e

---

[10] *Konstantin Markin k. Rusisë*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 22 marsit 2012, nr. 30078/06, §127 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 majit 1985, nr. 9474/8, §78.

trupës gjyqësore, si në vetë Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ashtu edhe në gjykatat vendore në Shtetet anëtare:

*"Diversiteti në trupën gjyqësore është i rëndësishëm për tri arsye kryesore: për të siguruar legjitimitetin e gjyqësorit në sytë e publikut, dhe veçanërisht besimin e kërkuesve tanë / kërkueseve tona; për të përmirësuar cilësinë e vendimeve me anë të përfitimeve nga një gamë më e gjerë e këndvështrimeve gjyqësore që vjen prej një grupimi sa më të gjerë të talenteve, dhe, në fund, për të garantuar që gjyqtarët/et të zgjidhen përmes proceseve të drejta të përzgjedhjes, të cilat nuk e vënë asnjë grup demografik në avantazh ose dizavantazh."*<sup>[11]</sup>

Aty ku është me vend, Udhërrëfytes po ashtu prek çështje të ndërlidhura me diskriminimin, siç janë aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, përkatësia etnike, dhe të drejtat transgjimore, por vetëm deri aty ku këto çështje ndërthuren me diskriminimin kundër grave. Kjo pasqyron natyrën e ndërthurur të diskriminimit, ku manifestimet e ndryshme të trajtimit të pabarabartë që i bëhet një personi janë të ndërlidhura për shkak të mbivendosjes së ndërsjellë mes tyre. Autorët/et e këtij Udhërrëfytes e njohin faktin se adresimi i diskriminimit nga perspektiva e një 'baze' të vetme (siç është gjinia, orientimi seksual etj.) shpesh nuk arrin të mbulojë ose të shtjellojë sa duhet manifestimet e ndryshme të trajtimit të pabarabartë me të cilin mund të përballen njerëzit në jetën e përditshme. Megjithatë, një analizë dhe diskutim i plotë rreth këtyre aspekteve të tjera të jurisprudencës së Gjykatës, siç janë të drejtat transgjimore për shembull, është përtej fushëveprimit të këtij Udhërrëfytes.<sup>[12]</sup>

Pjesa I e këtij Udhërrëfytes po ashtu përfshin një shikim të përgjithshëm mbi impaktin e pandemisë Covid-19 tek të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor,

[11] Shih [https://www.echr.coe.int/Documents/Speech\\_20210604\\_Spano\\_Seminar\\_Gender\\_Equality\\_Baden\\_Baden\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Speech_20210604_Spano_Seminar_Gender_Equality_Baden_Baden_ENG.pdf) "Seminar on Gender Equality in the Western Balkans: The Principle of Non-Discrimination on the Grounds of Sex in the Court's Case-Law", Speech by Robert Spano, Seminari i Qendrës AIRE për Barazinë Gjimore në Ballkanin Perëndimor, 4 qershor 2021.

[12] Vini re se qëllimi i Udhërrëfytes, dhe i programit të Qendrës AIRE 'Aspekti Gjitor dhe Gjyqësori' në tërësi, është që të ndihmojë gjyqësorët rajonalë për të promovuar dhe avancuar barazinë e vërtetë. Në qoftë se hisedarët (ang. stakeholders) mendojnë se një publikim i mëtejshëm i cili do të fokusohet më thellë në çështjet e përjashtuara nga ky Udhërrëfytes do të ishte burim i dobishë, Qendra AIRE do ta merrte në konsideratë me kënaqësi një gjë të tillë dhe do t'i diskutonte çështjet më tej.

megjithëse edhe kjo është çështje në zhvillim e sipër dhe është çështje të cilën deri tani Gjykata e marrë në konsideratë të veçantë në masë të kufizuar.

Pjesa II e këtij Udhërrëfyese përmbledh një numër çështjesh kyçe nga jurisprudenca e Gjykatës në aspektin e diskriminimit gjinor, të cilat përmenden në diskutimet e Pjesës I.

Shpresohet që sinteza dhe përmbledhjet e çështjeve në këtë Udhërrëfyese do të jenë të dobishme për anëtarët/et e gjyqësorit dhe politikëbërësit/et në rajon, kur trajtojnë çështje ose vendime në lidhje me politikatat e lidhura me diskriminimin gjinor.

## b) Terminologjia

Gjykata ka mëtuar të përdorë termat 'gjini' dhe 'seks' në mënyrë të këmbyeshme. Për shembull, ndërkohë që neni 14 i Konventës e ndalon diskriminimin mbi bazën e seksit, Gjykata ka folur për 'avancimin e barazisë gjinore' si një prej objektivave kyçe të Shteteve anëtare.<sup>[13]</sup> Rrjedhimisht, për qëllime të këtij Udhërrëfyese, këto terma duhet të konsiderohen të këmbyeshme.

Termi 'barazi gjinore' është marrë në konsideratë në të kaluarën nga KE. Për shembull, KE ka kërkuar marrjen e veprimeve të veçanta në fusha të tilla si: gjuha dhe komunikimet; interneti dhe mediat sociale; shtypi/media, reklammat dhe metodat e tjera të komunikimit; vendi i punës; sektori publik; sektori i drejtësisë; institucionet arsimore; kultura dhe sporti; dhe sfera private. Ai i ka inkurajuar Shtetet anëtare që të miratojnë ligje që dënojnë seksizmin dhe që penalizojnë gjuhën e urrejtjes seksiste. Gjithashtu, ai u ka kërkuar vendeve që të monitorojnë zbatimin e politikave anti-seksiste në nivel kombëtar dhe të raportojnë në KE në baza periodike.<sup>[14]</sup>

Këtij koncepti të barazisë gjinore mund t'i shërbejë nëse i shtohet koncepti 'katër-dimensional' i barazisë substanciale që është shtjelluar nga akademikja Sandra Fredman. Korniza përmban katër elemente të dallueshme për të arritur barazinë substanciale: (i) dimensionin distributiv, që mëton të zgjidhë një dizavantazh ndaj

[13] *Konstantin Markin k. Rusisë*, Vendimi i Dhomës së Madhe i 22 marsit 2012, nr. 30078/06, §127 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[14] Shih <https://rm.coe.int/cm-rec-2019-1-on-preventing-and-combating-sexism/168094d894> "Parandalimi dhe Luftimi i Seksizmit", Rekomandimi CM/Rec(2019)1, Këshilli i Evropës, miratuar më 27 mars 2019.

një grupi të caktuar, siç janë gratë; (ii) dimensiononi i njohjes, që adreson stigmën, stereotipet, paragjykimet, dhe dhunën kundër një grupi të caktuar; (iii) dimensiononi pjesëmarrës, që mëton të lehtësojë zërin dhe pjesëmarrjen e një grupi të caktuar; dhe (iv) dimensiononi transformativ, që mëton të rehatojë dallimet e një grupi të caktuar, përfshirë me anë të ndryshimeve strukturore.<sup>[15]</sup>

Secili prej këtyre elementeve shfaqet deri diku në praktikën gjyqësore që diskutohet në këtë Udhërrëfyes.

---

[15] Sandra Fredman, "Dalja nga hija në dritë: Barazia substanciale dhe neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", *Revista Ligjore e të Drejtave të Njeriut*, Vëllimi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 273-301.

# Pjesa I – Shikim i përgjithshëm i standardeve legjislative dhe jurisprudencës përkatëse të KEDNj-së

## (1) Standardet legjislative

Jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me diskriminimin kryesisht është e bazuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Protokollet e saj dhe në instrumente të tjera ligjore të KE-së. Megjithatë, jurisprudenca e Gjykatës gjithashtu merr parasysh aspekte të ligjeve të Bashkimit Evropian dhe instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare. Këtu jepet një përmbledhje e disa instrumenteve relevante kyçe, dhe eksplorohehen disa prej koncepteve kyçe të të drejtës së mos-diskriminimit, siç është diskriminimi direkt dhe ai indirekt.

### a) Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Ka disa mekanizma ligjore kyçe të miratuara nga KE në lidhje me mos-diskriminimin, prej të cilave kryesorja është KEDNj.<sup>[16]</sup>

#### **Neni 14, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut**

Neni 14 i Konventës, cili e ndalon diskriminimin, thotë:

*“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

[16] Në përgjithësi, sipas KEDNj-së, mbrojtja u garantohet të gjithë/a atyre brenda juridiksionit të një Shteti anëtar, pavarësisht a janë shtetas/e a jo, e madje edhe përtej territorit natyral të zonave nën kontrollin efektiv të një shteti (siç janë territoret e pushtuara). Megjithatë, jurisprudenca e KEDNj-së tregon se një shtet mund të konsiderojë se shtetasit/et dhe jo-shtetasit/et janë në pozita të ndryshme, e rrjedhimisht mund t'i trajtojë ndryshe në rrethana të caktuara.



Lista e bazave të ndaluara të diskriminimit në nenin 14 nuk është shteruese: ndërkohë që ajo nuk përjashton në mënyrë eksplicite baza të tjera relevante si orientimi seksual, aftësitë e kufizuara dhe moshja, këto janë vlerësuar nga Gjykata se hyjnë brenda tekstit "statuse të tjera" të nenit. Rrjedhimisht, Gjykata është e lirë që t'i shtojë në listën e bazave të ndaluara.

Neni 14 i KEDNJ-së vetëm e ndalon diskriminimin dhe garanton barazinë 'në gëzimin e ... [të] drejtave dhe lirive' të cekura në Konventë. Rrjedhimisht, Gjykata është kompetente vetëm për shqyrtimin e ankesave për diskriminim sipas nenit 14 kur ato hyjnë në kuadër të njëres prej të drejtave të tjera që mbrohen nga Konventa, pra neni 14 nuk ekziston i pavarur. Në praktikë kjo do të thotë se Gjykata shqyrton një kërkesë sipas nenit 14 vetëm në lidhje me një dispozitë tjetër substanciale të Konventës ose kur ai angazhohet përmes një dispozite tjetër.<sup>[17]</sup>

Megjithatë, zbatimi i nenit 14 nuk prezupozon shkelje të një ose disa neneve të tjera të Konventës. Në mënyrë që të aplikohet neni 14 në një çështje të dhënë, mjafton që faktet e çështjes të hyjnë brenda kuadrit të një dispozite tjetër substanciale të Konventës ose Protokolleve të saj.<sup>[18]</sup> Parimi i kuadrit lejon një aplikim më të gjerë të nenit 14 duke i liruar kërkuarit/et nga detyrimi për të vërtetuar një shkeljen e një të drejte tjetër. Kjo do të thotë se një masë e cila në vetvete është konform kritereve të nenit që ngërthen të drejtën ose lirinë në fjalë prapë se prapë mund ta shkelë po atë nen kur lexohet në lidhje me nenin 14, sepse është e natyrës diskriminuese.

Ndalimi i diskriminimit i ngërthyer në nenin 14 gjithashtu i zbatohet gëzimit të të drejtave të cilat Shteti vendos vullnetarisht që t'i ofrojë, përtej fushëveprimit të detyrimeve të tij sipas Konventës, për sa kohë që këto të drejta hyjnë brenda fushëveprimit të përgjithshëm të një neni të Konventës.<sup>[19]</sup>

[17] *Marckx k. Belgjikës*, vendimi i 13 qershorit 1978, nr. 6833/74, § 32.

[18] Kjo u konstatua në *Çështjen Gjuhësore Belge (Nr. 2)*, vendimi i 23 korrikut 1968, nr. 2126/64, dhe u konfirmua në *Thlimmenos k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, nr. 34369/97. Shih gjithashtu *Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, nr. 31871/96.

[19] *E.B. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 janarit 2008, nr. 43546/02, ku Gjykata gjeti se, ndërkohë që nuk ekzistonte e drejta substanciale që një person të adoptonte një fëmijë sipas nenit 8, legjislacioni vendas francez shprehimisht u lejoi beqarëve/eve të drejtën për të aplikuar për autorizim për adoptim. Kjo e drejtë u vendos se hynte gjerësisht brenda kuadrit të nenit 8. Rrjedhimisht, Shteti, i cili kishte shkuar përtej detyrimeve të tij sipas nenit 8 duke krijuar një të drejtë të tillë, nuk mundej, gjatë zbatimit të asaj të drejte, të merrte masa diskriminuese brenda

Në praktikë, kërkuesit/et shpesh pretendojnë shkelje të një të drejte substanciale, dhe përveç kësaj, shkelje të një të drejte substanciale në lidhje me nenin 14. Megjithatë, kur Gjykata gjen shkelje të të drejtës substanciale, jo gjithmonë vazhdon më tej me shqyrtimin e ankesës për diskriminim, për shembull kur konsideron se një gjë e tillë në thelb do të përfshinte shqyrtimin e të njëjtës ankesë.<sup>[20]</sup> Pra, niveli i jurisprudencës në lidhje me mos-diskriminimin sipas nenit 14 është pak a shumë i kufizuar në krahasim me fusha të tjera të jurisprudencës së Gjykatës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se diskriminimi nuk është çështje e rëndësishme për Gjykatën.<sup>[21]</sup>

Sa herë që një kërkues/e ngre një pretendim sipas nenit 14 për diskriminim në kontekstin e një shkeljeje të pretenduar të një të drejte tjetër substanciale, Gjykata *mund* ta marrë në konsideratë ankesën, në qoftë se diskriminimi i pretenduar hyn brenda njëres prej bazave të diskriminimit të cekura në nenin 14 (seksi, raca, gjuha e kështu me radhë). Kjo përbën një dallim domethënës nga e drejta e Bashkimit Evropian e mos-diskriminimit (shih seksionin 1(e) (ligjet e BE-së) të Udhërrëfyesit), sepse KEDNJ ofron mbrojtje nga diskriminimi në lidhje me çështje të cilat e drejta e mos-diskriminimit e BE-së nuk i rregullon.

---

kuptimit të nenit 14. Shih gjithashtu *Khamtokhu dhe Aksenchik k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, nr. 60367/08 961/11, §58 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku kërkuesit nuk pretenduan shkelje të së drejtës së tyre për liri sipas nenit 5 mbi bazën e dënimit me burg të përjetshëm që iu dha atyre. Përkundrazi, ata u ankuar se ishin trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa gratë e dënuara për krime të ngjashme ose të krahasueshme, në shkelje të nenit 14 i marrë në lidhje me nenin 5 të Konventës. Gjykata përsëriti se çështjet e dënimit të përshtatshëm në parim bien jashtë fushëveprimit të Konventës dhe se neni 5 § 1 (a) i Konventës nuk garanton të drejtën automatike të lirit me kusht. Megjithatë, Gjykata njohu se masat në lidhje me ekzekutimin ose ndryshimin e një dënimi ndikojnë tek e drejta e lirisë sipas nenit 5 § 1 dhe se mund të ngrihet një çështje sipas asaj dispozite e marrë së bashku me nenin 14 në qoftë se një politikë e dënimeve ndikon tek individët në mënyrë diskriminuese. Ishte e mjaftueshme që ligjet vendase për dënimet të hynin "*brenda kuadrin*" të nenit 5 në mënyrë që të aplikohet neni 14 në lidhje me atë dispozitë.

[20] Shih për shembull *J.L. k. Italisë*, vendimi i 27 majit 2021, nr. 5671/16 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[21] Gjyqtarja e GjEDNJ-së Siofra O'Leary theksoi, në fjalën e saj të mbajtur në Seminarin e Qendrës AIRE për barazinë gjinore në Ballkanin Perëndimor më 4 qershor 2021, se rezultati i qasjes së Gjykatës është "humbja e mundësive për të zhvilluar dhe konsoliduar praktika gjyqësore koherente sipas nenit 14 në lidhje me forma të caktuara të diskriminimit ose në lloje të caktuara çështjesh ku njëanshmëria dhe stereotipet gjinore mund të jenë në rrënjë të ankesave të shqyrtuara sipas dispozitave substanciale".

## **Protokolli 12, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut**

Protokolli 12, neni 1 thotë:

*“Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.*

*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

Protokolli Nr. 12 i KEDNJ-së, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2005, e ndalon diskriminimin në lidhje me ‘gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj’ dhe ‘nga një autoritet publik’. Pra është më i gjerë në fushëveprim sesa neni 14, i cili e ndalon diskriminimin vetëm në lidhje me të drejtat e garantuara nga vetë KEDNJ-ja.

Pas ratifikimit të Protokollit 12 nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, kërkuesit/et në rajon tani mund të ankohen pranë GjEDNJ-së dhe të kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi në lidhje me secilën të drejtë të garantuar nga e drejta vendase/kombëtare dhe në lidhje me secilin veprim nga cilido autoritet publik.<sup>[22]</sup>

Komentari në Raportin Shpjegues të Protokollit Nr. 12 thotë se neni 1 i Protokollit Nr. 12 ka të bëjë me diskriminimin:

- » në gëzimin e çdo të drejte dhënë veçanërisht një individ sipas të drejtës kombëtare;
- » në gëzimin e një të drejte e cila mund të nxirret nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas të drejtës kombëtare, pra kur një autoritet publik ka detyrimin sipas të drejtës kombëtare për t’u sjellë në një mënyrë të caktuar;

---

[22] Protokolli 12 është ratifikuar nga Shqipëria (2004), Bosnje dhe Hercegovina (2003), Kroacia (2003), Mali i Zi (2004), Maqedonia e Veriut (2004) dhe Serbia (2004). Mungesat që vlen të përmenden janë Mbretëria e Bashkuar dhe Franca të cilat nuk e kanë firmosur Protokollin, dhe Gjermania e cila e ka firmosur Protokollin por nuk e ka ratifikuar. Shih në vegzë listën e plotë të firmosjeve/ratifikimeve: <https://www.coe.int/en/web/conventions/acts-number/-/abridged-title-knoën?module=signatures-by-treaty&treatynum=177>

- » nga një autoritet publik gjatë ushtrimit të fuqisë së diskrecionit (për shembull, dhënia e subvencioneve të caktuara); dhe
- » nga çdo veprim ose mosveprim tjetër nga një autoritet publik (për shembull, sjellja e zyrtarëve ligjzbatues gjatë kontrollimit të një trazire).<sup>[23]</sup>

Raporti Shpjegues i Protokollit Nr. 12 gjithashtu deklaron se Protokollin zbatohet në marrëdhëniet mes personave privatë, kur këto normalisht do të rregulloheshin nga shteti.<sup>[24]</sup>

Gjykata ka konfirmuar se Neni 1 i Protokollit Nr. 12 fut një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit dhe një të drejtë “vetqëndruese” për të mos u diskriminuar,<sup>[25]</sup> dhe se Neni 1 i Protokollit Nr. 12 e shtrin fushëveprimin e mbrojtjes jo vetëm duke mbuluar “çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”, por edhe përtej saj. Kjo rrjedh nga paragrafi 2 i Nenit 1 të Protokollit Nr. 12, i cili parashikon që askush nuk mund të diskriminohet nga një autoritet publik.<sup>[26]</sup>

Për të vendosur nëse Neni 1 i Protokollit Nr. 12 është i aplikueshëm, së pari është e nevojshme të përcaktohet nëse ankesa hyn brenda njëres prej katër kategorive të përmendura në Raportin Shpjegues, të cilat janë renditur më lart.<sup>[27]</sup>

Bazat e ndaluara të diskriminimit sipas Protokollit 12 janë identike me ato të nenit 14. Ngjashëm, ndërkohë që lista nuk përfshin shprehimisht baza relevante siç janë orientimi seksual, aftësia e kufizuar, mosha, këto hyjnë brenda tekstit të Protokollit “statute të tjera”.

[23] Shih <https://rm.coe.int/09000016800cce48#:~:text=I.-,The%20Protocol%20No.11>. “Raporti Shpjegues i Protokollit Nr. 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”, Seria e Traktateve Evropiane Nr. 177. paragrafi 22.

[24] Shih [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf) “Doracaku i të Drejtës Evropiane të Mos-Diskriminimit”, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshill i Evropës, 2018, f. 34. Doracaku përmbledh funksionet e tërësishme të Protokollit 12 si vijon: “Në terma të gjera, Protokollin Nr. 12 ndalon diskriminimin jashtë konteksteve thjesht personale, ku individët ushtrojnë funksione që i vënë ata/ato në pozitë për të vendosur se si ofrohen mallrat dhe shërbimet publike”.

[25] *Sejdić dhe Finci k. Bosnje dhe Hercegovinës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 dhjetorit 2009, nr. 27996/06 dhe 34836/06, §53.

[26] *Savez crkava “Riječ života” dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendimi i 9 dhjetorit 2010, nr. 7798/08, §104.

[27] *Savez crkava “Riječ života” dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendimi i 9 dhjetorit 2010, nr. 7798/08, §104-105.

## b) Parimet kyçe të së drejtës së mos-diskriminimit sipas KEDNj-së

### **Diskriminimi direkt kundrejt atij indirekt**

Qasja e Gjykatës ndaj të drejtës së mos-diskriminimit ka parasysh dy lloje të diskriminimit: 'diskriminimin direkt' dhe 'diskriminimin indirekt'. Me gjithatë, neni 14 i KEDNj-së nuk jep një përkufizim eksplisit të asaj se çka përbën diskriminim direkt ose indirekt.

Diskriminimi 'direkt' ndodh kur:

- i) një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme;
- ii) në krahasim me të tjerët, të cilët janë në situatë të ngjashme, janë trajtuar ose do të trajtoheshin; dhe
- iii) arsyeja për këtë është një karakteristikë e caktuar që ka personi, gjë që hyn brenda një 'baze të mbrojtur'.

Konventa kërkon që duhet të ketë 'dallim në trajtimin e personave në situata analoge, ose përkatësisht të ngjashme', 'mbi bazën e një karakteristike të identifikueshme', në mënyrë që të ekzistojë diskriminimi direkt.<sup>[28]</sup> Një kërkues/e gjithashtu duhet të tregojë se ai/ajo është 'prekur direkt' nga masa në mënyrë që të paraqesë një kërkesë.<sup>[29]</sup>

Përkundrazi, diskriminimi 'indirekt' ndodh kur:

- i) ekziston një rregull, kriter ose praktikë në dukje neutrale; dhe
- ii) ka efekt paragjykses joproporcional tek një grup si rezultat i një karakteristike të caktuar.<sup>[30]</sup>

[28] *Biao k. Danimarkës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 majit 2016, nr. 38590/10, § 89; ngjashëm, *Carson dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 marsit 2010, nr. 42184/05, § 61; *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 13 nëntorit 2007, nr. 57325/00, § 175; *Burden k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 29 prillit 2008, nr. 13378/05, § 60.

[29] Këshilli i Evropës dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, "Udhërrëfyes Praktik mbi Kriteret e Pranueshmërisë", 2014, fq. 11.

[30] *Biao k. Danimarkës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 majit 2016, nr. 38590/10, § 103; *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 13 nëntorit 2007, nr. 57325/00, § 184.

Në këtë rast nuk është trajtimi ai që dallon por efektet e trajtimit, të cilat përjetohen ndryshe nga njerëz me karakteristika të ndryshme.

Diskriminimi indirekt në shkelje të nenit 14 gjithashtu mund të ndodhë kur Shtetet dështojnë të trajtojnë ndryshe persona situatat e të cilëve/ave janë të ndryshme në masë të konsiderueshme *pa ofruar asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*.<sup>[31]</sup> Trajtimit i mungon një justifikim i tillë në qoftë se ai nuk 'synon një qëllim legjitim'.<sup>[32]</sup>

Për shembull, një grua mund të përjashtohet nga punësimi qoftë për shkak se punëdhënësi nuk dëshiron të punësojë gra (diskriminim direkt), qoftë për shkak se kriteret e vendit të punës janë formuluar në mënyrë të atillë që shumica e grave nuk do të ishin në gjendje t'i përmbushnin (diskriminim indirekt).

### **Zhvendosja e barrës së provës**

Një tipar kyç i padive të diskriminimit para Gjykatës është barra e provës: procedurat e Gjykatës lejojnë që barra e provës të 'zhvendoset' drejt Shtetit të paditur. Kjo bëhet sepse mund të jetë veçanërisht e vështirë të tregohet se trajtimi diferencial i një kërkuesi/eje është bazuar në një karakteristikë të caktuar që është e mbrojtur, sepse motivi i trajtimit diferencial shpesh ekziston vetëm në mendjen e të pandehurit të pretenduar. Rrjedhimisht, paditë e diskriminimit shpesh procedojnë mbi bazën e konkluzioneve që nxirren nga rregulla ose praktika në fjalë.

Doracaku i KE-së për të drejtën e mos-diskriminimit e përmbledh parimin e zhvendosjes së barrës së provës si vijon:

*“Për shkak se i pandehuri i pretenduar posedon informacione që janë të nevojshme për të vërtetuar një padi, e ligji për mos-diskriminim lejon që barra e provës të ndahet me të pandehurin e pretenduar zhvendosja e barrës së provës). Pasi personi që pretendon diskriminimin e ka konstatuar prezumimin e diskriminimit (diskriminim prima facie), barra më tej zhvendoset tek i pandehuri, i cili duhet të tregojë se dallimi në trajtim nuk ka qenë diskriminues. Kjo mund të bëhet ose duke vërtetuar se nuk ka pasur lidhje shkakësore mes bazës së ndaluar dhe trajtimit diferencial, ose duke demonstruar se megjithëse trajtimi diferencial ka lidhje me bazën e ndaluar, ai ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.*

[31] *Thlimmenos k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, nr. 34369/97, § 33.

[32] *Shih për shembull Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 dhe nr. 65900/1, §51 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

*Në qoftë se diskriminuesi i pretenduar nuk arrin të vërtetojë cilëndo prej këtyre të dyjave, ai do të mbahet përgjegjës për diskriminim.*<sup>[33]</sup>

Kështu, për të zhvendosur barrën e provës tek i pandehuri, kërkuesi/ja së pari duhet të konstatojë faktet prej të cilave mund të presupozohet se ka pasur diskriminim.

### **Hapësira e ngushtë e vlerësimit në lidhje me diskriminimin mbi bazën e seksit**

Gjatë shqyrtimit nëse një Shtet Anëtar ka shkelur Konventën, Gjykata lejon një shkallë diskrecioni në lidhje me një veprim legjislativ, administrativ ose gjyqësor në nivel shteti sa i përket një të drejte të Konventës. Doktrina e 'hapësirës së vlerësimit' i lejon Gjykatës të marrë parasysh faktin që Konventa interpretohet ndryshe në Shtete të ndryshme Anëtare, duke pasur parasysh traditat e tyre të ndryshme ligjore dhe kulturore.

Kur hapësira e vlerësimit konsiderohet 'e ngushtë', Gjykata ndërmerr një shkallë më të lartë këqyrjeje. Trajtimi diferencial nga një Shtet në lidhje me çështje që konsiderohen se janë në thelb të dinjitetit personal është më i vështirë të justifikohet sesa trajtimi që ka të bëjë me konsiderata më të gjera sociale ose fiskale. Rrjedhimisht, Gjykata ka ndërmarrë një shkallë më të lartë këqyrjeje në këto raste, duke theksuar se duhet të paraqiten "arsye me shumë peshë" para se Gjykata të mund ta shohë një dallim në trajtim të bazuar ekskluzivisht mbi baza të seksit si i tillë që është në përputhje me Konventën.<sup>[34]</sup>

### **Diskriminimi përmes asociimit**

Gjykata ka konfirmuar gjithashtu se neni 14 mbulon diskriminimin 'përmes asociimit', pra kur një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme mbi bazën e karakteristikave të mbrojtura të një personi tjetër – një parim ligjor që rrjedh nga jurisprudenca e GjDBE-së.<sup>[35]</sup>

[33] Shih [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf) "Doracaku i të Drejtës Evropiane të Mos-Diskriminimit", Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshilli i Evropës, 2018, f. 232.

[34] *Burghartz k. Zvicrës*, vendimi i 22 shkurtit 1994, nr. 16213/90; *Jurčić k. Kroacisë*, vendim i 4 shkurtit 2021, nr. 54711/15 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 majit 1985, nr. 9474/81.

[35] Në *Guberina k. Kroacisë*, vendim i 22 marsit 2019, nr. 23682/13, §78, Gjykata gjeti se trajtimi i kërkuesit për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijës së tij ishte një formë e diskriminimit të

## c) Instrumente të tjera të Këshillit të Evropës

Së bashku me Konventën dhe Protokollet, legjislati dhe orientimi i KE-së për ligjet e mos-diskriminimit rrjedhin nga një sërë instrumentesh të ndryshme. Për shembull, Karta Sociale Evropiane (ang. ESC), traktati tjetër i KE-së për të drejtat e njeriut, garanton të drejtat themelore sociale dhe ekonomike si homologe të mbrojtjes nga KEDNJ-ja të të drejtave gjerësisht civile dhe politike. Në mënyrë të veçantë, ESC përmban një dispozitë mbizotëruese në Nenin E, që siguron të gjitha të drejtat e tjera në ESC pa diskriminim 'mbi asnjë bazë', si dhe të drejta të caktuara për mos-diskriminim në lidhje me punësimin dhe profesionin mbi baza të seksit.<sup>[36]</sup>

KE-ja gjithashtu ka dhënë rekomandime jo-detyruese në lidhje me çështje të caktuara brenda kuadrit të së drejtës mos-diskriminuese. Këto përfshijnë Rekomandimin Rec(2005) për mbrojtjen e dhunës kundër grave, i cili parashtron një seri masash për t'u dhënë fund të gjitha formave të dhunës kundër grave, përfshirë masa legjislative dhe politike për të parandaluar dhe hetuar dhunën kundër grave, për të ndihmuar viktimat, për të punuar me kryesit, për të ngritur vetëdijen, edukimin dhe trajnimin, dhe për të mbledhur të dhëna relevante. Rekomandimi u kërkon Shteteve Anëtare që të shqyrtojnë legjislativën vendasë në lidhje me dhunën kundër grave, dhe të njohin faktin që shtetet kanë detyrimin për të 'ushtruar zellin e duhur për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar dhunën kundër grave'.<sup>[37]</sup>

---

bazuar në aftësi të kufizuara duke pasur parasysh objektivin e tij dhe natyrën e të drejtave që mëton të mbrojë, duke konfirmuar se neni 14 mbulon rastet kur një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme mbi bazën e statusit ose karakteristikave të mbrojtura të një personi tjetër. Që nga ajo kohë, ky parim është konfirmuar nga Gjykata në vendimin e Dhomës së Madhe në *Molla Salik. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2018, nr. 20452/14 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[36] ESC-ja ka mekanizmin e vet të ankesave kolektive, i cili lejon që organizatat me status pjesëmarrës (si partnerët socialë dhe OJQ-të) të aplikojnë direkt pranë Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale (ang. ECSR), organi monitorues i ESC-së, për vendime në lidhje me mos-zbatimin e mundshëm të ESC-së nga shtetet ratifikuese. Ky mekanizëm përbën një shteg që devijon nga sigurimi i të drejtave të mos-diskriminimit si të dallueshme nga ngritja e çështjeve gjyqësore në gjykatë. Deri tani, vetëm 15 Shtete Anëtare e kanë pranuar mekanizmin e ankesave kolektive: Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Finlanda, Franca, Greqia, Irlanda, Italia, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Sllovenia dhe Suedia.

[37] Shih [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805e2612](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805e2612) "Recommendation Rec(2002)5 of the Committee of Ministers to Member States on the



Barazia gjinore dhe dhuna kundër grave janë në krye të agjendës legislative dhe mbikqyrëse të KE-së. Në vitin 2018, KE miratoi Strategjinë e re të Barazisë Gjinore 2018-2023, e cila identifikon një sërë temash kyçe: stereotipet gjinore dhe seksizmi, dhuna kundër grave dhe dhuna shtëpiake, qasja e grave në drejtësi, roli i grave në vendimmarrjen politike dhe publike, të drejtat e grave dhe vajzave migrante/azilkërkuese, dhe përcaktimi i aspektit gjinor si rrymë qendrore.<sup>[38]</sup> Në mars të vitit 2019, Komiteti i Ministrave i KE-së miratoi Rekomandimin (2009)1, i cili rekomandonte që Shtetet Anëtare të marrin masa për të “parandaluar dhe luftuar seksizmin dhe manifestimet e tij në sferat publike dhe private” dhe për të inkurajuar zbatimin e legjislacionit.<sup>[39]</sup>

#### d) Organet monitoruese

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ang. ECRI) është një organ unik i monitorimit të të drejtave të njeriut brenda KE-së i cili është i specializuar në çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër racizmit, diskriminimin (mbi bazat e “racës”, origjinës etnike/kombëtare, ngjyrës, shtetësisë, besimit fetar, gjuhës, orientimit seksual dhe identitetit gjinor), ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës në Evropë.<sup>[40]</sup> Mes aktiviteteve të tjera, ECRI zhvillon monitorime brenda vendit për të analizuar situatën në secilin prej shteteve anëtare, dhe bën rekomandime për të trajtuar të gjitha llojet e racizmit dhe intolerancës që identifikohen në vend.

---

Protection of Women Against Violence”, Council of Europe, recommendation II. Implementimi i rekomandimit në nivel vendi nuk është i detyrueshëm por është monitoruar nga Komiteti i Ministrave i KE-së për Mbrojtjen e Grave kundër Dhunës gjatë viteve pas publikimit të tij, duke bërë vlerësimin e progresit dhe duke u ofruar shteteve anëtare informacione në lidhje me progresin dhe hendeqet ekzistuese.

[38] Shih <https://rm.coe.int/prems-093618-gbr-gender-equality-strategy-2023-web-a5/16808-b47e1>, “Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore 2018-2023”, Këshilli i Evropës, qershor 2018.

[39] <https://rm.coe.int/cm-rec-2019-1-on-preventing-and-combating-sexism/168094d894>, “Parandalimi dhe Luftimi i Seksizmit: Rekomandimi CM/Rec(2019)1”, Këshilli i Evropës, f. 9.

[40] Shih <https://rm.coe.int/leaflet-ecri-2019/168094b101>, “komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës”, Këshilli i Evropës, f. 2.

## e) Legjislacioni i BE-së

### ***Ndërlidhshmëria e legjislacionit dhe jurisprudencës së KE-së dhe BE-së***

Ndërkohë që GjDBE dhe GjEDNj janë sisteme gjyqësore të pavarura<sup>[41]</sup>, të dy gjykatat informalisht kanë një numër të madh vlerash dhe parimesh të përbashkëta, sidomos duke pasur parasysh se të 27 shtetet anëtare të BE-së janë gjithashtu anëtarë të KE-së.

GjDBE-ja i referohet KEDNj-së dhe ESC-së si të tilla që ofrojnë udhërrëfim për interpretimin e të drejtës së BE-së<sup>[42]</sup> dhe ka integruar formalisht jurisprudencën e GjEDNj-së në një pjesë të parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së. Nga ana tjetër, GjEDNj-ja dhe ECSR-ja gjithashtu i referohen ligjeve të BE-së dhe jurisprudencës së GjDBE-së në praktikën e tyre gjyqësore.<sup>[43]</sup> Me fjalët e gjyqtarës aktuale të GjEDNj-së Siofra O’Leary: “*Jurisprudencat e GjEDNj-së dhe GjDBE-së janë ndërsjelltazi zbatuese dhe nuk mund të kuptohen plotësisht nëse janë të ndara.*”<sup>[44]</sup>

### ***Legjislacioni i BE-së për mos-diskriminim***

Sa i përket të drejtës substanciale të BE-së për mos-diskriminim, dispozita parësore në Nenin 10 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (ang. TFEU), e cila kërkon që BE-ja të luftojë diskriminimin mbi bazën e seksit, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual, kur përcakton dhe zbaton politikat dhe aktivitetet e saj.

[41] GjDBE-ja e merr autoritetin e saj nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian dhe merr vendime në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e të drejtës së BE-së, ndërsa GjEDNj-ja e merr autoritetin e saj nga sistemi ligjor i KE-së dhe merr vendime në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e KEDNj-së.

[42] Për shembull, shih: *Kone Oyj dhe të Tjerë k. Komisionit Evropian*, vendimi i 24 tetorit 2013, nr. C-510/11 P, § 20-22; *Istituto nazionale della previdenza sociale (INPS) k. Tiziana Bruno dhe Massimo Pettini dhe Daniela Lotti dhe Clara Matteucci*, vendimi i 10 qershorit 2010, nr. C-395/08 dhe C-396/08, § 31-32.

[43] Për shembull, shih *Biao k. Danimarkës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 majit 2016, nr. 38590/10.

[44] Gjyqtarja Siofra O’Leary, duke folur në Seminarin e Qendrës AIRE për Aspektin Gjinor në Gjyqësor, 4 qershor 2021.

Që nga viti 2000, fushëveprimi i të drejtës së BE-së për anti-diskriminim është zgjeruar shumë përtej Nenit 10 të TFEU-së. Në mënyrë të veçantë, miratimi i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore në vitin 2000, dhe hyrja në fuqi e Traktatit të Amsterdimit në vitin 1999 krijuan mundësinë për marrjen e veprimeve për të luftuar diskriminimin mbi një gamë të gjerë bazash dhe çuan në futjen e direktivave të reja për barazinë. Këto diskutohen më poshtë.

### ***Karta e BE-së për të Drejtat Themelore***

Karta e BE-së u bë detyruese për shtetet me futjen e Traktatit të Lisbonës në vitin 2009. Karta e BE-së u adresohet institucioneve dhe organeve të BE-së së bashku me autoritetet kombëtare të shteteve anëtare, duke i detyruar ato që të mos ndërhyrë tek të drejtat e njeriut në masat që marrin, dhe përfshin ndalimin e diskriminimit. Në lidhje me Shtetet Anëtare, Karta e BE-së aplikohet vetëm kur ato janë duke zbatuar të drejtën e BE-së. Gjithashtu, ka ndërlidhshmëri legjislative mes Kartës së BE-së dhe legjislacionit të KE-së. Për shembull, preambula e Kartës së BE-së i referohet Kartës Sociale Evropiane të KE-së.

Dispozitat e Kartës së BE-së për barazinë përmbahen në Nenet 20 deri në 26, ku parashikohet *inter alia* që secili/a është i/e barabartë para ligjit (Neni 20), ndalimi i diskriminimit mbi bazën e një liste jo-shteruese të bazave (Neni 21)<sup>[45]</sup> dhe barazia gjinore (Neni 23). Ndryshe nga neni 14 i Konventës, Neni 21 i Kartës së BE-së qëndron i lirë, që do të thotë se nuk varet nga shkelja e një të drejte tjetër.

### ***Direktivat kyçe të BE-së***

Direktiva 2006/54/EC ("Direktiva e Barazisë Gjinore (e rishikuar)") garanton trajtimin e barabartë mbi bazën e seksit sa u përket çështjeve të pagës, skemave të sigurimeve shoqërore në lidhje me punën dhe qasjes në punësim, aftësimin profesional, ngritjes në detyrë dhe kushteve të punës. Përveç kësaj, direktiva për barazinë gjinore janë futur në fushat e sigurimeve shoqërore të shtetit (Direktiva 79/7/EEC), trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave të vetpunësuar/a (Direktiva 2010/41/EU), në lidhje me shtatzaninë (Direktiva 92/85/EEC) dhe lejen prindërore (Direktiva 2010/18/EU).

[45] Neni 21 i Kartës së BE-së ndalon diskriminimin mbi 'çdo bazë si seksi, raca, ngjyra, prejardhja etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, anëtarësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, aftësitë e kufizuara, mosha ose orientimi seksual'.

Sipas të drejtës së BE-së, direktivat e lartcekura të mos-diskriminimit i nënshtrohen parimit të justifikimit objektiv. Kjo do të thotë se, në disa raste, GjDBE-ja mund të gjejë që ka pasur trajtim diferencial por që ai është i pranueshëm. Në kontekstin e të drejtës së punësimit, GjDBE-ja ka ngurruar të pranojë justifikimin e trajtimit diferencial si rezultat i çështjeve ekonomike të punëdhënësit. Nga ana tjetër, ajo ka lejuar hapësirë të gjerë diskrecioni në rastet e bazuara mbi qëllime të politikave sociale dhe të punësimit me implikime fiskale. Për shembull, GjDBE-ja ka theksuar se kompensimi i punonjëseve femra për dizavantazhet e pauzimit të karrierës për të rritur fëmijët përbën qëllim legjitim që justifikon diskriminimin kundër një punonjësi mashkull.<sup>[46]</sup>

Direktiva e Barazisë Gjinore (e rishikuar) gjithashtu i nënshtrohet një përjashtimi sipas 'kriterit real të punës' i cili i lejon punonjësit të diferencojnë mes individëve mbi bazën e një karakteristike të mbrojtur kur ajo karakteristikë është direkt e lidhur me përshtatshmërinë ose kompetencën për të kryer detyrat e kërkuara në një vend pune të caktuar. GjDBE-ja ka treguar fushat në të cilat mund të aplikohet ky përjashtim, siç janë profesionet artistike ku mund të kërkohen individë me attribute të caktuara. Për shembull, një kompani operistike mund të kërkojë një këngëtare femër ose një aktor mashkull për një rol të caktuar.<sup>[47]</sup>

## f) Instrumentet ligjore ndërkombëtare

Instrumentet ligjore ndërkombëtare në lidhje me diskriminimin gjithashtu janë relevante në jurisprudencën e Gjykatës. Neni 53 i Konventës e bën të qartë se të drejtat e Konventës nuk duhet të konceptohen si të tilla që kufizojnë ose derogojnë nga të drejtat e njeriut sipas instrumenteve ligjore ndërkombëtare. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh instrumentet ligjore ndërkombëtare në të cilat Shtetet janë palë kur diskutohen çështje të ndryshme.<sup>[48]</sup> Rrjedhimisht, Konventa nuk mund të interpretohet në vakuum, por duhet të interpretohet në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe instrumenteve relevante. Në vazhdim, bëhet një përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare kyçe në lidhje me barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin.

[46] *Maurice Leone dhe Blandine Leone k. Garde des Sceaux, ministre de la Justice dhe Caisse nationale de retraite des agents des collectivités locales*, vendimi i 17 korrikut 2014, nr. C-173/13.

[47] *Komisioni i Komuniteteve Evropiane k. Republikës Federale të Gjermanisë*, vendimi i 21 majit 1985, nr. C-248/83.

[48] Për shembull, dispozitat e CEDAW ishin të rëndësishme qendrore në vendimin e Gjykatës në *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02.

## **Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave**

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave është një instrument i OKB-së që është ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të KE-së. Ajo përbën një marrëveshje të të gjitha palëve të shtetit për të respektuar, mbrojtur, promovuar dhe përbushur të drejtat njerëzore të grave në të gjitha rrethanat.<sup>[49]</sup> Palët në CEDAW janë ligjërisht të detyruara, së pari, të eliminojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave në të gjitha fushat e jetës, dhe, së dyti, të garantojnë zhvillimin dhe avancimin e plotë të grave në mënyrë që ato të ushtrojnë dhe të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore dhe liritë themelore në të njëjtën mënyrë si burrat. Kjo përfshin marrjen e masave për të çrrënjësuar rolet stereotipike të grave dhe burrave; garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në jetën publike; garantimin e barazisë para ligjit; dhe eliminimin e diskriminimit në punësim.

CEDAW parashikon që masat e veprimeve afirmative nuk duhet të konsiderohen diskriminuese (Neni 4). Më tej, Shteteve u kërkohet të marrin masa të përshtatshme për "të modifikuar modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave ... të cilat janë të bazuara mbi idetë e inferioritetit ose superioritetit ... ose mbi rolet stereotipike për burrat dhe gratë" (Neni 5).

Ndërkohë që CEDAW nuk është direkt e aplikueshme për qëllimet e vendimmarrjes së Gjykatës, ajo shpesh përmendet si referencë në jurisprudencën e Gjykatës, dhe informon vendim-marrjen e gjyqësorëve vendas në lidhje me diskriminimin mbi baza të seksit.<sup>[50]</sup> Si rezultat, tani ka një shkallë të lartë të mbivendosjes normative mes CEDAW dhe Konventës.

---

[49] CEDAW është ratifikuar nga Shqipëria (1994), Bosnje dhe Hercegovina (1993), Kroacia (1992), Serbia (2001), Maqedonia e Veriut (1994) dhe Mali i Zi (2006), qasja tek: [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?Treaty=CEDAW&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?Treaty=CEDAW&Lang=en); Për shkak të statusit të saj sipas Rezolutës 1244 të OKB-së, Kosova nuk e ka ratifikuar CEDAW e as Konventën e Stambollit, por Neni 22 i Kushtetutës së saj rendit CEDAW në mesin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që janë direkt të aplikueshme në Kosovë. Mund të gjendet tek: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

[50] Shih për shembull *Staatkundig Gereformeerde Partij k. Holandës*, vendimi i 10 korrikut 2012, nr. 58369/10.

## **Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës shtëpiake ("Konventa e Stambollit")**

Konventa e Stambollit është një instrument ndërkombëtar ligjërishit detyrues që synon të godasë dhunën kundër grave dhe dhunën shtëpiake në të gjitha shtetet anëtare të KE-së. Ajo njeh se dhuna kundër grave vjen nga stereotipet gjinore, njëanësisë dhe diskriminimit, të cilat janë çështje shumë të përhapura në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor e kanë ratifikuar Konventën e Stambollit dhe kështu kanë marrë përsipër detyrimin për të harmonizuar ligjet e tyre në përputhje me dispozitat e saj me qëllim që të lehtësojnë parandalimin e dhe mbrojtjen kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës shtëpiake.<sup>[51]</sup>

Parandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave, ndjekja penale e kryesve dhe nevoja për politika të integruara në nivel kombëtar janë katër shtyllat e Konventës së Stambollit. Në thelb, këto masa bazohen në parimin që dhuna kundër grave është shkelje e të drejtave të njeriut dhe formë diskriminimi kundër grave. Sipas Konventës së Stambollit, dhuna kundër grave e bazuar në gjini dallon nga llojet e tjera të dhunës, meqenëse dhuna e bazuar në gjini është si shkak ashtu edhe rezultati i marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit mes grave dhe burrave që çon drejt statusit të nënshkruar të grave në sferat publike dhe private.<sup>[52]</sup> Rrjedhimisht, Konventa e Stambollit synon çrrënjosjen e dhunës kundër grave dhunës shtëpiake në kontekstin e avancimit të barazisë mes grave dhe burrave.

[51] Konventa e Stambollit është ratifikuar nga Shqipëria (2013), Bosnje dhe Hercegovina (2013), Kroacia (2018), Serbia (2013), Maqedonia e Veriut (2018) dhe Mali i Zi (2014), qasja tek: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210/signatures?module=signatures-by-treaty&treatyid=210>. Parlamenti Evropian ka kërkuar në mënyrë të përsëritur hyrjen e BE-së në Konventën e Stambollit dhe ratifikimin e saj nga Shtetet Anëtare individuale. BE-ja e ka nënshkruar Konventën e Stambollit më 13 qershor 2017 por e ka kufizuar fushëveprimin e hyrjes së saj në bashkëpunimin juridik në çështje penale, të azilit dhe të mos-kthimit të azilkërkesve (*non-refoulement*). Në shtator 2017, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë të përkohshme mbi hyrjen e plotë të BE-së në Konventën e Stambollit. Rezoluta u bëri thirrje Shteteve Anëtare që të përshpejtojnë negociatat për ratifikimin e Konventës së Stambollit nga BE-ja, dhe kërkoi hyrje të gjerë të BE-së pa asnjë kufizim. Më tej, anëtarët e Parlamentit Evropian u bënë thirrje shteteve anëtare të BE-së që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Stambollit që ta bëjnë një gjë të tillë. Shih: <https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20191121IPR67113/istanbul-convention-all-member-states-must-ratify-it-without-delay-say-meps>.

[52] See <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/key-facts>, "Fakte Kyçe rreth Konventës së Stambollit", Këshilli i Evropës.

Kryesisht, Konventa e Stambollit përcakton detyrimet e mëposhtme:

- » Për të kriminalizuar disa forma të caktuara të dhunës së bazuar në gjini (përfshirë dhunën fizike dhe psikologjike, martesat e detyruara, abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar); dhe
- » Për të garantuar që kultura, doket, feja, tradita ose i ashtuquajtimi "nderi" nuk shihen si justifikime për cilindo prej akteve të dhunës që mbulohen nga fushëveprimi i saj.

### ***Grupi i pavarur i Ekspertëve për Veprimet kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës Shtëpiake (ang. GREVIO)***

Konventa e Stambollit parashikon një mekanizëm monitorues me dy shtylla për të bërë vlerësimin dhe përmirësimin e interpretimit të Konventës së Stambollit nga shtetet palë: GREVIO dhe Komisioni i Palëve.

Në mënyrë të veçantë, GREVIO harton dhe publikon raporte ku bëhet vlerësimi i ligjeve dhe masave të tjera të marra nga Palët për futjen në fuqi të dispozitave të Konventës. Kur kërkohet marrja e veprimeve për të parandaluar ndonjë akt të rëndë, masiv ose të vazhdueshëm të dhunës të mbuluar nga Konventa, GREVIO mund të iniciojë një procedurë hetimore speciale. Po ashtu, GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme në lidhje me tematikat dhe konceptet e Konventës.<sup>[53]</sup>

### ***Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (ang. FCNM)***

FCNM është instrumenti i parë shumëpalësh ligjërish detyrues që i kushtohet mbrojtjes së pakicave kombëtare anembanë botës, dhe zbatimi i tij monitorohet nga i vetmi komision ndërkombëtar që i dedikohet ekskluzivisht të drejtave të pakicave: Komisioni Këshillimor.<sup>[54]</sup> Puna e Komisionit Këshillimor përfshin vizitat në vende të ndryshme dhe hartimin e raporteve shtetërore dhe opinioneve që çojnë në miratimin e rezolutave që përmbajnë rekomandime për veprime. Mbrojtja që ofron FCNM shpesh ka të bëjë me fusha në të cilat diskriminimi mbi

[53] Sa u përket instrumenteve të tjera ndërkombëtare relevante për këtë çështje, vlen të përmendet Rezoluta 1325 e miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (UNSCR 1325), datë 31 tetor 2000, e cila u bën thirrje shteteve që të shtojnë përfaqësimin e grave në nivelet vendim-marrëse në institucionet shtetërore: shih [https://undocs.org/S/RES/1325\(2000\)](https://undocs.org/S/RES/1325(2000)), "Rezoluta 1325 (2000)", Këshilli i Sigurimit të OKB-së, 31 tetor 2000.

[54] <https://www.coe.int/en/web/minorities>, "National Minorities (FCNM)", Council of Europe.

baza të pakicave kombëtare ndërthuret me diskriminimin mbi bazën e gjinisë, për shembull FCNM promovon të drejtat e arsimit dhe pjesëmarrjen efektive në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike, dhe në çështjet publike.

## (2) Dhuna shtëpiake, femicidi dhe dhuna e bazuar në gjini

Kryerja e dhunës kundër grave është pazgjidhshmërisht e lidhur me ekzistencën e stereotipeve gjinore, njëanshmërisë dhe diskriminimit kundër grave. Parandalimi i dhunës shtëpiake dhe asaj me bazë gjinore është aspekt thelbësor i të gjitha përpjekjeve për të avancuar barazinë gjinore.

Gjykata e ka adresuar çështjen e dhunës shtëpiake dhe asaj me bazë gjinore (ang. GBV) në shumë raste gjatë dekadës së fundit. Ndërkohë që Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk i referohet shprehimisht dhunës shtëpiake, jurisprudenca në evolucion e sipër e Gjykatës në çështje të lidhura me GBV ka gjetur shkelje të neneve të Konventës në këtë kontekst, përfshirë:

- » e drejta e jetës sipas **nenit 2** – e angazhuar kur dhuna shtëpiake arrin një shkallë që përbën kërcënim për jetën;
- » e drejta për të qenë i/e lirë nga tortura dhe nga trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës sipas **nenit 3** – e angazhuar kur dhuna shtëpiake arrin një prag të caktuar të rreptësisë;
- » e drejta për respekt të jetës private dhe familjare sipas **nenit 8** – e angazhuar në lidhje me "jetën private" kur ka ndërhyrje tek integriteti moral dhe fizik i viktimës i cili nuk është mjaftueshëm i ashpër sa të angazhojë nenin 3;
- » e drejta për zgjidhje efektive sipas **nenit 13**; dhe
- » ndalimi i diskriminimit sipas **nenit 14**.

### a) Shikim i përgjithshëm mbi detyrimet procedurale dhe ato substanciale sipas Konventës

Gjykata ka bërë një dallim thelbësor mes detyrimeve '**substanciale**' dhe atyre '**procedurale**' sipas neneve të Konventës. Parimi bazë i këtij dallimi është i ngërthyer në natyrën e veprimit të pritur nga Shtetet.

**Detyrimet substanciale** caktojnë detyrime **negative** dhe **pozitive** mbi Shtetet. Detyrimet negative i ndalojnë Shtetet që të përfshihen direkt në trajtim të ndaluar, siç është marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës sipas nenit 2, ose tortura dhe trajtimi poshtëruës nga neni 3. Detyrimet pozitive sigurojnë



që Shtetet gjithashtu duhet të marrin masa me qëllim të mbrojtjes së individëve brenda juridiksionit të tyre nga shkelje siç janë shkeljet e nenit 2 ose nenit 3 – ose nga vënia në rrezik ndaj këtyre shkeljeve – përfshirë rastet kur një trajtim i tillë kryhet nga individë privatë.<sup>[55]</sup>

Një Shtet gjithashtu ka detyrimin procedural për të zhvilluar hetime zyrtare mbi akuzat për shkelje të cilat mund të çojnë, nëse duhet, drejt ndjekjes penale dhe dënimit.<sup>[56]</sup> Këto detyrime procedurale konsiderohen thelbësore për gëzimin praktik dhe efektiv të të drejtave të garantuara në Konventë. Siç përshkruhet më poshtë, çështjet që kanë të bëjnë me GBV dhe dhunën shtëpiake mund të hyjnë brenda fushëveprimit të detyrimeve substanciale dhe procedurale sipas neneve 2, 3 dhe/ose 8.

### **Fushëveprimi i nenit 2**

Detyrimet pozitive të nenit 2 kërkojnë që një Shtet jo vetëm të përmbahet nga marrja "e qëllimshme" e jetës, por edhe që të marrë hapat e duhur për mbrojtjen e jetëve të atyre që janë brenda juridiksionit të tij, pra një detyrim pozitiv për të mbrojtur jetën.<sup>[57]</sup>

Neni 2 angazhohet kur ndodh një privim i paligjshëm nga jeta njerëzore (ose një kërcënim për këtë qëllim) i lidhur me veprime ose mosveprime të një agjenti të shtetit. Sipas një testi të tillë, të quajtur 'testi Osman', duhet të përcaktohet që:<sup>[58]</sup>

- » autoritetet e kanë ditur, ose me arsye duhet ta kishin ditur, ekzistencën e një rreziku real dhe të afërt ndaj jetës së një individi të identifikuar nga veprimet e një pale të tretë; dhe
- » ato kanë dështuar të marrin masa brenda fushëveprimit të fuqive të tyre të cilat, nëse gjykohet me arsye, mund të ishte pritur që ta shmangnin atë rrezik.

[55] *A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 23 shtatorit 1998, nr. 100/1997/884/1096; *Z dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 majit 2001, nr. 29392/95.

[56] *M.C. k. Bullgarisë*, vendimi i 4 dhjetorit 2003, nr. 39272/98.

[57] *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 17 korrikut 2014, nr. 47848/08, §130.

[58] *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, nr. 23452/94, § 117.

Në lidhje me GBV / dhunën shtëpiake, për të gjetur që një Shtet ka shkelur nenin 2, duhet të demonstrohet se qeveria ka dështuar të mbrojë siç duhet një individ nga një kryes i dhunës GBV, kur e ka ditur ose me arsye duhet ta kishte ditur që kryesi përbënte rrezik real dhe të afërt për jetën e individit.<sup>[59]</sup> Për shembull, kur një individ ka raportuar në polici incidente të përsëritura të dhunës dhe kërcënimeve me vdekje.<sup>[60]</sup>

### **Fushëveprimi i nenit 3**

Neni 3 parashikon se askush nuk do t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose poshtërues. Si e drejtë absolute e KEDNJ-së, nuk ka derogime të parashkuara nga forca ndaluese e nenit 3, qoftë edhe në kohë lufte ose ngjarjesh të tjera që kërcënojnë 'jetën e kombit'.<sup>[61]</sup>

Në lidhje me dhunën shtëpiake / GBV, keqtrajtimi i një individi duhet të ketë një shkallë minimale rreptësie për të arritur pragun e nenit 3 dhe për të angazhuar detyrimet pozitive të një Shteti sipas atij neni.<sup>[62]</sup> Vlerësimi i këtij pragu minimal është relativ: varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është natyra dhe konteksti i trajtimit, kohëzgjatja e tij, dhe efektet e tij fizike dhe mendore.<sup>[63]</sup> Seksi i viktimës dhe marrëdhënia mes viktimës dhe kryesit të keqtrajtimit gjithashtu kanë rëndësi në këtë vlerësim.<sup>[64]</sup>

Trajtimi mund të jetë "çnjerëzor" në qoftë se është me paramendim, ndodh me orë të tëra dhe shkakton ose lëndim faktik trupor ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore.<sup>[65]</sup> Trajtimi mund të konsiderohet "poshtërues" në qoftë se është i tillë që shkakton tek viktimja ndjenja frike, ankthi dhe inferioriteti, të cilat mund

[59] *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, nr. 23452/94; *Kontrová k. Sllovakisë*, vendimi i 31 majit 2007, nr. 7510/04; *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Branko Tomašić dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendimi i 15 janarit 2009, nr. 46598/06, §50.

[60] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[61] *Ocalan k. Turqisë (nr. 2)*, vendimi i 18 marsit 2014, nr. 24069/03, 6201/06, 10464/07, § 97-98, *Aksoy k. Turqisë*, vendimi i 18 dhjetorit 1996, nr. 21987/93, § 62; *Ireland v UK*, vendimi i 13 dhjetorit 1977, nr. 5310/71, § 163.

[62] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02, §158 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[63] *Opuz k. Turkey*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Costello-Roberts k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 marsit 1993, nr. 13134/87.

[64] *Tunikova dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2021, nr. 55974/16, 53118/17, 27484/18 dhe 280111/19, §73.

[65] *Labita k. Italisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, nr. 26772/95, §120.

t'i turpërojnë dhe ulin ato e mundësisht mund të thyejnë rezistencën e tyre fizike ose morale,<sup>[66]</sup> këtu përfshihet kur viktimat e dhunës shtëpiake turpërohet në sytë e vetes, edhe nëse jo në sytë e të tjerëve.<sup>[67]</sup>

Për shembull, keqtrajtimi fizik i një gruaje, përfshirë zënien e frymës, tërheqjen e flokëve, goditjet në fytyrë dhe shkelmimet në brinjë dhe shpinë, të kombinuara me ndjenja të frikës dhe pafuqisë, janë vlerësuar mjaftueshëm të rrepta sa që nxisin detyrimet pozitive sipas nenit 3.<sup>[68]</sup>

Gjykata ka theksuar se, përveç lëndimeve fizike, impakti psikologjik përbën një aspekt të rëndësishëm të dhunës shtëpiake. Frika e sulmeve të mëtejshme mund të jetë aq e rëndë sa t'u shkaktojë viktimit dhunës shtëpiake vuajtje dhe ankth të cilat mund të arrijnë pragun minimal të rreptësisë për zbatimin e nenit 3.<sup>[69]</sup> Për shembull, dëmi psikologjik (përfshirë ndjenjat e frikës dhe pafuqisë) i shkaktuar nga sjellja shtrënguese dhe kontrolluese, siç është monitorimi i lëvizjeve të një gruaje, ndjekja e saj jashtë shtëpisë së vet, mbyllja në makinë dhe kërcënimi për ta vrarë, është gjetur se janë mjaftueshëm të rënda sa që arrijnë, në vetvete, të hyjnë brenda fushëveprimit të nenit 3.<sup>[70]</sup>

### **Fushëveprimi i nenit 8**

Neni 8 parashikon që çdokush ka të drejtën e respektit për jetën private dhe familjare, të shtëpisë dhe korrespondencës. Qëllimi parësor i nenit 8 është mbrojtja kundër ndërhyrjeve arbitrare në jetën familjare, shtëpinë dhe korrespondencën nga një autoritet publik.<sup>[71]</sup> Megjithatë, neni 8 gjithashtu ngërthen detyrime pozitive mbi Shtetin për të siguruar 'respekt' efektiv për jetën private dhe familjare. Në mënyrë të veçantë, sipas nenit 8 Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë integritetin fizik dhe moral të një individi nga ndërhyrjet prej personave privatë.<sup>[72]</sup>

Neni 8 është e drejtë e kualifikuar. Shtetet mund të ndërhyjnë tek e drejta e gëzimit të nenit 8 për një sërë arsyesh të parashikuara (të cekura në §2 të nenit), në

[66] *Wieser k. Austrisë*, vendimi i 22 shkurtit 2007, nr. 2293/03, §36.

[67] *Volodina k. Rusisë*, vendimi i 9 korrikut 2019, nr. 41261/17 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[68] *Valiulienė k. Lituanisë*, vendimi i 26 marsit 2013, nr. 33234/07, §70.

[69] *Eremia k. Republikës së Moldavisë*, vendimi i 28 majit 2013, nr. 3564/11, §54.

[70] *Tunikova dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2021, nr. 55974/16, §76.

[71] *Libert k. Francës*, vendimi i 22 shkurtit 2018, nr. 588/13, §40-42.

[72] *Söderman k. Suedisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08.

qoftë se ndërhyrja është e ligjshme dhe e nevojshme. Për t'u justifikuar ndërhyrja në nenin 8, Gjykata duhet të vlerësojë nëse ajo ka ndodhur "në përputhje me ligjin" ose "e parashikuar me ligj", "duke ndjekur një qëllim legjitim" dhe se ka qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

Teksti i nevojshmërisë "në një shoqëri demokratike" përfshin vlerësimin e proporcionalitetit, ku qëllimi legjitim i ndjekur nga Shteti duhet të balancohet me të drejtat e individit. Në disa raste, të drejtat e individit sipas nenit 8 gjithashtu duhet të balancohen me interesat e një individi tjetër të mbrojtura nga dispozita të tjera të Konventës. Në kontekstin e parandalimit dhe hetimit të dhunës shtëpiake, këtu mund të përfshihet balancimi i të drejtave të një viktime nga neni 8 me të drejtën e kryesit të supozuar për gjyq të drejtë dhe mbrojtjen nga paraburgimi i paligjshëm sipas neneve 5 dhe 6 të Konventës.

Neni 8 angazhohet kur abuzimi ose dhuna kërcënon integritetin fizik dhe moral të një individi, dhe kur ndodhia e dhunës shtëpiake / GBV nuk e arrin shkallën e rreptësisë së nevojshme për të angazhuar nenin 3. Këtu përfshihen rastet e abuzimit ose ngacmimit fizik, ekonomik dhe psikologjik, për shembull filmimi i fshetë i një të miture nga njerku i saj kur ajo ishte e zhveshur.<sup>[73]</sup>

Bullizmi në internet dhe vëzhgimi në internet (ang. cyberbullying and cybersurveillance) gjithashtu njihen si aspekte të dhunës kundër grave të cilat hyjnë brenda fushëveprimit të nenit 8. Për shembull, hyrja tinzare në kompjuterin e një viktime, vjedhja, ndarja dhe manipulimi i të dhënave dhe pamjeve, monitorimi i papërshtatshëm, qasja dhe ruajtja e korrespondencës së një personi,<sup>[74]</sup> përdorimi i fotografive nudo për të krijuar llogari të rreme në media sociale, dhe bërja e kërcënimeve të dhunshme përmes mediave sociale.<sup>[75]</sup>

Në shumë raste<sup>[76]</sup> kur kërkueset kanë bërë akuza që pretendonin shkelje të neneve 3 dhe 8 së bashku, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 8 dhe më pas ka deklaruar se për këtë arsye ishte e panevojshme të shqyrtohej çështja edhe sipas nenit 3.

[73] *Söderman k. Suedisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 nëntorit 2013, nr. 5786/08.

[74] *Buturugă k. Rumanisë*, vendimi i 11 shkurtit 2020, nr. 56867/15.

[75] *Volodina k. Rusisë (Nr. 2)*, vendimi i 14 shtatorit 2021, nr. 40419/19 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[76] *Bevacqua dhe S. k. Bullgarisë*, vendimi i 12 qershorit 2008, nr. 71127/01; *A. k. Kroacisë*, vendimi i 14 tetorit 2010, nr. 55164/08; *Kalucza k. Hungarisë*, vendimi i 24 prillit 2012, no 57693/10; *Sandra Janković k. Kroacisë*, vendimi i 5 marsit 2009, nr. 38478/05.

Ky Udhërrëfyes tani do të bëjë një përmbledhje të detyrimeve të Shteteve sipas neneve 2, 3 dhe 8 për të ndaluar, parandaluar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar shkeljet e lidhura me dhunën shtëpiake dhe GBV.

### ***Detyrimi për të zbatuar një kornizë ligjore të përshtatshme***

Masat legjislative të marra nga Shtetet duhet të ofrojnë jo vetëm ndalimin efektiv të shkeljeve, por edhe mbrojtjen, sidomos për personat e cenueshëm, nga shkeljet. Një mbrojtje e tillë duhet të përfshijë hapat e arsyeshëm të marrë nga Shteti për të parandaluar trajtimin e ndaluar për të cilin autoritetet e kanë ditur ose është dashur ta kenë ditur duke zbatuar një kornizë të përshtatshme ligjore.<sup>[77]</sup> Legjislacioni duhet të ketë pengesa të përshtatshme dhe efekt mbrojtës në gjendje të sigurojë parandalimin operativ të dhunës shtëpiake.

Kjo do të thotë se legjislacioni duhet të jetë mjaftueshëm i saktë dhe i përcaktueshëm në mënyrë që:

- » viktimat potenciale të dhunës shtëpiake ta dinë se ligji i mbron ato dhe saktësisht si i mbron ato; dhe
- » kryesit e mundshëm të dhunës shtëpiake ta dinë se ligji ua ndalon atyre shkaktimin e dhunës; dhe
- » kryesit e mundshëm të dhunës shtëpiake ta dinë ndëshkimin me të cilin përballen për kryerjen e akteve të dhunës ose abuzimit.

Kur janë në rrezik vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private, kjo në praktikë kërkon dispozita efikase të së drejtës penale. Për shembull, Shtetet kanë detyrimin pozitiv sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës që të miratojnë dispozita të së drejtës penale që ndështojnë efektivisht përdhunimin dhe t'i zbatojnë ato në praktikë me anë të hetimeve dhe ndjekjes penale efektive.<sup>[78]</sup>

### ***Detyrimi për të parandaluar shkaktimin e dhunës shtëpiake në mënyrë që të mbrohet viktimat***

Detyrimi pozitiv substancial i parandalimit e kështu mbrojtjes sipas neneve 2, 3 dhe 8 kërkon që Shtetet të bëjnë më shumë sesa thjesht të miratojnë ligje të dizajnuara për të mbrojtur integritetin personal të personave të cenueshëm.<sup>[79]</sup> Ai

[77] *Osman k. United Kingdom*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, nr. 23452/94.

[78] *M.C. k. Bullgarisë*, vendimi i 4 dhjetorit 2003, nr. 39272/98.

[79] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë

gjithashtu përfshin, në rrethanat e duhura, një detyrim pozitiv të autoriteteve që të marrin **masa parandaluese operacionale** të arsyeshme për të mbrojtur një individ jeta ose siguria fizike e së cilës është në rrezik nga aktet kriminale të një individi tjetër.<sup>[80]</sup>

Ndërkohë që koncepti i 'masave parandaluese operacionale' u përcaktua për herë të parë në çështjen *Osman* në lidhje me nenin 2, dështimi për të marrë masa parandaluese operacionale tani është konstatuar se shkel detyrimet shtetërore sipas neneve<sup>[81]</sup> dhe 8<sup>[82]</sup>. Kur Gjykata vendos që Shteti ka pasur njohuri konstruktive për një ngjarje, ajo duhet të shqyrtojë nëse Shteti ka marrë të gjitha masat e arsyeshme parandaluese operacionale. Megjithatë, ky detyrim duhet të interpretohet në një mënyrë e cila nuk imponon ndonjë barrë të pamundur ose joproporcionale mbi autoritetet.<sup>[83]</sup> Rrjedhimisht, jo çdo rrezik i pretenduar ndaj jetës rezulton me kërkesën për të marrë masa operacionale për ta parandaluar atë rrezik nga materializimi.

Në çështjen *Valiulienë k. Lituanië*, Gjykata mori parasysh natyrën e detyrës së Shtetit për të parandaluar dhe mbrojtur individët nga dhuna shtëpiake nën dritën e testit *Osman*, duke komentuar:

*'Në qoftë se një Shtet e di ose do të duhej që ta kishte ditur se një segment i popullatës së tij, siç janë gratë, i nënshtrohet dhunës së vazhdueshme dhe dështon ta parandalojë shkaktimin e lëndimeve ndaj anëtareve të atij grupi njerëzish kur ato përballen me rrezik të pranishëm (por ende jo të afërt), Shteti mund të gjendet përgjegjës për mosveprim për shkeljet rezultuese të të drejtave të njeriut. Detyra e pritur konstruktive për të parandaluar dhe mbrojtur është ana tjetër e kontekstit të abuzimit dhe dhunës së përhapur tashmë të njohura për autoritetet shtetërore.'*<sup>[84]</sup>

publikim).

[80] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02, §128 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[81] *Valiulienë k. Lituanië*, vendimi i 26 marsit 2013, nr. 33234/07.

[82] *Hajduova k. Sllovakisë*, vendimi i 30 nëntorit 2010, no 2660/03.

[83] *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, nr. 23452/94, §115.

[84] *Valiulienë k. Lituanië*, vendimi i 26 marsit 2013, nr. 33234/07, opinioni pajtues i Gjyqtarit Pinto de Albuquerque.

Kjo do të thotë se testi klasik Osman duhet të zbatohet më rreptë në kontekstin e çështjeve të dhunës shtëpiake, në mënyrë që të marrë parasysh problemet serioze, të gjata dhe të përhapura të dhunës shtëpiake në shoqëri. Standardi i zellit të duhur që pritët është më rigoroz, ku lind detyra që autoritetet publike të veprojnë kur rreziku tashmë është i pranishëm, edhe nëse jo i afërt.

## b) Detyrimet procedurale sipas neneve 2, 3 dhe 8

Nenet 2 dhe 3 caktojnë detyrimin procedural pozitiv që Shtetet të hetojnë efektivisht krimet e raportuara të kryera nga individët privatë. Kështu, ekziston detyra operationale që autoritetet shtetërore të zhvillojnë hetimet e duhura rreth sjelljes që përbën shkelje të të drejtave sipas neneve 2 dhe 3. Qëllimi thelbësor i hetimeve të tilla është të sigurohet zbatimi efektiv i ligjeve vendase, të cilat mbrojnë të drejtat e individëve sipas Konventës.

Detyrimi procedural që del nga neni 2 kërkon që autoritetet të veprojnë menjëherë dhe me përshejtim të arsyeshëm,<sup>[85]</sup> sapo çështja të vijë në vëmendjen e tyre; ato nuk mund ta lënë në dorë të familjarëve më të afërt që të marrin iniciativën për të bërë ankesë formale ose për të marrë përsipër përgjegjësinë për zhvillimin e çfarëdo procedure hetimore.<sup>[86]</sup> Sipas neni 3, detyrimi procedural lind kur pretendimet rreth ekzistencës së trajtimit të ndaluar janë 'të argumentueshme'.<sup>[87]</sup> Për më tepër, kur rrethanat e një sulmi mbajnë vulën e dhunës së bazuar në gjini, autoritetet duhet të reagojnë me zell të veçantë në zhvillimin e masave hetimore. Kurdo që ekziston dyshimi se një sulm mund të jetë me motive gjinore, është veçanërisht e rëndësishme që hetimet të ndiqen në mënyrë të vrullshme.<sup>[88]</sup>

Hetimet efektive për një shkelje të pretenduar të neneve 2, 3 dhe/ose 8 duhet të marrin parasysh tiparet e veçanta të dhunës shtëpiake në linjë me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës shtëpiake.<sup>[89]</sup> Kjo përfshin (por nuk kufizohet me):

[85] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02, §128 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Yasa k. Turqisë*, vendimi i 2 shtatorit 1998, nr. 22495/93, §102-104.

[86] *Al-Skeini dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 7 korrikut 2011, nr. 55721/07, §165; *Nihayet Arici dhe të Tjerë k. Turqisë*, vendimi i 23 tetorit 2012, nr. 24604/04 dhe 16855/05, §159.

[87] *Chiriță k. Rumanisë*, vendimi i 29 shtatorit 2009, nr. 37147/02.

[88] *Tërshana k. Shqipërisë*, vendimi i 4 gushtit 2020, nr. 48756/14, § 160.

[89] *Buturugă k. Rumanisë*, vendimi i 11 shkurtit 2020, nr. 56867/15.

- » Zhvillimin e hetimeve pa vonesa të panevojshme;
- » Përpjekjet për të mbledhura provat relevante dhe për të marrë të gjitha masat e kërkuara për të ndriçuar rrethanat e çështjes;
- » Sigurimin që gjatë procedurave civile ose penale, provat në lidhje me historinë seksuale dhe sjelljen e viktimës do të lejohen vetëm në qoftë se janë relevante dhe të nevojshme;
- » Mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të viktimave, përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitare, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedurave gjyqësore, për shembull sigurimin që kontakti mes viktimave dhe kryesve në ambientet e gjykatës dhe ato ligjore të shmanget kur është e mundur; dhe
- » Mundësinë që këshilltarët e organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare të ndihmojnë dhe/ose të mbështesin viktimat, me kërkesën e këtyre të fundit, gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore.

Zhvillimi i hetimeve policore dhe procedurat ligjore vijuese duhet të respektojnë integritetin personal të një viktime sipas nenit 8, për shembull marrja në kundërpjetje në mënyrë të papërshtatshme ose agresive e një viktime gjatë gjyqit mund të përbëjë shkelje të nenit 8.<sup>[90]</sup>

Më tej, hetimet duhet të mbulojnë të gjitha aspektet e dhunës shtëpiake për të kuptuar në mënyrë të plotë të gjitha format e mundshme të dhunës si pjesë e një ankese. Për shembull, në qoftë se një individ pretendon se është viktimë e bullizmit në internet, e abuzimit emocional ose financiar nga partneri i saj abuzues, autoritetet duhet t'i hetojnë pretendime të tilla krahas çdo pretendimi tjetër për dhunë fizike brenda të njëjtës ankese / hetim për dhunë shtëpiake.<sup>[91]</sup>

Shtetet gjithashtu duhet të marrin masa për të mbrojtur viktimat nga abuzimi i mëtejshëm gjatë kohës që hetimet vazhdojnë. Edhe kur një kërkuese nuk ankohet

---

[90] Y. K. *Slovenisë*, vendimi i 28 majit 2015, nr. 41107/10, §114-116. Në Y. k. *Slovenisë*, Gjykata gjeti se në procedurat penale lidhur me sulmet e pretenduara seksuale kundër kërkueses, Shteti nuk i ofroi asaj mbrojtje të mjaftueshme për të drejtën e saj për respekt ndaj jetës private, dhe sidomos për integritetin e saj personal gjatë kohës që u mor në kundërpjetje nga i akuzuari.

[91] *Buturugă k. Rumanisë*, vendimi i 11 shkurtit 2020, nr. 56867/15: gjatë shqyrtimit të pretendimeve të kërkueses për bullizëm në internet dhe kërkesës së sak për të kontrolluar kompjuterin e familjes, Gjykata gjeti se autoritetet kombëtare ishin treguar tepër formale kur kishin hedhur poshtë çdo lidhje të mundshme me dhunën shtëpiake që ajo tashmë e kishte raportuar tek ato. Kërkuesja ishte detyruar të paraqiste një ankese të re ku pretendohet shkelja e konfidencialitetit të korrespondencës së saj. Gjatë shqyrtimit të ndarë të saj, autoritetet kishin dështuar të merrnin në konsideratë format e ndryshme që mund të kishte dhuna shtëpiake.



rreth natyrës së hetimeve penale për akuzat për abuzim në shtëpi, dështimi për të marrë masa parandaluese mbrojtëse krahas hetimit, si dështimi për të larguar një kryes të pretenduar nga vendbanimi i përbashkët me kërkuesen gjatë kohës që hetimet vazhdojnë, mund të përbëjë shkelje të nenit 8.<sup>[92]</sup>

Caktimi i masave të tilla mbrojtëse duhet të jetë në dispozicion që nga momenti që fillojnë hetimet, dhe nuk duhet të varen, për shembull, nga mbledhja e provave të mjaftueshme për të ngritur aktakuzë kundër një abuzuesi të pretenduar.<sup>[93]</sup>

### c) Detyrimi procedural sipas nenit 13 – e drejta për zgjidhje efektive

Neni 13 i Konventës përcakton të drejtën për zgjidhje efektive, duke deklaruar se 'çdokush të cilit/ës i shkelen të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare'.

Përveç detyrimeve procedurale të ngërthyera në nenet 2, 3 dhe 8, neni 13 cakton një detyrim të ndarë e largpamës, dhe ky është që 'neni 13 kërkon, përveç pagesës së kompensimit kur është e përshtatshme, hetime të plota dhe efektive në gjendje të çojnë drejt identifikimit dhe ndëshkimit të përgjegjësve, përfshirë qasjen efektive të ankueses në procedurën hetimore'.<sup>[94]</sup>

Kur ka shkelje të argumentueshme të një të drejte të Konventës, neni 13 kërkon dhënien e një zgjidhjeje efektive në nivel kombëtar. Dështimi për të trajtuar thelbin e një ankese relevante dhe mos-dhënia e një zgjidhjeje të përshtatshme mund të rezultojë në shkeljen nga Shteti të nenit 13.

[92] *Levchuk k. Ukrainës*, vendimi i 3 shtatorit 2020, nr. 17496/19, §90.

[93] *Volodina k. Rusisë (Nr. 2)*, vendimi i 14 shtatorit 2021, nr. 40419/19 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim): kur një urdhër i sapomarrë për të ndaluar një sjellje të caktuar u gjet se nuk ofronte mbrojtje të përshtatshme për viktimat në situatën e kërkueses, sepse urdhra të tilla viheshin në dispozicion vetëm pasi ishin mbledhur prova të mjaftueshme për të akuzuar kryesin, por në rastin e kërkueses hetimet nuk kishin shkuar përtej fazës së dyshimeve.

[94] Shih, për shembull: *Isayev dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 21 qershorit 2011, nr. 43368/04, §186-187; *Anguelova k. Bullgarisë*, vendimi i 13 qershorit 2002, nr. 38361/97, §161; *Mahmut Kaya k. Turqisë*, vendimi i 28 marsit 2000, nr. 22535/93, §107; *El-Masri k. "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë"*, vendimi i Dhomës së Madhe i 13 dhjetorit 2012, nr. 39630/09, §255; *Labita k. Italisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 prillit 2000, nr. 26772/95, §131.

## d) Dhuna shtëpiake dhe ajo e bazuar në gjini si diskriminuese sipas nenit 14

Gjykata e ka njohur dhunën e bazuar në gjini, përfshirë dhunën shtëpiake, si çështje e barazisë që angazhon nenin 14 të Konventës dhe çështje që prek në mënyrë të veçantë gratë (shih seksionin 1(b) (Parimet kyçe të së drejtës për mos-diskriminim sipas KEDNj-së) të këtij Udhërrëfytes për të parë një përmbledhje të kritereve të nenit 14).<sup>[95]</sup>

*Opuz k. Turqisë* ishte çështja e parë ku Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 14 (krahas neneve 2 dhe 3) në një çështje të dhunës shtëpiake. Gjykata gjeti se mos-reagimi i tërësishëm i sistemit gjyqësor turk ndaj çështjes së GBV dhe mos-ndëshkimi që gëzonin agresorët tregonin se kishte përkushtim të pamjaftueshëm nga ana e autoriteteve për të marrë veprimet e duhura për të adresuar dhunën shtëpiake, pavarësisht nga reformat e fundit legjislativë në lidhje me dhunën shtëpiake në Turqi.<sup>[96]</sup>

*Opuz* thekson tri tema shtesë në perspektivën e Gjykatës në lidhje me GBV si çështje diskriminimi sipas nenit 14:

[95] *Volodina k. Rusisë*, vendimi i 9 korrikut 2019, nr. 41261/17 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[96] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Kur e mori këtë vendim, Gjykata theksoi se stigma, stereotipet dhe paragjykimet kundër grave mund të bëjnë që autoritetet të refuzojnë t'i konsiderojnë viktimat e GBV-së si të tilla që e meritojnë mbrojtjen e Shtetit dhe të lejojnë në mënyrë pasive ose aktive veprimet e kryesve. Shih Sandra Fredman, "Dalja nga Errësira: Barazia Substanciale dhe Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", *Human Rights Law Review*, Volumi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 292. Një qasje e ngjashme me *Opuz k. Turqisë* u ndërmor edhe në çështjen e mëvonshme të *Eremia k. Republikës së Moldavisë*, vendimi i 28 majit 2013, nr. 3564/11. *Eremia* gjithashtu kishte të bënte me dhunën shtëpiake dhe rezultoi me gjetjen e një shkeljeje të nenit 14: kërkesja e parë ishte viktimë e dhunës shtëpiake në duart e burrit të saj, polic. Dy vajzat e tyre, kërkesja e dytë dhe e tretë, rregullisht kishin qenë dëshmitare të dhunës, gjë që kishte ndikuar në mirëqenien e tyre psikologjike. Gjykata vendosi që dështimi i autoriteteve për të mbrojtur kërkeset pasqyrore faktin se ato nuk e vlerësonin seriozitetin e dhunës kundër grave. Mungesa e konsideratës së autoriteteve për problemin e dhunës kundër grave në Republikën e Moldavisë përbëri trajtim diskriminues mbi bazën e seksit në shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 3.

1. Çështja konfirmon se nuk ekzistojnë barriera procedurale për pranueshmërinë e provave gjatë vlerësimit të Gjykatës të faktit nëse ka pasur dallime në trajtimin e kërkueses sa i përket GBV-së. Gjykata i pranoi provat statistikore të paraqitura nga kërkuesja në lidhje me rastet e dhunës shtëpiake kundër grave në rajonin e Turqisë, për të mbështetur përfundimin e saj se kërkuesja kishte treguar që dhuna shtëpiake prek kryesisht gratë dhe që pasiviteti mbizotërues dhe diskriminues në Turqi në lidhje me këtë çështje krijonte një klimë që çonte drejt dhunës shtëpiake.<sup>[97]</sup> Parashtrimi i gjetjeve, provave dhe raporteve që flasin për situatën e përgjithshme të grave që mbizotëron në shtet mund të përdoret për të treguar se ekziston njëanshmëria strukturore, që do të thotë se kërkuesja jo domosdoshmërisht ka nevojë të vërtetojë se ajo ka qenë viktimë e paragjykitimit individual.<sup>[98]</sup>
2. Gjykata nuk kërkoi prova të qëllimit nga ana e Shtetit për të diskriminuar kërkuesen në legjislacionin e tij dhe në trajtimin e çështjes. Kjo demonstroi parimin e 'zhvendosjes së barrës së provës' në lidhje me diskriminimin.
3. Gjykata tregoi pritshmërinë e saj që autoritetet vendase të vazhdonin të hetonin akuzat për GBV dhe dhunë shtëpiake, edhe pasi viktima e presupozuar e kishte tërhequr ankesën, siç kishte bërë kërkuesja në *Opuz*, pas kërcënimeve me vdekje nga kryesi kundër saj dhe vajzës së saj. Gjykata nënvizoi se nuk kishte konsensus të përgjithshëm mes Shteteve Kontraktuese në lidhje me faktin nëse duhet të zhvilloheshin procedura penale pas tërheqjes së një ankese. Pavarësisht, kishte shumë gjasa që ankesa ishte tërhequr nën presion të madh, përfshirë kërcënimet për dhunë. Prandaj, ajo vendosi që "sa më e rëndë që është vepra ose rreziku i veprave të mëtejshme, aq më shumë duhet që ndjekja penale të vazhdojë në interesin publik, edhe në qoftë se viktimat i tërheqin ankesat e tyre."<sup>[99]</sup>

Që nga çështja *Opuz*, Gjykata ka gjetur se trajtimi diskriminues nga një Shtet ndodh jo vetëm kur veprimet e autoriteteve përbëjnë dështim për të reaguar ndaj episodeve të dhunës, por edhe kur një Shtet ka treguar 'tolerancë të përsëritur' ndaj GBV-së që 'pasqyron sjellje diskriminuese karshi kërkueses si grua'.<sup>[100]</sup>

[97] Sandra Fredman, "Dalja nga Errësira: Barazia Substanciale dhe Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", *Human Rights Law Review*, Volumi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 292.

[98] *Tunikova dhe të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 14 dhjetorit 2021, nr. 55974/16, §129.

[99] *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02, §139 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); Sandra Fredman, " Dalja nga Errësira: Barazia Substanciale dhe Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", *Human Rights Law Review*, Volumi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 293.

[100] *Talpis k. Italisë*, vendimi i 2 marsit 2017, nr. 41237/14, §141. Ashtu si tek *Opuz k. Turqisë*,

Kur shtjellon çështje të dhunës shtëpiake, praktika aktuale e Gjykatës merr parasysh kriteret e Konventës së Stambollit (shih seksionin 1(f) të këtij Udhërrëfyese (Instrumentet e të Drejtës Ndërkombëtare)), posaçërisht qëndrimin e saj që Shtetet kanë detyrime "të veçanta" për zellin e duhur në lidhje me dhunën e bazuar në gjini, dhe që veçantia e akteve të dhunës shtëpiake, ashtu siç njihet në preambulën e Konventës së Stambollit, duhet të merret në konsideratë gjatë procedurave të brendshme.<sup>[101]</sup> Gjykata e përdor Konventën e Stambollit si instrument themelor për të interpretuar detyrimet pozitive të lidhura me të drejtat e ngërthyera në Konventë, duke vendosur kështu një standard gradualisht më të lartë të zellit të duhur sa u përket çështjeve të dhunës shtëpiake.<sup>[102]</sup>

### **Nevoja për masa mbrojtëse në lidhje me GBV sipas nenit 14**

Dështimi i një Shteti, edhe kur është i paqëllimshëm, për të mbrojtur gratë nga dhuna shtëpiake mund të shkelë të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë sipas ligjit.<sup>[103]</sup> Kjo afirmon nevojën që Shtetet të zbatojnë masa mbrojtëse për të luftuar dhunën kundër grave.

Gjykata i është përmbajtur këtij parimi në çështje kur një kërkueseje i është mohuar drejtësia për një periudhë prej disa viteve, edhe nëse Shteti gjatë kësaj kohe ka futur masa mbrojtëse përkatëse. Në *M.G. k. Turqisë*, Gjykata vendose se kishte pasur shkelje të neneve 3 dhe 14 në lidhje me dështimin e Shtetit për të ndjekur penalisht si duhet një pretendim për dhunë shtëpiake gjatë një periudhe prej pesë viteve e gjysmë.<sup>[104]</sup> Gjatë procedurave të gjata, në Turqi kishte hyrë në fuqi një ligj i ri i cili u ofronte grave të divorcuara mbrojtje nga ish-bashkëshortët e tyre. Pavarësisht nga ky ligj i ri, Gjykata konsideroi se realiteti ligjor në kohën

---

vendimi i 9 qershorit 2009, nr. 33401/02, §145, Gjykata iu referua të dhënave statistikore rreth dhunës shtëpiake në Itali, duke njohur se ky fenomen kryesisht prek gratë dhe se, pavarësisht nga reformat, një numër i konsiderueshëm grash vazhdojnë të vriten nga partnerët ose ish-partnerët, ndërkohë që diskriminimi socio-kulturor ndaj dhunës shtëpiake ende vazhdon.

[101] *Talpis k. Italisë*, vendimi i 2 marsit 2017, nr. 41237/14, §129.

[102] Sara De Vido, "Vendimi i GjEDNJ-së Talpis k. Italisë: Sfidimi i Testit Osman me Anë të Konventës së Stambollit të Këshillit të Evropës?", Ricerche Giuridiche Università Ca' Foscari Venezia, Volumi 6, Numër 2, dhjetor 2017.

[103] *M.G. k. Turqisë*, vendimi i 22 marsit 2016, nr. 646/10.

[104] *M.G. k. Turqisë*, vendimi i 22 marsit 2016, nr. 646/10. Gjykata gjithashtu theksoi në këtë çështje se, sipas Nenit 3 të Konventës së Stambollit, termi "dhuna kundër grave" duhet të kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe formë e diskriminimit kundër grave, duke afirmuar edhe një herë rëndësinë e asaj Konvente në arsyetimin e Gjykatës në lidhje me këtë fushë.

e ngjarjeve fillestare ishte i mjaftueshëm, duke pasur parasysh pasivitetin mbizotërues diskriminues në Turqi që çonte drejt dhunës shtëpiake, për të përbërë shkelje të nenit 14.

Ngjashëm, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 14 kur Shteti ka dështuar të siguronte që një urdhër i një gjykate vendase, pas ndjekjes penale për dhunë shtëpiake, në fakt është respektuar nga i pandehuri.<sup>[105]</sup>

### **Neni 14 dhe pragu minimal i rreptësisë sipas nenit 3**

Siç u diskutua më lart, në mënyrë që neni 3 të shkelet në lidhje me incidentet e dhunës shtëpiake / GBV, vepra duhet të arrijë një shkallë minimale të rreptësisë. Në praktikë, Gjykata ka njohur se pragu i një shkeljeje të nenit 3 është relativ<sup>[106]</sup> varësisht nga të gjitha rrethanat e çështjes.<sup>[107]</sup>

Trajtimi diskriminues në parim mund të përbëjë trajtim poshtërues brenda kuptimit të nenit 3 kur ai arrin një shkallë të tillë rreptësie që përbën sulm ndaj dinjitetit njerëzor.<sup>[108]</sup> Aktet të cilat të izoluara nuk do ta arrinin shkallën minimale të rreptësisë për shkelje të nenit 3 mund të kualifikohen si torturë dhe keqtrajtim për shkak të natyrës diskriminuese të një trajtimi të tillë.<sup>[109]</sup>

[105] *Halime Kiliç k. Turqisë*, vendimi i 28 qershorit 2016, nr. 63034/11. Gjykata vendosi në atë çështje se kishte pasur shkelje të neneve 2 dhe 14 në lidhje me vdekjen e vajzës së kërkueses, e cila u vra nga burri i saj pavarësisht se kishte bërë katër ankesa dhe kishte marrë tre urdhra mbrojtës dhe pengues. Shteti kishte dështuar të ndëshkonte burrin e vajzës së kërkueses për mosveprimin në pajtim me urdhrat e lëshuar kundër tij. Rrjedhimisht, autoritetet kombëtare i kishin zhveshur ato urdhra nga çdo efektivitet, duke krijuar kështu një kontekst të mos-ndëshkimit që i mundësoi atij ta sulmonte gruan e tij në mënyrë të përsëritur pa dhënë llogari – në shkelje të detyrimit pozitiv që përmban neni 2. Gjykata po ashtu e gjeti të papranueshme që vajza e kërkueses ishte lënë pa asnjë burim mbrojtjeje kur ishte përballur me sjelljen e dhunshme të burrit të saj dhe se, duke i bërë sytë qorr ndaj akteve të përsëritura të dhunës dhe kërcënimeve me vdekje ndaj viktimës, autoritetet kishin krijuar një klimë që çonte drejt dhunës shtëpiake.

[106] *Ireland k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 20 marsit 2018, nr. 5310/71, §130.

[107] *Khlaifia dhe të Tjerë k. Italisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2016, nr. 16483/12, §160.

[108] *M.C. dhe A.C. k. Rumanisë*, vendimi i 12 prillit 2016, nr. 12060/12.

[109] *Identoba dhe të Tjerë k. Gjeorgjisë*, vendimi i 12 majit 2015, nr.73235/12, § 65, duke cituar *Aziatikët Afrikanë-Veriorë k. Mbretërisë së Bashkuar*, raporti i Komisionit i datës 14 dhjetor 1973, nr. 4403/70 et al., § 208, *Smith dhe Grady k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 27 dhjetorit 1999, nr. 33985/96 dhe 3986/96, §121; dhe *Moldovan dhe të Tjerë k. Rumanisë* (Nr. 2), vendimi

Prandaj, natyra diskriminatore e dhunës shtëpiake / GBV mund të përbëjë faktor të rëndësishëm për të vlerësuar nëse është kaluar pragu minimal i rreptësisë për të angazhuar nenin 3.

### (3) Stereotipizimi gjinor në vendimet gjyqësore

Gjykata ka theksuar se përdorimi i gjuhës diskriminuese dhe stereotipeve gjinore në procedurat gjyqësore përbëjnë pengesë për mundësitë e grave për të pasur zgjidhje efektive dhe qasje të kënaqshme në drejtësi. Diskriminimi mund të marrë formën e:

- » Përdorimit të gjuhës seksiste ose diskriminuese gjatë procedurave ose në një vendim gjyqësor; dhe
- » Të mbështeturit tek prezumimet diskriminuese ose arsyetimet stereotipike për të justifikuar një vendim.

#### a) Gjuha seksiste ose diskriminuese

Përdorimi eksplicit i gjuhës seksiste ose diskriminuese nga autoritetet shtetërore përbën shkelje të nenit 14, duke pasur parasysh efektin negativ që ka tek e drejta e një individi për barazi.<sup>[110]</sup>

Gjuha stereotipike e përdorur nga autoritetet vendase gjithashtu mund të përbëjë shkelje të së drejtës së një kërkueseje nga neni 8 për respekt ndaj jetës personale dhe integritetit personal.<sup>[111]</sup> Përdorimi i një gjuhe dhe argumenteve të tilla njëkohësisht rrezikon të ekspozojë viktimat e GBV-së ndaj "viktimizimit sekondar" gjatë hetimeve dhe procedurave të ndjekjes penale, në kundërshtim me nenin 8.<sup>[112]</sup>

Shembuj të gjuhës dhe deklaratave në vendime gjyqësore të cilat janë gjetur se janë diskriminuese dhe/ose në shkelje të nenit 8 përfshijnë:<sup>[113]</sup>

---

i 12 korrikut 2005, nr. 41138/98 dhe 64320/01, § 111.

[110] *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë*, vendimi i 25 korrikut 2017, nr. 17484/15, §53-54.

[111] *J.L. k. Italisë*, vendimi i 27 majit 2021, nr. 5671/16 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[112] *J.L. k. Italisë*, vendimi i 27 majit 2021, nr. 5671/16 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[113] *J.L. k. Italisë*, vendimi i 27 majit 2021, nr. 5671/16, §141 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Gjykata vendosi se duke përdorur gjuhë "moraliste dhe faj-nxitëse" që dekurajon besimin e viktimave në sistemin gjyqësor, gjykatat italiane rrezikuan të ekspozonin viktimat femra të dhunës së bazuar në gjini ndaj "viktimizimit sekondar".

- » Komete rreth stilit të jetës së kërkueses të cilat nuk janë relevante për çështjen, siç janë komentet rreth qëndrimit të saj ndaj seksit, veshjes së saj, seksualitetit të saj dhe marrëdhënieve të saj seksuale në të kaluarën; dhe
- » Gjuhë moraliste ose gjuhë që nxit ndjenja faji.

## b) Arsyetimet, prezumimet dhe insinuatat stereotipike

Stereotipizimi i bazuar në gjini në të menduarit gjyqësor vendas mund të artikulohet si në mënyrë eksplicite, ashtu edhe në mënyrë implicite<sup>[114]</sup> dhe arsyetimi ose vendimet gjyqësore të bazuara mbi prezumime diskriminuese në aspektin e gjinisë mund të përbëjnë shkelje të nenit 14.<sup>[115]</sup>

Një vendim gjyqësor konsiderohet diskriminues kur ai bazohet në prezumime rreth grave dhe rolit të tyre në shoqëri, sidomos kur gjykata nuk e teston vlefshmërinë e atij prezumimi duke shtjelluar argumente të kundërta. Për shembull:

- » Prezumimi që një grua do ta lërë punën sapo të lindë fëmijë dhe do të jetë “aktive vetëm si grua shtëpiake dhe nënë”.<sup>[116]</sup>
- » Prezumimi që seksualiteti nuk është aq i rëndësishëm për një grua 50-vjeçare nënë e dy fëmijëve sa ç’është për dikë në moshë më të re.<sup>[117]</sup>

[114] *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë*, vendimi i 25 korrikut 2017, nr. 17484/15. Në këtë rast, ndërkohë që stereotipi në lidhje me moshën ishte eksplicit në pikëpamjen e gjykatës vendase që 50 vjeç është “një moshë kur seksi nuk është aq i rëndësishëm sa në vitet e rinisë”, stereotipi gjinor që gjithashtu implicit në pikëpamjen e gjykatës që kërkuesja nuk kishte nevojë për shërbëtoreshë/ndihmëse sepse ajo “mbase duhet të kujdesej vetëm për burrin e saj”.

[115] *Schuler-Zraggen k. Zvicrës*, vendimi i 24 qershorit 1993, nr. 14518/89.

[116] *Schuler-Zraggen k. Zvicrës*, vendimi i 24 qershorit 1993, nr. 14518/89, §64: Gjykata u mbështet në këtë prezumim për të arritur në përfundimin se, edhe sikur asaj të mos i ishte dashur të linte punën për shkak të një sëmundjeje të mushkërive që iu shfaq, ajo nuk do të kishte qenë ekonomikisht aktive për shkak të lindjes së një fëmije, kështu që asaj nuk i takonte pensioni i invaliditetit.

[117] *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë*, vendimi i 25 korrikut 2017, nr. 17484/15. Gjykata gjeti se vendimi i Gjykatës Administrative Supreme të Portugalisë ishte bazuar mbi stereotipet paragjyqëse rreth seksualitetit femëror, çka tregonte paragjykimet mbizotëruese në sistemin gjyqësor të Portugalisë. Gjykatat vendase në apel e kishin reduktuar kompensimin e kërkueses pas një operacioni të dështuar për shkak të të cilit ajo nuk mund të kishte marrëdhënie seksuale, gjë që e kishte çuar në depresion dhe mendime vetëvrasëse. Gjykatat vendase dolën në përfundimin se kompensimi i paguar duhet të ishte më i ulët meqenëse kërkuesja ishte në “një

- » Presumimi që seksualiteti femëror është i lidhur në thelb me qëllimin e lindjes së fëmijëve, duke injoruar rëndësinë fizike dhe psikologjike të vetpërbushjes së grave si njerëz. <sup>[118]</sup>

Në këtë kontekst, nuk ka nevojë për vlerësime të diskriminimit mbi bazën e seksit për të përfshirë një ushtrim krahasues me provat që një burrë do të trajtohej ndryshe mbi bazën e gjinisë së tij; përdorimi i gjuhës seksiste ose ekzistenca e arsytimit të bazuar mbi prezumimet stereotipike janë të mjaftueshme për të gjetur shkelje të nenit 14. <sup>[119]</sup>

Kur trajtohet një diskriminim i pretenduar në këtë kontekst është gjithashtu me rëndësi të merrin parasysh të dhëna dhe raporte më të gjera statistikore të cilat janë prova të një konteksti më të gjerë stereotipesh në lidhje me rolin e grave në shoqërinë e Shtetit në fjalë. <sup>[120]</sup>

Gjykata gjithashtu njeh se nënkuptime dhe prezumime të tilla mund të jenë pasojë e ndërthurjes së shumë bazave të diskriminimit. Për shembull, ndërveprimi i moshizmit (ang. ageism) dhe seksizmit për të minuar rëndësinë e seksit jo-riprodhues në jetën e një gruaje. <sup>[121]</sup>

---

moshë kur seksi nuk është aq i rëndësishëm sa në vitet e rinisë, ku rëndësia e tij zvogëlohet me kalimin e moshës". Më tej, një prej arsyeve për reduktimin e shumës së caktuar të kompensimit ishte se, duke pasur parasysh moshën e fëmijëve të kërkuases, ajo "mbase duhet të kujdesej vetëm për burrin e saj" dhe kjo kërkonte shpenzime më të vogla shtëpiake.

[118] *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë*, vendimi i 25 korrikut 2017, nr. 17484/15, §52.

[119] *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë*, vendimi i 25 korrikut 2017, nr. 17484/15. Në një opinion të ndarë pajtues, Gjyqtarja Yudkivska theksoi se "kur stereotipet gjyqësore prekin vlerësimin gjyqësor të provave, është krejtësisht e mjaftueshme të gjendet shkelje e nenit 14".

[120] Në *Opuz, Talpis dhe J.L.*, Gjykata që dukshëm e kënaqur të pranonte të dhëna statistikore si prova, duke shënuar raportet nga OKB dhe GREVIO mbi eliminimin e diskriminimit kundër grave të Itali, dhe duke arritur në përfundimin se këto raporte tregonin këmbënguljen e stereotipeve në lidhje me rolin e grave në shoqërinë italiane dhe rezistencën e asaj shoqërie ndaj kauzës së barazisë seksuale.

[121] *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë*, vendimi i 25 korrikut 2017, nr. 17484/15, shih seksionin (3) (Stereotipet gjinore në vendimet gjyqësore) të këtij Udhërrëfytyesi për diskutim të mëtejshëm.



## c) Diversiteti gjinor i gjyqësorëve kombëtarë

Gjykata gjithashtu ka zhvilluar jurisprudencë në lidhje me diversitetin gjinor të gjyqësorëve kombëtarë. Në lidhje me diversitetin e anëtarëve të gjyqësorit, procesi i emërimit të një gjyqtari/eje të re duhet të jetë në përputhje me kriteret e të drejtës përkatëse vendase për barazi.<sup>[122]</sup>

Instrumentet përkatëse ndërkombëtare gjithashtu inkurajojnë promovimin e përfaqësimit më të madh të grave dhe pakicave në gjyqësor.<sup>[123]</sup> Për shembull, Komisioni i Venecias për Demokraci përmes Ligjit i KE-së, teksta thekson se merita duhet të jetë kriteri parësor në përzgjedhjen e anëtarëve/eve të gjyqësorit, ka deklaruar se diversiteti brenda gjyqësorit do të mundësojë që publiku të ketë besim dhe ta pranojë gjyqësorin në tërësi. Prandaj, pozitativ gjyqësore duhet të jenë të hapura dhe qasja duhet t'i lejohet të gjithë personave të kualifikuar në të gjithë sektorët e shoqërisë.<sup>[124]</sup>

Më tej, Plani i Veprimit i KE-së thotë se ekuilibri gjinor dhe, më përgjithësisht, përfaqësimi i shoqërisë në tërësi, në përbërjen e gjyqësorit duhet të promovohet në çdo nivel, përfshirë edhe nivelet më të larta.<sup>[125]</sup> Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë konsideron se kjo është e udhës të inkurajohen aplikimet për emërimet gjyqësore nga gratë dhe pakicat etnike, dhe ka theksuar nevojën për të arritur barazinë mes grave dhe burrave në gjyqësor.<sup>[126]</sup>

[122] *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, §260-262.

[123] Parimet Bazë të OKB-së parashikojnë se gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve/eve nuk duhet të ketë diskriminim kundër një personi për shkak të racës, ngjyrës, seksit, fesë, opinionit politik ose tjetër, prejardhjes kombëtare ose shoqërore, pasurisë, lindjes ose statusit, ku vetëm kriteri që kandidati/ja për detyrën zyrtare të jetë shtetas/e i/e vendit në fjalë nuk do të konsiderohet diskriminues; shih gjithashtu <https://undocs.org/A/HRC/32/34>, "Raporti i Raportuesit Special mbi pavarësinë e gjyqtarëve/eve dhe avokatëve/eve", Këshilli i të Drejtave të Njeriut, 5 prill 2016: Raporti deklaroi se Shtetet gjithashtu duhet të sigurohen që secili/a mund t'i futet profesionit ligjor, shërbimeve prokuroriale dhe gjyqësorit pa asnjë lloj diskriminimi, në mënyrë të veçantë mbi bazën e gjinisë; Shtetet duhet të promovojnë përfaqësimin më të madh të grave dhe pakicave.

[124] Shih <https://rm.coe.int/1680700a63>, "Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I", Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, mars 2010.

[125] Shih <https://rm.coe.int/1680700285>, "Plani i Veprimit për Fuqizimin e Pavarësisë dhe Paanshmërisë Gjyqësore", Këshilli i Evropës, prill 2016, Veprimi 1.2.

[126] Shih <https://rm.coe.int/1680747830>, "Opinion Nr. 1 mbi Standardet Lidhur me Pavarësinë

## (4) Diskriminimi mbi bazën e seksit në lidhje me të drejtën për respekt të jetës private dhe familjare

Përgjatë viteve, Gjykata ka zhvilluar jurisprudencë në lidhje me diskriminimin mbi bazën e seksit në sferën e jetës private dhe familjare në një gamë të gjerë çështjesh, ku kërkesat shpesh kërkonin angazhimin e nenit 14 në lidhje me nenin 8. Shih seksionin 2(a) (Shikim i përgjithshëm mbi detyrimet procedurale dhe substanciale sipas Konventës) të këtij Udhërrëfyese për një përmbledhje të strukturës së nenit 8 dhe të praktikës gjyqësore sipas nenit 8 në lidhje me dhunën shtëpiake / GBV). Jeta private sipas nenit 8 është koncept i gjerë:

*“nacioni i “jetës private” brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës është koncept i gjerë i cili përfshin, inter alia, të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qenie njerëzore të tjera [...] të drejtën për “zhvillim personal” [...] ose të drejtën për vetvendosje si e tillë. Ai përfshin elemente siç janë emrat [...] identifikimi gjinor, orientimi seksual dhe jeta seksuale, të cilat hyjnë brenda sferës personale të mbrojtur nga neni 8 [...] dhe të drejtën për respektimin si të vendimit për të bërë fëmijë, ashtu edhe të vendimit për të mos bërë fëmijë”.*<sup>[127]</sup>

Përbërësi thelbësor i jetës familjare është përkufizuar nga Gjykata si e drejta për të jetuar së bashku në mënyrë që marrëdhëniet familjare të mund të zhvillohen natyrshëm,<sup>[128]</sup> dhe në mënyrë që anëtarët e familjes të mund të shijojnë shoqërinë e njëri-tjetrit.<sup>[129]</sup> Jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me diskriminimin në këtë aspekt diskutohet më poshtë sipas tematikave.

### a) Të Drejtat e prindërimit

Shtetet duhet të implementojnë mekanizma efektive përmes të cilave baballarët mund të kontestojnë ose të përcaktojnë atësinë e një fëmije.<sup>[130]</sup> Për sa i përket interesit të tyre në kontestimin e statusit të atësisë, Gjykata i sheh nënat dhe baballarët në situata analoge për qëllimet e nenit 14.<sup>[131]</sup> Në disa rrethana të

---

e Gjyqësorit dhe Mos-Shkarkimin e Gjyqtarëve”, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve/eve Evropianë/e, nëntor 2001, §31.

[127] *E.B. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 janarit 2008, nr. 43546/02, §43.

[128] *Marckx k. Belgjikës*, vendimi i 13 qershorit 1979, nr. 6833/74, §31.

[129] *Olsson k. Suedisë (Nr.1)*, vendimi i 24 marsit 1988, nr. 10465/83, §59.

[130] *Paulik k. Sllovakisë*, vendimi i 10 tetorit 2006, nr. 10699/05.

[131] *Paulik k. Sllovakisë*, vendimi i 10 tetorit 2006, nr. 10699/05, §54.

caktuara, megjithatë, dallimi në trajtimin e nënave dhe baballarëve mund të jetë i justifikuar në interes të sigurisë ligjore dhe për të mbrojtur interesat e fëmijëve dhe sigurinë e marrëdhënies familjare. Për shembull, në rrethanat të caktuara lejohet futja e afateve të ndryshme kohore për fillimin e procedurave të atësisë.<sup>[132]</sup> Megjithatë, baballarët e supozuar duhet të kenë të paktën një mundësi për të konstatuar ose konstatuar atësinë e një fëmije, dhe nuk duhet të pengohen për ta bërë këtë për shkak të zbatimit të ngurtë të afateve kohore në lidhje me fillimin e procedurave.<sup>[133]</sup>

Anasjelltas, nëna e një fëmije duhet të ketë të njëjtat të drejta për të kontestuar atësinë ashtu si babai i supozuar.<sup>[134]</sup> Respekti për jetën familjare sipas nenit 8 kërkon që realiteti biologjik dhe shoqëror duhet të ketë mundësinë të mbizotërojë ndaj një prezumimi ligjor në lidhje me të drejtat prindërore. Për shembull, një nënë duhet të ketë mundësinë për të kontestuar një prezumim ligjor që bashkëshorti i saj është njëkohësisht babai i fëmijës së saj, kur realiteti biologjik dhe shoqëror është se babai i fëmijës është një burrë tjetër.<sup>[135]</sup>

Përfundimisht, kur lipset të konstatohen ose të kontestohen të drejtat e atësisë, secili prind duhet të ketë fushëveprimin për të kërkuar vlerësim që merr parasysh të gjitha rrethanat e çështjes. E drejta për jetën private dhe familjare të një babai të supozuar duhet të peshohet me interesat më të mira të fëmijës, dhe me të drejtën për jetë familjare të prindërve me të cilët jeton fëmija,<sup>[136]</sup> duke marrë parasysh realitetin shoqëror të situatës. Për shembull, shkalla e kontaktit ose lidhjes mes një babai të supozuar dhe fëmijës.<sup>[137]</sup>

[132] *Rasmussen k. Danimarkës*, vendimi i 28 nëntorit 1984, nr.8777/79, §41.

[133] *Krahaso Mizzi k. Maltës*, vendimi i 12 janarit 2006, nr. 26111/02 me *Rasmussen k. Danimarkës*. Në këtë çështjen e fundit, Gjykata vendosi që institucioni i afateve të ndryshme kohore mes bashkëshortëve dhe bashkshorteve mund të justifikohet me dëshirën për të garantuar sigurinë ligjore dhe për të mbrojtur interesat e fëmijës. Megjithatë, në atë rast, kërkuesi pati mundësinë ta mohonte fëmijën gjatë pesë viteve pas lindjes dhe brenda 12 muajve pasi ishte bërë i vetëdijshëm për rrethanat që mundësonin bazën për kontestimin e atësisë. Përndryshe, tek *Mizzi. K. Maltës*, kërkuesi nuk e pati mundësinë ta bënte këtë. Zbatimi i afatit kohor dhe refuzimi për të lejuar përjashtimin nga kjo rregullë u gjetën se e kishin privuar atë nga mundësia për të ushtruar të drejtat e garantuara nga nenet 6 dhe 8 të Konventës.

[134] *Kroon dhe të Tjerë k. Holandës*, vendimi i 27 tetorit 1994, nr. 18535/91.

[135] *Kroon dhe të Tjerë k. Holandës*, vendimi i 24 tetorit 1994, nr. 18535/91.

[136] *Rózański k. Polonisë*, vendimi i 18 majit 2006, nr. 55339/00, §78-79.

[137] *Nylund k. Finlandës*, vendimi i 29 qershorit 1999, nr. 27110/95, në të cilin pati rëndësi që kërkuesja nuk e kishte parë fëmijën e as nuk kishte formuar lidhje emocionale me të. Kjo çështje

## b) Kujdestaria e fëmijëve dhe kontakti me fëmijët

Historikisht, Gjykata ka qenë e përgatitur për të pranuar trajtimin e diferencuar mes nënave dhe baballarëve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve në rastet kur prindërit e fëmijës nuk kanë qenë të martuar.<sup>[138]</sup> Vendime të tilla janë justifikuar me pikëpamjet e Gjykatës që një marrëdhënie e fortë familjare mes një fëmije dhe nënës së vet përcaktohet nga vetë ngjarja e lindjes, ku nënat e pamartuara e mbajnë këtë lidhje familjare, ndërsa babai i pamartuar i një fëmije mund të mos jetë i gatshëm për të marrë përsipër ndonjë detyrim familjar. Në jurisprudencën e saj që prej viteve 1980, Gjykata ka gjetur se dhënia e të drejtës së kujdesit dhe kujdestarisë së një fëmije prindërve të pamartuar ekskluzivisht nënës, edhe në qoftë se të dy prindërit jetojnë së bashku, ka qenë pasojë ligjore proporcionale e zgjedhjes së çiftit për të mos u martuar.<sup>[139]</sup>

Megjithatë, ky qëndrim është gërryer nga praktika gjyqësore bashkohore. Tani Gjykata vazhdimisht përforcon qëndrimin se nocioni i "jetës familjare" tek neni 8 nuk është i kufizuar vetëm në marrëdhëniet e bazuara në martesë dhe mund të përfshijë lidhje të tjera *de facto* "familjare" kur palët bashkëjetojnë jashtë martesës.<sup>[140]</sup> Gëzimi i ndërsjellë i shoqërisë së njëri-tjetrit mes një prindi dhe një fëmije përbën element themelor të jetës familjare sipas nenit 8, edhe kur marrëdhënia mes prindërve është ndërprerë.<sup>[141]</sup> Si rezultat, duhet të jepen arsye shumë me peshë për ta parë dallimin në trajtim mbi bazën e seksit ose lindjes në martesë apo jashtë saj si në pajtueshmëri me Konventën në këtë kontekst.<sup>[142]</sup>

Në kontekstin e procedurave të kujdestarisë nga një baba, ekzistenca ose mos-ekzistenca e "jetës familjare" brenda kuptimit të nenit 8 është çështje fakti, e cila nuk varet nga statusi martesor i babait. Vlerësimi i faktit nëse angazhohet neni 8, dhe/ose nëse ka ndërhyrje tek neni 8, varet nga vlerësimi i ekzistencës në praktikë të lidhjeve të afërta personale mes fëmijës dhe babait, veçanërisht interesi dhe përkushtimi i tregueshëm nga babai për fëmijën para dhe pas lindjes.<sup>[143]</sup> Për

---

u dallua nga *Kroon dhe të Tjerë*, ku kërkuesit kishin lidhje emocionale me fëmijët në fjalë.

[138] *B., R. dhe J. k. Republikës Federale të Gjermanisë*, vendimi i 15 marsit 1984, nr. 9639/82.

[139] *B., R. dhe J. k. Republikës Federale të Gjermanisë*, vendimi i 15 marsit 1984, nr. 9639/82, §4-5.

[140] *Kroon dhe të Tjerë k. Holandës*, vendimi i 24 tetorit 1994, nr. 18535/91, § 30.

[141] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/04, § 51.

[142] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043.

[143] *L. k. Holandës*, vendimi i 1 qershorit 2004, nr. 45582/99, §3.

shembull, sa gjatë ka jetuar babai me fëmijën, deri në ç'masë ai ka plotësuar nevojat e fëmijës, dhe sa kontakte ka pasur me fëmijën.<sup>[144]</sup>

Gjykata e pranon se mund të justifikohet mbrojtja e interesave të një fëmije duke atribuar fillimisht autoritetin prindëror ndaj fëmijës tek nëna e tij, për t'u siguruar që ka një person në lindje që mund të veprojë për fëmijën në mënyrë ligjërisht detyruese.<sup>[145]</sup> Më tej, mund të ekzistojnë arsye valide për t'i mohuar një babai të pamartuar pjesëmarrjen në autoritetin prindëror, për shembull, në qoftë se argumentet ose mungesa e komunikimit mes prindërve rrezikon të vërë mirëqenien e fëmijës në rrezik. Sidoqoftë, Shtetet nuk duhet të zbatojnë ligje ose politika në këtë fushë mbi bazën e një prezumimi të përgjithshëm që këto probleme janë tipar i përgjithshëm i marrëdhënies mes baballarëve të pamartuar dhe fëmijëve të tyre.<sup>[146]</sup> Më përgjithësisht, Shtetet nuk duhet të imponojnë prezumimin e përgjithshëm se kujdestaria e përbashkët kundër vullnetit të nënës është *prima facie* jo në interes të fëmijës.<sup>[147]</sup>

Babai duhet ta ketë mundësinë të kërkojë kujdestarinë e përbashkët të fëmijës, pavarësisht nëse ai është i martuar me nënën e fëmijës ose jo.<sup>[148]</sup> Gjykatat vendase nuk duhet ta pengojnë ose të krijojnë pengesa ligjore në procedurat e kujdestarisë për baballarët e pamartuar kur pengesa të tilla nuk ekzistojnë për nënat.<sup>[149]</sup> Të dy prindërit duhet të kenë qasje në një procedurë të drejtë vendimmarrëse për të vendosur mosmarrëveshjet lidhur me kujdestarinë. Procedura të tilla vendimmarrëse duhet të marrin parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, pa u mbështetur në prezumime të përgjithshme ose gjinore rreth marrëdhënies mes një fëmije dhe nënës dhe babait të tij. Për shembull, Gjykata ka gjetur shkelje të Konventës në rrethanat e mëposhtme:

[144] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043.

[145] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043, §55.

[146] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043, §56.

[147] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043, §59.

[148] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043; see also: *Sporer k. Austria*, vendimi i 3 February 2011, nr. 35637/03; *Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 qershorit 2003, nr. 31871/96, §91.

[149] *Zaunegger k. Gjermanisë*, vendimi i 3 dhjetorit 2009, nr. 22028/043; shih gjithashtu: *Sporer k. Austrisë*, vendimi i 3 shkurtit 2011, nr. 35637/03; *Sommerfeld k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 8 korrikut 2003, nr. 31871/96, §91.

- » Një vendim për t'i dhënë përgjegjësinë prindërore nënës së një fëmije, duke u mbështetur vetëm tek mosha e fëmijës dhe nevoja e saj për 'kujdesin dhe ngrohtësinë e nënës' (jo të babait) pa shqyrtuar asnjë rrethanë tjetër të çështjes.<sup>[150]</sup>
- » Një vendim për t'i dhënë përgjegjësinë prindërore ekskluzivisht nënës duke u bazuar tek orientimi seksual i babait.<sup>[151]</sup>

Kur kujdestaria i jepet njërit prind, Shteti ka detyrimin pozitiv që të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të lehtësuar kontaktin me prindin jo-kujdestar, deri në atë masë sa kjo mund të kërkohe në rrethanat e veçanta të një rasti. Kjo mund të përfshijë, për shembull, kriterin për të siguruar kontakte efektive mes një babai dhe bijës së tij në një kohë që përputhet me orarin e punës dhe udhëtimet e punës që ka babai.<sup>[152]</sup>

### c) Adoptimi

Neni 8 nuk garanton të drejtën për të themeluar familje (e cila përmbahet në nenin 12 – e drejta për t'u martuar, megjithëse praktika gjyqësore në lidhje me këtë pikë është e paktë) ose për të drejtën eksplicite për të adoptuar.<sup>[153]</sup> Megjithatë, e drejta për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qenie njerëzore të tjera, si dhe vendimet për të bërë ose për të mos bërë fëmijë, hyjnë brenda fushëveprimit të nenit 8.<sup>[154]</sup> Si rezultat, çështjet që kanë të bëjnë me adoptimin hyjnë brenda kompetencës së Gjykatës.

Ndërkohë që një pjesë e madhe e praktikës gjyqësore në këtë fushë ka të bëjë me dallimet në trajtim sa i përket orientimit seksual, më shumë sesa gjinisë, kjo sidoqoftë ilustron mendimin e Gjykatës kohët e fundit mbi diskriminimin në lidhje me adoptimin.

Masat kombëtare që pengojnë adoptimin kryesisht për shkak të orientimit seksual të kërkuesit/es janë diskriminuese, në mënyrë të veçantë kur njëkohësisht ekzistojnë masa që lejojnë adoptimin nga prindër beqarë.<sup>[155]</sup> Megjithatë, në një

[150] *Ilker Ensar Uyanik k. Turqisë*, vendimi i 3 majit 2012, nr. 60328/09, §57.

[151] *Salgueiro da Silva Mouta k. Portugalisë*, vendimi i 21 dhjetorit 1999, nr. 33290/96.

[152] *Gluhaković k. Kroacisë*, vendimi i 12 prillit 2011, nr. 21188/09.

[153] *E.B. k. France*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 janarit 2008, nr. 43546/02, §41.

[154] *E.B. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 janarit 2008, nr. 43546/02, §43.

[155] In *E.B. k. Francës*, kërkueses iu refuzua adoptimi i një fëmije sepse në shtëpinë e saj nuk kishte model mashkullor. Meqenëse e drejta kombëtare u lejonte prindërve beqarë që të adoptonin

çështje ku partneri civil homoseksual i një nëne biologjike kërkoi të adoptonte fëmijën e saj, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 13 mbi bazën se situata e kërkuesve nuk ishte e krahasueshme me atë të një çifti të martuar sepse, sipas ligjeve franceze, martesë u jepte status special atyre që martoheshin dhe KEDNJ-ja nuk shkante aq larg sa të detyronte Shtetet të mbështesnin martesat brenda seksit të njëjtë.<sup>[156]</sup>

Gjykata theksoi se edhe një çifti heteroseksual në partneritet civil gjithashtu do t'i refuzohej kërkesa sipas dispozitave përkatëse dhe kështu, ndërkohë që kërkuesit ndodheshin në një situatë ligjore të krahasueshme, nuk kishte dallim në trajtim mbi bazën e orientimit të tyre seksual.<sup>[157]</sup>

#### d) Leja prindërore nga puna

Në lidhje me të drejtën e lejes prindërore pas lindjes së një fëmije, Gjykata i sheh burrat dhe gratë në pozita analoge. Ndërkohë që leja e lindjes për nënën ka për qëllim t'i mundësojë një gruaje të marrë veten pas lindjes së fëmijës dhe ta ushqejë beben e saj me gji nëse dëshiron, leja prindërore ka të bëjë me një periudhë të mëpasme dhe shihet si e tillë që ka për qëllim t'i mundësojë një prindi që të qëndrojë në shtëpi për t'u kujdesur personalisht për beben e sapolindur. Ndërkohë që ekzistojnë dallime mes nënës dhe babait nga aspekti i marrëdhënies së tyre me fëmijën, kur bëhet fjalë për të kujdesurit për fëmijën gjatë lejes prindërore, burrat dhe gratë shihen si "në pozita të ngjashme" për sa i përket të drejtës së tyre për leje prindërore.<sup>[158]</sup>

---

fëmijë, GjEDNJ-ja gjeti se vendimi i autoriteteve ishte bazuar kryesisht në faktin se kërkuesja kishte qenë në marrëdhënie bashkëjetese me një grua tjetër. Rrjedhimisht, GjEDNJ-ja gjeti se kishte pasur diskriminim për shkak të orientimit të saj seksual.

[156] *Gas dhe Dubois k. Francës*, vendimi i 15 marsit 2012, nr. 25951/07.

[157] Krahaso *Gas dhe Dubois k. Francës* me çështjen *X dhe të Tjerë k. Austrisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2013, nr. 19010/07, ku kërkueset po ashtu ishin çift i pamartuar i seksit të njëjtë ku njëra partnere dëshironte të adoptonte fëmijën e partneres tjetër. Ndryshe nga *Gas dhe Dubois*, dispozitat përkatëse të së drejtës austriake lejonin adoptimin nga prindi i dytë për çiftet e pamartuara heteroseksuale. Meqenëse ligji përbante një ndalim absolut të adoptimit nga prindi i dytë për çiftet e seksit të njëjtë, gjykatat kombëtare nuk i shqyrtuar themelet e kërkesës për adoptim, e as refuzimi i babait për dhënien e pëlqimit për adoptim nuk luajti rol në konsideratat e gjykatave kombëtare gjatë çështjes së kërkueseve. Gjykata gjeti se ky fakt përbënte dallim në trajtimin e kërkueseve në krahasim me çiftet e pamartuara heteroseksuale, i cili nuk ishte justifikuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektive.

[158] *Konstantin Markin k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 marsit 2012, nr. 30078/06, §132

Prandaj, çdo dallim në lejen prindërore që u ofrohet burrave dhe grave duhet të jetë i justifikuar. Kur shqyrtohet nëse një dallim në lejen prindërore për burrat dhe gratë është i justifikuar, ndarja tradicionale e roleve gjinore në shoqëri nuk është justifikim i arsyeshëm dhe objektiv për dallimin në trajtim. Mbështetja tek këto role i vazhdon stereotipet gjinore dhe përbën dizavantash si për karrierën e gruas, duke përforcuar përgjegjësinë e saj për kujdesin ndaj fëmijës, ashtu edhe për jetën familjare të burrit.<sup>[159]</sup> Në *Konstantin Markin k. Ruisë*, Gjykata gjeti:

*“Në mënyrë të veçantë, referencat në tradita, prezumimet e përgjithshme ose qëndrimet mbizotëruese shoqërore në një vend të dhënë janë justifikim i pamjaftueshëm për dallimin në trajtim mbi bazën e seksit. Për shembull, Shteteve u ndalohej që të imponojnë tradita të cilat rrjedhin nga roli parësor i burrit dhe roli dytësor i gruas në familje.”<sup>[160]</sup>*

### e) Të drejtat për vënien e emrit

Rregullat të cilat: (i) i ndalojnë prindërit nga vënia e mbiemrit të nënës për fëmijën;<sup>[161]</sup> ose (ii) i ndalojnë prindërit nga vënia e mbiemrit të nënës para mbiemrit të babait,<sup>[162]</sup> përbëjnë trajtim diskriminues mbi bazën e seksit. Gjykata e pranon që rregulla të tilla synojnë qëllimin legjitim të garantimit të respektit për traditën e unitetit familjar dhe mund t'i shërbejnë qëllimit të sigurisë ligjore. Megjithatë, traditat e përgjithshme dhe qëndrimi shoqëror i shumicës nuk mund të justifikojnë diskriminimin kundër grave. Më tej, qëllimi i ruajtjes së sigurisë ligjore po aq lehtë mund të arrihet duke vënë mbiemrin e nënës para mbiemrit të babait.

Prandaj, duhet të jetë e mundur që të derogohet nga çdo rregullë që ka të bëjë me imponimin automatik të mbiemrit atëror të një fëmije kur regjistrohet lindja e një fëmije të ri. Ndërkohë që rregulla që mbiemri atëror duhet të vihet përpara në rast mosmarrëveshjeje mes prindërve nuk është domosdoshmërisht në

(i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[159] *Konstantin Markin k. Ruisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 marsit 2012, nr. 30078/06 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Gjykata gjithashtu refuzoi të pranonte argumentin e Shtetit që leja prindërore për punonjësit e shërbimit ushtarak do të kishte efekt negativ në fuqinë luftarake dhe efikasitetin operacional të forcave të armatosura ruse.

[160] *Konstantin Markin k. Ruisë*, Grand Chamber vendimi i 22 March 2012, nr. 30078/06, §127 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[161] *Cusan dhe Fazzo k. Italisë*, vendimi i 7 janarit 2014, nr. 77/07.

[162] *León Madrid k. Spanjës*, vendimi i 26 tetorit 2021, nr. 30306/13.



përputhje me Konventën, pamundësia për të deroguar nga një rregullë e tillë është për së tepërmi e shtrënguar dhe diskriminuese.<sup>[163]</sup> Nuk është e mjaftueshme të ofrohet mundësia që një fëmijë të ndryshojë mbiemrin e vet më vonë, mundësia e ndryshimit të emrit në një kohë të mëvonshme nuk kundërvepron ndaj efekteve negative që potencialisht pëson një nënë (dhe potencialisht një fëmijë) si pasojë e pamundësisë për të përcaktuar emrin e fëmijës në lindje.<sup>[164]</sup>

Sa i përket të drejtës së çifteve të martuara për të zgjedhur mbiemrin e tyre të ri, Shteteve u kërkohet që të japin 'arsye shumë me peshë' për të justifikuar ndalimin e një familjeje nga marrja e mbiemrit të bashkëshortes si mbiemër.<sup>[165]</sup> Ngjashëm, është diskriminuese të ndalohen gratë e martuara nga mbajtja e mbiemrit të vet pas martesës, kur burrat lejohen ta mbajnë të tyrin.<sup>[166]</sup> Në lidhje me këtë temë, Gjykata ka gjetur:

*"Çështja e parë për Gjykatën është nëse tradita e pasqyrimin të unitetit familjar përmes emrit të burrit mund të shihet si faktor vendimtar në rastin konkret. Pra, që ajo traditë rrjedh nga roli parësor i burrit dhe roli dytësor i gruas në familje. Në ditët e sotme avancimi i barazisë së sekseve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë Turqinë, dhe në mënyrë të veçantë rëndësia që i jepet parimit të mos-diskriminimit i ndalon Shtetet nga imponimi një asaj tradite mbi gratë e martuara."<sup>[167]</sup>*

## f) Të drejtat transgjimore

Ndërkohë që të drejtat transgjimore janë gjerësisht jashtë fushëveprimit të këtij Udhërrëfyesi, këtu përfshihet një përmbledhje rreth disa vendimeve kyçe të Gjykatës, për shkak të mënyrës se si ndërthuren të drejtat transgjimore me të drejta të tjera të diskriminimit mbi bazën e gjinisë.

[163] *León Madrid k. Spanjës*, vendimi i 26 tetorit 2021, nr. 30306/13.

[164] *León Madrid k. Spanjës*, vendimi i 26 tetorit 2021, nr. 30306/13.

[165] *Burghartz k. Zvicrës*, vendimi i 22 shkurtit 1994, nr.16213/90. Në *Burghartz*, një familje zgjodhi mbiemrin e gruas si mbiemër familjar ('Burghartz'), ndërsa burri zgjodhi të krijonte një emër të dyfishtë duke përdorur të dy mbiemrat ('Schnyder-Burghartz'). Autoritetet zvicerane, pasi kishin shënuar Schnyder si mbiemri familjar, e refuzuan kërkesën e familjes për të zëvendësuar "Burghartz" si mbiemër familjar dhe "Schnyder Burghartz" si mbiemri i burrit.

[166] *Ünal Tekeli k. Turqisë*, vendimi i 16 nëntorit 2004, nr. 29865/96.

[167] *Ünal Tekeli k. Turqisë*, vendimi i 16 nëntorit 2004, nr. 29865/96, §63; shih gjithashtu *Losonci Rose dhe Rose k. Zvicrës*, vendimi i 9 nëntorit 2010, nr. 664/06.

Çështja *Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar* e ilustron këtë ndërthurje.<sup>[168]</sup> Tek *Goodwin*, kërkuesja – një grua transgjimore e cila kishte pasur operacion për ripërcaktimin e gjinisë – tha se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur detyrimin e saj pozitiv sipas nenit 8 duke refuzuar të njihje ligjërisht ripërcaktimin e gjinisë së saj.<sup>[169]</sup>

Kur gjeti shkelje të nenit 8, Gjykata njohe se si kishte ndryshuar konteksti shoqëror për njerëzit transgjimorë në shoqëritë e Shteteve Anëtare; konkretisht, prerogativa e Shtetit për të futur, ose jo, masa ligjore për të mbështetur njerëzit transgjimorë tani binte jashtë hapësirës së vlerësimit të Shtetit. Për më tepër, Gjykata theksoi se nuk kishte faktorë domethënës të interesit publik që peshonin kundër interesit të kërkueses në marrjen e njohjes ligjore të ripërcaktimit të gjinisë së saj.<sup>[170]</sup>

Gjykata gjithashtu kishte gjetur se ligjet vendase që i ndalonin personat transgjimorë që të martoheshin ishte shkelje e nenit 12 (e drejta për t'u martuar).<sup>[171]</sup> Gjykata tha se i takonte Shtetit Kontraktues të vendoste kushtet në të cilat një person që kërkonte njohje ligjore si person trans e konstatonte se ripërcaktimi i gjinisë ishte kryer efektivisht si dhe formalitetet e martesave të ardhshme, përfshirë, për shembull, informacionet që do t'u jepeshin bashkëshortëve të ardhshëm. Megjithatë, nuk kishte justifikim për pengimin e një personi trans nga gëzimi i të drejtës për t'u martuar në çfarëdo rrethanash.<sup>[172]</sup>

[168] *Christine Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2002, nr. 28957/95 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[169] Gama e çështjeve që kërkuesja ngriti para Gjykatës ishte e gjerë, por përfshinte ngacmimin dhe diskriminimin gjatë punës së saj, probleme me të drejtat e saj të pensionit dhe shtesa të tjera shtetërore, dhe në shumë raste kërkesa për të zgjedhur mes statusit të saj të zgjedhur transgjimor dhe përfitimit të shërbimeve si kredia bankare.

[170] *Christine Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2002, nr. 28957/95, §93 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[171] *I. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2002, nr. 25680/94. Në këtë çështje kërkuesja – një grua transgjimore që kishte bërë operacion për ripërcaktimin e gjinisë së saj – iu drejtua Gjykatës mbi bazën e neneve 8, 12 dhe 14 në lidhje me refuzimin për të njohur ligjërisht ndryshimin e gjinisë së saj. Ajo nuk kishte mundur të merrte një certifikatë lindjeje që tregonte statusin e saj si femër, dhe në disa raste i ishte kërkuar të paraqiste certifikatën origjinale të lindjes. Pasojat e këtyre ngjarjeve në jetën e saj kishin qenë të tilla që seksi kishte rëndësi ligjore – për shembull në lidhje me një aplikim për një kurs infermierie, punësim në një burg dhe hua studentore.

[172] Kur mori vendimin e saj në *I. K. Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjithashtu theksoi se neni 8

## g) Të drejtat seksuale dhe riprodhuese, përfshirë sterilizimi i detyruar

Ka një sërë çështjesh që hyjnë brenda fushëveprimit të të drejtave seksuale dhe riprodhuese, përfshirë abortin, sterilizimin e detyruar, dhe çështjet më të gjera të diskriminimit që dalin nga shtatzania, siç është konteksti i punësimit (shih seksionin 5 (Diskriminimi mbi bazën e seksit në punësim dhe në jetën publike) të këtij Udhërrëfyesit për diskutimin lidhur me këtë të fundit).

### **Aborti**

Gjykata zakonisht i ofron Shteteve një hapësirë të gjerë vlerësimi kur vjen puna tek rregullimi i abortit.<sup>[173]</sup> Megjithatë, Gjykata ka njohur se vendimi i një gruaje shtatzënë për ta vazhduar ose ndërprerë shtatzaninë bën pjesë në sferën e jetës private dhe autonomisë. Pra, ndërkohë që neni 8 nuk akordon të drejtën për të kryer abort, ligji që rregullon ndërprerjen e shtatzanisë nuk e angazhon nenin 8.<sup>[174]</sup>

Edhe pse jo çdo rregullore në lidhje me ndërprerjen e shtatzanisë përbën ndërhyrje tek e drejta për respekt të jetës private, ndalimi i abortit kur kërkohet për arsye shëndetësore dhe/ose të mirëqenies përbën ndërhyrje tek e drejta e një gruaje për jetën private sipas nenit 8, që do të thotë se një kufizim i tillë duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional në rrethanat relevante.<sup>[175]</sup>

Nëse një Shtet zgjedh ta lejojë abortin në situata të caktuara, korniza ligjore që rezulton për këtë qëllim duhet të jetë mjaftueshëm e qartë dhe e përdorshme për t'i mundësuar si një gruaje shtatzënë, ashtu edhe profesionistëve mjekësorë që kujdesen për të që t'i kuptojnë situatat në të cilat ajo mund të kryejë abort

---

ofronte mbrojtje për sferën personale të secilit individ, përfshirë të drejtën për të vendosur hollësitë e identitetit të vet si qenie njerëzore individuale, dhe se situata e pakënaqshme në të cilën jetonin transgjiorët post-operativ në një zonë të ndërmjetme si asnjëra gjini plotësisht nuk ishte më e qëndrueshme.

[173] *A, B dhe C k. Irlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 dhjetorit 2010, nr. 25579/05, §237 ku Gjykata gjeti se çështja se kur fillon e drejta e jetës hyn brenda hapësirës së vlerësimit të Shteteve, meqenëse nuk ka konsensus evropian në lidhje me përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës, që do të thotë se ishte e pamundur të jepej përgjigje për pyetjen nëse një fëmijë i palindur është person e rrjedhimisht i mbrojtur nga neni 2.

[174] *R.R. k. Polonisë*, vendimi i 26 majit 2011, nr. 27617/04, §§180-181.

[175] *A, B dhe C k. Irlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 dhjetorit 2010, nr. 25579/05, §214 and §245.

në mënyrë ligjore. Në këtë aspekt, nuk mjafton zbatimi i dispozitave të gjera në lidhje me situatat kur lejohet aborti. Dispozita të tilla duhet të zbatohen me anë të ligjeve të qarta dhe duke dhënë drejtim të qartë për profesionistët mjekësorë.<sup>[176]</sup>

Shteti ka detyrimin pozitiv sipas nenit 8 për të siguruar integritetin fizik të nënave të ardhshme. Në këtë aspekt, ai është i detyruar sipas nenit 8 që të sigurojë vënien në dispozicion të procedurave efektive dhe të përdorshme për të përcaktuar pozicionin ligjor të një gruaje në lidhje me të drejtën e saj për abort. Këto procedura duhet të sigurojnë që vendimet të jenë të kohshme, të kufizojnë ose të parandalojnë dëmet ndaj shëndetit të një gruaje që mund të shkaktohen nga aborti i vonshëm. Procedurat në të cilat vendimet lidhur me mundësinë për abort të ligjshëm shqyrtohen *post factum* nuk mund ta përmbushin një funksion të tillë. Më tej, procedura të tilla duhet të ofrojnë mënyra për të trajtuar dhe zgjidhur çdo konfuzion që mund të rezultojë nga opinionet mjekësore që dallojnë nga njëri-tjetri dhe duhet t'i garantojnë një gruaje shtatzënë të paktën mundësinë për t'u dëgjuar personalisht dhe për shqyrtim të pikëpamjeve të saj.<sup>[177]</sup>

Gjykata e ka njohur “efektin dekurajues” si te gratë, ashtu edhe te profesionistët mjekësorë të dispozitave penale që ndalojnë abortin, të cilat mund t'i pengojnë profesionistët mjekësorë nga autorizimi i abortit në mungesë të procedurave transparente dhe qartë të definuara për të përcaktuar se kur lejohet aborti.<sup>[178]</sup>

Neni 8 gjithashtu mbron të drejtën e një gruaje për të marrë informacione rreth shëndetit të saj. Kjo përfshin qasjen në testimin prenatal diagnostik dhe informacionet që janë thelbësore për marrjen e vendimit për ta vazhduar ose jo një shtatzani, për të marrë trajtimin në dispozicion, ose për t'u përgatitur për lindjen e fëmijës, përfshirë edhe rastet kur pikasen anomali të fetusit.<sup>[179]</sup>

E drejta për qasje në informacion rreth abortit gjithashtu mbrohet me nenin 10. Për shembull, një pengim që kufizonte lirinë për të marrë e dhënë informacione në lidhje me udhëtimin jashtë vendit për të kryer abort, kur një gjë e tillë është

[176] *A, B dhe C k. Irlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 dhjetorit 2010, nr. 25579/05, §249; *R.R. k. Polonisë*, vendimi i 26 majit 2011, nr. 27617/04 §187; *P. dhe S. k. Polonisë*, vendimi i 30 tetorit 2012, nr. 57375/08, § 99; *Tysiç k. Polonisë*, vendimi i 20 marsit 2007, nr. 5410/03, §§116 dhe 178.

[177] *Tysiç k. Poland*, vendimi i 20 March 2007, nr. 5410/03, §§107, §118-124.

[178] *A, B and C k. Irlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 dhjetorit 2010, nr. 25579/05, §254; *Tysiç k. Polonisë*, vendimi i 20 marsit 2007, nr. 5410/03, §116.

[179] *R.R. k. Polonisë*, vendimi i 26 majit 2011, nr. 27617/04.

e ligjshme, u gjet se kishte shkelur nenin 10. Gjykata theksoi se shërbime të tilla mund të jenë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e një gruaje.<sup>[180]</sup>

Në këtë kontekst, gratë e moshës “kur mund të lindin fëmijë” jo domosdoshmërisht duhet të jenë shtatzënë para se të bëjnë ankesë për qasjen në informacionet rreth abortit. Fakti që ato mund të mbesin shtatzënë, duke rrezikuar kështu paragjykimin nga masat që rregullojnë abortin, mund të jetë i mjaftueshëm për t’u dhënë atyre statusin e “viktimit” sipas nenit 34 të KEDNJ-së.<sup>[181]</sup>

Përveç kësaj, CEDAW parashikon që kriminalizimi i abortit është formë e “dhunës së bazuar në gjini e cila, varësisht nga rrethanat, mund të përbëjë torturë ose trajtim mizor, çnjerezor ose poshtërues.”<sup>[182]</sup>

Gjykata ka njohur se mohimi i qasjes në abort mund të angazhojë nenin 3.<sup>[183]</sup> Në këtë kontekst, është me rëndësi të njihet se mungesa e qëllimit për të poshtëruar ose ulur viktimën nuk është se pashmangshëm çon në gjetjen se nuk ka pasur shkelje të nenit 3. Veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve në fushën e politikave të kujdesit shëndetësor po ashtu mund të angazhojnë pëëgjegjësinë e tyre sipas nenit 3.<sup>[184]</sup> Gjatë marrjes së vendimit nëse neni 3 angazhohet në këtë kontekst, është me rëndësi të merret parasysh mosha dhe cenusshmëria relative e gruas ose vajzës në fjalë.<sup>[185]</sup>

Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 3 në rrethanat e mëposhtme:<sup>[186]</sup>

[180] *Open Door dhe Well Woman k. Irlandës*, vendimi i 29 tetorit 1992, nr.14234/88.

[181] *Open Door dhe Well Woman k. Irlandës*, vendimi i 29 tetorit 1992, nr.14234/88, §44.

[182] CEDAW, General Comment Nr. 35 mbi Dhunën e Bazuar në Gjini kundër Grave, Përditësimi i Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 19 (2017), (UN Doc. CEDAW/C/GC/35), para. 18.

[183] *A, B and C k. Irlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 dhjetorit 2010, nr. 25579/05, §160-164, megjithëse në këtë rast trajtimi në fjalë nuk u gjet se ishte në shkelje të nenit 3.

[184] *R.R. k. Polonisë*, vendimi i 26 majit 2011, nr. 27617/04, §§151-152.

[185] *P dhe S k. Polonisë*, vendimi i 30 tetorit 2012, nr. 57375/08, §§161-162.

[186] Në kohën e shkrimit, çështja e *K.B. dhe të Tjerë k. Polonisë*, nr. 1819/21, është komunikuar nga Gjykata. Më 22 tetor 2020, Gjykata Kushtetuese e Polonisë shpalli një vendim që dispozita vendase që ligjëronte abortin në rastet e anomalive të fetusit ishte në papajtueshmëri me Kushtetutën polake. Çështja ka të bëjë me faktin nëse kërkueset (gra të cilat nuk janë shtatzënë) tani por të cilat janë të shqetësuara për impaktin e vendimikt në rast se mbeten shtatzënë) mund të pretendojnë se janë viktime të një shkeljeje të të drejtave të tyre sipas nenit 8 dhe/ose nenit 3, nëse ka pasur ndërhyrje tek të drejtat e tyre nga neni 8, nëse ka pasur shkelje të detyrimeve pozitive të Shtetit sipas nenit 8, dhe nëse ngrihet ndonjë problem sipas nenit 3.

1. Kur një gruaje shtatzënë i është mohuar qasja në informacione rreth shëndetit të fetusit të saj për shkak të zvarritjeve të profesionistëve mjekësorë. Ajo duroi me javë të tëra pasigurie dhe ankthi të thellë në lidhje me shëndetin e fetusit të saj, shëndetin e vet dhe të ardhmen e familjes së saj, si dhe perspektivës së rritjes së një fëmije me një sëmundje të pashërueshme. Ajo i mori rezultatet e testeve të bebes së saj kur ishte tepër vonë për të marrë një vendim të informuar për ta vazhduar shtatzaninë apo për të kryer abort të ligjshëm, meqenëse kufiri kohor i përcaktuar me ligj tashmë kishte skaduar.<sup>[187]</sup>
2. Kur një vajzë 14-vjeçare mbeti shtatzënë pasi ishte përdhunuar, dhe mbi të dhe nënën e saj u bë presion i konsiderueshëm nga mjekët për ta mbajtur fëmijën, ajo u detyrua të fliste me një prift, spitali dha informacione për rastin e saj në organet e shtypit si pasojë e të cilave ajo mori mesazhe ndërhyrëse dhe të padëshiruara, asaj iu refuzua kërkesa për t'u mbrojtur nga aktivistët anti-abort, dhe në përgjithësi qasja e autoriteteve u gjet se ishin karakterizuar nga zvarritja, konfuzioni dhe mungesa e këshillimit dhe informacionit të duhur dhe objektiv.<sup>[188]</sup>

### **Vendimet për t'u bërë ose për mos t'u bërë prind**

Neni 8 gjithashtu zbatohet në vendimet për t'u bërë ose për mos t'u bërë prind. Për shembull, një individ lejohet ta tërheqë pëlqimin për përdorimin e embrioneve të krijuara së bashku me një person tjetër, edhe kur një gjë e tillë mund ta ndalojë personin tjetër nga të pasurit fëmijë të lidhur gjenetikisht me të. Megjithatë, rrethanat e pëlqimit për një proces të tillë duhet t'i shpjegohen qartë secilit pjesëmarrës në fillim të procesit. Për shembull, të dy palëve duhet t'u bëhet e qartë qysh në fillim se materiali gjenetik i tij ose i saj nuk mund të përdoret pa pëlqimin e të dyja palëve. Më tej, rregulloret për procedura të tilla duhet të jenë të qarta dhe të marrin parasysh implikimet shoqërore, etike dhe ligjore të zhvillimeve në fushën e fertilizimit njerëzor dhe embriologjisë, dhe duhet të vendosin një ekuilibër të konsiderueshëm mes interesave konkurruese për të cilat bëhet fjalë.<sup>[189]</sup>

Gjykata u jep Shteteve hapësirë të gjerë vlerësimi në këtë kontekst, duke njohur se përdorimi i trajtimeve in vitro (IVF) u jep shkas problemeve të ndjeshme morale dhe etike në kuadrin e zhvillimeve të vrullshme mjekësore dhe shkencore.<sup>[190]</sup>

[187] *R.R. k. Polonisë*, vendimi i 26 majit 2011, nr. 27617/04.

[188] *P dhe S k. Polonisë*, vendimi i 30 tetorit 2012, nr. 57375/08.

[189] *Evans k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 prillit 2007, nr. 6339/05.

[190] *Evans k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 prillit 2007, nr. 6339/05, §81.

## **Sterilizimi i detyruar**

Gjykata ka dëgjuar një sërë kërkesash në lidhje me sterilizimin e detyruar të grave, në mënyrë të veçantë gratë e origjinës rome (për një diskutim më tematik të të drejtave të grave rome, shih seksionin 8 të këtij Udhërrëfyesi (Diskriminimi mbi bazën e seksit – Gratë Rome)). Në *V.C. k. Sllovakisë*, Gjykata konfirmoi se, meqenëse ka të bëjë me një prej funksioneve thelbësore të trupit të qenieve njerëzore, sterilizimi prek aspekte të shumta të integritetit personal të individit, përfshirë mirëqenien e saj fizike dhe mendore, si dhe jetën emocionale, shpirtërore dhe familjare.<sup>[191]</sup> Rrjedhimisht, Shtetet kanë detyrimin pozitiv për të jetësuar mbrojtje ligjore efektive për të mbrojtur gratë nga sterilizimi jo-konsensual. Gratë rome në veçanti kanë nevojë për mbrojtje kundër sterilizimit për shkak të historikut të sterilizimit jo-konsensual të kësaj pakice etnike të cenueshme.<sup>[192]</sup> Kjo jurisprudencë gjithashtu zbatohet edhe për sterilizimin e paqëllimshëm, kur një mjek dështon të kryejë kontrollet e duhura ose të marrë pëlqimin e informuar gjatë një procedure aborti. Kur një grua kalon nëpër një procedurë mjekësore e cila mund të rezultojë në pamundësinë e saj për të pasur fëmijë, profesionistët mjekësorë duhet ta përfshijnë gruan në të gjitha zgjedhjet e trajtimit mjekësor që do të administrohet dhe ta informojnë atë siç duhet për rreziqet e procedurës mjekësore, për të marrë pëlqimin e saj të informuar.<sup>[193]</sup>

[191] *K.C. k. Sllovakisë*, vendimi i 8 nëntorit 2011, nr. 18968/07, §106; shih gjithashtu *N.B. k. Sllovakisë*, vendimi i 12 qershorit 2012, nr. 29518/10; *I.G. dhe të Tjerë k. Sllovakisë*, vendimi i 13 nëntorit 2012, nr.15966/04; *R.K. k. Republikës Çeke*, vendimi i 27 nëntorit 2012, nr. 7883/08; *G.H. k. Hungarisë*, vendimi i 9 qershorit 2015, nr. 54041/14.

[192] *K.C. k. Sllovakisë*, vendimi i 8 nëntorit 2011, nr. 18968/07, §154-5; *I.G. dhe të Tjerë k. Sllovakisë*, vendimi i 13 nëntorit 2012, nr. 15966/04, §143-6.

[193] *Csoma k. Rumanisë*, vendimi i 15 janarit 2013, nr. 8759/05, §65-68.

## (5) Diskriminimi mbi bazën e seksit në punësim dhe në jetën publike

Sferat e punës dhe jetës publike janë ambiente kyçe ku shfaqen pabarazia gjinore dhe diskriminimi mbi bazën e seksit. Pavarësisht nga kjo, struktura e Konventës nuk ofron trajtim të dukshëm të diskriminimit në punë. Nuk ka një të drejtë specifike për punë, dhe punëdhënësit privatë nuk janë të lidhur direkt pas Konventës.<sup>[194]</sup> Kjo shënon një kontrast të madh me jurisprudencën e mirëzhvilluar të GjDBE-së mbi diskriminimin në lidhje me punësimin dhe qasjen në mallra dhe shërbime, përfshirë nga firmat private (shih seksionin 1(e) të këtij Udhërrëfyesi (Ligjet e BE-së) për një përmbledhje të instrumenteve ligjore përkatëse të BE-së).

Gjithashtu, ESC mbron në mënyrë eksplicite të drejtën për pagë të barabartë dhe mundësi të barabarta mes burrave dhe grave. Neni 4§3 i ESC-së parashikon që palët kontraktuese duhet të njohin të drejtat e punonjësve burra dhe punonjëseve gra për pagën e barabartë për punë të vlerës së barabartë. ESC inkurajon zbatimin e ligjeve për garantimin e pagës së barabartë, si dhe mbledhjen e statistikave mbi pagat e cilësisë së lartë të ndara sipas gjinisë, çka mundëson analizën e shkaqeve të hendekut të pagës dhe lehtëson hartimin e politikave për të trajtuar hendekun gjinor të pagës.<sup>[195]</sup> Më tej, Neni 8 ESC përmban dispozita specifike për gratë e punësuar, siç është e drejta për leje të mjaftueshme lindjeje dhe mbrojtje kundër heqjes nga puna gjatë lejes së lindjes.

Sipas KEDNj-së, në këtë fushë dalin ngrihen disa çështje sipas nenit 8 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (e drejta e pronës), të cilat përmbledhen shkurtimisht më poshtë.

### a) Neni 1, Protokollit 1 i Konventës – e drejta e pronës

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës kërkon që “çdo person natyror ose ligjor ka të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë së tij”.<sup>[196]</sup> Nuk ka një të drejtë të përgjithshme eksplicite për sigurime shoqërore *per se* sipas Konventës: neni 1 i

[194] Sandra Fredman, “Dalja nga Errësira: Barazia Substanciale dhe Neni 14 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut”, Human Rights Law Review, Volumi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 290.

[195] Shih [https://www.youtube.com/watch?v=xtJokvpëa6A&list=PLy62ZXXxDue4-hbowjJO-SHmu\\_kV3V8LQo&index=4](https://www.youtube.com/watch?v=xtJokvpëa6A&list=PLy62ZXXxDue4-hbowjJO-SHmu_kV3V8LQo&index=4), “Equal pay and equal opportunities: a right under the European Social Charter”, Council of Europe Directorate General Human Rights and Rule of Laë YouTube channel, 12 May 2021.

[196] KEDNj, neni 1 i Protokollit Nr.1.



Protokollit Nr. 1 nuk vë kufizime mbi lirinë e Shteteve për të vendosur nëse duhet të kenë ose jo ndonjë lloj forme të skemës së sigurimeve shoqërore, ose nëse duhet të zgjedhin llojin apo shumën e shtesave të ofruara në kuadër të ndonjë skeme të tillë.<sup>[197]</sup>

Përkufizimi i termit “pasuri” në dispozitë përfshin si pasurinë e paluajtshme, ashtu edhe atë të luajtshme si dhe interesa të tjera pronësore. Shembuj të interesave pronësore të cilat janë vlerësuar se përbëjnë “pasuri” e rrjedhimisht hyjnë brenda kuadrit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, përfshijnë:

- » Disa forma të sigurimeve shoqërore siç janë pagesat shtesë dhe shtesat e sigurimeve shoqërore.<sup>[198]</sup> Kur një individ ka të drejtën e vërtetueshme sipas të drejtës vendase për shtesa të asistencës sociale, rëndësia e atij interesi nënkupton që neni 1 i Protokollit Nr. 1 duhet të zbatohet.<sup>[199]</sup>
- » Pensionet shtetërore,<sup>[200]</sup> pavarësisht nëse këto skema kontribuojnë apo jo.<sup>[201]</sup>
- » Interesi pronësor i një gruaje në trashëgimin nga bashkëshorti i saj i vdekur.<sup>[202]</sup>

[197] *Sukhanov dhe Ilchenko k. Ukrainës*, vendimi i 26 qershorit 2014, nr. 68385/10 dhe 71378/10, §36; *Kolesnyk k. Ukrainës*, vendimi i 3 qershorit 2014, nr. 57116/10, §89 dhe §91; *Fakas k. Ukrainës*, vendimi i 3 qershorit 2014, nr. 4519/11, §34, §37-43, §48; *Fedulov k. Rusisë*, vendimi i 8 tetorit 2019, nr. 53068/08, §66.

[198] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 dhe 65900/01, § 47-56 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[199] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01, §51 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Moskal k. Polonisë*, vendimi i 15 shtatorit 2009, nr. 10373/05, §39; *Andrejeva k. Letonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 2009, nr. 55707/00, §77.

[200] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Luczak k. Polonisë*, vendimi i 27 nëntorit 2007, nr. 77782/01; *Andrejeva k. Letonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 2009, nr. 55707/00; *Koua Poirrez k. Francës*, vendimi i 30 shtatorit 2003, nr. 40892/98; *Gaygusuz k. Austrisë*, vendimi i 16 shtatorit 1996, nr. 17371/90; *Pichkur k. Ukrainës*, vendimi i 7 nëntorit 2013, nr. 10441/06.

[201] *Bucheň k. Republikës Çeke*, vendimi i 26 nëntorit 2002, nr. 36541/97, §46; *Koua Poirrez k. Francës*, vendimi i 30 shtatorit 2003, nr. 40892/98, §37; *Wessels-Bergervoet k. Holandës*, vendimi i 4 qershorit 2002, nr. 34462/97; *Van den Bouwhuijsen dhe Schuring k. Holandës*, vendimi i 16 dhjetorit 2003, nr. 44658/98.

[202] *Molla Sali k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2018, nr. 20452/14.

Fakti që interesa të tilla pronësore hyjnë brenda kuadrit të nenit 1 të Protokollit Nr. 2 e bën nenin 14 të zbatueshëm në implementimin dhe aplikimin e skemave të tilla dhe jetësimin e këtyre të drejtave pronësore, që do të thotë se rregullat që rregullojnë qasjen në skemat e sigurimeve shoqërore, pensionet dhe trashëgimia nuk duhet të diskriminojnë kundër grave, sipas nenit 14 i lexuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

## b) Qasja në punësim

Pavarësisht nga kufizimet e dispozitave të Konventës mbi diskriminimin në vendin e punës, Gjykata ka marrë hapa për ta sjellë atë brenda kuadrit të KEDNJ-së. Ndërkohë që nga neni 8 nuk mund të nxirren të drejta të përgjithshme për punësimin, e drejta e qasjes në punësimin në sektorin publik, ose e drejta për të zgjedhur një profesion të caktuar, nocioni i "jetës private" nuk përjashton në parim aktivitetet e natyrës profesionale ose tregtare.<sup>[203]</sup> Në mënyrë të veçantë, ka disa aspekte tipike të jetës private të cilat mund të ndikohen gjatë mosmarrëveshjeve rreth punësimit, siç janë shkarkimi, ulja në pozitë, mos-pranimi në një profesion të caktuar ose masa të tjera të pafavorshme në mënyrë të ngjashme.<sup>[204]</sup>

Përkufizimi i Gjykatës për parametrat e 'jetës private' thekson rëndësinë e punës për mirëqenien materiale të një personi, për vetbesimin e tij/saj dhe marrëdhëniet me të tjerët:

*"koncepti i "jetës private" ngërthen aspekte që lidhen me identitetin personal, dhe seksi i një personi është pjesë e qenësishme e identitetit të tij/saj. Kështu, një masë aq drastike sa shkarkimi nga posti vetëm mbi bazën e seksit ka efekte negative mbi identitetin e një personi, mbi vet-perceptimin dhe vet-respektin dhe, për pasojë, në jetën e tij/saj private."*<sup>[205]</sup>

Për shkak se diskriminimi në punë mund të hyjë brenda kuadrit të nenit 8, neni 14 gjithashtu zbatohet në këtë kontekst.<sup>[206]</sup> Shkarkimi i një gruaje nga puna

[203] *Bărbulescu k. Rumanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 5 shtatorit 2017, nr. 61496/08, §71; *Jankauskas k. Lituaniës (Nr. 2)*, vendimi i 27 qershorit 2017, nr. 50446/09, §56-57; *Fernandez Martinez k. Spanjës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 qershorit 2014, nr. 56030/07, §109-110.

[204] *Denisov k. Ukrainës*, vendimi i 25 shtatorit 2018, nr. 76639/11.

[205] *Emel Boyraz k. Turqisë*, vendimi i 2 dhjetorit 2014, nr. 61960/08, §44; Sandra Fredman, "Dalja nga Errësira: Barazia Substanciale dhe Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", *Human Rights Law Review*, Volumi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 290.

[206] *Emel Boyraz k. Turqisë*, vendimi i 2 dhjetorit 2014, nr. 61960/08; shih gjithashtu *Hülya Ebru*

mbi bazën e faktit që është grua shkel nenin 14 në lidhje me nenin 8 në qoftë se autoritetet nuk mund të ofrojnë justifikim të mjaftueshëm për të shpjeguar pamundësinë e pretenduar të një gruaje për ta kryer atë rol po aq mirë sa një burrë. Në mënyrë të veçantë, në qoftë se gruaja në fjalë tashmë ka demonstruar që ajo mund ta kryejë atë rol në mënyrën e duhur.<sup>[207]</sup>

Mosmarrëveshjet në lidhje me diskriminimin mbi bazën e seksit në kontekstin e punësimit gjithashtu mund të hyjnë brenda kuadrit të nenit 6 (e drejta për gjyq të drejtë) në lidhje me nenin 14. Për shembull, dështimi i autoriteteve të punësimit për të zbatuar një vendim në lidhje me orarin e punës së një gruaje, ose dështimi për t'i ofruar një gruaje kompensim kur u gjet se ajo ishte përballur me diskriminim në vendin e punës, mund të shkelin nenin 6§1 në lidhje me nenin 14.<sup>[208]</sup>

### c) Bullizmi dhe ngacmimi në punë

Sipas nenit 8, Shtetet kanë detyrën që të ruajnë dhe të zbatojnë një kornizë ligjore të mjaftueshme që ofron mbrojtje kundër ngacmimit në punë.<sup>[209]</sup> Ankesat për bullizëm duhet të shqyrtohen hollësisht sipas rasteve, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të secilit rast dhe tërë kontekstin e tij. Shtetet nuk duhet të imponojnë përkufizime tejet përshkruese se çka përbën ngacmim në punë, për shembull nuk duhet të ekzistojë kriteri për të paraqitur prova për numrin minimal ose shpeshhtësinë e incidenteve.<sup>[210]</sup>

*Demirel k. Turqisë*, vendimi i 19 qershorit 2018, nr. 30733/08.

[207] Tek *Emel Boyraz k. Turqisë*, kërkesja u shkarkua nga posti i saj si oficerë e sigurimit në shërbimin civil turk mbi bazën se detyrat e oficerëve të sigurimit përfshinin rreziqe dhe përgjegjësi të cilat vlerësohej se gratë nuk mund t'i marrin përsipër, siç ishte puna në turnin e natës në zona rurale dhe përdorimi i armëve të zjarrit dhe forcës fizike.

[208] *García Mateos k. Spanjës*, vendimi i 19 shkurtit 2013, nr. 38285/09: në të cilin një nënë vetushqyese me kujdestarinë ligjore të birit të saj, i cili ishte gjashtë vjeç në atë kohë, iu refuzua leja nga punëdhënësi i saj për të reduktuar numrin e orëve kur ajo punonte në supermarket. Gjykata Kushtetuese spanjolle vendosi në favor të saj, duke vënë nënë vendimin e gjykatës së punës për ta refuzuar kërkesën e saj dhe duke e kthyer çështjen për rishqyrtim, çka sërish u refuzua nga gjykata e punës. Kërkesja u ankuar në Gjykatë se Gjykata Kushtetuese spanjolle kishte dështuar të riparonte shkeljen e parimit që ndalon diskriminimin e bazuar në gjini i gjetur në çështjen e saj.

[209] *Şpadijer k. Malit të Zi*, vendimi i 9 nëntorit 2021, nr. 31549/18 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §87.

[210] *Şpadijer k. Malit të Zi*, vendimi i 9 nëntorit 2021, nr. 31549/18 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §95. Gjykata theksoi se mund të ketë rrethana në të cilat incidentet ndodhin më pak se një herë në javë gjatë një periudhe prej gjashtë muajsh dhe prapë se prapë përbëjnë bullizëm,

Detyrimi pozitiv i një Shteti sipas nenit 8 për të zbatuar efektivisht ligjet kundër ngacmimit të rëndë merr rëndësi të veçantë në rrethanat kur një ngacmim i tillë mund të jetë nxitur nga aktivitetet "fishkëllëse" nga ana e viktimës së ngacmimit në lidhje me sjelljen e punëdhënësit ose kolegëve.<sup>[211]</sup> Për shembull, kur një grua i raportoi kolegët e saj për sjellje të pahijshme në punë dhe më pas iu nënshtrua bullizmit në vendin e punës, përfshirë kërcënime dhe abuzim verbal dhe fizik. Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 si rezultat i dështimit të Shtetit për të zbatuar mekanizmat e të drejtës civile dhe penale në dispozicion për të adresuar ankesat e saj. Në mënyrë të veçantë, ishte dështimi për të vlerësuar të gjitha incidentet për të cilat ishte ankuar ajo dhe për të marrë parasysh kontekstin e tërësishëm, përfshirë kontekstin potencial të fishkëllimit, ku dukej se ajo kishte përjetuar incidente të tilla nga kolegët e saj, në përpjekje për ta ndëshkuar dhe për ta heshtur atë.<sup>[212]</sup>

#### d) Shtesat dhe rroga

Në lidhje me shtesat dhe rrogën, Shtetet mund të duhet të fusin masa – për shembull në lidhje me shtatzaninë dhe / ose amësinë *specifikisht* për të mbrojtur statusin e grave dhe për të respektuar parimin e trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave.

Gjykata është e mendimit se futja e masave për mbrojtjen e amësisë është thelbësore për të respektuar parimin e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave të punësuar/a.<sup>[213]</sup> Refuzimi për të punësuar ose për të njohur shtesat e punësimit për një grua shtatzënë duke u bazuar tek shtatzania e saj përbën diskriminim direkt mbi bazën e seksit, çka nuk mund të justifikohet me interesat financiare të Shtetit. Për shembull, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (e drejta e pasurisë) kur një gruaje iu refuzua statusi i punonjëses së siguruar dhe, në atë kontekst, një shtesë e lidhur me punësimin (kompensim i rrogës gjatë lejes shëndetësore), sepse punësimi i saj u deklarua fiktiv për shkak të shtatzanisë së saj.<sup>[214]</sup>

---

ose rrethana në të cilat incidente të tilla ndodhin më shpesh e megjithatë nuk përbëjnë bullizëm.

[211] *Špadijer k. Malit të Zi*, vendimi i 9 nëntorit 2021, nr. 31549/18 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §90 and §97.

[212] *Špadijer k. Malit të Zi*, vendimi i 9 nëntorit 2021, nr. 31549/18 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §101.

[213] *Jurčić k. Kroacisë*, vendimi i 4 shkurtit 2021, nr. 54711/15 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §76.

[214] *Jurčić k. Kroacisë*, vendimi i 4 shkurtit 2021, nr. 54711/15 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Në atë çështje, kërkueses iu refuzua statusi i punonjëses së siguruar dhe një shtesë e

Vetëm gratë mund të trajtohen ndryshe mbi bazën e shtatzanisë, që do të thotë se dallime të tilla në trajtim përbëjnë diskriminim direkt mbi bazën e seksit, në qoftë se nuk mund të justifikohen. Në parim, edhe kur gatishmëria e punonjësit/es për punë është parakusht për përmbylljen e duhur të një kontrate punësimi, mbrojtja e ofruar një gruaje gjatë shtatzanisë nuk mund të bëhet e varur nga fakti nëse prania e saj në punë gjatë amësisë është thelbësore për funksionimin e duhur të punëdhënësit të saj, ose nga fakti se ajo përkohësisht është e penguar nga kryerja e punës për të cilën është angazhuar. Impakti i përkohshëm negativ mbi një kompani në këtë kontekst nuk është justifikim i mjaftueshëm për diskriminim mbi bazën e shtatzanisë.<sup>[215]</sup>

Gjykata gjithashtu ka shprehur shqetësime rreth stereotipeve dhe presupozimeve gjinore rreth rolit të grave në shoqëri që ndikojnë në vendimet e Shteteve mbi ato që u takojnë grave në aspektin e shtesave ose kur kërkojnë punë. Vendimet të cilat lënë të kuptohet se gratë nuk duhet të punojnë ose të kërkojnë punë gjatë shtatzanisë, edhe kur një gjë e tillë nuk thuhet shprehimisht, paraqesin pengesë serioze për arritjen e barazisë së vërtetë substanciale gjinore.<sup>[216]</sup>

Në disa raste që kanë të bëjnë me të drejtat e pensionit dhe shtesa të tjera të lidhura me të, Gjykata ka zbatuar një logjikë të ngjashme: mbështetja e trajtimit diferencial të Shtetit në favor të grave me qëllim të korigjimit të pabarazive faktike ose historike të cilat favorizojnë burrat.<sup>[217]</sup> Këto çështje adresohen në seksionin 5(g) (Veprimi afirmativ) dhe seksionin 6 (Diskriminimi mbi bazën e seksit – qasja në mallra dhe shërbime, shërbime publike, shtesa/asistencë sociale) të këtij Udhërrëfyesi.

---

lidhur me punësimin mbi bazën se punësimi i saj ishte deklaruar fiktiv për shkak të shtatzanisë së saj me *in vitro* e cila kishte ndodhur pak kohë para fillimit të punësimit të saj.

[215] *Jurčić k. Kroacisë*, vendimi i 4 shkurtit 2021, nr. 54711/15 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §76.

[216] *Jurčić k. Kroacisë*, vendimi i 4 shkurtit 2021, nr. 54711/15 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), §83.

[217] Për shembull, *Andrle k. Republikës Çeke*, vendimi i 17 shkurtit 2011, nr. 6268/08; *Lindsay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 11 nëntorit 1986, nr. 11089/84; *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

## e) Leja prindërore nga puna

Sipas nenit 8, në lidhje me nenin 14, ligjet vendase që rregullojnë lejen prindërore për gratë gjithashtu duhet të rregullojnë lejen prindërore edhe për burrat.<sup>[218]</sup> Kjo çështje diskutohet më me hollësi në seksionin 4 të këtij Udhërrëfyti (Diskriminimi mbi bazën e seksit në lidhje me të drejtën për respekt të jetës private dhe familjare) meqenëse ka mbivendosje të konsiderueshme mes të drejtës për respekt të jetës familjare dhe të drejtës për respekt të jetës private në këtë aspekt.<sup>[219]</sup>

## f) Pjesëmarrja femërore në jetën publike

Ka jurisprudencë të paktë të Gjykatës në lidhje me rolin e grave në jetën publike. Një çështje e kohëve të fundit ka të bëjë me rolin e grave në politikën kombëtare.<sup>[220]</sup> Ndërkohë që Gjykata përfundimisht e gjeti kërkesën të papranueshme, ajo afirmoi në vendimin e saj se *“në ditët e sotme avancimi i barazisë së sekseve në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës i ndalon Shtetet nga mbështetja e pikëpamjeve që e shohin rolin e burrit si parësor dhe të gruas si dytësor.”*<sup>[221]</sup> Kjo demonstroi qëndrimin

[218] *Weller k. Hungarisë*, vendimi i 31 marsit 2019, nr. 44399/05, §30-35; *Hulea k. Rumanisë*, vendimi i 2 tetorit 2012, nr. 33411/05. Në çështjen *Hulea k. Rumanisë*, gjykatat vendase kishin refuzuar t'i jepnin kompensim një ushtari për shkeljen e të drejtës së tij për leje prindërore. Gjykata Kushtetuese rumune kishte gjetur se ligji në fjalë, që parashikonte lejen prindërore vetëm për personelin ushtarak femëror, ishte diskriminues. Megjithatë, gjykatat rumune të apelit e rrëzuan apelin e kërkuarit dhe ia refuzuan atij kompensimin mbi bazën që dispozita statutoare në fjalë nuk ishte e aplikueshme. Gjykata gjeti se ky vendim ishte diskriminues, se shkelte të drejtën e kërkuarit për të mos u diskriminuar gjatë ushtrimit të së drejtës së tij për jetë familjare dhe private.

[219] *Konstantin Markin k. Ruisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 22 marsit 2012, nr. 30078/06 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[220] *Staatkundig Gereformeerde Partij k. Hollandës*, vendimi i 10 korrikut 2012, nr. 58369/10. Në atë çështje, dhe pas procedurave ligjore të zgjatura në vend, Gjykata Supreme e Hollandës vendosi që, sipas Nenit 7 të CEDAW, Shteti ka për detyrim të sigurojë që partitë politike t'i lejojnë gratë që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të garuar në zgjedhje. Kërkuësja, një parti politike tradicionale, nuk i lejonte gratë për candidate në zgjedhjet për organet përfaqësuese. Pas procedurave vendase, ajo bëri kërkesë në Gjykatë duke u ankuar se të drejtat e saj të Konventës sipas nenit 9 (e drejta për lirinë e fesë), neni 10 (e drejta për lirinë e shprehjes) dhe neni 11 (e drejta e tubimit) ishin shkelur.

[221] *Staatkundig Gereformeerde Partij k. Hollandës*, vendimi i 10 korrikut 2012, nr. 58369/10, §73. Ky vendim vlen të përmendet sepse Gjykata ndërmori një hap të pazakontë duke iu rikthyer bazave të regjimit të saj të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke theksuar (§70): *“Konventa është*

e vendosur të Gjykatës kundër diskriminimit të bazuar në stereotipet gjinore, sadoqë nuk e çon aq larg jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me rolin e grave në politikë në mënyrë të veçantë.

Gjykata ka gjetur se disa rregulla vendase në lidhje me shërbimin në jurinë gjyqësore janë diskriminuese mbi bazën e seksit, kur ato imponojnë trajtim të ndryshëm të burrave dhe grave. Kur burrave u kërkohet të jenë anëtarë të jurisë, nën rrezikun e ndjekjes penale, por grave thuajse kurrë nuk u kërkohet një gjë e tillë, Gjykata gjeti se kjo qasje ishte diskriminuese në shkelje të nenit 14 të lexuar në lidhje me nenin 4§3 (ndalimi i punës së detyruar).<sup>[222]</sup> Kur e mori vendimin, Gjykata refuzoi argumentin e Shtetit se përjashtimi nga shërbimi në juri mund t'u lejohej atyre që kujdeseshin për familjen e tyre, dhe se në dispozitën ligjore përkatëse mund të mbështeteshin më shumë gra sesa burra.<sup>[223]</sup> Edhe në rajone ku nuk ka shërbim të detyruar në juritë e gjyqit, siç janë shtetet e Ballkanit Perëndimor, kjo çështje tregon se Gjykata mund të gjejë shkelje të nenit 14 në lidhje me ndalimin e tij të punës së detyruar në nenin 4§3, sa u përket aspekteve të detyrueshme të shërbimit publik nga qytetarët të cilat u aplikohen ndryshe burrave e ndryshe grave.

## g) Veprimet afirmative

Siç sugjeron jurisprudenca e lartpërmendur, Gjykata mund të jetë proaktive në qasjen e saj për arritjen e barazisë substanciale, që do të thotë lejimi i procedurave vendase që favorizojnë gratë, në mënyrë që të korrigjohet një pabarazi faktike ose historike. Kjo shihet qartë në lidhje me masat e 'veprimeve afirmative', pra politika dhe praktika brenda një qeverie ose organizate të cilat synojnë të përfshijnë dhe

---

*dizajnuar për të promovuar dhe mbrojtur idealet dhe vlerat e shoqërisë demokratike. Demokracia ... është i vetmi model politik që pranon Konventa dhe i vetmi që është në pajtueshmëri me të. Në përputhje me tekstin e paragrafit të dytë të nenit 11, dhe gjithashtu tekstin e neneve 8, 9 dhe 10 të Konventës, e vetmja nevojshmëri që arrin të justifikojë ndërhyrjen në cilëndo të drejtë të atyre neneve është ajo që mund të pretendojë se del nga një 'shoqëri demokratike'".*

[222] Në *Zarb Adami k. Maltës*, vendimi i 20 qershorit 2006, nr. 17209/02, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 4§3 (d) në një çështje ku kërkuesi ishte gjobitur për mos-pjesëmarrjen në jurinë e gjyqit në procedura penale në vend. Kërkuesi u ankuar se kishte qenë viktimë e diskriminimit mbi bazën e seksit, meqenëse përqindja e grave të cilave u kërkohet të kryejnë shërbimin si anëtare të jurisë në Maltë ishte e papërfillshme, dhe se ai ishte detyruar të përballej me procedura penale në lidhje me imponimin e një detyre civile diskriminuese.

[223] *Zarb Adami k. Maltës*, vendimi i 20 qershorit 2006, nr. 17209/02, § 82.

të promovojnë grupe të caktuara mbi bazën e gjinisë, racës, seksualitetit, besimit ose kombësisë, në fusha ku ato grupe janë të nënperfaqësuar, siç është arsimi dhe punësimi. Këtu përfshihen kuotat gjinore dhe masat e lidhura me qasjen ndaj shërbimeve publike, ku Gjykata lejon trajtimin e diferencuar të justifikuar mbi bazën e seksit. Shih seksionin 10 të këtij Udhërrëfyesi (Veprimet afirmative / dallimet e justifikuar në trajtimin mbi bazën e seksit) për një studim të mëtejshëm të jurisprudence së Gjykatës në lidhje me këtë çështje.

## **(6) Diskriminimi mbi bazën e seksit – qasja në mallra dhe shërbime, shërbime publike, ndihmë sociale/shtesa**

Në lidhje me diskriminimin mbi bazën e seksit, sa i përket qasjes në shërbime publike si ndihma sociale dhe shtesat, Gjykata historikisht u ka dhënë Shteteve hapësirë mjaft të gjerë vlerësimi. Gjykata ka theksuar se, për shkak të njohurive të drejtpërdrejta që Shetet kanë për shoqërinë e tyre dhe nevojat e saj, ato në parim janë në pozicion më të mirë sesa gjyqtarët ndërkombëtarë për të vlerësuar se çka është në interesin publik në aspektin social ose ekonomik. Gjithashtu, ajo ka njohur se përgjithësisht do t'i përkrahte politikat vendase në këtë fushë në qoftë se atyre dukshëm u mungojnë bazat e arsyeshme.<sup>[224]</sup> Sidoqoftë, Gjykata është angazhuar me çështjen e diskriminimit gjinor në këtë kontekst, posaçërisht në lidhje me të drejtat pronësore dhe sigurimet shoqërore, ndihmën sociale dhe shtesat.

### **a) Sigurimet shoqërore, ndihma sociale dhe shtesat**

Nuk ka një të drejtë eksplicite të përgjithshme për sigurinë sociale sipas Konventës, por është e qartë nga jurisprudenca e Gjykatës se disa forma të sigurimeve shoqërore, siç është pagesa e shtesave dhe pensioneve shtetërore, mund të hyjnë brenda kuadrit të nenit 8 ose nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës), në rastin e kësaj të fundit për shkak se ato përbëjnë "posedime" brenda kuptimit të asaj dispozite.<sup>[225]</sup> Shih seksionin 5(a) të këtij Udhërrëfyesi (neni 1, Protokollin 1 i Konventës – e drejta e pronës) për një diskutim më të hollësishëm të kësaj çështjeje.

[224] *Luczak k. Polonisë*, vendimi i 27 nëntorit 2007, nr. 77782/01, §48.

[225] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Luczak k. Polonisë*, vendimi i 27 nëntorit 2007, nr. 77782/01; *Andrejeva k. Letonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 2009, nr. 55707/00; *Koua Poirrez k. Francës*, vendimi i 30 shtatorit 2003, nr. 40892/98; *Gaygusuz k. Austrisë*, 16 shtator 1996, nr. 17371/90; *Pichkur k. Ukrainës*, vendimi i 7 nëntorit 2013, nr. 10441/06.



Një sërë çështjesh në këtë fushë kanë të bëjnë me trajtimin diskriminues mes burrave dhe grave kur bëhet fjalë për kualifikimin për ofrimin e sigurimeve shoqërore. Në përgjithësi, ndërkohë që e respekton hapësirën e vlerësimit që kanë Shtetet në këtë aspekt, Gjykata ka ndërmarrë një qasje proaktive për të ndrequr pabarazitë historike ose faktike për të arritur barazi të vërtetë mes burrave dhe grave. Në një rast të tillë, i cili kishte të bënte me moshën e pensionimit për burrat që i rrisin fëmijët vetë, Gjykata gjeti se ky dallim në trajtim mes burrave dhe grave ishte objektivist dhe me arsye i justifikuar për të kompensuar pabarazitë me të cilat përballen gratë (siç janë rrogat dhe pensionet më të ulëta) dhe vështirësitë që lindin nga pritet që ato të punojnë me orar të plotë dhe të kujdesen për fëmijët dhe shtëpinë.<sup>[226]</sup>

Ligjet vendase në këtë fushë duhet të ecin me hapin e zhvillimeve aktuale në kushtet e jetesës dhe perceptimet mbizotëruese publike në shtetet demokratike sot. Shtetet nuk mund ta justifikojnë dallimin në trajtim mes burrave dhe grave në lidhje me sigurimet shoqërore duke iu referuar traditave, prezumimeve të përgjithshme ose qëndrimeve mbizotëruese shoqërore.<sup>[227]</sup> Në një çështje në lidhje me qasjen e një burri të ve në shtesa publike, Gjykata vlerësoi se ligjet vendase ishin diskriminuese dhe theksoi se, ndërkohë që ligjet mund të kishin qenë të justifikuar nga roli dhe statusi që kishin gratë në shoqërinë zvicerane në kohën e miratimit të tij në vitin 1948, Konventa është "instrument i gjallë". Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që Qeveria nuk mund të mbështetej më në presupozimin që burri e mban gruan financiarisht (koncepti i "fituesit të bukës së gojës") për të justifikuar dallimin në trajtim që i vë burrat e ve në dizavantazh në krahasim me vejushat.<sup>[228]</sup>

[226] *Andrle k. Republikës Çeke*, vendimi i 17 shkurtit 2011, nr. 6268/08, i cili analizohet më me hollësi në seksionin 10(c) të këtij Udhërrëfyesi (Dallimi i justifikuar në trajtim: Pensioni, Sigurimet Sociale & Skemat Tatimore).

[227] *B. k. Zvicrës*, vendimi i 20 tetorit 2020, nr. 78630/12 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[228] *B. k. Zvicrës*, vendimi i 20 tetorit 2020, nr. 78630/12 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). NB: çështja iu referua Dhomës së Madhe në mars 2021, ku vendimi ende pritet të merret. Shih gjithashtu *Willis k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 11 qershorit 2002, nr. 36042/97. Në atë çështje, një kërkuesi mashkull iu mohuan disa të drejta që u jepen vejanëve dhe vejushave, siç janë pensioni dhe shtesat, pas vdekjes së gruas së tij. Përfundimi i Gjykatës ishte i ndarë, me deklarin e shkeljes në lidhje me disa shtesa të caktuara por jo të tjera: ku e vetmja arsye e dhënë nga Shteti për refuzimin e shtesave në fjalë ishte se kërkuesi ishte mashkull, dhe kërkuesi do të ishte kualifikuar për shtesat sikur të kishte qenë femër, Gjykata arriti të dilte në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Një qasje e ngjashme i ndërmor në disa çështje: *Runkee dhe White k. Mbretërisë së Bashkuar*,

Qasja jo-diskriminuese në sigurimet shoqërore gjithashtu mund të përkohë pjesërisht me të drejtat e Konventës që i referohen aspektit gjinor, siç janë mbrojtjet kundër dhunës shtëpiake. Në një çështje ku një grua ishte në rrezik të dhunës shtëpiake ekstreme dhe kështu iu lejuan disa adaptime të vendbanimit të saj (përfshirë instalimin e një 'dhome paniku' në tavan për të dhe djalin e saj), çka rezultoi në ndryshimin e statusit të saj sipas rregullave të shtesave të strehimit, Gjykata theksoi se kishte një konflikt mes rregullave të reja për shtesat e strehimit dhe qëllimit të skemës së Shtetit për parandalimin e GBV-së e cila ishte dizajnuar për të lejuar viktimat e GBV-së që të qëndronin në shtëpitë e tyre.<sup>[229]</sup> Në një situatë të tillë, Shtetit i kërkohet të paraqiste "arsye me peshë të madhe" që justifikojnë bërjen prioritet të rregullave të reja për shtesat e strehimit para skemës për parandalimin e GBV-së.

## b) Shtesat për aftësitë e kufizuara

Shtesat për aftësitë e kufizuara gjithashtu duhet të adresohen duke pasur parasysh parimet e barazisë gjinore. Për shembull, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 8 kur shtesa e vendit të punës për një grua me aftësi të kufizuara u ndërpre pas lindjes së fëmijës, mbi bazën e pikëpamjes së autoriteteve vendase që ajo nuk do të punonte me kohë të plotë pas lindjes së fëmijëve të saj. Ndërkohë që qëllimi i sigurimeve përkatëse të aftësive të kufizuara – pra mbrojtja e individëve nga rreziku i pamundësisë për punë me pagë për shkak të aftësisë së kufizuar – ishte legjitim, trajtimi që i ishte bërë kërkueses nuk ishte proporcional. Metoda me të cilën autoritetet e llogaritën shkallën e shtesës së aftësisë së kufizuar që aplikohet "nuk ishte më në përputhje me përpjekjet për të arritur barazinë gjinore në shoqërinë bashkohore, ku gratë gjithnjë e më shumë dhe në mënyrë legjitime synojnë të harmonizojnë jetën familjare dhe karrierën."<sup>[230]</sup>

---

vendimi i 10 majit 2007, nr. 42949/98 dhe 53134/99; *Cross k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 9 tetorit 2007, nr. 62776/00; *Blackgrove k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 prillit 2009, nr. 2895/07. Në fund, shih gjithashtu *Aldeguer Tomás k. Spanjës*, vendimi i 14 qershorit 2016, nr. 35214/09, në të cilin kërkuesi u ankua se ai ishte diskriminuar mbi bazën e orientimit të tij seksual sepse, si i vetmi partner i mbijetuar i bashkimit të një çifti të seksit të njëjtë, atij i ishte mohuar pensioni i të mbijetuarit pas vdekjes së partnerit të tij.

[229] *J.D dhe A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 24 tetorit 2019, nr. 32949/17 dhe 34614/17. Kërkuesja parashtroi se rregullat e reja për shtesat e banimit në sektorin e strehimit publik (jo-zyrtarisht e njohur si "taksa e dhomës së gjumit") e diskriminonin atë për shkak të situatës së sa të veçantë si viktimë e GBK. Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

[230] *Di Trizio k. Zvicër*, vendimi i 2 shkurtit 2016, nr. 7186/09, §100.

### c) Të drejtat e lidhura me pronën

Praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me diskriminimin që përbën shkelje të nenit 14 i marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (mbrojtja e pronës) janë të ndryshme. Siç u tha më lart, disa forma të sigurimeve shoqërore siç janë shtesat e fituara dhe pensionet mund të hyjnë brenda kuadrit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 sepse përbëjnë "posedime" brenda kuptimit të asaj dispozite.

E drejta për të marrë pensionin e të mbijetuarit<sup>[231]</sup> dhe të drejtat e trashëgimisë gjithashtu hyjnë brenda fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe mund të ndërveprojnë me diskriminimin mbi bazën e seksit, dhe baza të tjera.<sup>[232]</sup> Për shembull kur një gruajë myslimane greke iu mohua titulli i pronës së bashkëshortit të saj të vdekur për shkak se autoritetet greke zbatuan ligjin islamik të trashëgimisë në vend të së drejtës civile greke në rastin e saj. Gjykata theksoi shqetësimet ndërkombëtare rreth zbatimit të ligjit të Sheriatit për grekët myslimanë në Trakinë Perëndimore dhe diskriminimi që krijohej kështu, veçanërisht kundër grave dhe fëmijëve, jo vetëm brenda asaj pakice në krahasim me burrat, por gjithashtu në lidhje me grekët jo-myslimanë<sup>[233]</sup> dhe pranoi se kërkuesja ishte vënë në një pozitë të ndryshme në krahasim me pozitën e një gruajë të martuar përfituese e testamentit të një bashkëshorti jo-mysliman.

Gjykata vlerësoi nëse trajtimi diferencial i përjetuar nga kërkuesja ishte diskriminues mbi bazën e fesë.<sup>[234]</sup> Pa shqyrtuar legjitimitetin e trajtimit diferencial mbi bazën e seksit, Gjykata gjeti se ndryshimi i përshkruar në trajtim mbi bazën e fesë nuk ishte i justifikuar sepse nuk ishte proporcional me qëllimin e synuar. Ndërkohë që Shteti pretendonte se po zbatonte ligjin e Sheriatit me qëllim të mbrojtjes së pakicës myslimane brenda Greqisë, Gjykata theksoi se Shteti nuk mund të marrë përsipër rolin e garantuesit të identitetit minoritar të një grupi

[231] *Aldeguer Tomás k. Spanjës*, vendimi i 14 qershorit 2016, nr. 35214/09.

[232] *Fabris k. Francës*, vendimi i 7 shkurtit 2013, nr. 16574/08.

[233] *Molla Sali k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe 19 dhjetorit 2018, nr. 20452/14, §154 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[234] *Molla Sali k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2018, nr. 20452/14 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Kërkueses, një shtetase greke myslimane, iu mohua titulli i pasurisë së bashkëshortit të saj të vdekur sepse testamenti, i ekzekutuar sipas ligjeve greke, u deklarua i pavlefshëm. Kjo u bë meqenëse, në përputhje me disa marrëveshje ndërkombëtare detyruese dhe normat përkatëse vendase, ligji i aplikueshëm në atë çështje ishte e drejta islame e trashëgimisë në vend të së drejtës civile greke, sipas parimit të pluralizmit ligjor që aplikohet tek myslimanët grekë.

të caktuar të popullatës në dëm të së drejtës së anëtarëve të atij grupi për të zgjedhur që të mos i përkasin grupit në fjalë ose që të mos ndjekin praktikat dhe rregullat e tij. Anëtarët e një pakice fetare duhet të kenë të drejtën për të zgjedhur dhe për të përfitur nga ligjet e zakonshme; t'u mohohet atyre kjo mundësi do të thotë t'u mohohet e drejta e vet-identifikimit.<sup>[235]</sup>

## (7) Diskriminimi mbi bazën e seksit – liria e shprehjes, ngacmimi seksual, krimet e urrejtjes

Të drejtat që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes shpesh ndërthuren me të drejtën e lirisë nga diskriminimi mbi bazën e seksit. Dy tema në jurisprudencën e Gjykatës diskutohen më poshtë: së pari, rastet kur një kërkuese mëton të mbështesë të drejtat nga neni 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë) dhe neni 10 (liria e shprehjes) në kontekstin e legjislacionit vendas që pretendohet se është diskriminues; së dyti, rastet kur një kërkuese pretendon se autoritetet vendase kanë dështuar në detyrimet e tyre pozitive (si sipas nenit 3) për të mbrojtur persona siç janë gratë nga gjuha e urrejtjes, krimet e urrejtjes dhe seksizmi.

### a) Mbulesat fetare të kokës për gratë

Neni 9 i Konventës mbron të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, si dhe të drejtat për ta ndryshuar dhe për ta manifestuar këtë mendim, ndërgjegje ose fe. Sipas nenit 9§2, Shteti ka të drejtë të ndërhyjë në atë liri kur kjo është “e parashikuar me ligj” dhe “e nevojshme në një shoqëri demokratike” në interes të një liste shteruese të qëllimeve legjitime: siguria publike, mbrojtja e rendit publik, shëndeti dhe morali, ose mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në mënyrë që një kufizim i kësaj lirie të jetë në përputhje me Konventën, ai duhet në mënyrë të veçantë të ndjekë një qëllim që mund të lidhet me njërin prej atyre qëllimeve të renditura në këtë dispozitë.<sup>[236]</sup>

[235] *Molla Sali k. Greqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2018, nr. 20452/14, §157 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Gjykata shtoi se mohimi anëtarëve të një komuniteti fetar i mundësisë për të dalë nga kornizat e minoritetit dhe për të zgjedhur ligjet e rregullta, siç bënte ligji grek duke i detyruar myslimanët grekë që t'u përmbaheshin rregullave islame, çonte jo vetëm në trajtim diskriminues, por gjithashtu edhe në shkeljen e të drejtës me rëndësinë më thelbësore: të drejtën për vet-identifikim. Gjykata theksoi se kjo e drejtë përbën gurthemelin e të drejtës ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e pakicave.

[236] *Svyato-Mykhaylivska Parafija k. Ukrainës*, vendimi i 14 qershorit 2007, nr. 77703/01, §132 dhe §137; *S.A.S. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 korrikut 2014, nr. 43835/11, §113 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Zakonisht Gjykata ka ofruar një hapësirë të gjerë vlerësimi për Shtetet në lidhje me legjislacionin e tyre vendas në lidhje me mbajtjen e mbulesës së kokës për arsye fetare. Kufizimet për mbajtjen e mbulesave fetare të kokës vërtet përbëjnë ndërhyrje në të drejtën për lirinë e fesë sipas nenit 9. Për shembull ndalimi i mbajtjes së vellos që mbulon krejtësisht fytyrën në vende publike dhe ndalimi i grave myslimane që të mbajnë shaminë e kokës në institucione arsimore<sup>[237]</sup> të dyja janë gjetur se ndërhyjnë në nenin 9. Megjithatë, në dy çështje kyçe në lidhje me këtë temë, Gjykata ka gjetur se ndërhyrjet tek e drejta e grave për lirinë e fesë kanë qenë të justifikuara.

Në *Leyla Şahin k. Turqisë*, Gjykata konsideroi se kufizimet për mbajtjen e shamisë së kokës synonte qëllimet legjitime të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të të tjerëve dhe të mbrojtjes së rendit publik, duke mos gjetur kështu shkelje të nenit 9. Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme, Gjykata theksoi se ajo ishte e bazuar mbi parimet e Republikës Turke të laicizmit dhe barazisë. Në marrjen e vendimit të saj, Gjykata gjithashtu nënvizoi theksin që vë sistemi kushtetues turk tek mbrojtja e të drejtave të grave. Barazia gjinore – e njohur nga Gjykata si një prej parimeve bazë në thelb të Konventës dhe qëllim për t'u arritur nga Shtetet anëtare të KE-së gjithashtu është gjetur nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë se është një parim i ngërthyer në vlerat mbi të cilat është ndërtuar kushtetuta turke kur ka vendosur në lidhje me këtë çështje.<sup>[238]</sup>

Në *S.A.S. k. Francës*, kur mori në konsideratë ndalimin e mbajtjes së vellos që mbulon krejtësisht fytyrën në vende publike, Gjykata njohu se një grua myslimane që dëshiron të mbajë vellon që mbulon krejtësisht fytyrën në vende publike për

[237] *Leyla Şahin k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 nëntorit 2005, nr. 44774/98, §78 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[238] *Leyla Şahin k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 10 nëntorit 2005, nr. 44774/98, §115 (citohet vendimi i Dhomës, §107-109) (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Gjykata iu referua arsytimit të saj të mëhershëm në vendimin tek *Dahlab k. Zvicrës*, vendim i 15 shkurtit 2001, nr. 42393/98, i cili kishte të bënte me një mësuese të shkollës fillore që mbante shaminë myslimane të kokës. Në *Dahlab*, Gjykata kishte theksuar se si shamia e kokës përfaqëson një "simbol të jashtëm të fuqishëm" i cili ishte i pajtueshëm me barazinë gjinore, meqenëse ai dukej se u imponohej grave nga normat islame. Ajo gjithashtu theksoi se mbajtja e shamisë islame të kokës nuk mund të ishte aq kollaj në pajtueshmëri me mesazhin e tolerancës, respektin për të tjerët dhe, mbi të gjitha, barazinë dhe mos-diskriminimin që të gjithë/a mësuesit/et në një shoqëri demokratike duhet t'u përcjellin nxënësve/eve të tyre. Gjithashtu, vlen të citohet opinioni mospajtues i Gjyqtarit Tulkens në *Leyla Şahin k. Turqisë*, i cili shënoi se "Barazia dhe mos-diskriminimi janë të drejta subjektive të cilat duhet të mbeten nën kontrollin e atyre të cilëve u takon të përfitojnë prej tyre" [§12].

arsye fetare realisht kishte statusin e “viktimës” për qëllimet e ngritjes së një pretendimi sipas nenit 9. Një grua nuk ka nevojë ta tregojë se ajo është e detyruar nga besimi i saj për të mbajtur vellon që mbulon krejtësisht fytyrën, Gjykata e pranon se për disa gra myslimane mbajtja e kësaj velloje është një formë e të përmbajturit praktik ndaj fesë së tyre dhe mund të shihet si “praktikë fetare” brenda kuptimit të nenit 9 § 1.<sup>[239]</sup>

Gjykata gjeti se ndërhyrja ishte e justifikuar për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Megjithatë, Gjykata nuk e pranoi që ndalimi kishte lindur nga respekti për barazinë gjinore, duke theksuar se një Shtet nuk mund të japë si arsye barazinë gjinore për të ndaluar një praktikë që në fakt është mbrojtur nga gratë myslimane në kontekstin e të drejtave të ngërthyer në nenet 8 dhe 9. Ajo gjithashtu shtoi se një ndalim i tillë përbënte një zgjedhje të shoqërisë, gjë për të cilën nuk kishte konsensus në Shtetet Anëtare të KE-së; rrjedhimisht Franca duhet të ketë një hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me këtë çështje.

## b) Krimet e urrejtjes

Nëni 10 mbron të drejtën për lirinë e shprehjes, përfshirë të drejtën për të pasur opinione dhe për të marrë e dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Megjithatë, ushtrimi i këtyre lirive vlerësohet se mbart detyra dhe përgjegjësi. Ndërhyrjet tek e drejta mund të lejohen kur janë të parashikuara me ligj dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike për të synuar njërin prej qëllimeve legjitime që përcaktohen në nenin 10 § 2. Këto qëllime përfshijnë interesat e sigurisë kombëtare, integriteti territorial ose siguria publike, për parandalimin e trazirave ose krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informacioneve që merren në konfidencë, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Për shembull, mbrojtja e grave nga gjuha e urrejtjes.

Detyrimet pozitive të Shteteve për t'i mbrojtur personat nga gjuha e urrejtjes, krimet e urrejtjes, seksizmi dhe ngacmimi seksual janë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e bazave të mbrojtura siç janë aspekti gjinor dhe orientimi seksual.

[239] *S.A.S. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 korrikut 2014, nr. 43835/11, §56 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Tek *S.A.S.*, kërkesja u ankua që ligjet franceze e ndalonin atë që të mbante *burqa* ose *niqab*, të dy vello që mbulojnë krejtësisht fytyrën, në shkelje të të drejtave të saj sipas neneve 8, 9 dhe 10 të Konventës. Në lidhje me nenin 14, kërkesja u ankua se ndalimi vendos çonte në diskriminim mbi bazën e seksit, fesë dhe origjinës etnike, në dëm të grave të cilat, ashtu si ajo, mbanin vellon që mbulon krejtësisht fytyrën.

Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 3, për shkak të dështimit të autoriteteve të Shtetit për të ndjekur penalisht në mënyrë efektive një krim të dhunshëm të urrejtjes homofobe kundër një gruaje homoseksuale.<sup>[240]</sup> Gjykata e pranoi se krimi i urrejtjes kishte arritur një shkallë rreptësie që hynte brenda kuadrit të nenit 3, dhe sqaroi se keqtrajtimi i pësuar nuk është e thënë të përfshijë lëndime trupore faktike ose vuajtje të rënda fizike ose mendore. Edhe në mungesë të këtyre aspekteve, kur trajtimi poshtëron ose ul një individ, duke treguar mungesë respekti për të ose duke zvogëluar dinjitetin e tij/saj njerëzor, ose ngjall ndjenja frike, ankthi ose inferioriteti që mund të thyejnë rezistencën morale dhe fizike të një individi, mund të karakterizohet si poshtëruar dhe hyn brenda ndalimit të nenit 3.<sup>[241]</sup>

Çështja ilustron detyrimin pozitiv në lidhje me krimet diskriminuese të urrejtjes sipas nenit 3. Duke dështuar të fillonin procedurat penale dhe të adresonin elementin e krimit të urrejtjes në atë sulm, autoritetet vendase kishin dështuar në përmbushjen e përshtatshme dhe efektive të detyrimit të tyre pozitiv procedural sipas Konventës në lidhje me një sulm të dhunshëm të motivuar nga orientimi seksual. Një sjellje e tillë ishte në kundërshtim me detyrimin e autoriteteve për të luftuar mos-ndëshkimin për krimet e urrejtjes të cilat janë posaçërisht destruktive për të drejtat themelore të njeriut.<sup>[242]</sup>

[240] *Sabalić k. Kroacisë*, vendimi i 14 janarit 2021, nr. 50231/13 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim). Pas një sulmi të dhunshëm ndaj kërkueses, për çka sulmuesi mori një dënim për kundërvajtje, kërkuesja u ankua në Gjykatë se mungesa e një reagimi të përshtatshëm të autoriteteve vendase për veprën ishte motivuar nga diskriminimi mbi bazën e orientimit të saj seksual. Autoritetet e refuzuan kërkesën e kërkueses për të ngritur aktakuzë kundër të pandehurit me akuza penale dhe krim të urrejtjes.

[241] *Sabalić k. Kroacisë*, vendimi i 14 janarit 2021, nr. 50231/13, §68 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[242] *Sabalić k. Kroacisë*, vendimi i 14 janarit 2021, nr. 50231/13, §114 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

## (8) Diskriminimi mbi bazën e seksit – gratë rome

Të gjitha problemet dhe të drejtat e diskutuara në kontekstin e diskriminimit kundër të gjitha grave përgjatë tërë këtij Udhërrëfyese pa dyshim që i prekin gratë rome. Megjithatë, KE ka njohur se gratë rome në tërë Evropën përballen me barrën e shtuar të racizmit si dhe diskriminimit gjinor, gjë që i shtyn ato të margjinat e shoqërisë dhe përkeqëson përvojën e tyre të problemeve me të cilat përballen të gjitha gratë, të diskutuara të krejt këtë Udhërrëfyese.<sup>[243]</sup> Prandaj, është e nevojshme që të konsiderohet e drejta e tyre për liri nga diskriminimi mbi bazën e përkatësisë etnike, si dhe mbi bazën e seksit, dhe të ndërmerret një qasje e ndërthurur për avancimin e barazisë substanciale për gratë rome.

Gjykata njihet që, si rezultat i historisë së tyre të trazuar dhe lëvizjeve të shumta, romët janë bërë një lloj i veçantë minoriteti të lënë pas dore dhe të cenusëshëm dhe, si të tillë, kërkojnë mbrojtje të veçantë kundër diskriminimit direkt dhe indirekt.<sup>[244]</sup> Me këtë qasje, sjellja ndaj romëve është gjetur se është diskriminuese në shumë kontekste. Për shembull, praktika e Gjykatës në çështjet e sterilizimit të detyruar të grave rome diskutohet lart në seksionin 4(g) të këtij Udhërrëfyese (Të drejtat seksuale dhe riprodhuese, përfshirë sterilizimin e detyruar).

Në kontekstin e sistemit të drejtësisë penale, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6 në lidhje me nenin 14 kur një grua rome është dalluar për trajtim më të ashpër në dënimin penal dhe kur dënimi i saj me gjasë është vlerësuar si dënim shembull për komunitetin rom.<sup>[245]</sup> Një trajtim i tillë minon gëzimin e garancive të gjyqit të drejtë, si dhe parimin e barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit.<sup>[246]</sup>

[243] Shih <https://rm.coe.int/16806f32ff> - :-:text=Romani women often fall victims, by various state actors, etc "Strategjia për Avancimin e Grave dhe Vajzave Rome (2014-2020), Këshilli i Evropës, 2016.

[244] *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 13 nëntorit 2007, nr. 57325/00, §182.

[245] *Paraskeva Todorova k. Bullgarisë*, vendimi i 25 marsit 2010, nr. 37193/07. Në atë çështje kërkuesja, një gruajë me origjinë rome iu dha një dënim zakonor për mashtrim penal nga gjykatat vendase, në vend të një dënimi me kusht, mbi bazën e një supozimi të "ndjenjës së mos-ndëshkimit" në shoqërinë bullgare, "sidomos mes grupeve minoritare", që dënimi me kusht nuk konsiderohej se kishte të njëjtën rreptësi si një dënim i mirëfilltë (§10, duke cituar nga vendimi i Gjykatës së Rrethit të Plovdivit).

[246] *Paraskeva Todorova k. Bullgarisë*, vendimi i 25 marsit 2010, nr. 37193/07, §45.



Diskriminimi, racizmi dhe pabarazitë gjinore janë gjetur se shkelin qasjen e grave romë në drejtësi, duke bërë që ato të mos duan të shfrytëzojnë mekanizmat e ankesave dhe të kërkojnë drejtësi në gjykata pjesërisht për shkak të mungesës së besimit tek sistemi i drejtësisë.<sup>[247]</sup> Mungesa e besimit në gjykata mund të nënkuptojë që gratë romë nuk përpiqen t'i realizojnë të drejtat e tyre dhe të ndërmarrin veprime kundër incidenteve të diskriminimit mbi bazën e seksit. Prandaj, mbrojtja e të drejtës për gjyq të drejtë të romëve, dhe sigurimi që ata të jenë të lirë nga diskriminimi kur janë në kontakt me sistemin e drejtësisë, është posaçërisht i rëndësishëm në kontekstin e mbrojtjes së grave romë nga diskriminimi.

Arritjet e ulëta arsimore, vijimi i parregullt i shkollës dhe braktisja e shkollës janë probleme të zakonshme në mesin e grave romë.<sup>[248]</sup> Segregimi i shkollimit për fëmijët romë është praktikë e përhapur në shumë vende evropiane, e cila shpesh mbrohet mbi bazën se fëmijët romë kanë nevoja të veçanta ose nuk e njohin mirë gjuhën mbizotëruese. Ky justifikim duket se është në linjë me qëllimin legjitim në të drejtën e mos-diskriminimit për rehatimin e dallimeve. Megjithatë, në praktikë shkollimi i romëve shpesh është tepër inferior: kur pretendimi i trajtimit special i kundërvihet nevojës për të zgjidhur dizavantazhet për fëmijët romë, është e qartë se një politikë e tillë është maskë për përsëritjen e dizavantazhit.<sup>[249]</sup>

Gjykata e pranon që mund të ketë nevojë për masa specifike për të përfshirë romët në shoqëri, përfshirë me anë të edukimit, por kjo nuk do të thotë që atyre t'u kërkohej që të asimilohen: *"pozita e cënueshme e romëve/ciganëve do të thotë se duhet t'u jepet konsideratë e veçantë nevojave dhe stilit të ndryshëm të jetës së tyre, si në kornizën rregullatore përkatëse, ashtu edhe në marrjen e vendimeve në raste të veçanta."*<sup>[250]</sup>

[247] Shih <https://rm.coe.int/16806f32ff> - :~:text=Romani women often fall victims, by various state actors, etc "Strategjia për Avancimin e Grave dhe Vajzave Rome (2014-2020)", Këshilli i Evropës, 2016.

[248] Shih <https://rm.coe.int/16806f32ff> - :~:text=Romani women often fall victims, by various state actors, etc "Strategjia për Avancimin e Grave dhe Vajzave Rome (2014-2020)", Këshilli i Evropës, 2016.

[249] Sandra Fredman, " Dalja nga hija në dritë: Barazia substanciale dhe neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", Revista Ligjore e të Drejtave të Njeriut, Vëllimi 16, Numri 2, qershor 2016, fq. 288.

[250] *Oršuš dhe të Tjerë k. Kroacisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 marsit 2010, nr. 15766/03, §148. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 2 të Protokollit Nr. 1 (e drejta për arsim). Shih gjithashtu *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*,

Gjykata po ashtu ka marrë vendime në çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e grave rome për sigurime shoqërore siç është pensioni i të mbijetuarës. Në një rast të tillë, një gruaje rome iu refuzua pensioni i të mbijetuarës pas vdekjes së burrit të saj mbi bazën se autoritetet spanjolle e konsideruan martesën e saj – e cila ishte bërë vetëm sipas traditave rome – si të tillë që nuk ishte në fuqi sipas të drejtës civile spanjolle.<sup>[251]</sup> Gjykata gjeti se ishte joproporcionale nga ana e Shtetit spanjoll, i cili i kishte ofruar kërkuases dhe familjes së saj sigurime shëndetësore dhe kishte mbledhur kontribute të sigurimeve shoqërore nga burri i saj për më shumë se 19 vjet, që të refuzonte të njihte martesën e saj rome kur erdhi puna tek dhënia e pensionit të të mbijetuarës pas vdekjes së burrit të saj. Vendimtar në vendimin e Gjykatës ishte fakti që martesë rome ishte lidhur në mirëbesim dhe ishte njohur *de facto* nga autoritetet që kishin ofruar sigurime shëndetësore dhe kishin mbledhur kontributet e sigurimeve shoqërore.<sup>[252]</sup>

Gratë rome gjithashtu mund të përjetojnë nivele të larta të papunësisë ose mundësi shumë të pakta të punësimi.<sup>[253]</sup> Migrimi për të kërkuar lëmshë dhe puna informale e rrugës janë bërë strategji të zakonshme të jetesës në shumë komunitete rome të Rumanisë<sup>[254]</sup> dhe mund të ofrojnë një mjet esencial të mbijetesës për gratë rome. Kur një grua rome rumune u urdhërua të paguante një gjobë prej 500 frangash zvicerane (afro 464 euro) sepse kishte kërkuar lëmshë në publik në Gjenevë, dhe me pas u mbajt në paraburgim pesë ditë për shkak të mos-pagimit të gjobës, Gjykata e gjeti ndalimin e kërkimit të lëmshës në publik ndërhyrje të papranueshme në jetën e saj private sepse e kishte privuar atë nga mjeti i jetesës. Gjykata njohu se kërkuësja ishte analfabete, vinte nga një familje

---

vendimi i Dhomës së Madhe i 13 nëntorit 2007, nr. 57325/00 dhe *Horváth dhe Kiss k. Hungarisë*, vendimi i 29 janarit 2013, nr. 11146/11, në të cilin Gjykata theksoi se Shteti kishte detyrime pozitive për të zhbërë historikun e segregimit racor në shkolla speciale dhe për të shmangur përsëritjen e këtij diskriminimi të kaluar. Mangësitë strukturore kërkonin implementimin e masave pozitive, mes të tjerash, me qëllim që të ndihmoheshin kërkuëset me vështirësitë që hasnin gjatë vijimit të kurrikulës shkollore.

[251] *Muñoz Díaz k. Spanjës*, vendimi i 8 dhjetorit 2009, nr. 49151/07.

[252] *Muñoz Díaz k. Spanjës*, vendimi i 8 dhjetorit 2009, nr. 49151/07, §61. Gjykata njohu se “ndërkohë që përkatesia në një minoritet nuk krijon përjashtim nga pajtueshmëria me ligjet e martesës, ajo mund të ndikojë tek mënyra se si zbatohen ato ligje.”

[253] Shih <https://rm.coe.int/16806f32ff> - :-:text=Romani women often fall victims, by various state actors, etc "Strategjia për Avancimin e Grave dhe Vajzave Rome (2014-2020)", Këshilli i Evropës, 2016.

[254] Jon Horgen Friberg, "Varfëria, rrjetet, rezistenca: Sociologjia ekonomike e migrimit të romëve për të kërkuar lëmshë", Studime të Migracionit, Vëllimi 8, Numri 2, qershor 2020, fq. 228–249.

jashtëzakonisht e varfër, nuk kishte punë dhe nuk merrte shtesa sociale. Prandaj, kërkimi i lëmoshës përbënte mënyrë mbijetese për të. Duke qenë në një situatë qartazi të cënueshme, ajo kishte të drejtën, e ngërthyer në dinjitetin njerëzor, që të kishte mundësinë për të përballuar gjendjen e saj duke u përpjekur për të përmbushur nevojat e saj elementare duke kërkuar lëmoshë.<sup>[255]</sup>

Të drejtat e romëve gjithashtu ndërthuren me fusha të tjera të së drejtës civile në jurisprudencën e Gjykatës, përfshirë të drejtën e planifikimit. Për shembull, e drejta për respektin ndaj shtëpisë sipas nenit 8 përfshin shtëpitë lëvizëse siç janë rulotet, edhe në situata kur ato pozicionohen në mënyrë të paligjshme.<sup>[256]</sup>

## (9) Diskriminimi mbi bazën e seksit – gratë refugjate / migrante / azilkërkuese

Në përgjithësi, Shteteve u është dhënë një hapësirë e gjerë vlerësimi në organizimin e politikave të tyre të migracionit. Megjithatë, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 14 në lidhje me seksin për shkak të trajtimit diskriminues të migranteve femra.

Trajtimi diferencial mes imigrantëve mbi bazën e seksit nuk mund të justifikohet mbi bazën e impaktit krahasues të burrave dhe grave në tregun e punës së Shtetit. Për shembull, Gjykata ka gjetur se rregullat e imigracionit të bazuara mbi nocionin që një burrë ka më shumë gjasa të jetë ekonomikisht aktiv dhe prandaj e bëjnë më të vështirë për një burrë që t'i bashkohet gruas ose të fejuarës së tij në një vend tjetër sesa për një grua t'i bashkohet burrit ose të fejuarit të saj në një vend tjetër, janë diskriminuese mbi bazën e seksit në shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8.<sup>[257]</sup> Mbrojtja e tregut të punës së një vendi është qëllim legjitim për një Shtet kur harton sistemin e vet të imigracionit.<sup>[258]</sup> Megjithatë, duke qenë se avancimi i barazisë së sekseve është qëllim

[255] *Lăcătuș k. Zvicrës*, vendimi i 19 janarit 2021, nr. 14065/15.

[256] *Buckley k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 29 shtatorit 1996, nr. 20348/92, §60, ku kërkueses, një grua rome, iu refuzua një leje planifikimi e cila do t'i mundësonte asaj të jetonte në një rulot në tokën që ishte pronë e saj. Ajo pretendoi se ligji kombëtar mbi të cilin ishte bazuar refuzimi ishte diskriminues për shkak të origjinës së saj etnike rome. Megjithatë, Gjykata nuk e konsideroi ligjin kombëtar diskriminues meqenëse nuk u duk se kërkuesja ishte penalizuar ose i ishte nënshtuar në ndonjë moment ndonjë trajtimi dëmtes për tentimin e ndjekjes së stilit tradicional cigan të jetës.

[257] *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 majit 1985, nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81.

[258] *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 majit 1985, nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81, §75.

madhor në Shtetet Anëtare të KE-së, duhet të jepen arsye shumë me peshë në mënyrë që një dallim në trajtim mbi bazën e seksit në hartimin ose zbatimin e rregullave të imigracionit mund të shihet si në pajtueshmëri me Konventën.<sup>[259]</sup> Gjykata ka theksuar se, ndërkohë që një pjesë e migranteve femra, për sa kohë që janë "ekonomikisht aktive", janë të angazhuara në punë me kohë të pjesshme, impakti i tregut vendor të punës së grave imigrante në krahasim me burrat nuk duhet të nënvleftësohet.<sup>[260]</sup>

Çështjet në lidhje me diskriminimin mbi bazën e seksit sipas nenit 14 (në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1) gjithashtu dalin në pah në lidhje me të drejtën e refugjatëve dhe migrantëve për të marrë shtesa/benefite. Dallimi në trajtim mbi bazën e seksit në lidhje me të drejtat e një refugjati/eje, ose fëmijëve të tyre, për të pasur siguri sociale siç është shtesa e strehimit nuk mund të justifikohet nga nocionet e roleve familjare tradicionale, siç është ideja që burrat e zhvendosur kanë më shumë gjasa sesa gratë e zhvendosura që të jenë ata që fitojnë bukën e gojës.<sup>[261]</sup> Edhe në qoftë se ato role pasqyrojnë realitetin ekonomik mbizotërues në kohën në fjalë, kjo nuk e justifikon trajtimin e të gjithë burrave të zhvendosur si bukëfituesit dhe të gjitha gratë e zhvendosura si të paafta për ta përbushur atë rol.<sup>[262]</sup> Për më tepër, një dallim i tillë në trajtim nuk mund të justifikohet thjesht nga nevoja për të priorizuar burimet: vetëm kufizimet buxhetore nuk mund të justifikojnë dallimin në trajtim të bazuar vetëm mbi gjininë.

Të drejtat e grave migrante gjithashtu ndërthuren e çështje të tjera të bazuara në gjini që diskutohen në tërë këtë Udhërrëfyes, siç është ligji që ka të bëjë me kontestimin e atësisë së fëmijëve (shih seksionin 4(a) të këtij Udhërrëfyesi (Të drejtat prindërore) për hollësi të mëtejshme rreth çështjeve në këtë fushë).

Në këtë aspekt, trajtimi diferencial i kërkuesve për ndihmë ligjore në lidhje me procedurat e kujdestarisë së fëmijëve mbi bazat e statusit rezidencial të kërkuesit

[259] *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 majit 1985, nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81, §78.

[260] *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 majit 1985, nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81, §79.

[261] *Vrountou k. Qipros*, vendimi i 13 tetorit 2015, nr. 33631/06. Çështja kishte të bënte me një shtetase qipriote që kërkonte shtesat e strehimit mbi bazën e statusit të nënës së saj si refugjate. Sipas të drejtës vendase, fëmijët dhe gratë jo të zhvendosura mund të regjistroheshin në kartën e baballarëve dhe bashkëshortëve të tyre të zhvendosur respektivisht. Megjithatë, fëmijët dhe bashkëshortët e grave të zhvendosura ishin shprehimisht të përjashtuar nga regjistrimi i persona të zhvendosur.

[262] *Vrountou k. Qipros*, vendimi i 13 tetorit 2015, nr. 33631/06, §79-80.

mund të jenë diskriminuese, në qoftë se nuk ka arsye detyruese për të justifikuar dallimin në trajtim mes individëve me leje qëndrimi dhe atyre pa leje qëndrimi. Për shembull, kur një kërkuese tashmë ka ndërmarrë hapa për të rregulluar situatën e saj, nuk ka arsye që ajo të presë deri sa ta rinovojë lejen e qëndrimit dhe të rrezikojë skadimin e afatit kohor të parashikuar me ligjet vendase për kontestimin e atësisë.<sup>[263]</sup>

Po kështu, ka përkim të pjesshëm në këtë kontekst me të drejtën e mos-diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual. Nocioni i respektit për "jetën familjare" sipas nenit 8 shtrihet përtej marrëdhënieve të bazuara në martëse dhe përfshin partneritete *de facto* mes gjinisë së njëjtë pavarësisht nëse çifti bashkëjeton apo jo.<sup>[264]</sup> Duke pasur parasysh këtë, refuzimi për t'u dhënë leje për bashkim familjar partnerëve të seksit të njëjtë kur një leje e tillë është në dispozicion për çiftet e pamartuara heteroseksuale përbën diskriminim mbi bazën e orientimit seksual sipas nenit 14 në lidhje me nenin 8.<sup>[265]</sup>

### **Trafikimi me qenie njerëzore**

Neni 4 i KEDNj-së e ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar. Ndërkohë që trafikimi me qenie njerëzore (ang. THB) nuk është shprehimisht i përfshirë në nenin 4, KEDNj-ja ka përcaktuar që THB gjithashtu është i ndaluar sipas nenit 4.<sup>[266]</sup> Prandaj, Shtetet kanë detyrime të shumta procedurale dhe substanciale sipas neneve 2, 3 dhe 4 për të hetuar, ndjekur penalisht dhe mbrojtur individët nga THB dhe skllavëria moderne. Një diskutim i plotë rreth detyrimeve të Shteteve për të luftuar THB-në është jashtë fushëveprimit të këtij Udhërrëfyesi. Megjithatë, disa shembuj përfshijnë:

- » Shtetet duhet të miratojnë dhe të zbatojnë një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative dhe administrative që ndalon dhe ndëshkon punën e detyruar ose të forcuar, shërbëtorinë, skllavërinë dhe THB.<sup>[267]</sup>

[263] *Anakomba Yula k. Belgjikës*, vendimi i 10 marsit 2009, nr. 45413/07. Në këtë çështje, kërkueses iu refuzua ndihma ligjore me qëllim të kontestimit të atësisë së fëmijës së saj brenda një afati kohor njëvjeçar sepse ajo kishte qenë duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në Belgjikë.

[264] *Pajić k. Kroacisë*, vendimi i 23 shkurtit 2016, nr. 68453/13, §63-64.

[265] Vlen të theksohet se në çështjen e mëhershme të *Jeunesse k. Holandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 3 tetorit 2014, nr. 12738/10, §107, Gjykata kishte konfirmuar se neni 8 nuk vendos detyrime të përgjithshme për bashkim familjar.

[266] *Rantsev k. Qipros dhe Rusisë*, vendimi i 7 janarit 2010, nr. 25965/04.

[267] *Rantsev k. Qipros dhe Rusisë*, vendimi i 7 janarit 2010, nr. 25965/04.

- » Autoritetet kombëtare duhet të zhvillojnë hetime të menjëhershme për të parë nëse një individ është trafikuar kur ka dyshime të besueshme për të menduar se një gjë e tillë ka ndodhur.<sup>[268]</sup>
- » Hetimet për THB të dyshuar duhet të jenë efektive dhe të pavarura nga ato të implikuara në ngjarje, të tilla që mund të çojnë drejt identifikimit, dënimit dhe ndëshkimit të individëve përgjegjës, të jenë të shpejta dhe të përsheptuara me arsye, të synojnë mbledhjen e provave relevante dhe të përfshijnë viktimën ose të afërmit e viktimës në procedurë për aq sa është e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime.<sup>[269]</sup>
- » Autoritetet kombëtare duhet të konsiderojnë impaktin e mundshëm të traumës psikologjike mbi aftësinë e kërkueses për të treguar në mënyrë koherente rrethanat e shfrytëzimit gjatë hetimeve dhe procedurave ligjore.<sup>[270]</sup>

Detyrime të tilla u zbatohen edhe trafikimit të brendshëm dhe përtej kufijve. Nuk ka rëndësi nëse nuk ka elemente ndërkombëtare. Neni 2 i Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (ang. ECAT) përmbledh "të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, pavarësisht nëse janë kombëtare apo transkombëtare".<sup>[271]</sup>

Sadoqë është e qartë se gratë, vajzat, burrat dhe djemtë të gjithë/a mund të jenë viktima të THB-së, instrumentet dhe organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të fokusuara në parandalimin e THB-së theksojnë rëndësinë e ndërmarrjes së një qasjeje të ndjeshme ndaj aspektit gjinor në parandalimin dhe mbrojtjen kundër THB-së dhe skllavërisë moderne.<sup>[272]</sup> Shpesh, gratë nuk trafikohen në të njëjtën

[268] Rantsev k. Qipros dhe Ruisë, vendimi i 7 janarit 2010, nr. 25965/04.

[269] S.M. k. Kroacisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 qershorit 2020, nr. 60561/14 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[270] S.M. k. Kroacisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 qershorit 2020, nr. 60561/14 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[271] S.M. k. Kroacisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 qershorit 2020, nr. 60561/14 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[272] Shih për shembull Raportin Përmbledhës të Komisionit të BE-së mbi Dimensionin Gjinor të Trafikimit Njerëzor, shkurt 2016: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/577950/EPRS\\_BRI\(2016\)577950\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/577950/EPRS_BRI(2016)577950_EN.pdf), Paketa e Përcaktimit të Aspektit Gjinor si Rrymë Qendrore për Barazinë Gjinore dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore: [https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/486700\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/486700_1.pdf) dhe Letrën e OSBE-së për Aplikimin e Qasjeve të Ndjeshme ndaj Aspektit Gjinor në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore: [https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/486700\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/486700_1.pdf)

mënyrë ose për të njëjtat qëllime si burrat, dhe eksperiencia e trafikimit të tyre mund të jetë shumë e ndryshme. Mund të thuhet se i tërë cikli i trafikimit ka elemente thellësisht gjinore, që nga shkaqet rrënjësore që i bëjnë gratë dhe vajzat më të prekshme, e deri tek qasjet e politikave dhe masave për luftimin e THB-së. Për shembull, sipas të dhënave të BE-së, 60% e viktimave të detektuara në BE janë trafikuar për shfrytëzim seksual, dhe 92% e këtyre viktimave janë gra dhe vajza, ndërsa mbi 70% të trafikantëve janë burra.<sup>[273]</sup>

Dimensionet gjinore të THB-së njihen në instrumentet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.<sup>[274]</sup> Për shembull, ECAT parashikon që Shtetet duhet të synojnë të promovojnë barazinë gjinore dhe të përcaktojnë aspektin gjinor si rrymë qendrore në zhvillimin, implementimin dhe vlerësimin e masave, politikave dhe programeve të referuara kudo në Konventë, dhe të fusin programe edukative për djemtë dhe vajzat gjatë shkollimit të tyre të cilat të theksojnë natyrën e papranueshme të diskriminimit të bazuar në seks dhe pasojat e tij shkatërrimtare, rëndësinë e barazisë gjinore dhe dinjitetit dhe integritetit të çdo qenieje njerëzore.<sup>[275]</sup> Po ashtu, Direktiva e BE-së e vitit 2011 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij<sup>[276]</sup> e njeh dukurinë specifike gjinore të trafikimit dhe rekomandon që masat e ndihmës dhe mbështetjes të jenë specifike gjinore kudo që është e nevojshme.<sup>[277]</sup>

[273] Raporti Përmbledhës i Komisionit të BE-së mbi Dimensionin Gjinor të Trafikimit Njerëzor, shkurt 2016: [https://ëëë.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/577950/EPRS\\_BRI\(2016\)577950\\_EN.pdf](https://ëëë.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/577950/EPRS_BRI(2016)577950_EN.pdf), fq. 4.

[274] Për shembull, Protokollin i OKB-së për Parandalimin, Dhënien Fund dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave sidomos Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Transkombëtar, miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 55/25 e 15 nëntorit 2000. Neni 6(4) parashikon: Secili Shtet Palë do të marrë parasysht, gjatë zbatimit të dispozitave të këtij neni, moshën, gjininë dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikimit me persona. Neni 10(2) parashikon: Shetet Palë do të ofrojnë ose do të fuqizojnë trajnimet për zbatimin e ligjit, imigracionin dhe zyrtarë të tjerë përkatës për parandalimin e trafikimit të personave. Trajnimi duhet të fokusohet në metodat e përdorura për ta parandaluar një trafikim të tillë, për të ndjekur penalisht trafikantët dhe për të mbrojtur të drejtat e viktimave, përfshirë mbrojtjen e viktimave nga trafikantët. Trajnimi gjithashtu duhet të marrë parasysht nevojën për të konsideruar të drejtat e njeriut dhe çështjet e ndjeshme të aspektit gjinor dhe të fëmijëve.

[275] Shih në mënyrë të veçantë Nenet 5(3), 6(d) dhe 17, ECAT.

[276] Ndërkohë që Direktiva 2011/36/EU u zbatohet vetëm vendeve të BE-së, Gjykata i merr parasysht dispozitat e kësaj Direktive në kuadër të jurispruencës së saj.

[277] Shih në mënyrë të veçantë, Nenin 1 dhe §§ 3 dhe 25 të preambulës së Direktivës 2011/36/EU.

Prandaj, Shtetet duhet të ndërmarrin një qasje specifike gjinore gjatë përbushjes së detyrimeve të tyre sipas neneve 2, 3 dhe 4 të KEDNj-së në lidhje me hartimin dhe zbatimin e masave për të luftuar, hetuar dhe ndjekur penalisht THB-në dhe për të mbrojtur viktimat e tij. Nevoja për qasje të përshtatshme në aspektin gjinor përgjatë tërë procesit të drejtësisë penale, përfshirë trajnimet me viktimat dhe aspektin gjinor në qendër për ligjzbatuesit dhe profesionistët gjyqësorë, përbën një aspekt thelbësor të një qasjeje të tillë, siç diskutohet në seksionin (3) të këtij Udhërrëfyese (Stereotipet gjinore në vendimet gjyqësore).<sup>[278]</sup>

## (10) Veprimet afirmative / dallimet e justifikuar në trajtimin mbi bazën e seksit

Masat që kanë të bëjnë me dallimin në trajtimin e burrave dhe grave mund të jenë të justifikuar për të kompensuar pabarazitë paraekzistuese. Neni 14 nuk i ndalon Shtetet Anëtare nga trajtimi i grupeve në mënyrë të ndryshme për të korrigjuar 'pabarazitë faktike' mes tyre.<sup>[279]</sup> Kështu, masat afirmative ose pozitive që promovojnë barazinë e plotë dhe efektive mund të jenë në përputhje me nenin 14 në qoftë se ato janë objektivist dhe me arsye të justifikuar.

Kjo qasje konfirmohet në Preambulën e Protokollit Nr. 12, i cili afirmon:

*"parimi i mos-diskriminimit nuk i ndalon Shtetet Palë nga marrja e masave për të promovuar barazinë e plotë dhe efektive, përderisa ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për ato masa."*

Masa të tilla shihen si afatshkurtra, dhe pasi pabarazia faktike zvogëlohet justifikimi për masën vlerësohet se është zhdukur.<sup>[280]</sup> Përveç kësaj, mund të ketë

[278] Letra e OSBE-së për Zbatimin e Qasjeve të Ndjeshme ndaj Aspektit Gjinor në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore përmban rekomandime të shumta për zbatimin e qasjes së ndjeshme ndaj aspektit gjinor gjatë luftimit të trafikimit: [https://www.osce.org/files/f/ documents/7/4/486700\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/ documents/7/4/486700_1.pdf).

[279] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Çështja Gjuhësore Belge (Nr. 2)*, vendimi i 23 korrikut 1968, nr. 2126/64, §10.

[280] *Çështja Gjuhësore Belge (Nr. 2)*, vendimi i 23 korrikut 1968, nr. 2126/64. Gjithashtu, vlen të theksohet se CEDAW, Neni 4§1 ndërmerr një qasje të ngjashme me veprimet afirmative: *"Miratimi nga Shtetet Palë i masave të veçanta të përkohshme me qëllim të përshejtitimit de facto të barazisë mes burrave dhe grave nuk do të konsiderohet diskriminim ashtu siç përkufizohet në Konventën aktuale, por në asnjë mënyrë nuk do të përmbajë si pasojë mbajtjen e standardeve të*



arsye të tjera përse dallimi në trajtim mbi bazën e seksit është i justifikuar, të cilat nuk kanë lidhje me korrigjimin e pabarazisë ose promovimin e barazisë. Për shembull, kur vlerësohet e nevojshme të mbrohen të drejtat e të tjerave.

Poshtë janë përmbledhur disa shembuj të rasteve kur Gjykata ka gjetur se dallimi në trajtimin mbi bazën e seksit është i justifikuar.

### a) Dallimi i justifikuar në trajtim: Shtatzania

Përfundimi i punësimit, kryesisht për shkak se një grua është shtatzënë, përbën dallim në trajtim mbi bazën e seksit meqenëse vetëm gratë mund të mbesin shtatzënë. Megjithatë, në rrethana të caktuara, një dallim i tillë në trajtim mund të jetë i justifikuar në qoftë se përfundimi i punësimit është i nevojshëm për të shmangur rrezikimin e kapacitetit funksional të punëdhënësit.<sup>[281]</sup>

Megjithatë, nëse përfundimi i punësimit është i justifikuar varet nga natyra e punës së kryer dhe nga impakti i saktë i punësimit të vazhduar. Për shembull, përfundimi i parakohshëm i postit diplomatik të një gruaje jashtë vendit për shkak të shtatzanisë së saj është gjetur se është i nevojshëm për të siguruar që mungesa e saj për shkak të shtatzanisë nuk rrezikonte kapacitetin funksional të seksionit konsullor të ambasadës, dhe përfundimisht për të siguruar qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, kryesisht shtetasve rumunë që kishin nevojë për shërbime konsullore në Slloveni.<sup>[282]</sup> Megjithatë, në këtë rast, ishte posti i saj që përfundoi, dhe jo punësimi i saj në tërësi.

Gjithashtu, është me rëndësi të konsiderohet impakti i përfundimit të punësimit tek gruaja, përfshirë nëse ajo vuan ndonjë dizavantazh afatgjatë në karrierën e saj.<sup>[283]</sup> Për shembull, nëse përfundimi ka të bëjë me një aspekt të veçantë të punësimit të gruas por ajo është në gjendje të kthehet në punë pas lindjes dhe nëse ajo vazhdon të ngrihet në detyrë gjatë kohës që mungon nga puna gjatë shtatzanisë dhe menjëherë pas kthimit në punë.

---

*pabarabarta ose të ndara; këto masa do të ndërpriten kur objektivat e barazisë së mundësive dhe trajtimit do të përmbushen."*

[281] *Napotnik k. Rumanisë*, vendimi i 20 tetorit 2020, nr. 33139/13, §77.

[282] *Napotnik k. Rumanisë*, vendimi i 20 tetorit 2020, nr. 33139/13.

[283] *Napotnik k. Rumanisë*, vendimi i 20 tetorit 2020, nr. 33139/13: ishte me rëndësi për gjetjen e Gjykatës se nuk kishte shkelje të Protokollit Nr. 12 që kërkuesja vazhdoi të promohej gjatë kohës që mungonte gjatë shtatzanisë së saj të parë dhe përsëri rreth një vit pasi u kthye në punë.

## b) Dallimi i justifikuar në trajtim: Dënimi me burg dhe leja nga burgu

Trajtimi diferencial mes burrave dhe grave mund të jetë i justifikuar nga nevoja për të mbrojtur gratë nga dhuna e bazuar në gjini, abuzimi dhe ngacmimi seksual në ambientet e burgut, si dhe nga nevoja për të mbrojtur shtatzaninë dhe amësinë.

Gjykata në përgjithësi u jep autoriteteve kombëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi në çështje të politikave penale, duke theksuar se nuk i takon Gjykatës të përcaktojë ndëshkimin e duhur për një krim të caktuar.<sup>[284]</sup> Prandaj, Gjykata po ashtu u jep Shteteve hapësirë të gjerë vlerësimi për të vendosur nëse trajtimi diferencial është i justifikuar në këtë kontekst.<sup>[285]</sup>

Dallimi në trajtim është gjetur se është i justifikuar në rrethanat e mëposhtme:

- » Përrjashtimi i vepër-kryeseve femra nga jeta në burg për të mbrojtur gratë nga dhuna e bazuar në gjini, abuzimi dhe ngacmimi seksual në ambientet e burgut, dhe mbi bazën e “*nevojës për të mbrojtur shtatzaninë dhe amësinë*”.<sup>[286]</sup>
- » Zbatimin e një mase të veçantë që u lejon të burgosurave femra pezullimin e ekzekutimit të dënimit të tyre me burg deri në ditëlindjen e parë të fëmijës së tyre nëse janë shtatzënë ose nëse kanë një fëmijë nën moshën një-vjeçare, për të mbrojtur interesat e fëmijëve, duke marrë parasysh situatën e veçantë të një gruaje shtatzënë dhe lidhjen e veçantë mes nënës dhe fëmijës gjatë vitit të parë pas lindjes.<sup>[287]</sup>

Në lidhje me përjashtimin nga burgimi i përjetshëm, Gjykata ka shqyrtuar të dhëna statistikore që tregojnë proporcionin relativisht të vogël të të burgosurave femra, prej të cilave shumë pak ishin duke vuajtur dënime me burgim të përjetshëm, çka tregonte interesin e qartë publik të ngërthyer në politikat e përjashtimit. Kështu, Gjykata ka theksuar se kishte një marrëdhënie të arsyeshme

[284] *Khamtokhu dhe Aksenchik k. Ruisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, nr. 60367/08 dhe 961/11, §78 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Alexandru Enache k. Rumanisë*, vendimi i 3 tetorit 2017, nr. 16986/12, §72.

[285] *Clift k. Mbretërisë së Bashkaur*, vendimi i 13 korrikut 2010, nr. 7205/07, §73; *Costel Gaciu k. Rumanisë*, vendimi i 23 qershorit 2015, nr. 39633/10, §56; *Khamtokhu dhe Aksenchik k. Ruisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, nr. 60367/08 dhe 961/11, §85 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[286] *Khamtokhu dhe Aksenchik k. Ruisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 janarit 2017, nr. 60367/08 dhe 961/11, §82 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[287] *Alexandru Enache k. Rumanisë*, vendimi i 3 tetorit 2017, nr. 16986/12, §76.

proporcionaliteti mes mënyrave të përdorura dhe qëllimit legjitim të promovimit të "parimeve të drejtësisë dhe njerëzimit", të tilla që nuk kishte pasur shkelje të nenit 14.

### c) Dallimi i justifikuar në trajtim: Pensioni, skemat e sigurimeve shoqërore dhe ato tatimore

Dallimi në trajtimin mes burrave dhe grave në lidhje me funksionimin e skemave të pensioneve, sigurimeve shoqërore dhe tatimeve mund të justifikohet për të korrigjuar pabarazitë faktike. Këto tema diskutohen lart në seksionin 6(a) të këtij Udhërrëfyesi (Sigurimet shoqërore, ndihma sociale dhe shtesat), por rishikohen këtu në kontekstin e situatave kur dallimi në trajtim është i justifikuar.

Ashtu si me politikat penale, autoriteteve kombëtare u jepet hapësirë e gjerë vlerësimi në fushën e strategjisë ekonomike ose sociale,<sup>[288]</sup> për shkak se ato janë në pozitën më të mirë për të përcaktuar çështje komplekse që varen nga elemente variabël shumëdimensionale vendore dhe nga njohuritë e drejtpërdrejta të shoqërisë në fjalë.<sup>[289]</sup> Në kontekstin e një "mase tranzitore që është pjesë e një skeme që ka për qëllim korrigjimin e një pabarazie", testi normalisht i rreptë i diskriminimit ia lë vendin testit 'dukshëm pa bazë të arsyeshme', që do të thotë se Gjykata e respekton zgjedhjen e autoritetit kombëtar në qoftë se nuk është dukshëm pa bazë të arsyeshme.<sup>[290]</sup>

Në lidhje me pensionin, sigurimet shoqërore dhe skemat tatimore, Gjykata ka theksuar natyrën vazhdimisht në evolucion të jetës së grave në punë dhe shtëpi, duke e bërë të pamundur të përcaktohet një datë e saktë në të cilën masat që korrigjojnë pabarazitë faktike nuk nevojiten më. Kështu, Gjykata heziton të kritikojë autoritetet kombëtare për mos heqjen e mëparshme të masave që korrigjojnë pabarazitë faktike.<sup>[291]</sup>

[288] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[289] *Andrle k. Republikës Çeke*, vendimi i 17 shkurtit 2011, nr. 6268/08.

[290] *J.D dhe A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 24 tetorit 2019, nr. 32949/17 dhe 34614/17, §88; *Runkee dhe White k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 10 majit 2007, nr. 42949/98 dhe 53134/99.

[291] *Runkee dhe White k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 10 majit 2007, nr. 42949/98 dhe 53134/99.

Për shembull, dallimi në trajtim është gjetur se është i justifikuar, domethënë nuk ka pasur shkelje të nenit 14, në rrethanat e mëposhtme:

- » Pagesa e shtesave të ndihmës sociale deri sa një person mbush moshën e pensionimit, kur moshja e pensionimit për burrat dhe gratë ishte e ndryshme, për të korigjuar pozicionin e pafavorshëm të grave që del nga roli i tyre tradicional shtëpiak.<sup>[292]</sup>
- » Ulja e moshës së pensionimit për gratë që kanë pasur fëmijë për të kompensuar gratë për pabarazitë (përfshirë rrogat dhe pensionet më të ulëta) dhe vështirësitë e dala nga pritjet që gratë të punojnë me orar të plotë dhe njëkohësisht të kujdesen për fëmijët dhe shtëpinë.<sup>[293]</sup>
- » Trajtimi preferencial në lidhje me pensionet për vejushat më të moshuara për të njohur faktin se vejushat më të moshuara, si grup, përballen me vështirësi financiare dhe me pabarazi për shkak të rolit tradicional të një gruaje të martuar ku ajo kujdeset për burrin dhe familjen në shtëpi në vend që të fitojë para në vendin e punës.<sup>[294]</sup>
- » Politika tatimore të favorshme për familjet ku nëna ka qenë ajo që ka pasur të ardhurat kryesore, për të inkurajuar gratë e martuara që të kthehen në punë pas lindjes së fëmijëve.<sup>[295]</sup>

## d) Dallimi i justifikuar në trajtim: pakicat etnike

Në lidhje me grupet e pakicave etnike, siç janë romët (shih gjithashtu seksionin 8 të këtij Udhërrëfyesi (Diskriminimi mbi bazën e seksit – gratë rome)), Gjykata ka theksuar se "mund të thuhet se gjithnjë e më shumë ka konsensus ndërkombëtar mes Shteteve Kontraktuese të Këshillit të Evropës ku njihen nevojat e veçanta të pakicave dhe detyrimi për të mbrojtur sigurinë, identitetin dhe mënyrën e jetës së tyre, jo vetëm me qëllim të ruajtjes së interesave të vetë pakicave, por edhe për të mbrojtur një diversitet kulturor me vlerë për tërë komunitetin."<sup>[296]</sup>

[292] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[293] *Andrle k. Republikës Çeke*, vendimi i 17 shkurtit 2011, nr. 6268/08; shih gjithashtu *Runkee dhe White k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 10 majit 2007, nr. 42949/98 dhe 53134/99.

[294] *Runkee dhe White k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 10 majit 2007, nr. 42949/98 dhe 53134/99.

[295] *Lindsay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 11 nëntorit 1986, nr. 11089/84.

[296] *D.H. dhe të Tjerë k. Republikës Çeke*, vendimi i Dhomës së Madhe i 13 nëntorit 2007, nr. 57325/00, §181.

## e) Dallimi i justifikuar në trajtim: Personat me aftësi të kufizuara

Gratë me aftësi të kufizuara përbëjnë një grup tjetër posaçërisht të cenueshëm nga diskriminimi mbi bazën e identiteteve të tyre të ndërthurura. Për shembull, gratë me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh të ekspozimit ndaj dhunës, atyre u mungojnë shërbimet e nevojshme të veçanta sipas nevojave të viktimave me aftësi të kufizuara që pësojnë dhunë, përballen me pengesa të shtuara në marrjen e mbrojtjes dhe shërbimeve mbështetëse, dhe përballen me rrezikun e shtuar të ekspozimit ndaj abortit dhe sterilizimit të detyruar.<sup>[297]</sup> Prandaj, kur zbatohen masa pozitive për të avancuar barazinë e grave, është me rëndësi të theksohen detyrimet e KEDNj-së për të ndërmarrë veprime pozitive ose afirmative në kontekstin e diskriminimit mbi bazën e aftësive të kufizuara. Për shembull, dështimi për të marrë hapa pozitivë për të siguruar që studentët me aftësi të kufizuara mund të gëzojnë arsimimin përmes masave të arsyeshme të akomodimit (për shembull dështimi për të adaptuar metodat e mësimdhënies për t'i bërë ato të kapshme për nxënësit e verbër) përbën diskriminim mbi bazën e aftësive të kufizuara.<sup>[298]</sup> Kur vihen në zbatim detyrimet pozitive të përshkruara në këtë Udhërrëfyes, për shembull në seksionet mbi dhunën shtëpiake dhe të drejtat riprodhuese, çdo detyrim pozitiv duhet të zbatohet në mënyrë të atillë që të merren parasysh nevojat e veçanta të grave me aftësi të kufizuara. Për shembull, materialet informuese në lidhje me shërbimet mbështetëse duhet të vihen në dispozicion të grave të verbra dhe të shurdhra, dhe shërbimet mbështetëse duhet t'u vihen në dispozicion.

## f) Dallimi i justifikuar në trajtim: gratë si grup i cenueshëm

Gjykata nuk i ka njohur gratë në KE si grup i cenueshëm në terma të përgjithshme në të njëjtën mënyrë si, për shembull, romët. Në vend të kësaj, Gjykata është e prirur të fokusohet në situata të caktuara që i japin shkas cenueshmërisë, përfshirë gratë që janë viktime të dhunës shtëpiake ose grave shtatzëna.

Për shembull, diç diskutohet në seksionin 2 të këtij Udhërrëfyesi (Dhuna shtëpiake, femicidi dhe dhuna e bazuar në gjini), ka disa detyrime pozitive mbi Shtetet që të ofrojnë mbrojtje dhe të hetojnë dhunën e bazuar në gjini.<sup>[299]</sup>

[297] <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/12/women-with-disabilities-at-higher-risk-of-violence-in-private-and-public-realms>, "Gratë me aftësi të kufizuara në rrezik më të madh për dhunë në sferat private dhe publike", UN Women, 7 dhjetor 2020.

[298] *Çam k. Turqisë*, vendimi i 23 shkurtit 2016, nr. 51500/08.

[299] *Kalucza k. Hungarisë*, vendimi i 24 prillit 2012, nr. 57693/10, §53; *Opuz k. Turqisë*, vendimi i 9

Gjykata gjithashtu ka theksuar se “futja e masave për mbrojtjen e amësisë është thelbësore për të respektuar parimin e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim”.<sup>[300]</sup> Nga ana tjetër, në rrethana të caktuara, Gjykata ka theksuar se zhvillimet pozitive në lidhje me jetën në punë dhe shtëpi të grave e bëjnë të dukshme nevojën për veprime pozitive ose afirmative.

## (11) Impakti i Covid-19 mbi të drejtat e grave – impakti tek dhuna shtëpiake, rolet gjinore

Impakti i pandemisë Covid-19 e ka thelluar më tej hendekun ngaherë të madh gjinor të bazuar në strukturat dhe kulturat patriarkale në Ballkanin Perëndimor dhe në tërë Evropën. Incidentet e dhunës shtëpiake u shtuan, ndërkohë që sistemet mbështetëse për viktimat e dhunës shtëpiake u zvogëluar. Mbylljet brenda (ang. lockdowns) rezultuan me një shkallë më të lartë të papunësisë tek gratë sesa tek burrat, grave më shpesh iu desh të merrnin leje ose të merrnin rrogë të reduktuar, masat e mbrojtjes sociale të marra si reagim ndaj pandemisë ishin më pak në dispozicion për gratë, dhe gratë zhvilluan më shumë punë të papaguar në sektorin e kujdestarisë dhe punë shtëpiake.

Gjithashtu, vlen të shtohet se gratë përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore që është në pararojën e sektorit të shëndetësisë, gjë që i ka lënë ato të ekspozuara ndaj rrezikut më të madh për Covid-19.<sup>[301]</sup>

Gjatë tërë pandemisë dhe më pas mes pasojave të saj, të drejtat dhe detyrimet e përshkruara përgjatë tërë këtij Udhërrëfyesi vazhdojnë të jenë të aplikueshme. Megjithatë, pandemia solli situata të reja në të cilat të drejtat e grave duhet të mbrohen, kontekste të reja në të cilat të drejta të ndryshme të Konventës duhet të ekuilibrohen me njëra-tjetrën, dhe faktorë të rinj për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit të proporcionalitetit sa i përket mbrojtjes së të drejtave që nuk janë 'absolute'.

---

qershorit 2009, nr. 33401/02, §139 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[300] *Jurčić k. Kroacisë*, vendimi i 4 shkurtit 2021, nr. 54711/15, §76 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[301] Në Bosnje dhe Hercegovinë, gratë përbëjnë 67% të vendeve të punës në sektorin e shëndetësisë dhe të kujdesit, në Maqedoninë e Veriut kjo shifër është 77%, në Malin e Zi është 81%, në Serbi është 76%. Shih [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms\\_774439.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_774439.pdf).

## a) Dhuna e bazuar në gjini dhe dhuna shtëpiake

Pandemia Covid-19 dhe, në mënyrë të veçantë, mbylljet brenda në shtëpia që pasuan ishin kataklizma e rritjes së incidenteve të dhunës më bazë gjinore dhe dhunës shtëpiake, për shkak të faktorëve lidhur me stresin e shtuar nga rreziqet shëndetësore, kushtet e ngushta dhe të vështira të jetesës, humbjet ekonomike dhe rënien e mekanizmave mbështetëse në komunitet.<sup>[302]</sup>

Ka pasur rritje të incidenteve të abuzimit psikologjik, i karakterizuar nga grindjet dhe konfliktet kryesisht mes prindërve dhe fëmijëve, posaçërisht adoleshentëve.<sup>[303]</sup> Natyra e abuzimeve të shkaktuara gjithashtu ka ndryshuar, ku janë shtuar ankesat për abuzimet online.<sup>[304]</sup>

Pandemia Covid-19 gjithahtu e ka kufizuar më tej mundësinë e grave për t'i ikur abuzimit. Kjo është pjesërisht për shkak të frikës së sëmundjes ose të përhapjes së saj tek të tjerët, mbylljes ose reduktimit të shërbimeve për parandalimin dhe mbrojtjen e grave, mungesës së informacioneve për llojet e reja të shërbimeve, kufizimit të lëvizjeve dhe mungesës së qasjes në shërbimet e reja online.<sup>[305]</sup> Disa strehimore u mbyllën, të tjera nuk kishin hapësira të mjaftueshme për shkak të

[302] Sipas Rrjetit të Komiteteve të Ballkanit Perëndimor për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, gjatë pandemisë ka pasur 40% rritje të numrit të thirrjeve për ndihmë nga viktimat e dhunës gjinore dhe shtëpiake: Shih <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/517081/pandemija-produbljuje-nejednakosti-teret-krize-posebno-osjecaju-zene> "Pandemija produbljuje nejednakosti, teret krize posebno osjecaju žene", Vijesti Online, 2 mars 2021. Ngjashëm, Komisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore në Kroaci ka raportuar 31% rritje të dhunës shtëpiake gjatë vitit 2020: Shih <https://www.worldbank.org/en/news/opinion/2021/03/05/gender-inequality-the-pandemic-has-hit-women-at-more-levels-than-men>; dhe në Bosnje dhe Hercegovinë, Shoqata e Punonjësve Socialë ka deklaruar se ka pasur rritje të numrit të rasteve të dhunës gjinore dhe shtëpiake: shih <https://www.osce.org/files/f/documents/7/a/470658.pdf>.

[303] Shih <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/517081/pandemija-produbljuje-nejednakosti-teret-krize-posebno-osjecaju-zene> "Pandemija produbljuje nejednakosti, teret krize posebno osjecaju žene", Vijesti Online, 2 mars 2021.

[304] Shih <https://www.endviolenceagainstwomen.org.uk/online-abuse-during-covid-almost-half-of-women-have-experienced-online-abuse-during-pandemic/> "Online abuse during Covid: Almost half of women have experienced abuse online during pandemic", End Violence Against Women, 8 September 2020.

[305] Shih <https://eca.unwomen.org/en/neës/in-focus/in-focus-gender-equality-in-covid-19-response>; Shih gjithashtu <https://www.osce.org/files/f/documents/7/a/470658.pdf>.

masave të izolimit dhe distancimit që iu imponuan banoreve, dhe shumë prej tyre u mungonin pajisjet e nevojshme mbrojtëse dhe dezinfektantët.<sup>[306]</sup>

Gratë me aftësi të kufizuara ishin më të ekspozuara ndaj dhunës së bazuar në gjini, meqenëse ato në të shumtën e rasteve qëndruan të mbyllura në shtëpi me abuzuesin nga i cili varehin në një mënyrë apo një tjetër.<sup>[307]</sup> Gratë që jetonin në zona rurale, si dhe gratë rome, u përballën me pengesa që i ndalonin ato që ta raportonin vetë dhunën ose të merrnin informacione ose të lidheshin me shërbimet mbështetëse përmes kanaleve online, përfshirë mospasjen e telefonit celular, kompjuterit ose internetit, dhe faktit që jetonin në komunitete të izoluar dhe të privuara.<sup>[308]</sup> Gratë refugjate kanë nevojë për forma komplekse të mbështetjes, përfshirë përkthyesit, avokatët dhe punonjësit socialë, por organizatat që ofrojnë mbështetje në kampet e refugjatëve ishin të ndaluar të hynin dhe gjetën se komunikimi online nuk ishte efektiv.<sup>[309]</sup>

Të gjitha vështirësitë e lartpërmendura me të cilat u përballën gratë pa qasje në internet, ose ato që jetonin në lokacione të izoluar, u përkeqësuan nga kufizimet e lëvizjeve, përfshirë edhe anulimin e transportit publik.<sup>[310]</sup>

Çdo masë që merret për të mbrojtur jetën dhe shëndetin duke parandaluar përhapjen e Covid-19 njëkohësisht duhet të marrë parasysh detyrimet e Shtetit për të mbrojtur jetën dhe për të parandaluar trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues në duart e një abuzuesi. Detyrimet nga nenet 2 dhe 3 të përshkruara në seksionin 2 (Dhuna shtëpiake, femicidi dhe dhuna e bazuar në gjini) të këtij Udhërrëfyesi janë absolute. Shtetet nuk mund të bëjnë derogim nga këto detyrime, qoftë edhe në kohë emergjencash.

[306] Shih <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2020/06/infographic%20-%20safe%20houses%20in%20bosnia%20and%20herzegovina%20and%20covid-19-min.pdf?la=en&vs=1237>.

[307] See <https://www.osce.org/files/f/documents/7/a/470658.pdf>

[308] Shih <https://eca.unwomen.org/en/news/in-focus/in-focus-gender-equality-in-covid-19-response>; "Në Fokus Çështjet e Barazisë Gjinore në Reagimin ndaj Covid-19", UN Women News, 23 mars 2020.

[309] Shih <https://eca.unwomen.org/en/news/in-focus/in-focus-gender-equality-in-covid-19-response>; "Në Fokus Çështjet e Barazisë Gjinore në Reagimin ndaj Covid-19", UN Women News, 23 mars 2020.

[310] Shih <https://eca.unwomen.org/en/news/in-focus/in-focus-gender-equality-in-covid-19-response>; "Në Fokus Çështjet e Barazisë Gjinore në Reagimin ndaj Covid-19", UN Women News, 23 mars 2020.



Duke pasur parasysh këto detyrime pozitive për të parandaluar, ndaluar, hetuar dhe ndjekur penalisht incidentet e dhunës shtëpiake, Shtetet duhet të sigurohen që autoritetet, përfshirë policinë dhe gjykatat, të vazhdojnë të trajtojnë incidentet e abuzimit shtëpiak si raste urgjente të cilave duhet t'u jepet përparësi dhe drejt të cilave duhet të orientohen burimet, edhe në kohë pandemie.

Shtetet po ashtu duhet të përpiqen të miratojnë masa për të siguruar që strehimoret dhe shërbimet mbështetëse të vazhdojnë të funksionojnë në maksimumin e mundshëm pa komprometuar kriteret e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë nga pandemia.<sup>[311]</sup> Çdo kufizim i lëvizjeve dhe çdo mbyllje e shërbimeve mbështetëse duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional për arritjen e qëllimit të mbrojtjes së shëndetit dhe parandalimit të përhapjes së Covid-19. Duke ditur impaktin diskriminues mbi gratë dhe fëmijët dhe dëmet që mund të shkaktojë për shëndetin e tyre fizik dhe mendor, mbyllja e plotë e shtëpive të sigurta dhe hapësirave për refugjatët me gjasë nuk është mënyrë proporcionale e ndjekjes së qëllimit të mbrojtjes së shëndetit. Më tej, çdo kufizim i tërësishëm i lëvizjeve, ose masa që ndalojnë qëndrimin në një adresë tjetër, të cilat nuk lejojnë përjashtime për ato që duan të largohen nga abuzimi shtëpiak, me gjasë nuk janë kufizime të nevojshme ose proporcionale të lëvizjes.

Kur zbatohen politika të tërësishme si "rri në shtëpi, rri në siguri", Shtetet duhet të marrin parasysh mënyrat se si politika të tilla mund të ndikojnë tek të drejtat e grupeve të ndryshme në forma të ndryshme, dhe potencialisht mund të kenë efekt diskriminues mbi grupet e cenueshme, siç janë viktimat e abuzimit shtëpiak, për të cilat shtëpia mund të mos jetë vend i sigurt.<sup>[312]</sup> Ato duhet "të bëjnë kujdes të veçantë" rreth impaktit të zgjedhjeve të tyre mbi ato që janë më të prekshëm<sup>[313]</sup> dhe të bëjnë adaptimet e nevojshme në politikat e përgjithshme për të adresuar çdo impakt diskriminues që identifikohet. Në realitet, reagimet qeveritare janë kritikuar për dështime në konsiderimin e nevojave të ndryshme, dhe në disa raste edhe për dështimin për të marrë në konsideratë ose për t'u konsultuar me hisedarët përkatës në lidhje me adaptimet që duhen bërë për të mbrojtur gratë.<sup>[314]</sup>

[311] Shih <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2020/4/albania-adopts-new-protocol-to-ensure-undisrupted-shelterservices> "Shqipëria miraton protokoll të ri për të garantuar shërbime strehuese të pandërprera", UN Women News, 21 prill 2020.

[312] Shih <https://www.osce.org/files/f/documents/7/a/470658.pdf>.

[313] Enver [Şahin k. Turqisë](#), vendimi i 30 janarit 2018, nr. 23065/12, §68.

[314] Për shembull, dy përfaqësues/e të shtëpive të sigurta (një prej Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, dhe një prej Republika Srpska) konfirmuan se askush nuk ishte konsultuar me ta/to para futjes së masave të mbylljes brenda (lockdown): Shih <https://www.osce.org/files/f/>

## b) Papunësia

Masat e zbatuara për të parandaluar përhapjen e pandemisë Covid-19, si mbylljet brenda në shtëpi, kanë rezultuar në shtimin e madh të papunësisë, i cili ka prekur gratë shumë më tepër sesa burrat.<sup>[315]</sup> Gratë kishin më shumë gjasa të humbin vendin e punës dhe të ardhurat, dhe kishin më pak gjasa të merrnin shtesat e asociuara të sigurimeve sociale, përfshirë ato që janë specifikisht të lidhura me pandeminë Covid-19.<sup>[316]</sup> Krahas papunësisë, grave iu desh më shpesh që të merrnin leje ose të merrnin rroga të reduktuara për shkak të pandemisë Covid-19.<sup>[317]</sup>

Një faktor primar që ka rezultuar me faktin që gratë përbëjnë shumicën e papunësuar (ose më pak e punësuar sesa duhet) pas pandemisë Covid-19 është se gratë shpesh janë të mbi-përfaqësuara në sektorët që u prekën më shumë nga pandemia, përfshirë industrinë e shërbimeve si restorantet, hotelet, shërbimet e kujdesit personal dhe shërbimet e kohës së lirë, si dhe në punën informale. Rrjedhimisht, gratë kishin më shumë gjasa të dëmtoheshin ekonomikisht nga masat e mbylljes brenda dhe karantinës, distancimit social dhe ngadalësimi ekonomik.<sup>[318]</sup> Për më tepër, gratë që informalisht ofrojnë shërbime shtëpiake,

[documents/7/a/470658.pdf](#), "Odgovor Na Krizu Uzrokovanu Pandemijom Covid-19: Analiza Iz Perspektive Ljudskih Prava i Rodne Ravnopravnosti", Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë: Misioni në Bosnje dhe Hercegovinë, 17 nëntor 2020.

- [315] Në Serbi, në vitin 2020, 7% e grave dhe 4% e burrave ishin të papunë: Shih [Pandemijska kriza najviše pogodila žene - Ekonomija - Dnevni list Danas](#); "Pandemijska kriza najviše pogodila žene", nga M. N. Stevanović, Danas Online, 6 prill 2021. Në Malin e Zi, nga fundi i shkurtit deri në fund të qershorit 2020, numri i grave të papuna u rrit me 3,560, që përbën 56% të numrit të individëve të papunë në atë periudhë. Ky trend ka vazhduar; në mars 2021, gratë përbënin 58.5% të popullatës së papunë: Shih <https://gradski.me/tokom-pandemije-znacajno-se-povecao-broj-nezaposlenih-zena/>.
- [316] Shih <https://www.worldbank.org/hr/news/opinion/2021/03/05/gender-inequality-the-pandemic-has-hit-women-at-more-levels-than-men> "(Pa)Barazia Gjinore: Pandemia ka Ndikuar tek Gratë në Kroaci në Nivele më të Larta sesa Burrat" nga Valerie Morrica dhe Nga Thi Viet Nyuyen, Banka Botërore, 5 mars 2021.
- [317] Shih <https://www.danas.rs/ekonomija/pandemijska-kriza-najvise-pogodila-zene/> "Pandemijska kriza najviše pogodila žene", by M. N. Stevanović, Danas Online, 6 prill 2021.
- [318] COVID-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut – Qendra AIRE: në Kroaci, 52% e grave kundrejt 18% të burrave punojnë në sektorin e shërbimeve, përfshirë shëndetësinë, arsimin, turizmin dhe sektorët e hotelevisë e turizmit, të cilat kanë qenë më të prirura për t'u mbyllur. Shih <https://www.worldbank.org/en/news/opinion/2021/03/05/>

si pastrimi ose mirëmbajtja shtëpiake, kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit, në shumë raste mbetën pa punë ose pa të ardhura.<sup>[319]</sup> Shumë gra gjithashtu i reduktuan orët e tyre të punës, ose iu desh ta linin krejtësisht punën për t'u kujdesur për fëmijët dhe për t'i shkolluar ato në shtëpi kur u mbyllën shkollat.

Një tjetër faktor që kontribuoi në faktin që gratë përbëjnë shumicën e atyre që mbetën pa punë pas pandemisë është fakti se punëdhënësit preferojnë punonjës meshkuj, sepse ka më shumë mundësi që një grua 30-vjeçare do të marrë leje për të rritur fëmijën.<sup>[320]</sup>

Siç u shpjegua lart në seksionin 5(b) të këtij Udhërrëfyesi (Qasja në punësim), heqja e grave nga puna pa justifikim të mjaftueshëm rreth shkakut përse një grua, e jo një burrë, është shkarkuar mund të përbëjë shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8.<sup>[321]</sup> Më tej, përfundimi i punësimit kryesisht për shkak se një grua është shtatzënë përbën dallim në trajtim mbi bazën e seksit i cili mund të jetë i justifikueshëm vetëm në rrethana të kufizuara. Kur një punëdhënës i jep fund punësimit të pjesëtarëve të caktuar të stafit për shkak të impaktit ekonomik të mbylljeve brenda në shtëpi etj., vendimet për të hequr gratë në vend të burrave pa asnjë justifikim, krahas faktit që janë gra ose që mund të mbeten shtatzënë, me gjasë do të përbente diskriminim të pajustificuar sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 12, ose sipas nenit 14 në lidhje me nenin 8.<sup>[322]</sup>

Siç u diskutua në seksionin 5(g) dhe seksionin 10 të këtij Udhërrëfyesi (Veprimet afirmative / dallimet e justifikuar në trajtimin mbi bazën e seksit), neni 14 nuk e ndalon një Shtet Anëtar nga trajtimi i ndryshëm i grupeve për të korrigjuar 'pabarazitë faktike' mes tyre.<sup>[323]</sup> Kështu, masat afirmative ose pozitive që promovojnë barazinë e plotë dhe efektive mund të jenë në përputhje me nenin

[gender-inequality-the-pandemic-has-hit-women-at-more-levels-than-men](#) "(Pa)Barazia Gjinore: Pandemia ka Ndikuar tek Gratë në Kroaci në Nivele më të Larta sesa Burrat" nga Valerie Morrica dhe Nga Thi Viet Nyuyen, Banka Botërore, 5 mars 2021.

[319] Shih <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/05/impact-of-the-covid-19-pandemic-on-specialist-services-for-victims-and-survivors-of-violence>

[320] Shih <https://bit.ly/3wCxewm>.

[321] *Emel Boyraz k. Turqisë*, vendimi i 2 dhjetorit 2014, nr. 61960/08.

[322] *Napotnik k. Rumanisë*, vendimi i 20 tetorit 2020, nr. 33139/13; *Emel Boyraz k. Turqisë*, vendimi i 2 dhjetorit 2014, nr. 61960/08.

[323] *Stec dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 65731/01 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Çështja Gjuhësore Belge (Nr. 2)*, vendimi i 23 korrikut 1968, nr. 2126/64.

14 në qoftë se janë objektivisht dhe arsyeshëm të justifikuara. Gjatë vlerësimit nëse masat janë objektivisht dhe arsyeshëm të justifikuara, Gjykata merr parasysh shkallën deri ku vazhdojnë të ekzistojnë pabarazi të tilla / shkallën deri ku është shënuar përparim drejt korigjimit të këtyre pabarazive.

Prandaj, impakti që ka pasur pandemia tek mundësitë e punësimit të grave, dhe mënyrat se si ajo e ka dëmtuar përparimin e shënuar drejt avancimit të mundësive të punësimit për gratë do të ishte me rëndësi gjatë vlerësimit lidhur me faktin nëse dallimi në trajtim mes burrave dhe grave në këtë kontekst është i justifikuar. Për shembull, masat e rimëkëmbjes ekonomike ose qasja në skemat e punës që kanë në qendër gratë pas pandemisë kanë më shumë gjasa të jenë të justifikuara, duke pasur parasysh mënyrat se si pandemia ka ndikuar në forma joproportionale tek mundësitë e tyre për punësim.

### c) Masat e mbrojtjes sociale

Një numër i madh i grave janë përballur me pandeminë Covid-19 pa shtesat elementare të sigurimeve sociale, siç janë shtesat e papunësisë, kontributet pensionale, e drejta për leje shëndetësore dhe sigurime shëndetësore. Kjo në masë të madhe vjen nga fakti se gratë që rrinë në shtëpi, kultivojnë tokën, zhvillojnë punë informale ose ndihmojnë në bizneset familjare shpesh janë të padukshme brenda sistemit të sigurimeve sociale.<sup>[324]</sup>

Kjo situatë është përkeqësuar edhe më tej nga fakti se reagimet e qeverive ndaj pandemisë Covid-19 kanë dështuar të merrnin në konsideratë nevojat e ndryshme të burrave dhe të grave dhe kontekstet e ndryshme në të cilat ato punojnë.<sup>[325]</sup>

[324] Hulumtimet e zhvilluara nga Banka Botërore në Kroaci treguan se gratë në Kroaci marrin mesatarisht 23% më pak shtesa për të moshuarit sesa burrat. Varësisht nga kohëzgjatja e papunësisë, së paku 40% e burrave marrin shtesa papunësie, ndërsa afro 30% e grave i marrin këto shtesa. Shih <https://www.worldbank.org/hr/news/opinion/2021/03/05/gender-inequality-the-pandemic-has-hit-women-at-more-levels-than-men> "(Pa)Barazia Gjinore: Pandemia ka Ndikuar tek Gratë në Kroaci në Nivele më të Larta sesa Burrat" nga Valerie Morrica dhe Nga Thi Viet Nyuyen, Banka Botërore, 5 mars 2021. Në Kosovë, afro 30% e grave të punësuar në sektorin privat punojnë informalisht dhe nuk kanë mundësi të përfitojnë shtesat e sigurimeve shoqërore: Shih <https://www.radiokim.net/vesti/saopstenja/sgg-poziva-vladu-na-usvajanje-mera-za-podrsku-zena.html>.

[325] Shih <https://data.undp.org/gendertacker/> "Gjurmuesi i Reagimeve Globale për Covid-19", Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim; Shih [https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/Kosovo\\_eng\\_web.pdf](https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/Kosovo_eng_web.pdf).

Për shembull, në Kosovë gratë e punësuara në ekonominë informale dhe nënat vetushqyese u lanë jashtë mbështetjes së qeverisë për ofrimin e ndihmës për punonjësit dhe bizneset.<sup>[326]</sup>

Pandemia Covid-19 dhe, në mënyrë të veçantë, mbylljet brenda që pasuan i janë shtuar si barrë kujdesit të papaguar për fëmijët, të moshuarit dhe familjarët me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta, dhe barrë e shtuar mbi punët e shtëpisë në përgjithësi. Gratë, më shumë se burrat, kanë ofruar kujdes për fëmijët dhe shkollim në shtëpi për to gjatë mbylljes së çerdheve dhe shkollave, si dhe janë kujdesur për familjarët e moshuar kur këto i kishin lëvizjet e kufizuara ose të ndaluara.<sup>[327]</sup>

Gratë më pak të arsimuara u prekën në mënyrë joproporcionale nga shpërndarja e pabarabartë e përgjegjësiwe familjare.<sup>[328]</sup> Kështu, gratë më pak të arsimuara përballen me një sërë sfidash të shumëfishta; ata kanë më shumë gjasa të humbin vendin e punës ose të ardhurat e tyre, kanë më pak gjasa të marrin sigurime ose shtesa në raste emergjencash në lidhje me pandeminë Covid-19, dhe bëjnë pjesën më të madhe të punës së papaguar në familje, gjë që e pakëson shumë mundësinë e tyre për të gjetur një punë tjetër.<sup>[329]</sup>

Siç diskutohet më lart në seksionin 6 të këtij Udhërrëfyesi (Diskriminimi mbi bazën e seksit – qasja në mallra dhe shërbime, shërbime publike, ndihma sociale/shtesa), ndërkohë që nuk ekziston një e drejtë e përgjithshme për sigurimet shoqërore sipas Konventës, kur sistemet e sigurimeve shoqërore janë të ngritura, realizimi i tyre duhet të bëhet duke u mbështetur në parimet e barazisë gjinore. Në mënyrë të veçantë, metoda përmes së cilës autoritetet llogarisin kontributet

[326] Shih [https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/Kosovo\\_eng\\_web.pdf](https://crd.org/wp-content/uploads/2021/03/Kosovo_eng_web.pdf).

[327] Shih <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/05/impact-of-the-covid-19-pandemic-on-specialist-services-for-victims-and-survivors-of-violence>, "Impakti i Pandemisë Covid-19 mbi shërbimet specialiste për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë: Propozim për adresimin e nevojave", UN Women, 2020.

[328] Shih <https://www.worldbank.org/hr/news/opinion/2021/03/05/gender-inequality-the-pandemic-has-hit-women-at-more-levels-than-men> "(Pa)Barazia Gjinore: Pandemia ka Ndikuar tek Gratë në Kroaci në Nivele më të Larta sesa Burrat" nga Valerie Morrica dhe Nga Thi Viet Nyuyen, Banka Botërore, 5 mars 2021.

[329] Shih <https://www.worldbank.org/hr/news/opinion/2021/03/05/gender-inequality-the-pandemic-has-hit-women-at-more-levels-than-men> "(Pa)Barazia Gjinore: Pandemia ka Ndikuar tek Gratë në Kroaci në Nivele më të Larta sesa Burrat" nga Valerie Morrica dhe Nga Thi Viet Nyuyen, Banka Botërore, 5 mars 2021.

dhe shtesat duhet të jetë në linjë me përpjekjet për të arritur barazi gjinore në shoqërinë bashkohore.

Aty ku shtesat e sigurimeve shoqërore ose paketat financiare apo të ndihmave gjatë pandemisë ishin më të vështira për t'u marrë nga gratë, për shembull për shkak se kriteret e kualifikimit për to kërkonin prova të një historiku të tillë të punësimit që me gjasë më shumë bëhet nga burrat, Shtetet do të duhej të ishin në gjendje që të jepnin justifikim për dështimin e tyre në adaptimin e arsyeshëm të politikave të tilla për të marrë parasysh mënyrën se si ato ndikojnë ndryshe tek gratë.

## (12) Përfundim

Është e qartë se, në shumë aspekte, pozicioni i grave dhe vajzave në Ballkanin Perëndimor mbetet më keq sesa pozicioni i burrave. Gjykatat vendase në tërë rajonin duhet të luajnë rol jetik në adresimin e këtij çekuilibri. Ato duhet të mbrojnë dhe të zbatojnë efektivisht të drejtat dhe liritë në lidhje me barazinë gjinore që përmbahen në KEDNJ dhe instrumente të tjera përkatëse ndërkombetare.

Ashtu siç vazhdon të zhvillohet roli i grave në shoqëri dhe sfidat që hasin ato, edhe natyra dhe fushëveprimi i mbrojtjeve të ofruara nga Konventa vazhdon të zhvillohet. Prej këtu e tutje, jurisprudenca e Gjykatës e përmbledhur në këtë Udhërrëfyes me gjasë do të ketë rëndësi gjithnjë e më të madhe duke pasur parasysh impaktin e pandemisë Covid-19 mbi gratë, përfshirë pasojat e veçanta sociale dhe ekonomike që ato kanë pasur, si dhe rritjen alarmante të incidenteve të dhunës shtëpiake.

Jurisprudenca e Gjykatës mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e grave njeh se pozicioni i grave në shoqëri dhe mënyrat më efektive për goditjen e pabarazisë nuk janë fare temë e vendosur as vendet evropiane. Zbatimi nga Gjykata i doktrinë së hapësirës së vlerësimit në këtë aspekt u jep mundësi disa Shteteve që të zhvillojnë politika dhe rregullore sociale, ekonomike, politike dhe kulturore të cilat marrin parasysh realitetet dhe nevojat specifike të grave në shoqëritë e tyre.

Megjithatë, Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se avancimi i barazisë së sekseve është qëllim madhor në Shtetet Anëtare të KE-së dhe se, në çdo kontekst, duhet të jepen arsye me shumë peshë për të justifikuar dallimin në trajtim mbi bazën e seksit. Prandaj doktrina e hapësirës së vlerësimit nuk mund të përdoret për të minuar përpjekjet për avancimin e barazisë. Në sferat ku Shtetit zakonisht i jepet hapësirë e gjerë vlerësimi, siç është hartimi i rregullave të imigracionit ose

politikave fiskale për shembull, Gjykata ndërhyr kur këto rregulla dhe politika operojnë në mënyrë diskriminuese.

Konventa është instrument i gjallë, interpretimi i të cilit duhet të marrë parasysh ndryshimet në lidhje me rolin e grave në shoqëri. Në këtë aspekt, Gjykata ka theksuar se dallimet në trajtim mes burrave dhe grave nuk mund të justifikohen mbi bazën e stereotipeve, prezumimeve ose nocioneve tradicionale të vjetëruara rreth roleve përkatëse të burrave dhe grave në shoqëri.

Për të siguruar avancimin e vërtetë të barazisë së grave brenda KE-së, Shtetet duhet të ndërmarrin një qasje shumëdimensionale dhe të ndërthurur, të bazuar mbi elemente pjesëmarrëse dhe transformativë të barazisë që janë të shtrira dhe të njohura. Në disa kontekste, kjo mund të kërkojë dallime në trajtimin mes burrave dhe grave për të korrigjuar pabarazitë faktike ose për të avancuar pozitën e grave në shoqëri. Jurisprudenca e Gjykatës gjithnjë e më shumë njeh rëndësinë e qasjes së ndërthurur ndaj diskriminimit gjinor, dhe është e vetëdijshme për efektin kumulativ të bazave të shumta për diskriminimin ndaj kërkueseve. Kështu ishte në *B.S. k. Spanjës*, një çështje në lidhje me një grua spanjolle me origjinë nga Nigeria e cila u abuzua verbalisht dhe fizikisht kur u ndalua dhe u mor në pyetje gjatë kohës që punonte si prostitutë. Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 3, duke theksuar cenueshmërinë e veçantë në situatën e kërkueses si grua afrikane që punonte si prostitutë.<sup>[330]</sup> Ngjashëm, në çështjen *S.A.S. k. Francës* (shih lart seksionin 7(a) të këtij Udhërrëfyesi (Mbulesa fetare e kokës për gratë)), Gjykata njohu se ndalimi i vellos që mbulon krejt fytyrën kishte pasur efekte negative mbi situatën e grave myslimane që dëshironin ta mbanin vellon.<sup>[331]</sup>

Në fund, për tu siguruar që detyrimet dhe mbrojtjet e diskutuara gjatë këtij Udhërrëfyesi të zbatohen dhe të mbrohen në mënyrë efektive, gjykatat dhe profesionistët e drejtësisë në mbarë Ballkanin Perëndimor gjithashtu duhet të ndërmarrin një qasje të ndjeshme ndaj aspektit gjinor gjatë zhvillimit të procedurave ligjore dhe marrjes së vendimeve gjyqësore, si dhe të synojnë të avancojnë barazinë gjinore brenda vetë gjyqësorit. Jurisprudenca e Gjykatës në çështje si *J.L. k. Italisë* dhe *Carvalho Pinto de Sousa Morais k. Portugalisë* e ilustron impaktin e dëmshëm të stereotipeve gjinore në vendimmarrjen gjyqësore, dhe efektin shtypës që kanë ato tek përpjekjet për promovimin e barazisë.

[330] *B.S. k. Spanjës*, vendimi i 24 korrikut 2012, nr. 47159/08.

[331] *S.A.S. k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 korrikut 2014, nr. 43835/11 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

## Pjesa 2 – Përmbledhje e çështjeve sipas rendit kronologjik

*Dështimi për të njohur seksin, pas operacionit të një gruaje trans,  
në të gjitha fushat e jetës u vendos se kishte shkelur nenet 8  
dhe 12 pasi Gjykata e ngushtoi hapësirën e vlerësimit*

### **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN CHRISTINE GOODWIN k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 28957/95)

**11 korrik 2002**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, znj. Christine Goodwin, ishte shtetase e Mbretërisë së Bashkuar e lindur në vitin 1937. Nga mesi i viteve '60, asaj iu dha diagnoza si transseksuale, ku mendimi i saj ishte që 'seksi i trurit' të saj nuk përputhej me seksin e trupit të saj. Prej mesit të viteve '60 e deri në vitin 1984, periudhë gjatë së cilës ajo u martua me një grua dhe patën katër fëmijë, kërkuesja vishej si burrë në punë por si grua në kohën e lirë. Në janar 1985 ajo filloi trajtimin mjekësor, të financuar nga fonde publike, për të ndryshuar seksin, përfshirë terapi me hormone, terapi për kordat zanore, dhe operacion për ripërcaktimin e plotë të gjinisë. Gjatë kësaj kohe, kërkuesja u divorcua nga bashkëshortja, por vazhdoi të kishte marrëdhënie të afërt me fëmijët e saj.

Në fillim të vitit 1990, kërkuesja pretendoi se ishte ngacmuar seksualisht në punë dhe pastaj ishte shkarkuar për shkak të statusit të saj si trans. Më pas ajo nuk pati mundësi të ngrinte padi për diskriminim sepse me ligj konsiderohej se ishte burrë. Kërkesa e saj që pensioni i Shtetit të pasqyronte ripërcaktimin e gjinisë së saj u refuzua, dhe punëdhënësi i saj e zbuloi statusin e saj trans, duke shkaktuar sërish trajtim diskriminues për të. Gjithashtu, kërkuesja nuk mundi të ndryshonte moshën e saj të pensionit nga mosha e burrave tek mosha e grave, pra prej moshës 65 në moshën 60 vjeç. Ndërkohë që kërkuesja arriti të modifikonte kontributet pensionale shtetërore pas moshës 60 vjeç, çështja e saj u cilësua 'e ndjeshme'



dhe asaj filluan t'i kërkonin që të zhvillonte takime sy-më-sy në departamentin qeveritar përkatës edhe për arsyet më të parëndësishme. Për më tepër, të dhënat qeveritare vazhduan ta deklaropin seksin e saj si mashkull, ku e gjithë posta i adresohet asaj me ish-emrin si mashkull dhe jo me emrin e saj si femër.

Në fund, kërkuesja gjithashtu deklaroi se në shumë raste asaj i ishte dashur të zgjidhte mes zbulimit të certifikatës së saj të lindjes, e rrjedhimisht zbulimit të statusit të saj trans, dhe përfitimit nga benefitet siç ishin marrja e kredisë, oferta ri-hipotekimi, dhe e drejta për shtesa për lëndë djegëse për dimër. Asaj gjithashtu iu desh të paguante çmime më të larta për sigurimin e makinës të cilat asociohen me burrat, dhe në një rast ndjeu që nuk e pati të mundur të raportonte në polici një krim viktimë e të cilit qe ajo vetë, për shkak të frikës se hetimet do ta detyronin të zbulonte identitetin e saj trans.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur tek nenet 8, 12, 14 dhe 13 të Konventës, kërkuesja u ankua para Gjykatës se trajtimi i saj kishte shkelur Konventën. Në mënyrë të veçantë, ajo argumentoi se Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar nuk kishte ndërmarrë hapa konstruktivë për të adresuar vuajtjet dhe shqetësimet e pësuar nga ajo dhe personat e tjerë trans pas-operimit, dhe se dështimi për ta njohur gjininë e saj të ndryshuar kishte çuar në diskriminim dhe poshtërim ndaj të cilave ajo nuk kishte mbrojtje ligjore.

### Neni 8

Gjykata filloi duke theksuar se çështja ngrinte probleme që kishin të bënin me faktin nëse Shteti i kishte plotësuar detyrimet e tij pozitive sipas nenit 8, për t'u siguruar që kërkuesja gëzonte të drejtën për respektim të jetës së saj private. Këto detyrime pozitive njihen nga Gjykata si të tilla që varen nga hapësira e vlerësimit që kanë Shtetet kur vendosin se si t'i plotësojnë detyrimet e tyre. Sidoqoftë, sipas Konventës një Shtet duhet t'i plotësojë detyrimet e tij pozitive duke siguruar që të vendoset ekuilibër i drejtë mes interesave të përgjithshme të komunitetit dhe interesave të individit në fjalë.

Në çështjet e mëparshme që kanë lidhje me pikat e ngritura në këtë rast, Gjykata nuk kishte gjetur shkelje të Konventës. Gjykata njohu faktin se ajo nuk do të devijonte nga precedentët e saj pa arsye të forta, por njëkohësisht pohoi se Konventa duhet të interpretohet në mënyrë të atillë që i bën të drejtat e saj praktike dhe efektive, e jo teorike dhe iluzive. Meqenëse konteksti i personave

trans kishte ndryshuar prej kohës së vendimeve të mëhershme të Gjykatës, ishte e nevojshme që të përcaktohej se cili duhet të ishte interpretimi dhe zbatimi i përshtatshëm i Konventës.

Për të vlerësuar se si të bëhej më së miri interpretimi dhe zbatimi i Konventës, Gjykata mori në shqyrtim secilin prej aspekteve të rëndësishme dhe interesave relevante tek çështja në fjalë. Së pari, Gjykata mori në konsideratë situatën e kërkueses si person trans, e konkretisht faktin se, ndërkohë që kërkuesja kishte pasur operacion për ripërcaktimin e gjinisë dhe jetonte në mesin e shoqërisë si femër, ligjërisht ajo ishte ende mashkull. Edhe pse ajo kishte arritur të realizonte përjashtime të veçanta, siç ishin kontributet e pensionit të saj shtetëror, Gjykata njohu faktin se përjashtime të tilla prapë se prapë tërhiqnin vëmendjen drejt statusit të saj trans. Gjykata kishte njohur edhe më parë se, kur e drejta vendase ishte në kundërshtim me një aspekt të rëndësishëm të identitetit personal të një individi, tensioni dhe izolimi i shkaktuar nuk mund të shiheshin thjesht si bezdi e parëndësishme. Më tej, Gjykatës i bëri përshtypje fakti që trajtimi shëndetësor i kërkueses ishte ofruar nga shërbimi shëndetësor kombëtar, dhe që dukej e palogjikshme që Shteti të refuzonte t'i njihje me ligj pasojat e këtij trajtimi të financuar prej vetë Shtetit.

Konsiderata e dytë ishte në lidhje me njohuritë mjekësore dhe shkencore. Këtu Gjykata e konsideroi veçanërisht domethënës faktin që transseksualizmi njihet botërisht si gjendje mjekësore për të cilën mund të ofrohej trajtim, si ai i ofruar nga shërbimi shëndetësor kombëtar në Mbretërinë e Bashkuar, për të lehtësuar gjendjen. Duke pasur parasysh ndërhyrjet mjekësore të pakthyeshme, të dhimbshme, dhe të shumta që ndërthhen ky trajtim, si dhe shkallën e përkushtimit dhe bindjes që duhet të ketë njeriu për të ndryshuar rolin e vet gjinor, Gjykata konsideroi se vendimi për ripërcaktimin e gjinisë nuk është arbitrar e as tekanjöz. Pas përfundimit të trajtimeve hormonale dhe kirurgjike, Gjykata konsideroi që i vetmi aspekt i pandryshuar i identitetit gjinor të një personi mbetet elementi i kromozomeve. Gjykata nuk e pa këtë element si faktor vendimtar për qëllime të identifikimit gjinor. Prandaj, Gjykata nuk mendoi se njohuritë mjekësore ose shkencore mund të përcaktonin në masë kritike ndonjë argument në lidhje me njohjen ligjore të personave trans.

Konsiderata e tretë ishte situata e konsensusit evropian dhe ndërkombëtar. Gjykata njohu se ekzistonte një tendencë në rritje, mes Shteteve Kontraktuese dhe në arenën ndërkombëtare, drejt njohjes ligjore pas ripërcaktimit të gjinisë. Gjykata vlerësoi se, në atë kohë, kishte konsensus të paktë mes Shteteve rreth kësaj çështjeje. Prandaj, Gjykata njohu se, mbi këtë bazë, Mbretëria e Bashkuar

mund të gëzonte një hapësirë të gjerë vlerësimi për të vendosur në lidhje me masat e nevojshme për të siguruar të drejtat e Konventës brenda juridiksionit të saj, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Megjithatë, Gjykata deklaroi se ende mbetej tendenca e qartë dhe e pakontestueshme drejt njohjes ligjore të identitetit të ri seksual të personave trans pas operacionit.

Konsiderata e fundit ishte në lidhje me impaktin në sistemin e regjistrimit të lindjeve në Mbretërinë e Bashkuar. Gjykata njohu se ajo më parë kishte lejuar që Qeveritë t'i jepnin rëndësi të madhe natyrës historike të sistemit të regjistrimit të lindjeve dhe funksionit të tij si sistem të dhënash historike. Megjithatë, Gjykata njohu se ishin bërë shumë përjashtime nga parimi që të dhënat e lindjes ishin dokumente historike, dhe Gjykata konsideroi se bërja e një përjashtimi të mëtejshëm për personat trans nuk do të përbënte kërcënim për sistemin në tërësi.

Më tej, Gjykata shqyrtoi ekuilibrin e vendosur mes interesave të kërkuases dhe interesave të publikut. Këtu Gjykata njohu vështirësitë e përjetuara nga kërkuësja, dhe deklaroi se e drejta e personave trans për të gëzuar të drejtat e tyre sipas nenit 8 në të njëjtën shkallë si të tjerët nuk mund të ishte çështje polemikash, dhe se 'zona e ndërmjetme' në të cilën ndodhej kërkuësja nuk ishte e qëndrueshme. Gjykata njohu vështirësitë që hasnin Shtetet gjatë ndryshimeve madhore në sistemet e tyre ligjore por njëkohësisht edhe faktin që shoqëritë me arsye duhet të tolerojnë njëfarë parehatie në mënyrë që disa individëve t'u mundësohet të jetuarit me dinjitet dhe vlere, në përputhje me identitetin e tyre, sidomos kur një identitet i tillë arrihet me kosto shumë të lartë personale. Në çështjet e mëparshme, Gjykata ia kishte theksuar Mbretërisë së Bashkuar rëndësinë e mbajtjes nën rishqyrtim të nevojës për masa të përshtatshme ligjore në lidhje me zhvillimet shkencore dhe shoqërore, por Gjykata nuk pa prova se një gjë e tillë kishte ndodhur. Duke pasur parasysh këto faktorë, Gjykata vendosi që vendimi për t'i iniciuar ose jo këto masa ligjore tani ndodhej jashtë hapësirës së vlerësimit të Mbretërisë së Bashkuar, dhe që nuk kishte faktorë domethënës të interesit publik karshi të cilëve të peshohej interesi i kërkuases. Ndërkohë që vendimi se si të inicioheshin masat e përshtatshme ishte ende brenda hapësirës së vlerësimit të Shtetit, ekuilibri i drejtë i ngërthyer në Konventë tani favorizonte kërkuesen, dhe rrjedhimisht kishte pasur shkelje të së drejtës së saj për jetë private sipas nenit 8.

## Neni 12

Duke pasur parasysh çështjet dhe përfundimet e arritura mbi argumentet e kërkuases në lidhje me nenin 8, Gjykata konsideroi se, ndërkohë që u takon Shteteve të përcaktojnë kushtet në të cilat një person mund të pretendojë njohjen

ligjore si person trans dhe të zhvleftësojë martesat e kaluara si dhe të rregullojë formalitetet e duhura për martesa të ardhshme, nuk kishte justifikim për pengimin e personave trans nga e drejta për t'u martuar në çfarëdo rrethanash. Prandaj, pengimi i kërkueses që të martohet me partnerin e saj mashkull shkeli nenin 12.

#### Neni 14

Gjykata deklaroi se çështjet e trajtuara sipas nenit 8 mbulonin edhe çështjet e ngritura sipas nenit 14. Prandaj, ajo nuk e pa të arsyeshme t'i adresohet pikave të ngritura në lidhje me këtë nen.

#### Neni 13

Gjykata pohoi se e drejta për zgjidhje efektive nuk duhet të interpretohet si e tillë që kërkon një zgjidhje kundër të drejtës vendase, sepse kjo do të kërkonte që Konventa të inkorporohej brenda të drejtës vendase. Prandaj, nuk kishte shkelje të nenit 13.

#### Neni 41

Gjykata nuk e pa të udhës që të jepte shpërblim në këtë çështje, meqenëse Gjykata e konsideroi të mjaftueshme marrjen e masave nga Qeveria për të përmbushur detyrimet e saj të reja sipas Konventës pasi Gjykata kishte gjetur se çështja nuk hynte më brenda hapësirës vlerësuese të Shtetit. Gjykata i caktoi kërkueses 39,000 euro për kosto dhe shpenzime.

*Ndalimi nga një universitet i studenteve që të mbanin mbulesën islame në kokë nuk përbëri shkelje të të drejtave të kërkuases për lirinë e fesë dhe arsimin – Gjykata iu referua parimit të barazisë gjinore duke e gjetur ndërhyrjen proporcionale*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN LEYLA ŞAHİN K. TURQISË**

(Kërkesa Nr. 44774/98)

**10 nëntor 2005**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuësja, Leyla Şahin, ishte shtetase turke e lindur në vitin 1973. Ajo kishte jetuar në Vjenë që nga viti 1999, kur ishte larguar nga Stambolli për të vijuar studimet për mjekësi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Vjenës. Ajo vinte nga një familje e fesë myslimane, dhe e konsideronte detyrë fetare që të mbante mbulesën islame të kokës.

Në kohën materiale, ajo ishte studente e vitit të pestë në fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Stambollit. Më 23 shkurt 1998, Zv/Kancelari i Universitetit lëshoi një qarkore që udhëzonte se studentëve me mjekra dhe studente që mbanin mbulesën islame të kokës do t'u refuzohej hyrja në ligjërata, kurse dhe klasa.

Në mars 1998, kërkuësja iu refuzua hyrja në një provim me shkrim në lidhje me një prej lëndëve që ajo studioje për shkak se ajo kishte në kokë mbulesën islame. Më pas, autoritetet universitare refuzuan, për të njëjtën arsye, që ta regjistronin atë në një kurs, ose që ta pranonin në ligjërata të ndryshme dhe provime me shkrim. Fakulteti gjithashtu i lëshoi asaj një paralajmërim për kundërshtim të rregullave të universitetit në lidhje me veshjen, dhe e pezulloi atë nga universiteti për një semestër për pjesëmarrjen në një tubim të paautorizuar ku kishte protestuar kundër tij. Të gjitha dënimet disiplinore që iu dhanë kërkuësja u tërhoqën në bazë të një ligji për amnesti.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuësja u ankua sipas nenit 9 që ajo ishte ndaluar të mbante mbulesën islame të kokës në universitet, dhe u ankua për ndërhyrje të pajustificuar tek e drejta e saj për arsim, brenda kuptimit të nenit 2 të Protokollit Nr. 1. Ajo gjithashtu u mbështet tek nenet 8, 10 dhe 14.

Në vendimin e saj të datës 29 qershor 2004, Dhoma e Gjykatës Evropiane deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 9 dhe se nuk ngrihej asnjë çështje e ndarë sipas neneve 8 dhe 10, nenit 14 të marrë së bashku me nenin 9, dhe nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 me kërkesë të kërkueses.

### Neni 9

Dhoma e Madhe vazhdoi shqyrtimin me prezumimin se qarkorja në fjalë, e cila vinte kufizime ndaj vendit dhe mënyrës në lidhje me të drejtën e mbajtjes së mbulesës islame në universitete, përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkueses për të shprehur fenë e saj.

Lidhur me faktin nëse ndërhyrja kishte qenë "e parashikuar me ligj", Gjykata theksoi se qarkorja ishte lëshuar nga Zv/Kancelari në kuadër të kornizës statutore të përcaktuar me Ligjin Nr. 2547 dhe në përputhje me dispozitat rregullore që ishin miratuar përpara, si dhe me praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Turqisë. Në këto rrethana, Gjykata gjeti se kishte bazë ligjore për ndërhyrjen sipas të drejtës turke, dhe se duhet të kishte qenë e qartë për kërkuesen, prej momentit që kishte filluar universitetin, që kishte kufizime për mbajtjen e mbulesës islame, dhe, prej datës së lëshimit të qarkores në vitin 1998, se asaj mund t'i refuzohej hyrja në ligjëratat dhe provime në qoftë se vazhdonte të mbante mbulesën e kokës. Vendimet e gjykatave më të larta vendase, të cilat e mbështesnin qarkoren, ishin të bazuara mbi nocionin që mbajtja e mbulesës së kokës në universitet ishte në kundërshtim me parimet themelore të Republikës. Kjo ishte posaçërisht e vërtetë, sipas gjykatave vendase, duke marrë parasysh se mbulesa e kokës ishte simbol gjithnjë e më shumë politik i një vizioni që ishte në kundërshtim me liritë e grave.

Gjykata konsideroi që ndërhyrja e kontestuar kryesisht synonte qëllimet legjitime të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe mbrojtjes së rendit publik.

Lidhur me faktin nëse ndërhyrja ishte e nevojshme, Gjykata theksoi se ajo bazohej tek parimet e laicizmit dhe barazisë. Sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese, parimet e ndalonin Shtetin nga shprehja e ndonjë preference për ndonjë fe ose besim të caktuar; kështu që ato e udhëhiqnin Shtetin gjatë kryerjes së rolit të tij si arbitër i paanshëm, dhe domosdoshmërisht ngërthente lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes.

Gjykata po ashtu vuri në dukje theksin që sistemi kushtetues i Turqisë vinte tek mbrojtja e të drejtave të grave. Barazia gjinore – e njohur nga Gjykata Evropiane si

një prej parimeve kyçe të Konventës dhe qëllim për t'u arritur nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës – gjithashtu ishte gjetur nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë si parim i ngërthyer në vlerat e përmbajtura në Kushtetutë.

Në ato rrethana, dhe duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit të Shteteve Kontraktuese, Gjykata gjeti se ndërhyrja në fjalë ishte e justifikuar në parim dhe proporcionale me qëllimet e synuara, dhe mund të konsiderohej se kishte qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Prandaj, ajo nuk gjeti shkelje të nenit 9.

#### Neni 2 i Protokollit Nr. 1

Gjykata së pari shqyrtoi zbatueshmërinë e nenit 2 të Protokollit Nr. 1 në rrethanat e kësaj çështjeje. Ndërkohë që fjalja e parë e asaj dispozite në thelb përcaktonte qasjen në arsimin fillor dhe të mesëm, Gjykata konsideroi se nuk ekzistonte një ndarje e prerë mes arsimit të lartë dhe formave të tjera të arsimit. Gjykata konsideroi se çdo institucion i arsimit të lartë që ekzistonte në një kohë të dhënë hynte brenda fushëveprimit të fjalisë së parë të nenit 2 të Protokollit Nr. 1, meqenëse e drejta për qasje në institucione të tilla ishte pjesë përbërëse e të drejtës së përcaktuar në atë dispozitë.

Në çështjen që kishte përpara saj, përmes analogjisë me arsyetimin e saj në lidhje me çështjen e ekzistimit të ndërhyrjes sipas nenit 9, Gjykata e pranoi se rregulloret mbi bazën e të cilave kërkueses i ishte refuzuar hyrja në ligjërata dhe provime për shkak të mbulesës islame përbënte kufizim mbi të drejtën e saj për arsimim. Ashtu si tek neni 9, kufizimi ishte i parashikueshëm dhe synonte qëllime legjitime, dhe mënyrat e përdorura ishin proporcionale.

Ndalimi i mbajtjes së mbulesës islame të kokës nuk kishte prekur thelbin e të drejtës së kërkueses për arsim. As nuk kishte qenë në kundërshtim me të drejtat e tjera të ngërthyera në Konventë ose në Protokollin e saj. Prandaj Gjykata gjeti se nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 1.

#### Nenet 8, 10 dhe 14

Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të neneve 8, 10 ose 14.

*Vënia e kushteve lidhur me moshat e ndryshme të pensionit për burra dhe gra në lidhje me një shtesë të ndihmës sociale që kishte të bënte me vendin e punës nuk shkeli nenin 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN STEC DHE TË TJERË k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat nr. 65731/01 dhe nr. 65900/01)

**12 prill 2006**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit/et ishin Anna Stec, lindur në vitin 1933 me banim në Stoke-on-Trent, Patrick Lunn, lindur në vitin 1923 me banim në Stockton-on-Tees, Sybil Spencer, lindur në vitin 1926 me banim në Bury, dhe Oliver Kimber, lindur në vitin 1924 me banim në Pevensey.

Secili/a kërkues/e mernte shtesa për shkak të lëndimeve të pësuar në vendin e punës. Secili/a prej tyre kishte nisur procedura pranë Gjykatës respektive të Apelit për Sigurime Shoqërore (ang. "SSAT") në lidhje me supozime për trajtim diskriminues. Përpara SSAT, tre prej kërkuesve ia dolën me sukses, ndërsa kërkesa e njërit kërkues u rrëzua. Për secilën procedurë u apelua tek Komisioneri i Sigurimeve Shoqërore ("Komisioneri"), i cili iu bashkua kërkesave dhe kërkoi një vendim paraprak nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë ("GjED"). Pasi që GjED-ja vendosi se ishte objektivisht e nevojshme që skema e sigurimeve t'i trajtonte burrat dhe gratë ndryshe, Komisioneri i rrëzoi çështjet në të cilat kërkuesit ishin apelues dhe i lejoi çështjet në të cilat zyrtarët gjykues të SSAT-së kishin qenë apelues.

Pagesa në fjalë e ndihmës sociale ishte Shtesa e Të Ardhurave të Redukuara (ang. Reduced Earnings Allowance, "REA"), një pagesë plotësuese e lidhur me të ardhurat e cila ishte futur me një emër tjetër në vitin 1948 (Shtesa për Vështirësi të Veçanta; ang. Special Hardship Allowance). Nga fundi i viteve 1980, Qeveria futi ligje të ndryshme me qëllim të heqjes ose reduktimit të përfitimit nga kërkues të cilët ishin përtej moshës së punës. Përpara kësaj, kërkuesit kishin gëzuar të drejtën e vazhdueshme për REA, pavarësisht nëse kërkuesi e kishte mbushur moshën e pensionit apo jo. Metoda që ishte përdorur për të reduktuar përfitimin ishte vënia e kushtëzimeve për prapësinë e moshës së përdorur nga skema pensionale (d.m.th. 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë deri në vitin 1996, hendeq i cili u ngushtua duke iu afruar barazisë në vitin 2020).



## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit/et u ankuan se skema ishte diskriminuese, në shkelje të nenit 14 të Konventës i lexuar krahas nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ata/o diskutuan se do të duhej të ishte përdorur një rregullore e vetme për prapun e moshës ose për përfitimin e dyfishtë, në vend që përfitimi i shtesës të varej nga moshja shtetërore e pensionit, sepse metoda e zgjedhur diskriminonte mbi bazën e seksit. Dhoma e Gjykatës ia kaloi juridiksionin Dhomës së Madhe në përputhje me nenin 30 të Konventës.

### Neni 14 i Konventës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1

Duke nënvizuar parimet përkatëse, Gjykata vuri në dukje se neni 14 i Konventës nuk i ndalon Shtetet nga trajtimi i disa grupeve ndryshe, kur kjo bëhet me qëllim të adresimit të dallimeve faktike mes tyre. Trajtimi diferencial duhet të jetë objektivist i justifikuar, që do të thotë se ai duhet të synojë një qëllim legjitim dhe të jetë proporcional në masë të arsyeshme me atë qëllim. Shtetet gëzojnë njëfarë hapësire vlerësimi në këtë aspekt, gjë që ndryshon sipas rrethanave. Nga njëra anë, mund të kërkohen arsye me shumë peshë për të justifikuar diskriminimin mbi bazën e seksit si i tillë që është në pajtueshmëri me Konventën. Nga ana tjetër, Shtetet gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi për sa u përket masave të përgjithshme në kuadër të strategjive ekonomike ose shoqërore.

Palët nuk kishin mosmarrëveshje lidhur me faktin nëse vendimi për t'ua ndërprerë pagesën e REA-s atyre që e kishin kaluar moshën e punës përbënte qëllim legjitim apo jo. REA ishte shtesë që kishte të bënte me vendin e punës. Kështu, në vitin 1986 Qeveria kishte marrë një vendim, në kuadër të politikave, për t'ua hequr të drejtën për të përfituar shtesën atyre që nuk ishin më të punësuar/a me rrogë. Kjo përmbushte fazën e parë të testit të cekur më lart.

Në lidhje me proporcionalitetin e masave të marra, Gjykata gjeti se Qeveria kishte qenë e justifikuar kur kishte bërë lidhjen e të drejtës për REA me moshën e pensionit. Gjykata e rrëzoi parashtrimin e kërkuesve që duhet të ishte përdorur një prag i vetëm i moshës, duke gjetur se kjo do të kishte krijuar pabarazi edhe më të mëdha mes burrave dhe grave. Pyetja se cila ishte mënyra më e mirë për të ndjekur qëllimin legjitim të identifikuar ishte në thelb çështje e ekonomisë administrative, e cila hynte brenda hapësirës së vlerësimit të Qeverisë. Gjykata i dha peshë të konsiderueshme vendimit të GjED-së, i cili e njohu këtë justifikim duke pasur parasysh se ai lidhej drejtpërsëdrejti me ankesat e kërkuesve.

Për sa i përket progresionit historik drejt barabarësisë mes sekseve, Gjykata përmendi zhvillimet në reformat pensionale në vitet 1977 dhe 1978 që kishin shkuar në dobi të grave të cilat kishin qenë pa punë për periudha të gjata kohore, një ligj të vitit 1986 që i ndalonte punëdhënësit të kishin moshë të ndryshme pensioni për burrat dhe për gratë, dhe Letrën e Bardhë të Qeverisë të vitit 1993 ku njihej se numri i grave të punësuar me rrogë ishte rritur në mënyrë të konsiderueshme mes viteve 1967 dhe 1992. Hapi më i rëndësishëm ishte Letra e Gjelbër e Qeverisë e vitit 1991, e cila përfaqësonte një "lëvizje të parë konkrete" drejt një moshe universale të pensionueshme.

Gjykata shqyrtoi nëse ky dallim në trajtim mes burrave dhe grave ishte i justifikuar sipas nenit 14 të Konventës. Ajo njohu se, duke pasur parasysh historikun e praktikave të punës në Mbretërinë e Bashkuar, mos-barazia historike e trajtimit mes sekseve synonte të adresonte pabarazitë faktike. Në mënyrë të veçantë, dallimi në trajtim synonte të lehtësonte vështirësitë financiare që dilnin nga roli tradicional shtëpiak i grave. Duke pasur parasysh ndryshimet graduale drejt barazisë në praktikën e punës mes burrave dhe grave, nuk ishte e mundur të përcaktohej një moment ku dallimi diferencial ishte i pajustificuar. Në fund, Gjykata gjeti se vendimi për mënyrën më të mirë të trajtimit të tranzicionit drejt barabarësisë së sekseve në këtë aspekt hynte brenda hapësirës vlerësuese të Shtetit Kontraktues.

Në përmbledhje, Gjykata gjeti se dallimi historik në trajtimin e burrave dhe grave drejtohej kah pabarazitë faktike. Dallimi i moshës shtetërore të pensionit ishte i justifikuar në masë të arsyeshme dhe objektive për sa kohë që këto pabarazi vazhdonin. Vendimet e autoriteteve në lidhje me kohën dhe mënyrën e saktë të rregullimit të pabarazisë nuk ishin aq dukshëm të paarsyeshme sa të shkonin përtej hapësirës së gjerë të vlerësimit që lejohej në këtë fushë. Mbi këtë bazë, vendimi i palës së paditur për të lidhur REA-n me moshën e pensionit ishte i justifikuar në masë të arsyeshme dhe objektive, meqenëse ajo shtesë ishte pazgjdhshëmrisht e lidhur me periudhën punuese të jetës së një personi. Prandaj, Gjykata gjeti se nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 i lexuar në lidhje me nenin 14 të Konventës.

*Shtetet kanë detyrime pozitive sipas neneve 2 dhe 3 për të mbrojtur gratë nga dhuna shtëpiake me anë të vepruesve privatë, dhe pasiviteti gjyqësor diskriminues në lidhje me dhunën gjinore është në kundërshtim me nenin 14*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN OPUZ k. TURQISË

(Kërkesa Nr. 33401/02)

**9 qershor 2009**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja, znj. Nahide Opuz, ishte shtetase turke e lindur në vitin 1972 e cila jetonte në Turqi.

Në vitin 1990, kërkuesja filloi të jetonte me H.O., djali i bashkëshortit të nënës së saj. Kërkuesja dhe H.O. u martuan në nëntor 1995 dhe patën tre fëmijë të lindur në vitet 1993, 1994 dhe 1996. Që nga fillimi i marrëdhënies së tyre kishin mosmarrëveshje të shumta, dhe më pas u divorcuan.

Mes prillit 1995 dhe marsit 1998 ndodhën katër incidente të sjelljes së dhunshme dhe kërcënuese të H.O. ndaj kërkueses dhe nënës së saj, incidente të cilat erdhën në vëmendjen e autoriteteve. Ato incidente përfshinë disa rrahje, një përlëshje ku H.O. nxori thikën, dhe një rast ku H.O. i zuri të dyja gratë me makinë. Pas atyre sulmeve gratë u ekzaminuan nga mjekët të cilët dëshmuan në raportet e tyre për lëndime të shumta, përfshirë gjakderdhje, mavijosje, ënjtje, gërvishtje të rënda dhe të lehta. Të dyja gratë morën vërtetime mjekësore për pësimin e lëndimeve që përbënin kërcënim për jetën: kërkuesja si pasojë e një rrahjeje veçanërisht të dhunshme, dhe nëna e saj si pasojë e sulmit me makinë.

Kundër H.O. nisën procedurat penale për tre prej atyre rasteve, për kërcënime me vdekje, për lëndime trupore aktuale të rënda dhe të rënduara, dhe për vrasje në tentativë. Sa i përket incidentit me thikë, u vendos që të mos ndiqej penalisht për mungesë provash. H.O. u dërgua në paraburgim dy herë, dhe u lirua në pritje të gjyqit.

Megjithatë, meqenëse kërkuesja dhe nëna e saj i tërhoqën ankesat e tyre gjatë të gjitha atyre procedurave, gjykatat vendase i ndërprejnë çështjet sepse Kodi Penal kërkonte që për të vazhduar më tej duheshin ankesat e tyre. Procedura rreth incidentit me makinë vazhdoi në lidhje me nënën e kërkueses, duke pasur parasysh se lëndimet e saj ishin të rënda, dhe H.O. u dënua me tre muaj burgim i cili më vonë u shndërrua në gjobë.

Më 29 tetor 2001, kërkuesja u thur me thikë shtatë herë nga H.O. dhe u dërgua në spital. H.O. u akuzua për sulm me thikë dhe u gjobit përsëri me shumën prej afro 840,000 lira turke (afro 385 euro), të cilën ai pati mundësinë ta paguante me tetë këste. Pas atij incidenti, nëna e kërkueses kërkoi që H.O. të vihej në paraburgim, duke thënë se në të kaluarën ajo dhe vajza e saj ishin detyruar t'i tërhiqnin ankesat e tyre për shkak të presioneve të vazhdueshme dhe kërcënimeve me vdekje prej tij.

Më 11 mars 2002, nëna e kërkueses, e cila kishte vendosur të lëvizte për të jetuar në Izmir me vajzën e saj, u nxor me forcë nga kamioni transportues prej H.O., i cili e detyroi të ndalte kamionin. H.O. hapi derën e kamionit dhe shtiu mbi nënën e kërkueses, duke e lënë të vdekur në vend.

Në mars 2009, H.O. u shpall fajtor për vrasje dhe posedim të paligjshëm të një arme zjarri, dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Ai u lirua nga paraburgimi në pritje të procedurës së apelit. Në prill 2008, kërkuesja bëri një ankesë tjetër penale pranë autoriteteve të prokurorisë, ku ajo kërkonte që autoritetet të merrnin masa për ta mbrojtur atë sepse që kur ishte liruar ish-burri i saj kishte filluar ta kërcënonte përsëri. Në maj dhe nëntor 2008, përfaqësuesja e kërkueses e informoi Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut se asnjë masë e tillë nuk ishte marrë, dhe Gjykata kërkoi shpjegime. Nga ajo kohë autoritetet kanë marrë masa të veçanta për të mbrojtur kërkuesen, konkretisht duke shpërndarë fotografinë e ish-burrit të saj dhe shenjat e gishtave të tij tek stacionet e policisë bashkë me urdhrin që ai të arrestohej sapo të pikasej në afërsi të vendbanimit të kërkueses.

Ndërkohë, në janar 1998, në Turqi hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Familjes, i cili parashikon masa të caktuara për mbrojtjen kundër dhunës shtëpiake.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja pretendoi se autoritetet turke kishin dështuar të mbronin të drejtën e jetës për nënën e saj, dhe se ato e kishin neglizhuar dhunën e vazhdueshme, kërcënimet ndaj jetës, dhe lëndimet që ajo kishte pësuar. Ajo u mbështet tek nenet 2, 3, 6 dhe 13. Më tej, ajo u ankua për mungesën e mbrojtjes për gratë kundër dhunës shtëpiake sipas të drejtës vendase në Turqi, në shkelje të nenit 14.

### Neni 2

Gjykata konsideroi se, në rastin e kërkueses, dhuna e mëtejshme, në fakt sulmi vdekjeprurës, kishte qenë jo vetëm e mundshme por madje e parashikueshme,

duke ditur historikun e sjelljes së dhunshme të H.O. dhe veprat penale të tij ndaj gruas së tij dhe nënës së saj, si dhe kërcënimet e tij të vazhdueshme ndaj shëndetit dhe sigurisë së tyre.

Sipas praktikës së zakonshme në Shtetet Anëtare, sa më e rëndë që është vepra ose rreziku i përsëritjes së veprave, aq më shumë gjasa ka që ndjekja penale të vazhdojë në interesin publik, edhe në qoftë se viktimat i tërheqin ankesat e tyre. Megjithatë, gjatë marrjes së vendimeve të vazhdueshme për ndërprerjen e procedurave penale kundër H.O., autoritetet iu referuan ekskluzivisht nevojës për t'u përmbajtur nga ndërhyrja tek ajo që autoritetet e perceptonin si "çështje familjare". Me sa duket autoritetet nuk i morën në konsideratë motivet për tërheqjen e ankesave, pavarësisht nga deklaratat e nënës së kërkueses në prokurori që ajo dhe vajza e saj ishin detyruar t'i tërhiqnin ankesat për shkak të kërcënimeve me vdekje dhe presionit nga H.O. Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë se çdo ndërhyrje e mëtejshme nga autoritetet kombëtare do të kishte përbërë shkelje të të drejtave të kërkueses sipas nenit 8. Një ndërhyrje e tillë në jetën private ose familjare të individëve mund të jetë e nevojshme për të mbrojtur shëndetin dhe të drejtat e të tjerëve, ose për të parandaluar kryerjen e veprave penale. Serioziteti i rrezikut ndaj nënës së kërkueses e bënte të nevojshme një ndërhyrje të tillë nga autoritetet.

Pavarësisht nga tërheqja e ankesave të viktimës, korniza ligjore duhet të kishte mundësuar që autoritetet prokuroriale të vazhdonin hetimet penale kundër H.O. mbi bazën e faktit që sjellja e tij e dhunshme kishte qenë aq e rëndë sa e kërkonte pa tjetër ndjekjen penale, dhe faktit që kishte pasur kërcënime të vazhdueshme ndaj integritetit fizik të kërkueses. Gjykata theksoi se korniza ligjore në fuqi në atë kohë nuk i përmbushte kriteret e ngërthyera në detyrimet pozitive të Shtetit për të ngritur dhe zbatuar në mënyrë efektive një sistem që ndëshkonte të gjitha format e dhunës shtëpiake dhe ofronte mbrojtje të mjaftueshme për viktimat.

Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kombëtare nuk kishin treguar zellin e duhur për parandalimin e dhunës kundër kërkueses dhe nënës së saj, posaçërisht duke ndjekur penalisht ose duke ndërmarrë masa parandaluese kundër H.O. Këtu, Shteti kishte dështuar në detyrimin pozitiv për të marrë masa parandaluese operationale për të mbrojtur individët jeta e të cilave ishte në rrezik. Nga ana tjetër, hetimet për vrasje, për të cilën kishte pasur rrëfim, nuk mund të konsiderohen efektive duke pasur parasysh se procedurat ende vazhdonin pas gjashtë vitesh. Për më tepër, sistemi i të drejtës penale nuk kishte pasur efekt pengues në rastin konkret. Gjykata përsëriti se kur autoritetet kombëtare vihen në dijeni të një situatë të caktuar, ato nuk mund të mbështeten tek sjellja e viktimës për të

arsyetuar dështimin e tyre për të marrë masat e duhura. Prandaj, autoritetet turke kishin dështuar të mbronin të drejtën e jetës për nënën e kërkueses, në shkelje të nenit 2.

### Neni 3

Gjykata konsideroi se kërkuesja hynte brenda grupit të "individëve të cenueshëm" të cilave u takon mbrojtja nga Shteti. Ajo mund të futej në atë kategori për shkak të dhunës së pësuar, të prejardhjes shoqërore, kërcënimeve të bëra nga H.O. dhe situatës së grave në Turqinë juglindore. Më tej, dhuna e pësuar nga kërkuesja në formën e lëndimeve fizike dhe presionit psikologjik ishin aq të rënda saqë përbënin keqtrajtim brenda kuptimit të nenit 3. Prandaj, Shteti e kishte për detyrim të merrte të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar rindodhjen e sulmeve të dhunshme kundër integritetit fizik të kërkueses.

Gjykata konsideroi se reagimi ndaj sjelljes së H.O. kishte qenë dukshëm i pamjaftueshëm duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprave të tij. Vendimet gjyqësore, të cilat nuk kishin pasur asnjë efekt parandalues ose pengues për H.O., kishin qenë joefektive, e madje kishin treguar njëfarë tolerance për veprimet e tij. Vlen të kujtohet se, pas incidentit me makinë, H.O. kishte kaluar vetëm 25 ditë në burg dhe kishte marrë vetëm gjobë për lëndimet e rënda që i kishte shkaktuar nënës së kërkueses. Ajo që bën edhe më shumë përshtypje është fakti se, si ndëshkim për therjen shtatë herë me thikë të kërkueses, ai u dënua vetëm me gjobë të vogël të cilën mund ta paguante me këste.

E drejta turke nuk parashikonte masa të veçanta administrative dhe policore për të mbrojtur personat e cenueshëm nga dhuna shtëpiake para janarit 1998, kur hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Familjes. Edhe pas asaj date, autoritetet vendase nuk i kishin zbatuar në mënyrë efektive ato masa dhe sanksione për të mbrojtur kërkuesen.

Në fund, Gjykata theksoi me shqetësim të madh se dhuna e pësuar nga kërkuesja nuk kishte përfunduar dhe se autoritetet vazhdonin të tregonin mosveprim. Pavarësisht nga kërkesa e kërkueses në prill 2008 që autoritetet të merrnin masa për mbrojtjen e saj, asgjë nuk u bë deri kur Gjykata i kërkoi Qeverisë që të jepte informacione rreth masave mbrojtëse që kishte marrë.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 si pasojë e dështimit të autoriteteve për të marrë masa mbrojtëse në formën e pengesave efektive kundër shkeljeve të rënda të integritetit personal të kërkueses nga H.O.

## Neni 14

Gjykata theksoi se diskriminimi nënkupton trajtimin e ndryshëm të personave të situata të ngjashme, pa justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Një politikë e përgjithshme ose një masë që ka efekte paragjyqësore joproporcionale mbi një grup të caktuar mund të konsiderohet diskriminuese, edhe kur nuk i drejtohet atij grupi në veçanti. Ajo përsëriti se, kur kërkuesja vërteton dallimin në trajtim, qeveria ka barrën e provës për të treguar se ka pasur arsye. Nuk ka barriera procedurale për pranueshmërinë e provave për vlerësimin nga Gjykata të faktit nëse ka pasur dallime në trajtim, dhe Gjykata mund të mbështetet tek statistikat.

Sipas raporteve të paraqitura nga kërkuesja, të hartuara nga dy organizata të rëndësishme joqeveritare, dhe të pakontestuara nga Qeveria, numri më i madh i viktimave të raportuara të dhunës shtëpiake ishte në Diyarbakır, ku kërkuesja kishte jetuar në kohën relevante. Të gjitha viktimat ishin gra, shumica dërrmuese e tyre ishin me origjinë kurde, analfabete ose me nivel të ulët arsimor, dhe kryesisht pa burime të pavarura të ardhurash. Në fakt, raportet sugjeronin se dhuna shtëpiake tolerohej nga autoritetet, dhe se zgjidhjet e treguara nga Qeveria efektivisht nuk funksiononin. Prandaj, Gjykata konsideroi se kërkuesja kishte arritur të tregonte që dhuna shtëpiake prekte kryesisht gratë, dhe se pasiviteti i përgjithshëm e diskriminues në Turqi kishte krijuar një klimë që çonte drejt dhunës shtëpiake.

Duke pasur parasysh këto, dhuna e pësuar nga kërkuesja dhe nëna e saj mund të shihej si dhunë e bazuar në gjini, çka përbënte një formë diskriminimi kundër grave. Pavarësisht nga reformat e Qeverisë vitet e fundit, mosreagimi i tërësishëm i sistemit gjyqësor dhe mosndëshkimi që gëzonin agresorët, siç u gjet në rastin e kërkueses, tregonin se nuk kishte përkushtim të mjaftueshëm për të marrë veprimet e duhura për të trajtuar rastet e dhunës shtëpiake. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenet 2 dhe 3.

## Nene të tjera

Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, Gjykata nuk e pa të nevojshme të shqyrtonte të njëjtat fakte në kontekstin e neneve 6 dhe 13.

## Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 30,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 6,500 euro për kosto dhe shpenzime.

*Përjashtimi i ushtarakëve meshkuj prej lejes prindërore që u takon ishte diskriminim mbi bazën e seksit në shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 – ofrimi i lejes prindërore vetëm ushtarakeve femra ishte përsëritje e stereotipeve gjinore*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KONSTANTIN MARKIN K. RUSISË**

(Kërkesa Nr. 30078/06)

**22 mars 2012**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Konstantin Markin, ishte shtetas rus i lindur në vitin 1976.

Në vitin 2004 ai firmosi një kontratë për shërbimin ushtarak sipas të cilës ai mori përsipër "të shërbente sipas kushteve të parashikuara me ligj". Ai filloi shërbimin e tij si operator i inteligjencës në radiolidhje, ku shpesh zëvendësohej nga anëtare të personelit ushtarak që ishin femra.

Pas divorcit të kërkuesit nga nëna e tre fëmijëve të tij, atij iu desh t'i rriste fëmijët i vetëm. Në tetor 2005, ai aplikoi për leje prindërore tre-vjeçare pak pas lindjes së fëmijës së tij të tretë. Shefi i njësisë së tij ushtarake e refuzoi këtë kërkesë, me arsyetimin se leja prindërore tre-vjeçare mund t'i jepej vetëm pjesëtareve femra të personelit ushtarak. Kështu, kërkuesit iu lejua të merrte vetëm tre muaj leje. Megjithatë, më 23 nëntor 2005 atij i erdhi përsëri thirrja për shërbim. Kërkuesi e kontestoi këtë thirrje për shërbim ushtarak, çka Gjykata Ushtarake e Garnizonit e pranoi duke mbështetur të drejtën e kërkuesit për të vazhduar shfrytëzimin e 39 ditëve të mbetura të punës gjatë të cilave atij i ishte dhënë leja tremujore.

Në të njëjtën kohë, në nëntor 2005, kërkuesi nisi procedurën kundër njësisë së tij ushtarake, duke pretenduar leje prindërore tre-vjeçare, me arsyetimin se ai ishte kujdestari i vetëm i tre fëmijëve të tij. Më 14 mars 2006, Gjykata Ushtarake e Garnizonit Pushkin e rrëzoi pretendimin e kërkuesit si të pabazuar në ligj. Gjykata deklaroi se vetëm personeli i gjinisë femërore kishte të drejtë të merrte leje prindërore tre-vjeçare, ndërkohë që personelit të gjinisë mashkullore nuk i takonte një e drejtë e tillë. Kërkuesi apeloj, duke argumentuar se refuzimi për t'i dhënë atij leje prindërore tre-vjeçare shkelte parimin e barazisë mes burrave dhe grave i garantuar me Kushtetutë. Më 27 prill 2006, Gjykata Ushtarake e Komandës Leningradskiy e rrëzoi apelin e tij, me arsyetimin se sipas të drejtës vendase "personelit ushtarak të gjinisë mashkullore në asnjë rrethanë nuk i takonte e drejta për leje prindërore".



Në tetor 2006, pavarësisht nga vendimet e Gjykatës Ushtarake, njësia ushtarake e kërkuetit i dha atij leje prindërore gati dy-vjeçare dhe ndihmë financiare në shumën rreth 5900 euro për shkak të situatës së tij të vështirë financiare. Më pas, Gjykata Ushtarake e Garnizonit Pushkin mori një vendim ku kritikohet njësia ushtarake për dhënien e lejes prindërore kërkuetit, duke theksuar paligjshmërinë e veprimeve të njësisë ushtarake.

Në gusht 2008, kërkueti apeloj pranë Gjykatës Kushtetuese, duke thënë se dispozitat e Ligjit për Shërbimin Ushtarak në lidhje me lejen prindërore tre-vjeçare ishin në papajtueshmëri me klauzolën e barazisë në Kushtetutë. Në janar 2009, Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën e tij, duke gjetur se dispozitat ishin në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Më 13 mars 2011, një prokuror ushtarak vizitoi shtëpinë e kërkuetit. Sipas autoriteteve ruse, vizita u bë me kërkesë të Përfaqësuesit të Ruisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut me qëllim të zhvillimit të hetimeve rreth situatës familjare të kërkuetit. Pasi u konsultua me avokatin e tij në telefon, kërkueti refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve ose të paraqiste dokumentacione. Ai firmosi një deklaratë me shkrim për atë qëllim, pas së cilës prokurori u largua menjëherë nga apartamenti i tij. Prokurori mori në pyetje fqinjët e kërkuetit, të cilët dëshmuar se ai dhe ish-gruaja e tij ishin duke jetuar bashkë. Sipas Qeverisë, hetimet e saj konstatuan se kërkueti ishte ri-martuar me gruan dhe nënën e fëmijëve të tij në prill 2008 dhe se ata ishin shtuar me fëmijën e tyre të katërt në gusht 2010. Në dhjetor 2008, kërkueti e përfundoi shërbimin e tij ushtarak për arsye shëndetësore. Ai dhe gruaja e tij në atë kohë jetonin së bashku me katër fëmijët e tyre dhe me vjehrritë e tij.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 14 i marrë në lidhje me nenin 8 të Konventës, kërkueti u ankua që refuzimi për t'i dhënë atij leje prindërore kishte përbërë diskriminim mbi bazën e seksit. Më 7 tetor 2010, një Dhomë gjeti shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8. Çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 me kërkesë të Qeverisë.

### Neni 37 § 1 (b)

Si kundërshtim paraprak, Qeveria u përpoq ta rrëzonte ankesën e kërkuetit, duke argumentuar se çështja tashmë ishte zgjidhur, në përputhje me nenin 37 § 1 (b). Qeveria parashtrij se kërkueti i ishte dhënë leja prindërore dhe ai kishte marrë ndihmë financiare.

Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë. Së pari, ajo theksoi se efektet e një shkeljeje të mundshme të Konventës nuk ishin adresuar mjaftueshëm që ajo të arrinte në përfundimin se çështja ishte zgjidhur brenda kuptimit të nenit 37 § 1 (b). Megjithëse leja prindërore ishte dhënë nga njësia e tij ushtarake, kishte pasur një vonesë një-vjeçare dhe më pas leja kishte qenë dy-vjeçare. Kërkuesi nuk kishte marrë kompensim për vonesën e as për reduktimin. Më tej, ndihma financiare e dhënë nga njësia ushtarake e kërkuesit ishte për arsye të situatës së tij të vështirë financiare, e jo si kompensim.

Gjykata gjithashtu theksoi se vendimet e saj shërbenin jo vetëm për të sjellë lehtësim individual, por edhe për të mbrojtur dhe zhvilluar rregullat e Konventës, duke ngritur kështu standardet e përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe shtrirjes së jurisprudencës së të drejtave të njeriut në tërë komunitetin e Shteteve të Konventës. Rrjedhimisht, çështja përfshinte një pyetje të rëndësishme të interesit të përgjithshëm, jo vetëm për Rusinë por edhe për Shtetet e tjera palë të Konventës, të cilën Gjykata ende nuk e kishte shqyrtuar. Shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës në fjalë do të kontribuonte për ndriçimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e standardeve të mbrojtjes sipas Konventës.

#### Neni 14 në lidhje me nenin 8

Gjykata theksoi se avancimi i barazisë gjinore në ditët e sotme ishte synim madhor i Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, ku të gjitha janë palë në Konventë. Kështu, duhet të jepeshin arsye me peshë shumë të madhe në mënyrë që këto dallime në trajtim të shiheshin si të tilla që janë në pajtueshmëri me Konventën. Arsyet si tradita, prezumimet e natyrës së përgjithshme ose qëndrimet sociale të një vendi të dhënë ishin justifikime të pamjaftueshme për dallimin në trajtim mbi bazën e seksit.

Në kontekstin e veçantë të forcave të armatosura, Gjykata e pranoi mundësinë e vënies së kufizimeve mbi disa prej të drejtave dhe lirive të anëtarëve të forcave të armatosura, kufizime të cilat përndryshe nuk mund t'u viheshin civilëve.

Gjykata vërejti se neni 8 nuk përfshinte të drejtën për leje prindërore, as nuk caktonte detyrimin që Shtetet të ofronin shtesa për leje prindërore. Megjithatë, leja prindërore dhe shtesat përkatëse hynin brenda fushëveprimit të nenit 8, duke qenë se ato promovonin jetën familjare dhe domosdoshmërisht ndikonin tek mënyra se si organizohej ajo. Nga kjo rridhte se ishte i zbatueshëm neni 14, i marrë së bashku me nenin 8. Rrjedhimisht, nëqoftëse një Shtet vendoste të krijonte një skemë të lejes prindërore, ai duhet ta bënte këtë në një mënyrë që ishte në pajtueshmëri me nenin 14 të Konventës.

Për t'u siguruar nëse kishte shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8, Gjykata së pari shqyrtoi nëse kërkuesi ishte në situatë të ngjashme me gratë ushtarake. Gjykata përsëriti se, për sa i përket lejes prindërore dhe shtesave të lejes prindërore, burrat janë në situatë të ngjashme me gratë meqenëse roli i kujdesit për fëmijën gjatë periudhës së lejes prindërore ishte "i vendosur në mënyrë të ngjashme" mes burrit dhe gruas. Prandaj, qëllimi i lejes prindërore për kërkuenin, pjesëtar i shërbimit ushtarak, ishte i ngjashëm me situatën e një pjesëtareje të shërbimit ushtarak.

Më tej, Gjykata shqyrtoi nëse dallimi në trajtim mes burrave në shërbimin ushtarak dhe grave në shërbimin ushtarak ishte objektivisht dhe me arsye i justifikuar sipas nenit 14. Gjykata e refuzoi argumentin e Shtetit që dallimi në trajtim mund të justifikohet mbi bazën e faktit se gratë kishin rol të veçantë në rritjen e fëmijëve. Ajo theksoi se në shumicën e vendeve evropiane, përfshirë Rusinë, kishte ligje që lejonin civilët burra dhe gra të merrnin leje prindërore. Nga kjo rridhte se shoqëritë evropiane kishin ecur përpara drejt një ndarjeje më të drejtë mes burrave dhe grave të përgjegjësishë për rritjen e fëmijëve të tyre, dhe që roli i burrave në kujdesin ndaj fëmijëve tani ishte i njohur.

Më tej, Gjykata nuk e pranoi që dallimi në trajtimin e burrave dhe grave në shërbimin ushtarak shpjegohej me diskriminimin pozitiv në favor të grave. Në fakt, Gjykata gjeti se efekti i një dallimi të tillë në trajtim ishte përsëritje e stereotipeve gjinore dhe krijonte disavantazhe si për karrierën e grave ashtu edhe për jetën familjare të burrave. Ngjashëm, dallimi në trajtim nuk mund të justifikohet duke iu referuar traditave mbizotëruese. Perceptimi i grave si kujdestaret parësore të fëmijëve dhe burrave si bukëfituesit parësorë, në vetvete, nuk mund të konsiderohet justifikim i mjaftueshëm për dallimin në trajtim më shumë sesa mund të konsideroheshin stereotipet e ngjashme mbi bazën e racës, origjinës, ngjyrës apo orientimit seksual.

Gjykata e pranoi se, duke pasur parasysh rëndësinë e ushtrisë për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, disa kufizime të caktuara në të drejtën për leje prindërore mund të justifikoheshin për sa kohë që nuk ishin diskriminuese. Për shembull, personeli ushtarak, pa marrë parasysh a burrë a grua, mund të përjashtohet nga leja prindërore në rast se nuk do të mund të zëvendësoheshin për shkak të pozicionit në hierarki, kualifikimeve teknike të rralla, ose për shkak të përfshirjes në operacione ushtarake aktive. Përkundrazi, në Rusi, e drejta për leje prindërore varej ekskluzivisht nga seksi i personit. Përjashtimi i burrave në shërbimin ushtarak nga e drejta për leje prindërore impononte një kufizim të tërësishëm. Gjykata gjeti se, si i tillë, një kufizim i tillë i përgjithshëm dhe automatik i zbatuar ndaj një grupi

njerëzish mbi bazën e seksit binte jashtë çdo hapësire të pranueshme të vlerësimit nga ana e Shtetit.

Gjykata theksoi se kërkuesi, i cili ishte operator i inteligjencës së radiolidhjes, ishte e mundur që të zëvendësohej nga burrat ose gratë e shërbimit ushtarak. Nga tërë personeli ushtarak, ato që ishin gra kishin të drejtën e pakushtëzuar për leje prindërore tre-vjeçare. Përkundrazi, kërkuesi nuk e kishte këtë të drejtë, dhe kjo ishte vetëm për shkak të faktit që ai ishte burrë. Prandaj, ai i është nënshtruar diskriminimit mbi bazën e seksit.

Në fund, Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë që, kur kishte firmosur kontratën me ushtrinë, kërkuesi kishte hequr dorë vullnetarisht nga e drejta për të mos u diskriminuar. Rëndësia themelore e ndalimit të diskriminimit mbi bazën e seksit nënkuptonte se nuk mund të pranohej asnjë heqje dorë sepse një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me një interes të rëndësishëm publik.

Duke pasur parasysh sa u tha më lart, Gjykata konsideroi se përjashtimi i pjesëtarëve burra të shërbimit ushtarak nga e drejta për leje prindërore nuk mund të thuhet se ishte e justifikuar objektivisht ose me arsye. Gjykata arriti në përfundimin se ky dallim në trajtim, viktimë e të cilit ishte kërkuesi, përbënte diskriminim mbi bazën e seksit. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8.

#### Neni 34

Gjykata theksoi se, në parim, nuk ishte e udhës që autoritetet e një Shteti, kundër të cilit kishte ankesë para Gjykatës, të viheshin në kontakt të drejtpërdrejtë me kërkuesin në lidhje me atë çështje. Sa i përket vizitës së prokurorit në shtëpinë e kërkuesit, nuk kishte pasur prova që ajo vizitë ishte llogaritur me qëllim që ai të nxitej për të tërhequr ankesën e tij para Gjykatës ose për ta modifikuar atë, e as që vizita e kishte pasur një efekt të tillë në praktikë. Kështu, nuk mund të thuhet se autoritetet kishin penguar ushtrimin nga kërkuesi të së drejtës së tij për kërkesë individuale. Rrjedhimisht, Rusia nuk e kishte shkelur detyrimin e saj sipas nenit 34.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që Rusia t'i paguante kërkuesit 3000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 3150 euro për kosto dhe shpenzime.

*Ndalimi i tërësishëm në publik i veshjes që mbulon fytyrën mund të ishte i justifikueshëm si qëllim legjitim për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve sipas neneve 8 dhe 9 të Konventës*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN S.A.S. k. FRANCËS**

(Kërkesa Nr. 43835/11)

**1 korrik 2014**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja ishte shtetase franceze e lindur në vitin 1990 dhe jetonte në Francë. Ajo ishte myslimane që e praktikonte fenë e saj. Ajo u ankua se ndalimi i veshjeve që mbulonin fytyrën në vende publike, i futur me anë të Ligjit Nr. 2010-1192 të 11 tetorit 2010, e privonte atë nga mundësia e mbajtjes së vellos që mbulonte komplet fytyrën në publik.

Kërkuesja parashtroi se ajo mbante veshjen që mbulon trupin (burka) dhe mbulesën e kokës (hixhab) në përputhje me besimin e saj fetar, kulturën e saj dhe bindjet e saj personale. Kërkuesja gjithashtu theksoi se as burri i saj e as ndonjë anëtar i familjes nuk i bënin presion që të vishej në këtë mënyrë. Ajo shtoi se ajo e vishte hixhabin në publik dhe në ambiente private, por jo në mënyrë sistematike. Në fund, qëllimi i saj nuk ishte të mërziste të tjerët por të ndihej në paqe me veten.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja u ankua që ndalimi statutor për veshjet që mbulojnë fytyrën në publik ishte në kundërshtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Konventës. Më tej, sipas nenit 14, ajo u ankua se ndalimi çonte në diskriminim mbi bazën e seksit, fesë dhe origjinës etnike, në dëm të grave të cilat, ashtu si ajo, mbanin vellon që mbulonte komplet fytyrën.

#### Neni 8 dhe neni 9

Ndërkohë që zgjedhjet personale për dukjen e secilit/ës kanë të bëjnë me shprehjen e personalitetit të një individi dhe kështu hyjnë brenda nocionit të jetës private, kërkuesja u ankua që asaj po i ndalohej mbajtja në publik e veshjeve që asaj ia kërkonte feja, duke ngritur kryesisht një çështje në lidhje me lirinë për shfaqjen e fesë ose besimeve të veta të parashikuara me nenin 9 të Konventës.

Gjykata gjeti se kishte pasur ndërhyrje të vazhdueshme në ushtrimin e të drejtave të kërkueses sipas nenit 8 dhe 9, meqenëse ajo përballej me dilemën që ose të vepronte në përputhje me Ligjin e 11 tetorit 2010 duke mos u veshur në përputhje me besimin e saj fetar, ose të refuzonte përputhjen me ligjin dhe të përballej me sanksione penale. Ndërhyrja në fjalë ishte e parashkruar në ligj.

Gjykata e pranoi që ndërhyrja synonte dy prej qëllimeve legjitime të renditura në nenin 8 dhe 9, pra sigurinë publike dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në lidhje me qëllimin e sigurisë publike, Gjykata theksoi se Ligji plotësonte nevojën për t'i identifikuar individët për të parandaluar rreziqet ndaj sigurisë së personave dhe pronës dhe për të luftuar aktet e mashtrimit të identitetit. Megjithatë, duke pasur parasysh impaktin që kishte ai mbi të drejtat e grave të cilat dëshironin të mbanin vallon që mbulon komplet fytyrën për arsye fetare, një ndalim i tërësishëm në publik i veshjes që mbulonte fytyrën mund të shihej vetëm në një kontekst ku ekzistonte një kërcënim i përgjithshëm i sigurisë publike dhe ku siguria publike nuk mund të garantohej thjesht me detyrimin për heqjen e veshjeve me konotacione fetare gjatë kontrolleve të sigurimit. Qeveria nuk kishte treguar se ndalimi i vendosur me anë të Ligjit hynte brenda një konteksti të tillë, dhe kështu Ligji nuk ishte i nevojshëm për sigurinë publike në një shoqëri demokratike.

Më pas, Gjykata shqyrtoi nëse një ndërhyrje e tillë synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Qeveria iu referua nevojës për "të siguruar respekt për vlerat bazë të një shoqërie të hapur demokratike", duke renditur tri vlera: respekti për barazinë gjinore, respekti për dinjitetin njerëzor dhe respekti për kërkesat bazë të jetës në shoqëri (ose të 'të jetuarit së bashku'). Gjykata e pranoi se barazia gjinore mund ta justifikonte një ndërhyrje tek ushtrimi i të drejtave të caktuara. Për shembull, kur një Shtet Palë ua ndalon të gjithëve që t'i detyrojnë gratë ta mbulojnë fytyrën, kjo ndjek një qëllim i cili përputhet me "mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve" brenda kuptimit të neneve 8 dhe 9. Megjithatë, një Shtet Palë nuk mund të mbështetet tek barazia gjinore për të ndaluar një praktikë që mbrohet nga gratë, siç është rasti i kërkueses. Gjykata gjithashtu gjeti se respekti për dinjitetin njerëzor nuk mund të justifikojë një ndalim të tërësishëm të mbajtjes së vellos që mbulon komplet fytyrën në vende publike. Velloja që mbulon komplet fytyrën është shprehje e identitetit kulturor i cili kontribuon në pluralizmin e ngërthyer në demokraci. Nga ana tjetër, Gjykata e pranoi se bariera e krijuar karshi të tjerëve nga velloja që mbulon fytyrën në publik mund të dëmtojë nocionin e 'të jetuarit së bashku', meqenëse fytyra luan rol të rëndësishëm në raportet shoqërore.

Në lidhje me fleksibilitetin e nocionit të 'të jetuarit së bashku', Gjykata u desh të bënte një ekzaminim të kujdesshëm të nevojshmërisë së masës në fjalë, veçanërisht nëse ndalimi ishte proporcional me qëllimin e synuar. Ajo vërejti se ndalimi i tërësishëm mund të dukej i tepruar dhe joproporcional, duke pasur parasysh numrin e vogël të grave në fjalë. Ndërkohë që Gjykata e kuptonte se ndalimi i kontestuar ndikonte vetëm disa gra të caktuara myslimane, sidoqoftë ajo theksoi se nuk kishte kufizime tek liria për të mbajtur në publik çdo lloj veshjeje që nuk mbulonte fytyrën. Kështu ndalimi nuk ishte shprehimisht i bazuar në konotacionet fetare të veshjes në fjalë por thjesht në faktin që ai mbulonte fytyrën. Përveç kësaj, sanksionet e parashikuara me Ligj (gjobë deri në 150 euro dhe/ose detyrimi i mundshëm për të vijuar një kurs qytetarie) ishin ndër më të lehtat që mund të mendoheshin. Më tej, meqenëse çështja nëse lejimi ose jo i vellos që mbulon komplet fytyrën kishte të bënte me zgjedhjen e shoqërisë, temë rreth së cilës nuk kishte konsensus mes Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, Franca kishte hapësirë të gjerë vlerësimi. Në këtë kontekst, Gjykata kishte për detyrë të tregojë e përmbajtur gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë me Konventën.

Prandaj, ndalimi i ankimuar mund të shihej si proporcional me qëllimin e synuar, pra ruajtjen e kushteve për të 'jetuar së bashku'. Kufizimi i kontestuar pra mund të shihej si "i nevojshëm në një shoqëri demokratike". Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 e as të nenit 9 të Konventës.

#### Neni 10

Gjykata po ashtu ishte e mendimit se nuk ngrihej çështje e ndarë në lidhje me të drejtën e lirisë së shprehjes e marrë ndaras ose së bashku me nenin 14.

#### Neni 14

Kërkuesja u ankua për diskriminim indirekt, meqenëse, si grua myslimane, ajo i përkiste një kategorie individësh veçanërisht të ekspozuar prej ndalimit në fjalë. Ndërkohë që ndalimi i vënë nga Ligji francez pa dyshim që kishte efekte negative në situatën e grave myslimane të cilat, për arsye fetare, dëshironin të mbanin vellon që mbulon komplet kokën në publik, ajo masë kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për arsyet e cekura më lart. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenet 8 ose 9.

*Trajtimi i pafavorshëm i burrave të moshës 18-65 vjeç në dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm krahasuar me grupet e tjera nuk përbëri shkelje të nenit 14 i lexuar në lidhje me nenin 5*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KHAMTOKHU DHE AKSENCHIK k. RUSISË**

(Kërkesat Nr. 60367/08 dhe Nr. 961/11)

**24 janar 2017**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin z. Khamtokhu, i lindur në vitin 1970, dhe z. Aksenchik, i lindur në vitin 1985. I pari ishte gjetur fajtor për vepra të ndryshme, përfshirë arratisje nga burgu, vrasje në tentativë e policëve dhe zyrtarëve të Shtetit, dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit. I dyti ishte gjetur fajtor për tri akuza për vrasje.

Të dy ishin dënuar me burgim të përjetshëm. Sipas Nenit 79 § 5 të Kodit Penal të Federatës Ruse, një person i dënuar me burgim të përjetshëm kishte të drejtën për lirim të parakohshëm pas përfundimit të periudhës 25-vjeçare. Megjithatë, Neni 57 përmbante një përjashtim për dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm për gratë, kryesit nën moshën 18 vjeç dhe ata mbi moshën 65 vjeç.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se trajtimi i diferencuar i grupit të tyre, mbi bazën e moshës dhe të seksit, përbënte trajtim diskriminues në shkelje të nenit 14 të Konventës i lexuar bashkë me nenin 5.

#### Neni 14 në lidhje me nenin 5

Gjykata së pari shqyrtoi nëse çështja hynte brenda kuadrit të nenit 5 i lexuar së bashku me nenin 14. Ajo theksoi se kërkuesit ishin dënuar nga një gjykatë kompetente, siç kërkohet nga neni 5 § 1, dhe deklaroi se çështjet e dënimeve zakonisht ishin jashtë fushëveprimit të shqyrtimit nga Gjykata. Megjithëse neni 14 nuk është dispozitë vetqëndruese, ndalimi i diskriminimit në këtë nen shtrihet duke mbuluar edhe të drejta të tjera, duke hyrë brenda fushëveprimit të përgjithshëm të çdo neni të Konventës, të cilin Shteti vullnetarisht ka vendosur ta ofrojë. Duke pasur parasysh se ligjet vendase përjashtonin disa kategori të burgosurish nga burgimi i përjetshëm, kjo çështje hynte brenda kuadrit të nenit



5 § 1 për qëllimet e nenit 14. Në fund, Gjykata njohur se mosha dhe seksi ishin të dyja baza që mbuloreshin nga neni 14. Rrjedhimisht, neni 5 në lidhje me nenin 14 ishin të zbatueshëm në rastin konkret.

Më tej, Gjykata shqyrtoi nëse dispozita që përjashtonte kategori të caktuara të të dënuarve nga burgimi i përjetshëm ishte në pajtueshmëri me Konventën. Testi përmbajti dy pjesë: së pari, a kishte dallim në trajtim në krahasim me personat në situata të ngjashme? Së dyti, ky dallim në trajtim a ishte i justifikuar objektivisht dhe me arsye, apo a kishte marrëdhënie proporcionaliteti mes mënyrës dhe qëllimit? Barra e identifikimit të dallimit i binte kërkuesve, e më pas i takonte qeverisë të vërtetonte që ai ishte i justifikuar.

Në lidhje me pyetjen e parë, Gjykata pranoi se kërkuesit ishin trajtuar ndryshe në krahasim me të tjerët në situata të ngjashme. Për shembull, sikur ata të kishin qenë femra, ose po të kishin qenë jashtë grupmoshës 18-65 vjeçare, dhe po të kishin qenë të dënuar për të njëjtat vepra, ata nuk do të kishin marrë dënimin me burgim të përjetshëm.

Në lidhje me faktin nëse dallimi në trajtim ishte i justifikuar ose proporcional, Gjykata parashtroi disa vërejtje dhe parime të përgjithshme, para se të ekzaminonte nëse dallimi në trajtimin e burrave të grupmoshës 18-65 vjeç ishte i justifikuar në krahasim me secilin prej grupeve të përjashtuara. Ajo njohu hapësirën e vlerësimit që kishin Shtetet në fushën e politikës penale. Ajo theksoi se caktimi i dënimit me burgim të përjetshëm nuk është në pajtueshmëri me Konventën *per se*. Sipas kodit penal të Rusisë, dënimet me burgim të përjetshëm rezervoheshin për veprat më të rënda dhe asnjëherë nuk caktoheshin në mënyrë automatike. Megjithatë trajtimi i ndryshëm mbi bazën e seksit do të kërkonte justifikim të veçantë, nuk i takonte Gjykatës që të përcaktonte dënimin e përshtatshëm në procedura penale.

Në lidhje me shkelësit e moshës së mitur, Gjykata nuk pa arsye pse të vihej në pyetje trajtimi i ndryshëm i tyre. Kjo qartazi justifikohet mbi bazën e ndryshimeve fiziologjike themelore mes të rinjve dhe të rriturve. Në lidhje me personat e moshës 65 vjeç e sipër, Gjykata përsëriti se një dënim me burgim të përjetshëm do të ishte në pajtueshmëri me nenin 3 vetëm në qoftë se kishte perspektivë reale lirimi dhe mundësi rishikimi. Meqenëse kodi penal rus parashikonte një periudhë minimale prej 25 vitesh për dënimin me burgim të përjetshëm, pragu i moshës 65 vjeç synonte qëllimin legjitim të garantimit që mundësia e lirit nuk ishte e natyrës iluzive. Në këtë aspekt, Shteti kishte vepruar brenda hapësirës së vlerësimit të tij. Në fund, në lidhje me shkelëset femra, Gjykata gjeti se përjashtimi njihje nevojën, siç është ngërthyer në instrumente të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare,

që të mbronte gratë nga dhuna me bazë gjinore, nga abuzimi dhe ngacmimi seksual në burg, si dhe nevojën për të mbrojtur shtatzaninë dhe amësinë. Gjykata mori në konsideratë të dhënat e ofruara nga Qeveria të cilat tregonin proporcionin relativisht të vogël të të burgosurave femra, prej të cilave shumë pak ishin duke vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm. Kjo tregonte interesin e qartë publik në thelb të politikës së përjashtimit të të burgosurave femra nga dënimet me burgim të përjetshëm.

Një pjesë e konsiderueshme e parashtrimeve të kërkuesve kishte të bënte me evolucionin e pretenduar të qasjeve globale drejt heqjes së tërësishme të dënimeve me burgim të përjetshëm, ku citohej fakti se njëzet vende tani nuk e kishin më fare këtë dënim. Ndërkohë që Gjykata ishte dakord që politika penale ishte fushë në zhvillim e sipër, pra që të drejtat dhe liritë e ndryshme ishin në proces të evolucionit, ajo e refuzoi nocionin se ekzistonte konsensus në lidhje me këtë pikë. Më tej, ajo njohu hapësirën e vlerësimit që kishin Shtetet gjatë vendosjes për çështje të politikës penale.

Në tërësi, Gjykata gjeti se ekzistonte një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti mes mënyrave të përdorura dhe qëllimit legjitim të synuar. Përjashtimet e kontestuara prej dispozitës së përgjithshme për dënimet me burgim të përjetshëm nuk përbënë dallim të ndaluar në trajtim për qëllimet e nenit 14 të marrë në lidhje me nenin 5.

*Ligji i Sheriatit për trashëgiminë iu zbatua testament-lënësit, shtetas grek që i përkiste pakicës myslimane, kundër dëshirës – shkëlje e nenit 14 i lexuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MOLLA SALI K. GREQISË**

(Kërkesa Nr. 20452/14)

**19 dhjetor 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuësja ishte shtetase greke e lindur në vitin 1950, dhe në kohën e procedurave ajo jetonte në Komotini. Para se të vdiste, bashkëshorti i kërkuësese hartoi një testament publik të noterizuar në përputhje me Kodin Civil grek. Bashkëshorti, i cili ishte anëtar i komunitetit mysliman të Trakës, ia la tërë pronat e tij bashkëshortes së vet. Gjykata e Shkallës së Parë e Komotinit e miratoi testamentin mbi bazën e certifikatës së lidhjes më të afërt familjare e paraqitur nga kërkuësja, dhe ajo i pranoi pronat e bashkëshortit të saj më 6 prill 2010, kur edhe i regjistroi pronat e transferuara në regjistrin e tokave.

Më 12 dhjetor 2009, dy motrat e bashkëshortit të vdekur kontestuan vlefshmërinë e testamentit para Gjykatës së Shkallës së Parë të Rodopit. Motrat paraqitën pretendim për tri të katërtat e pronave të lëna trashëgimi. Ato paraqitën arsyetimin se si i ndjeri, ashtu edhe ato të dyja, i përkiste komunitetit mysliman të Trakës, kështu që çështjet e pronave hynin brenda ligjit të Sheriatit, e jo Kodit Civil. Motrat pretenduan se zbatimi i ligjit të Sheriatit tek shtetasit grek të besimit mysliman ishte i parashikuar me dispozitat e Traktatit të Sèvres të vitit 1920 dhe Traktatit të Lozanës të vitit 1923, të dy traktate të ratifikuara në Greqi. Ato debatuan duke thënë se ligji i trashëgimisë për myslimanët ishte pa testament, e jo me testament. Në qoftë se i vdekuri linte pas familjarë të afërt, testamenti ishte vetëm pjesë e trashëgimisë pa testament. Më 1 qershor 2010 Gjykata e Rodopit e rrëzoi kontestin e motrave, duke vendosur që zbatimi i ligjit të Sheriatit ndaj shtetasve grek krijonte diskriminim mbi baza fetare.

Pas kësaj, motrat apeluan pranë Gjykatës së Apelit të Trakës, ku apeli i tyre sërish u rrëzua. Më tej, bënë apel në Gjykatën e Kasacionit. Më 6 prill 2017, Gjykata e Kasacionit vendosi që ligji i zbatueshëm për ato prona ishte ligji i Sheriatit. Konkretisht, u theksua se pronat kishin qenë tokë publike (*mulkia*) që kishte qenë nën administratën Osmane dhe përpara e qeverisur nga ligji i Sheriatit. Kështu,

testamenti publik do të duhej të zhvleftësohej dhe të bëhej nul meqenëse ligji i Sheriatit nuk e njihnte institucionin. Gjykata e Kasacionit e ktheu çështjen tek Gjykata e Apelit e Trakës vendimi i së cilës ishte në linjë me gjykatën e mëparshme dhe e cila vuri mënjanë vendimin e Gjykatës së Rodopit të marrë më 1 qershor 2010.

Kërkuesja apeloj në Gjykatën e Kasacionit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, duke argumentuar se vendimi ishte arsyetuar në mënyrë të pamjaftueshme në lidhje me faktin nëse bashkëshorti i saj kishte qenë mysliman që e praktikonte fenë – parakusht për zbatimin e ligjit të Sheriatit. Së dyti, ajo argumentoi se interpretimi i pasaktë i Kodit Civil krijonte një grup ligjesh të veçuara për shtetasit grek myslimanë edhe nëse myslimanët nuk i përmbaheshin me besnikëri doktrinës islame. Në fund, ajo argumentoi se lënia e testamentit publik ishte e drejtë e të gjithë shtetasve grek pavarësisht nga feja. Më tej, kërkuesja argumentoi se zbatimi i ligjit të Sheriatit shkelte të drejtat individuale të myslimanëve sipas Kushtetutës greke dhe nenit 6 si dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së. Më 6 prill 2017, apeli i kërkueses u rrëzua pa iu referuar Konventës. Përfundimisht kërkueses iu hoqën tri të katërtat e pronave të lëna trashëgimi.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendoi se kishte pasur shkelje të nenit 6 i vetëm dhe në lidhje me nenin 14, si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata, duke qenë mjeshtre e karakterizimit të dhënë në kuadër të ligjit për faktet e një çështjeje, konsideroi se meqenëse fokusi kryesor i çështjes ishte refuzimi i Gjykatës së Kasacionit për të zbatuar ligjin e trashëgimisë ashtu siç parashikon Kodi Civil për arsye të lidhura me besimin mysliman të trashëgim-lënësit, pika kryesore ishte nëse kishte pasur dallim në trajtim që përbënte diskriminim fetar. Prandaj, ajo vendosi ta shqyrtonte çështjen vetëm sipas nenit 14 të Konventës i lexuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

### Neni 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1

Gjykata së pari shqyrtoi nëse pamundësia e kërkueses për të trashëguar sipas një testamenti hynte brenda fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Duke pasur parasysh hapat që kishte marrë kërkuesja për të siguruar pronat dhe sfidat që kishin paraqitur motrat me kontestimin e vlefshmërisë së testamentit pas miratimit të tij, kërkuesja do t'i kishte trashëguar pronat sikur testament-lënësi nuk do të kishte qenë mysliman. Kështu, interesi pronësor i trashëgimisë ishte i mjaftueshëm dhe përbënte posedim ashtu siç përcaktohet nga neni 1 i Protokollit Nr. 1, që do të thoshte se neni 14 ishte i zbatueshëm.

Gjatë shqyrtimit nëse ishte shkelur neni 14, Gjykata u desh të sigurohej nëse kishte dallim në trajtimin e personave në situata analoge ose të ngjashme dhe nëse ai dallim bazohej mbi ndonjë karakteristikë të identifikueshme që përbënte diskriminim. Në çështjen në fjalë, Gjykata gjeti se kishte dallime në trajtim mes situatës së kërkueses si përfituesja e testamentit të përgatitur në përputhje me Kodin Civil nga një trashëgim-lënës mysliman dhe një trashëgim-lënës jo-mysliman. Ishte e qartë se kërkuesja priste, si çdo shtetas/e grek/e, që pronat e bashkëshortit të saj do të trajtoheshin në përputhje me testamentin e tij. Vendimi i Gjykatës së Kasacionit për të zbatuar ligjin e Sheriatit e trajtoi një situatë relativisht të ngjashme ndryshe mbi bazën e fesë së trashëgim-lënësit.

Më tej Gjykata vendosi nëse kishte pasur justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për dallimin në trajtim. Qeveria parashtroi se dallimi në trajtim ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së pakicës myslimane të Trakës. Gjykata gjeti se nuk ishte e nevojshme të ndërmerrej një qëndrim i ngulitur në lidhje me çështjen, dhe vazhdoi me shqyrtimin nëse dallimi në trajtim kishte qenë proporcional.

Gjykata së pari diskutoi justifikimet e Qeverisë për privimin e kërkueses nga një pjesë e pronave të saj. Justifikimet përfshinin detyrimet ndërkombëtare të Greqisë dhe natyrën e pronave në fjalë që përbënin *mulkia*. Gjykata i shqyrtoi traktatet ndërkombëtare të Athinës, Sèvres dhe Lozanës, dhe përcaktoi se këto detyrime ndërkombëtare nuk kërkonin që Greqia të zbatonte ligjin e Sheriatit apo t'i jepej çfarëdo juridiksioni një grupi të caktuar në lidhje me praktikat fetare. Përveç kësaj, Gjykata vlerësoi se *mulkia* ishte relevante vetëm kur prona qeverisej nga një myfti. Megjithatë, sipas të drejtës vendase, fusha e kompetencës së myftiut kishte të bënte vetëm me testamentet islame dhe trashëgimitë pa trashëgim-lënës. Në këtë rast, bashkëshorti i vdekur qartazi i kishte kërkuar shërbimit të noterisë që të hartonte një testament, ku pronat vendoseshin jashtë qeverisjes së myftiut.

Gjykata gjithashtu theksoi pasigurinë brenda të drejtës greke në lidhje me faktin nëse ligji i Sheriatit ishte në pajtueshmëri me parimin e trajtimit të barabartë dhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo divergjencë e opinionëve gjyqësore dëmtonte sigurinë ligjore dhe ishte në papajtueshmëri me kriteret e shtetit të së drejtës. Organe të shumta ndërkombëtare shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me zbatimin e ligjit të Sheriatit për myslimanët grekë, sidomos tek gratë dhe fëmijët. Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut raportoi se zbatimi i ligjit të Sheriatit në të drejtën familjare dhe atë të trashëgimisë ishte në papajtueshmëri me detyrimet ndërkombëtare të Greqisë. Komisioneri rekomandoi që autoritetet greke ta interpretonin Traktatin

e Lozanës dhe traktatet e tjera përkatëse në përputhje me detyrimet e tyre sipas instrumenteve ndërkombëtare dhe evropiane të të drejtave të njeriut.

Gjykata arriti në përfundimin se qëllimi i Greqisë në mbrojtjen e pakicës myslimane të Trakës nuk ishte proporcional me mazën e marrë kundër të drejtave trashëgimore të kërkuases. Liria e fesë nuk kërkon që Shteti të krijojë një kornizë ligjore për t'u ofruar status të veçantë komuniteteve fetare me privilegje të caktuara. Megjithatë, kur Shtetet e lejojnë statusin special, ato duhet të sigurohen që kriteret për dhënien e statusit special të zbatohen në mënyrë jo-diskriminuese. Nuk mund të supozohet se një trashëgim-lënës mysliman ka hequr dorë nga e drejta për të mos u diskriminuar mbi bazën e fesë. Për më tepër, besimi fetar i një personi nuk mund të nënkuptojë heqjen dorë nga të drejta të caktuara në qoftë se kjo do të ishte në kundërshtim me interesa të rëndësishme publike. Një Shtet nuk mund ta mbrojë një grup pakicë në dëm të anëtarëve të cilët më pas zgjedhin që të mos i përkasin atij grupi ose të mos ndjekin praktikat dhe rregullat e tij. Rrjedhimisht, refuzimi i të drejtës së anëtarëve të një pakice fetare për të zgjedhur vullnetarisht ligjet e zakonshme përbën trajtim diskriminues dhe shkel të drejtën themelore për vet-identifikim të lirë. Vet-identifikimi ngërthen të drejtën për të zgjedhur që të mos trajtohesh si anëtar i një pakice, dhe duhet të respektohet nga anëtarët e tjerë të pakicës dhe Shtetit. Duke u mohuar individëve zgjedhjen për të dalë jashtë një regjimi të caktuar ligjor që synon të mbrojë myslimanët, Greqia dështoi të përmbushte qëllimin legjitim të mbrojtjes së pakicës myslimane të Trakës.

Gjykata gjeti se dallimi në trajtim që kishte pësuar kërkuësja, si përfituese e një testamenti të hartuar në përputhje me Kodin Civil nga një trashëgim-lënës i fesë myslimane, në krahasim me përfituesin/en e një testamenti të hartuar në përputhje me Kodin Civil nga një trashëgim-lënës jo-mysliman, nuk kishte justifikim objektiv e as të arsyeshëm. Prandaj, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të nenit 14 të Konventës i lexuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

#### Neni 41

Sipas nenit 41, Gjykata deklaroi se çështja e shpërblimit të drejtë nuk ishte e gatshme për vendim. Çështja u rezervua në lidhje me çdo marrëveshje që mund të arrihet mes Shtetit dhe kërkuases brenda tre muajve.

*Mungesa e mbrojtjeve ligjore ose procedurale kundër dhunës në familje dhe efekti joproporcional që kishte kjo te gratë përbëri shkelje të nenit 3 si dhe një shkelje të ndarë të nenit 3 lexuar në lidhje me nenin 14*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN VOLODINA K. RUSISË

(Kërkesa Nr. 41261/17)

**9 korrik 2019**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja, znj. Valeriya Igorevna Volodina, ishte shtetase ruse e lindur në vitin 1985. Në gusht të vitit 2018 ajo ndryshoi me ligj emrin e saj, që do të thotë se emri në këtë kërkesë nuk ishte më emri që ajo përdorte.

Në nëntor 2014, ajo pati një marrëdhënie të shkurtër me 'S', e cila përfundoi në maj të vitit pasues. S vazhdoi ta abuzonte kërkuesen për një periudhë të gjatë. Kjo kryesisht ndodhi në formën e dhunës fizike, për shkak të së cilës, në një rast, asaj iu desh të kryente abort për arsye mjekësore. Gjithashtu, dhuna përfshiu dëmtime në pronën e saj, një tentativë për t'i marrë jetën (asaj), kërcënime verbale, një përpjekje për të vënë një pajisje përgjimi në trupin e saj, dhe publikimin e fotografive pa pëlqimin e saj.

Kërkuesja lëvizi duke banuar në qytete të ndryshme për të ikur nga S, por kjo gjë nuk e ndali abuzimin. Pasi u vendos në Moskë, ajo vendosi CV-në e saj në një faqe interneti për të gjetur punë, dhe u kontaktua nga D. Pasi caktoi një takim me D dhe hipi në makinën e tij, ajo zbuloi se kishte rënë në kurth. D i dha çelësat e makinës S-së, i cili e mori kërkuesen me makinë dhe e ktheu në qytetin e tyre fillestar.

Kërkuesja kontaktoi policinë shumë herë gjatë periudhës së abuzimit, por në shumicën e rasteve këto ankesa u vunë mënjanë për arsye të procedurave dhe provave. Përjashtim ishin hetimet rreth publikimit të fotografive të kërkueses në media sociale, megjithatë kjo nuk solli ndonjë rezultat. Ajo gjithashtu tentoi, pa sukses, të aplikonte për mbrojtje nga Shteti, duke u bazuar në statusin e saj si palë e dëmtuar në hetime penale (në lidhje me publikimin e fotografive të saj).

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua se autoritetet vendase kishin dështuar që ta mbronin nga aktet e përsëritura të dhunës dhe që ta bënë abuzuesin e saj të jepte llogari, çka

përbëri shkelje të nenit 3 të Konventës. Ajo gjithashtu u ankua rreth mungesës së mekanizmave të parandalimit efektiv kundër dhunës shtëpiake në Rusi, çka përbënte shkelje të nenit 13 të marrë së bashku me nenin 3. Në fund, ajo u ankua për efektin joproporcional që këto dështime kishin mbi gratë, çka përbënte shkelje të nenit 14 të marrë bashkë me nenin 3.

### Neni 3

Duke theksuar ashpërsinë e abuzimit që supozohet se ishte pësuar nga kërkuesja, dhe me gjasë dëmet fizike dhe emocionale që kjo i shkaktoi asaj, Gjykata gjeti se çështja në fjalë hynte brenda kuadrit të nenit 3. Gjykata e lexoi nenin 3 së bashku me nenin 1, i cili i detyron Palët Kontraktuese të sigurojnë të drejtat dhe liritë e përmbajtura në Konventë. Detyrimet pozitive të autoriteteve në një situatë të tillë ishin të trefishta: të ngrenë një kornizë ligjore efektive për të ofruar mbrojtje kundër keqtrajtimit, të marrin hapa të arsyeshëm për të parandaluar çdo rrezik ose keqtrajtim të ditur, dhe të zhvillojnë hetime efektive kur bëhet një padi e argumentuar.

Gjykata gjeti se Shteti përgjegjës nuk i përmbushte këto kritere. Së pari, Shtetet duhet të kriminalizonin aktet e dhunës në familje dhe të ofronin sanksione efektive. Në Rusi, nuk ekzistonin dispozita specifike që adresonin dhunën ndër-familjare, as nuk ekzistonte koncepti i veçantë i 'dhunës shtëpiake' në të drejtën vendase. Fakti që ky sulm përbëri vepër penale vetëm pasi ndodhi për herë të dytë brenda një periudhe 12-mujore shkeli praktikën gjyqësore të Gjykatës, e cila ndalon çdo kriter të rreptësisë minimale. Gjykata e rrëzoi pretendimin e qeverisë që dhuna shtëpiake mbulohej në mënyrë adekuate nga dispozitat ekzistuese. Nuk ishte e mjaftueshme mbështetja tek ndjekja penale private, duke pasur parasysh se sa e rëndë ishte kjo mbi viktimat. Sidoqoftë, edhe sikur të mund të konstatohesh fajësia, ligjet ruse nuk parashikonin sanksione efektive siç janë urdhrat mbrojtëse ose kufizuese.

Në lidhje me pikën e dytë, Gjykata theksoi pamjaftueshmërinë e reagimit të Shtetit ndaj ankesave të kërkueses në rastin konkret. Mes janarit 2016 dhe marsit 2018, ajo i kontaktoi autoritetet shtatë herë, ku çdo herë ajo shpjegoi natyrën e abuzimeve të dhunshme me të cilat përballej, që do të thotë se autoritetet e dinin rrezikun që i kanosej asaj. Përsëri, Gjykata theksoi mungesën e masave mbrojtëse në dispozicion të viktimave të dhunës shtëpiake, siç janë urdhrat mbrojtës, të cilat mund t'i kishin ofruar kërkueses njëfarë sigurie. Autoritetet efektivisht kishin lejuar që S të vazhdonte ta kërcënonte, ta ngacmonte, dhe ta sulmonte kërkuesen pa u ndëshkuar.



Në fund, Gjykata gjeti se modeli i vazhdueshëm i vënies mënjanë të ankesave të kërkueses nga autoritetet vendase, dhe dështimi i tyre për të nisur hetimet penale, nënkuptonin që nuk ishin zhvilluar hetime efektive. Ndërkohë që qeveria argumentoi se kërkuesja kishte të hapura rrugë të tjera ligjore, siç ishte padia civile për dëmshpërblim, ky ishte opsion i papërshtatshëm sepse nuk do të çonte drejt ndjekjes penale, që ishte kriter kyç për aktet e dhunës sipas nenit 3. Në tërësi, Gjykata gjeti shkelje të nenit 3.

### Neni 13

Pasi gjeti shkelje të nenit 3, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte nëse kishte pasur gjithashtu shkelje sipas nenit 13.

### Neni 14 në lidhje me nenin 3

Kërkuesja u ankua se dështimi i autoriteteve për të marrë masa specifike për të luftuar diskriminimin gjinor ndaj grave përbënte shkelje të nenit 14, të lexuar së bashku me nenin 3.

Gjykata përsëriti se, për të pasur çështje sipas nenit 14, duhet të kishte dallim në trajtimin e personave në situata të ngjashme, pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Ajo njohu rëndësinë e punës së Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), dhe të Konventës së CEDAW, që ka konstatuar se dhuna kundër grave është formë e diskriminimit ndaj grave. Sa i përket barrës së provës në kontekstin e dhunës kundër grave, pasi që vërtetohet ekzistenca e dhunës diskriminuese, i takon Shtetit përgjegjësia për të treguar se cilat procese janë në dispozicion për të zgjidhur dizavantazhet e lidhura me gjininë dhe për të siguruar që gratë mund të ushtrojnë dhe të gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut në mënyrë të barabartë me burrat. Kërkuesja kishte mundësinë të mbështetej tek të dhënat statistikore dhe raportet e organeve ndërkombëtare ose akademike për të konstatuar tregues *prima facie* të ekzistencës së efektit joproporcional të dhunës shtëpiake kundër grave. Prandaj, gjatë vendimit nëse kishte ndodhur shkelje, Gjykata zbatoi një test me dy faza: së pari, nëse ekzistonte njëanshmëria strukturore që ndikonte në mënyrë joproporcionale mbi gratë; së dyti, nëse autoritetet ruse kishin marrë hapa të mjaftueshëm për ta luftuar atë.

Në lidhje me pyetjen e parë, nëse gratë ndikohen në mënyrë joproporcionale nga dhuna shtëpiake në Rusi, Gjykata e rrëzoi argumentin e qeverisë që kërkuesja ishte fajtores për faktin se nuk kishte paraqitur të dhëna të sakta zyrtare për të mbështetur padinë e saj. Të dhëna të tilla që gratë diskriminohen në këtë kontekst

nuk ekzistonin, për shkak të faktit se 'dhuna shtëpiake' nuk ekzistonte si koncept vetqëndruar në të drejtën vendase ruse. Gjykata vuri në dukje punën e organeve të shumta ndërkombëtare, si Komiteti i CEDAW, Raportuesi Special i OKB-së për dhunën kundër grave, dhe Human Rights Watch, të cilat kanë nënvizuar mungesën e këtyre të dhënave për Rusinë. Gjykata pranoi parashtrimin nga kërkuesja të të dhënave zyrtare mbi 'krimet e kryera brenda familjes dhe shtëpisë' si të përafërta me çështjen specifike të pabarazisë në dhunën gjinore. Ajo theksoi raportimin shumë të mangët të dhunës shtëpiake në tërë botën dhe pranoi se situata ishin vërtet më keq në Rusi në krahasim me vendet e tjera. Marrë së bashku, informacionet e dhëna nga kërkuesja dhe ato të burimeve ndërkombëtare ishin të mjaftueshme për të konstatuar *prima facie* se gratë ishin të ndikuara në mënyrë joproporcionale nga dhuna shtëpiake në Rusi.

Pyetja e dytë ishte nëse autoritetet kishin ngritur politika me qëllim të barazisë mes gjinive. Një mangësi e theksuar në Rusi ishte mungesa e dispozitave specifike në lidhje me dhunën shtëpiake brenda kodit ligjor vendas. Kjo ishte nënvizuar nga organe të shumta ndërkombëtare, përfshirë Komiteti i CEDAW, Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Komiteti kundër Torturës, dhe ishte në kontrast të theksuar me përhapjen e madhe të dhunës shtëpiake në Rusi. Përveç një periudhe të shkurtër mes korrikut 2016 dhe janarit 2017, kur u krijua një vepër e veçantë për rrahje kundër 'personave të afërt', korniza ligjore dështoi të mbulonte dhunën shtëpiake. Kjo do të thoshte se viktimat detyroheshin të kalonin përmes procedurës së rëndë të ndjekjes private, të cilën kishin mundësi ta shfrytëzonin shumë më pak sesa procedurën publike për shkak të nevojës për të paraqitur një sanksion administrativ të mëparshëm brenda një periudhe 12-mujore. Autoritetet vendase kishin toleruar, për shumë vite, një klimë që shkaktonte dhunë shtëpiake. Kështu, kishte pasur shkelje të nenit 3 të marrë në lidhje me nenin 14 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 20,000 euro në lidhje me dëme jomateriale, krahas shumës 5,875.69 euro për kosto dhe shpenzime.

*Hetimet e autoriteteve rreth ankesës së kërkueses për faktin se ajo ishte detyruar me forcë që të merrej me prostitucion nuk ishin të mjaftueshme dhe si të tilla shkelën detyrimin procedural sipas nenit 4*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN S.M. k. KROACISË

(Kërkesa Nr. 60561/14)  
**25 qershor 2020**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1990 dhe jetonte në Z. Prej vitit 2000 deri në vitin 2004 ajo jetoi në një familje kujdestare, dhe më pas jetoi në shtëpinë e fëmijëve dhe adoleshentëve ku qëndroi deri sa përfundoi trajnimin profesional si kameriere.

Më 27 shtator 2012, kërkuesja bëri një ankesë në polici kundër T.M., ish-polici, duke pretenduar se nga vera e vitit 2011 e deri në shtator të të njëjtit vit ai e kishte detyruar me forcë që të merrej me prostitucion, duke i bërë asaj presion fizik dhe psikologjik. Kërkuesja tregoi se ajo ishte njohur me T.M. në Facebook, dhe se ai kishte ofruar t'i gjente punë si kameriere. Në vend të kësaj, ai kishte filluar t'i kërkonte që asaj që të kryente shërbime seksuale për burra të tjerë, dhe e rrihte kur ajo kundërshtonte. Ai i dha asaj një celular që ta kontaktonin klientët. Kërkuesja tha se ajo kishte pasur shumë frikë nga T.M. për t'i rezistuar. Më pas T.M. mori një apartament me qira, ku ai dhe kërkuesja jetonin bashkë, dhe ajo ofronte shërbime seksuale për burra të tjerë. Sa herë që ajo refuzonte, ai e rrihte, gjë që ndodhte çdo dy-tre ditë. Meqë T.M. jetonte në të njëjtin apartament, ai kontrollonte gjithçka që bënte ajo.

Kërkuesja tha se një herë kur ajo mbeti në shtëpi me çelësin me vete, ajo thirri një shoqe, M.I., dhe i kërkoi që ta ndihmonte të arratisesh. Pas kësaj, i dashuri i M.I., T.R, erdhi dhe e mori tek shtëpia e M.I., ku kërkuesja qëndroi rreth dhjetë ditë. M.I. i tregoi policisë që vetëm pasi kërkuesja erdhi të rrinte me M.I. dhe nënën e saj, M.I. e mori vesh se ku dhe prej kujt ishte përfshirë në prostitucion kërkuesja. Kërkuesja i tregoi M.I. se ajo e kishte shfrytëzuar mundësinë për të ikur nga T.M. kur ai kishte qenë jashtë banesës ku jetonin. I dashuri i M.I., T.R., i kishte treguar asaj se ai kishte folur me kërkuesen rreth situatës, por nuk dha hollësi.

Më 6 nëntor 2012, Prokuroria Shtetërore e Krahinës ngriti aktakuzë kundër T.M. për detyrimin me forcë të një personi për prostitucion, si vepër e rënduar

e organizimit të prostitucionit. Më 21 dhjetor 2012, kërkueses iu dha zyrtarisht statusi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore nga Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave pranë Qeverisë së Kroacisë. Policia kroate kontaktoi Kryqin e Kuq Kroat, i cili organizoi këshillim individual për kërkuesen. Kërkueses gjithashtu iu dha ndihmë ligjore nga një organizatë jo-qeveritare në kuadër të skemës së ndihmës ligjore të mbështetur nga Shteti.

Gjatë dëshmisë së kërkueses në gjyq, ajo shtjelloi më tej deklaratën e parë të saj dhënë policisë. Megjithatë, T.M. e mohoi versionin e ngjarjeve sipas kërkueses, dhe tha që ajo i kishte hyrë prostitucionit për të larë borxhet e saj dhe për të fituar para. T.M. kishte jetuar me të në apartamentin ku ajo nganjëherë takonte klientët, por kurrë nuk e kishte detyruar kërkuesen të bënte ndonjë gjë. Më 15 shkurt 2013, gjykata vendase e liroi T.M. mbi bazën se, sado që ishte konstatuar se ai e kishte organizuar rrethin e prostitucionit, nuk ishte konstatuar se kërkuesja ishte detyruar me forcë të merrej me prostitucion. Meqenëse ai ishte akuzuar për veprën e rënduar, ai nuk mund të dënohej për akuzën e organizimit të prostitucionit.

Dëshmisë së kërkueses iu dha më pak peshë gjatë vendimmarrjes së gjykatës sepse gjykata vendase e kishte gjetur deklaratën e saj jo koherente, të pasigurt, dhe se ajo kishte bërë pauza dhe kishte hezitur gjatë kohës që fliste. Gjykata Krahinore e rrëzoi apelin e Prokurorisë. Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankesën e kërkueses të papranueshme më 10 qershor 2014.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në nenet 3, 4 dhe 8 të Konventës, kërkuesja u ankua për pamjaftueshmërinë e kornizës ligjore vendase dhe reagimin procedural të autoriteteve vendase në lidhje me akuzat e saj kundër T.M.. Në mënyrë të veçantë, ajo pretendoi se autoritetet vendase kishin dështuar në ndriçimin e të gjitha rrethanave të çështjes, nuk kishin siguruar pjesëmarrjen e duhur të saj gjatë procedurave, dhe nuk e kishin bërë siç duhej kualifikimin e veprës. Në vendimin e saj të 19 qershorit 2018, Dhoma deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 4. Me kërkesë të Qeverisë sipas nenit 43, çështja iu referua Dhomës së Madhe. Duke qenë mjeshtre e karakterizimit të ligjit në lidhje me faktet, Gjykata e mori çështjen nën shqyrtim vetëm në lidhje me nenin 4.

### Neni 4

Çështja në fjalë i lejoi Gjykatës që të qartësonte praktikën e saj gjyqësore dhe të shqyrtonte nëse trafikimi si dhe shfrytëzimi i prostitucionit hynin brenda

fushëveprimet të nenit 4. Duke pasur parasysh detyrimin e saj për ta interpretuar Konventën nën dritën e kushteve të sotme dhe duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata përsëriti se nuk ishte e nevojshme të specifikohet nëse trafikimi me qenie njerëzore përbën skllavëri, shërbëtori, apo punë të detyruar sipas nenit 4 meqenëse nuk ka dyshim se trafikimi me qenie njerëzore kërcënon dinjitetin njerëzor dhe është në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e nenit 4. Prandaj, trafikimi me qenie njerëzore, ashtu siç përkufizohet nga Konventa Kundër Trafikimit dhe Protokollit të Palermos, pavarësisht a është kombëtar apo ndërkombëtar dhe i lidhur apo jo me krimin e organizuar, hyn brenda fushëveprimet të nenit 4. Kjo, megjithatë, nuk përjashton mundësinë që disa raste të lidhura me trafikimin njerëzor mund të ngrenë çështje sipas dispozitave të tjera. Trafikimi me qenie njerëzore përkufizohet nga këto instrumente ndërkombëtare si kombinim i tre elementeve: (1) veprimi (siç është rekrutimi, transportimi, transferimi, mbajtja ose pranimi i personave; (2) mënyra (përfshirë trajtimi ose përdorimi i forcës, shtrëngimi, rrëmbimi, mashtrimi, të gënjerit, abuzimi i pushtetit ose pozitave të cenushme, huadhënia ose pëfitimet); dhe (3) qëllimi (siç është shfrytëzimi i prostitucionit).

Ndërkohë që Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të përcaktohet nëse prostitucioni, në vetvete, ishte në kundërshtim me nenin 3, ajo theksoi se kur prostitucioni ishte i detyruar lindte çështje nga neni 3. Ngjashëm, pa detyrim, kërkuesja nuk iu nënshtrua "punës së detyruar ose të detyrueshme" brenda kuptimit të nenit 4. Ky term synon të ofrojë mbrojtje kundër rasteve të shfrytëzimit të rëndë, përfshirë prostitucionin e detyruar, pavarësisht nëse ka lidhje apo jo me kontekstin e trafikimit njerëzor.

Gjykata arriti në përfundimin se ajo nuk mund t'i jepte rëndësi vendimtare faktit që kërkueses i ishte dhënë njohja administrative e statusit të saj si viktimë e trafikimit njerëzor nga Zyra e të Drejtave të Njeriut, meqenëse kjo nuk mund të merrej si e tillë që nënkuptonte se elementet e veprës ishin konstatuar. Në mënyrë të veçantë dhe në lidhje me këtë pikë, ajo theksoi mbrojtjen e të drejtës së të akuzuarit për prezumimin e pafajësisë dhe garancitë e tjera të procesit të drejtë sipas nenit 6.

Çështja në fjalë kishte të bënte me detyrimin pozitiv të Shtetit, sipas nenit 4, për të hetuar situatat e trafikimit potencial. Pyetja nëse ngihej ky detyrim procedural duhet të vlerësohet në kohën kur u bënë akuzat përkatëse dhe jo duke u bazuar tek përfundimet e nxjerra pas përfundimit të hetimeve. Në rastin konkret, kërkuesja qartazi kishte paraqitur një pretendim të argumentueshëm me prova *prima facie* që ajo ishte viktimë e trafikimit njerëzor dhe e shfrytëzimit të prostitucionit në kundërshtim me nenin 4. Kjo ishte e dukshme në mënyrën se si T.M. e kontaktoi së

pari kërkuesen, që i përkiste një grupi të cënueshëm, me premtimin për punësim. Më tej, T.M. e pranoi edhe përdorimin e forcës kundër kërkueses, dhe huadhënien e parave, çka sugjeronte mundësinë e detyrimit të borxhit; ku të gjitha këto janë 'mënyra' të njohura të trafikimit. Prandaj, rrethanat e çështjes nxitën detyrimin procedural të autoriteteve për të zhvilluar hetimet sipas nenit 4.

Ndërkohë që autoritetet reagues me shpejtësi në lidhje me akuzat e kërkueses, hetimet që zhvilluan ato dështuan të konstatojnë natyrën e vërtetë të marrëdhënies së kërkueses me T.M.; është e qartë se kjo është linja hetimore që duhet të ishte ndjekur. Mungesa e veprimit nga ana e viktimës nuk justifikon mosveprimin e autoriteteve, meqenëse këto të fundit janë në pozicion më të mirë për të zhvilluar hetime. Nuk kishte prova që autoritetet kishin kontrolluar llogaritë në Facebook të T.M., ose që kishin marrë në pyetje nënën e kërkueses e cila duket se kishte pasur kontakte të mëparshme me T.M., ose që kishin marrë zyrtarisht në pyetje pronarin e apartamentit ku kërkuesja jetonte me T.M. ose fqinjët për të konstatuar 'veprimin' e trafikimit. Më tej, edhe pse autoritetet e morën në pyetje shoqen e kërkueses, M.I., ato nuk morën në pyetje nënën e M.I. dhe të dashurin e M.I. i cili supozohej se kishte njohuri për arratisjen e kërkueses nga T.M.. Prandaj, Gjykata konsideroi se autoritetet kishin dështuar të zhvillonin hetime efektive mbi rrethanat përkatëse të çështjes, ku si pasojë ndjekja penale ishte mbështetur tek deklaratat e kërkueses të vetme kundër mohimeve nga T.M. në procedurën gjyqësore të mëpasme. Në lidhje me këtë, Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (ang. GRETA) dhe organe të tjera ndërkombëtare kishin paralajmëruar kundër mbështetjes së tepruar vetëm tek deklaratat e viktimave, duke pasur parasysh impaktin potencial të traumave psikologjike.

Si përfundim, kishte defekte të konsiderueshme në reagimin procedural të autoriteteve pas pretendimit të argumentueshëm të kërkueses, ku dështuan të konstatojnë natyrën e vërtetë të marrëdhënies së saj me T.M.. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të aspektit procedural të nenit 4.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 5,000 euro në lidhje me dëme jomateriale, dhe e rrëzoi pretendimin e saj për kosto dhe shpenzime meqenëse asaj i ishte dhënë ndihmë ligjore për procedurat para Dhomës së Madhe.

*Duke pasur parasysh statistikat që tregojnë se klima e përgjithshme në Shqipëri ishte e tillë që çonte drejt dhunës ndaj grave, dështimi i autoriteteve për të reaguar me zellin e duhur për të zhvilluar hetime të menjëhershme dhe të plota rreth një sulmi me acid kundër një gruaje shkeli aspektin procedural të nenit 2*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN TËRSHANA K. SHQIPËRISË

(Kërkesa Nr. 48756/14)

**4 gusht 2020**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1984 dhe jetonte në Tiranë, Shqipëri. Rreth orës 4 pasdite më 29 korrik 2009, ajo pësoi lëndime të rënda në një sulm me acid prej një sulmuesi të paignifikuar teksa po ecte rrugës në Tiranë. Kërkuesja u dërgua menjëherë në spital, dhe më pas u transferua në një spital në Itali për trajtim mjekësor nga specialistët si pasojë e djegieve me thellësi mesatare të shkaktuara nga acidi sulfurik. Mes viteve 2009 dhe 2012 ajo pati së paku katërmbëdhjetë operacione.

Edhe pse kërkuesja nuk e kishte dalluar sulmuesin e saj, ajo dyshonte se sulmi ishte organizuar si akt hakmarrjeje nga ish-partneri i saj ("E.A."), i cili kishte qenë i dhunshëm me të në të kaluarën, dhe madje e kishte kërcënuar se do ta vriste. Anëtarët e familjes së kërkueses e vërtetuan deklaratën e saj për dhunën nga E.A. Megjithatë, kur u mor në pyetje, E.A. deklaroi se ai kishte qenë në Durrës (gjysmë ore larg Tiranës) deri në orën 6 pasdite atë ditë, alibi e cila u mbështet nga familja e E.A.

Më 29 korrik 2009, zyrtari i policisë gjyqësore vendosi që duhet të hartoheshin disa raporte, konkretisht një raport mjeko-ligjor, një raport ekspert për gjurmët e gishtave mbi enën prej qelqi që ishte përdorur për të hedhur acidin, dhe dy raporte eksperte të kimisë dhe toksikologjisë rreth enës dhe rrobave të kërkueses dhe viktimës tjetër (një koleg/e që ishte duke ecur bashkë me kërkuesen). Më 30 korrik 2009 zyrtari i policisë gjyqësore ia referoi veprën e dyshuar prokurorisë së rrethit, e cila më pas urdhëroi analizimin e raportit të shenjave të gishtave, raportit mjeko-ligjor dhe raporteve të tjera të ekspertëve; marrjen në pyetje të çdo personi që kishte njohuri për ngjarjen; ekzaminimin e përgjimeve telefonike; marrjen e të dhënave telefonike; gjetjen dhe verifikimin e numrave të telefonit të përdorur nga E.A. dhe konfiskimin e video-incizimeve me CCTV.

Megjithatë, hapat e marrë dështuan të identifikonin sulmuesin. Raporti ekspert i shenjave të gishtave nuk identifikoi asnjë gjurmë mbi enën e qelqit. Nuk qe e mundur të identifikoheshin sulmuesi nga video-incizimet me CCTV e as të gjendeshin incizime të tjera për shkaqe teknike. Përveç kësaj, nuk qe e mundur të hartoheshin raportet e kërkuara të kimisë dhe toksikologjisë sepse institucionet përkatëse nuk kishin pajisjet e specializuara të nevojshme dhe deklaruan që raporti nuk hynte në sferën e kompetencave të tyre.

Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit i ndërpreu hetimet me anë të një vendimi ndaj të cilit nuk mund të bëhej apel. Gjatë viteve në vijim kërkuesja nuk mori asnjë komunikatë zyrtare në lidhje me hetimet, dhe kështu më 10 mars 2012 ajo autorizoi Qendrën Shqiptare për Rehabilitim nga Trauma dhe Tortura (Qendra) që ta ndiqte çështjen e saj. Më 23 maj 2012 policia informoi Qendrën se hetimet ishin duke vazhduar. Megjithatë, më 8 janar 2014 prokuroria informoi Qendrën se hetimet ishin ndërprerë.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja pretendoi se kishte pasur shkelje të aspekteve substanciale dhe procedurale të së drejtës për jetën sipas nenit 2 të Konventës. Ajo parashtroi se korniza ligjore ekzistuese nuk i mbronte mjaftueshëm gratë nga dhuna, dhe se duke pasur parasysh të dhënat rreth shpeshësisë së dhunës kundër grave, autoritetet duhet ta kishin ditur rrezikun dhe duhet të kishin marrë masa parandaluese për ta mbrojtur kërkuesen. Më tej, ajo deklaroi se hetimet nuk kishin qenë efektive, të plota dhe të shpejta, dhe se autoritetet kishin dështuar ta informonin atë rreth ecurisë së hetimeve kundër E.A.

### Neni 2

Gjykata së pari kujtoi se mbrojtja e nenit 2 mund të shfrytëzohet jo vetëm në rast të vdekjes së viktimës së akteve të dhunshme, por edhe në situata ku personi në fjalë ka qenë viktimë e një aktiviteti ose sjelljeje e cila si e tillë e ka vënë jetën e personit në rrezik real ose të afërt, dhe personi ka pësuar lëndime kërcënuese për jetën. Në rastin konkret, kërkuesja pësoi një sulm të dhunshëm i cili rezultoi me lëndime të rënda, dhimbje dhe shfytyrimin e njëzet e pesë për qind të trupit të saj. Ajo u dërgua në spital në gjendje kritike, dhe jeta e saj do të ishte vënë në rrezik sikur të mos i ishte dhënë ndihma mjekësore që iu dha. Prandaj neni 2 nuk ishte i zbatueshëm.



Në lidhje me aspektin substancial të nenit 2, u kujtua se sipas nenit 2 Shteti duhet që jo vetëm të përmbahet nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por edhe të mbrojë jetën e atyre brenda juridiksionit të tij. Kjo ka të bëjë me detyrën për të siguruar të drejtën e jetës me anë të dispozitave penale efektive të mbështetura në makinerinë e zbatimit të ligjit. Aty ku duhet, autoritetet madje mund të jenë të detyruara të marrin masa parandaluese për të mbrojtur një individ jeta e të cilit është në rrezik për shkak të akteve kriminale të një tjetri. Megjithatë, kjo detyrë duhet të interpretohet në një mënyrë e cila nuk imponon një barrë joproporcionale mbi autoritetet. Në mënyrë që të lindë detyrimi pozitiv duhet të tregohet se autoritetet e kanë ditur (ose është dashur që ta kenë ditur) rrezikun real dhe të afërt ndaj jetës së individit të identifikuar që paraqitet nga aktet kriminale të një pale të tretë. Kur konstatohet kjo, gjykatat vlerësojnë nëse autoritetet kanë marrë masa të mjaftueshme të cilat mund të ishte pritur që ta shmangnin atë rrezik.

Në lidhje me pjesën e parë, u konsiderua se korniza legjislative e të drejtës penale në Shqipëri ishte efektive dhe se ishin ndërmarrë veprime për të hapur hetimet. Më tej, në lidhje me faktet e kësaj çështjeje, detyrimi pozitiv i Shtetit për të marrë masa parandaluese për të mbrojtur jetën e kërkueses nuk ishte aktivizuar. Ndërkohë që kërkuesja dyshonte se E.A. qëndronte pas sulmit, në asnjë moment para sulmit ajo nuk e kishte sjellë në vëmendje të autoriteteve që ai përbënte kërcënim për jetën e saj. Prandaj, nuk kishte shkelje të pjesës substancialë të nenit 2.

Në lidhje me aspektin procedural të nenit 2, Gjykata kujtoi se detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetët kërkon që, kur ka arsye për të besuar se një individ ka pësuar lëndime kërcënuese për jetën në rrethana të dyshimta, duhet të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv që është në gjendje të përcaktojë shkakun e lëndimeve dhe të identifikojë përgjegjësit me qëllim të ndëshkimit të tyre. Ndërkohë që pengesat mund të vonojnë përparimin, reagimi i autoriteteve duhet të jetë i menjëhershëm dhe i shpejtë, meqenëse kjo është thelbësore për ruajtjen e besimit publik tek shteti i së drejtës dhe parandalimin e çdo dukjeje të tolerimit të akteve të paligjshme. Përveç kësaj, deri aty sa është e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime, hetimet duhet të jenë të njohura për familjen e viktimës.

Sipas disa raporteve kombëtare, dhuna kundër grave ishte problem gjerësisht i përhapur në Shqipëri në atë kohë. Më tej, raportet ndërkombëtare në lidhje me Shqipërinë në mënyrë të përsëritur theksonin përhapjen e madhe të dhunës kundër grave së paku që nga viti 2003. Përveç kësaj, raportet ndërkombëtare gjithashtu tregonin se ekzistonte një klimë e përgjithshme e mos-ndëshkimit të kryesve të dhunës kundër grave, dhe theksonte se mes viteve 2006 dhe 2012 dhuna kundër

grave ishte raportuar më pak sesa duhej, ishte hetuar më pak se duhej, ishte ndjekur penalisht më pak se duhej, dhe ishte ndëshkuar më pak se duhej. Kështu, u arrit në përfundimin që, në kohën e sulmit, në Shqipëri ekzistonte një klimë e përgjithshme që çonte drejt dhunës ndaj grave. Kur ndodh një sulm në një klimë të tillë, hetimet nga ana e autoriteteve marrin rëndësi më të madhe dhe kërkojnë zell më të madh.

Në rastin konkret, megjithëse u ndërmorën një sërë veprimesh hetimore, autoritetet dështuan në përcaktimin natyrën e substancës së gjetur në enë dhe mbi rrobat e kërkueses. Konteksti i sulmit, i cili përmbante shenjat e dhunës së bazuar në gjini, duhet t'i kishte nxitur autoritetet që të vepronin me zell dhe vull të veçantë. Megjithatë, autoritetet dështuan të ndërmerrnin hapat e nevojshme me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur. Gjithashtu, u theksua se vendimi i 2 shkurtit 2010 për të ndërprerë hetimet nuk ofroi përgjigje definitive rreth natyrës së substancës së gjetur në enë dhe në rroba. Pavarësisht nga kërkesat e përsëritura, kërkueses nuk iu dhanë informacione rreth hetimeve ose rreth dokumenteve, e prandaj ajo nuk mundi të kontestonte veprimin e ndërmarrë, të kërkonte që autoritetet të merrnin masa të tjera ose të bënte kërkesë për dëmshpërblim në mungesë të një kryesi të pidentifikuar. Në përfundim, autoritetet dështuan të ofronin një përgjigje të përshtatshme dhe të kohshme në përputhje me detyrimet e tyre sipas nenit 2, duke shkelur kështu aspektin e tij procedural.

### Pretendime të tjera

Kërkuesja gjithashtu pretendoi shkelje të nenit 8 mbi bazën se autoritetet vendase kishin dështuar t'i ofronin asaj psikoterapi ose trajtim rehabilitues dhe shkelje të nenit 13 mbi bazën se kërkuesja nuk kishte mundur t'i kontestonte veprimet e prokurorisë e as të kërkonte kompensim. Të dy pretendimet, krahas pretendimit për diskriminim sipas nenit 14, u refuzuan si të papranueshme.

### Neni 41

Gjykata urdhëroi Shtetin të paguante dëmshpërblim në shumën 12,000 euro si dhe kostot dhe shpenzimet e kërkueses prej 2,720 euro, plus interes.

*Ligjet vendase që kufizonin qasjen e një vejani mashkull në benefitet publike që kanë në dispozicion vejushat femra u vendos se ishin diskriminuese në lidhje me seksin sipas nenit 14 i lexuar në lidhje me nenin 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN B. k. ZVICRËS

(Kërkesa Nr. 78630/12)  
**20 tetor 2020**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1953 dhe jetonte në Kantonin Appenzell Ausserrhoden në Zvicër. Pas humbjes së bashkëshortes në një aksident, ai e la punën për t'u kujdesur me kohë të plotë për dy fëmijët e tij, të cilët në atë kohë ishin një vjeç e nëntë muajsh dhe katër vjeç.

Më 9 shtator 2010, pasi vajza e vogël e kërkuesit ishte gati të mbushte moshën madhore, Zyra e Kompensimit Kantonal e përfundoi pagesën e pensionit të vejanit për kërkuesin, në përputhje me dispozitat e Ligjit Federal për Sigurimet e Personave në Moshë të Vjetër dhe të Mbijetuarve (*la loi fédérale sur l'assurance-vieillesse et survivants* – "LAVS"). Në atë kohë, kërkuesi ishte 57 vjeç, dhe kishte më shumë se 16 vjet që nuk kishte qenë i punësuar me rrogë.

Kërkuesi e apeloj vendimin, duke u mbështetur tek parimi i barazisë gjinore në Kushtetutën e Zvicrës, argument të cilin Zyra e Kompensimeve e refuzoi. Më pas, ai apeloj pranë Gjykatës Kantonale, duke argumentuar se nuk kishte arsye që ai të vihej në pozicion disavantazhi në krahasim me një vejushë. Gjykata Kantonale e rrëzoi apelin e tij, duke theksuar se ligjvënësit kishin qenë në dijeni të trajtimit të pabarabartë të vejushave dhe vejanëve gjatë hartimit dhe amendamenteve të LAVS, me qëndrimin që vejanët me përgjegjësinë e kujdesit për fëmijët mund të pritej që të ktheheshin në punë me përfundimin e atyre përgjegjësi, ndërkohë që një gjë e tillë nuk mund të pritej me arsye nga gratë në rrethana të njëjta.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se ndaj tij kishte pasur diskriminim në krahasim me nënat vejusha të cilat ishin përgjegjëset e vetme të rritjes së fëmijëve të tyre, në shkëlqje të nenit 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit) i marrë së bashku me nenin 8 (e drejta për respekt të jetës private dhe familjare).

## Pranueshmëria

Gjykata kujtoi se neni 14 nuk "ekziston në mënyrë të pavarur": ai është një dispozitë plotësuese e Konventës, ku ofrohet mbrojtje kundër diskriminimit gjatë gëzimit të të drejtave dhe lirive të garantuara me klauzolat e tjera normative të Konventës dhe Protokolleve të saj. Rrjedhimisht, faktet e çështjes duhet të hyjnë brenda fushëveprimit të së paku njëres prej dispozitave substanciale të Konventës ose Protokolleve të saj në mënyrë që një ankesë sipas nenit 14 të jetë e pranueshme.

Gjykata gjeti se ankesa e kërkuarit hynte brenda fushëveprimit të nenit 8 sepse qëllimi i pensionit për një vejtash ose vejan ishte që të lehtësonte bashkëshortin/en e mbijetuar nga nevoja për të gjetur punë me rrogë, në mënyrë që ai/ajo të mund të kujdesej për fëmijët e vet. Prandaj ky benefit ishte qartazi i natyrës "familjare", meqenëse kishte impakt real mbi organizimin e jetës familjare të kërkuarit. Për më tepër, meqenëse kërkuari kishte qenë 57 vjeç kur kishte pushuar së marri pensionin dhe 59 vjeç kur Gjykata Supreme Federale kishte marrë vendimin e saj, ai do ta kishte pasur të vështirë kthimin në tregun e punës, faktor ky që kishte pasur ndikim praktik tek mënyra se si ai e kishte organizuar jetën e tij familjare.

Rrjedhimisht, Gjykata e refuzoi parashtrimin e Qeverisë që ankesa ishte e papranueshme sipas nenit 35 §3 (a), qoftë për shkak të papajtueshmërisë *ratione materiae* me Konventën, qoftë për shkak se ishte dukshëm e pabazuar, dhe gjeti se ishte i zbatueshëm neni 14 i marrë së bashku me nenin 8.

## Neni 14

Gjykata theksoi se dallimi në trajtim është diskriminues brenda kuptimit të nenit 14 në qoftë se atij i mungon justifikimi objektiv dhe i arsyeshëm. Duke cituar çështje të mëparshme, u përsërit se progresi drejt barazisë gjinore kishte qenë, për një kohë të gjatë, synim i rëndësishëm i Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, dhe se vetëm "arsye me peshë shumë të madhe" do të mund të çonin drejt gjetjes që një dallim i tillë në trajtim ishte në pajtueshmëri me Konventën.

Gjykata qe dakord se kërkuari me të drejtë mund të pretendonte se ishte viktimë e diskriminimit mbi baza të seksit (që është një prej bazave të ndaluara të diskriminimit në neni 14), meqenëse pensioni i tij i vejanit kishte përfunduar kur vajza e tij e vogël kishte mbushur moshën madhore vetëm mbi bazën e faktit që ai ishte burrë, ndërkohë që një vejtash në të njëjtën situatë nuk do ta kishte humbur të drejtën e saj për të marrë pension.

Gjykata ishte e përgatitur të pranonte parashtrimin e Qeverisë që trajtimi i kërkuesit ishte objektivisht i justifikuar mbi bazën e arsytimit se LAVS përmbante një prezumim që një bashkëshort në përgjithësi ishte përgjegjës për mbajtjen e bashkëshortes së tij, e rrjedhimisht që vejshave duhet t'u ofrohej mbrojtje më e madhe sesa vejanëve.

Megjithatë, Gjykata nuk ishte dakord se kishte "arsye me peshë shumë të madhe" që mund të justifikonin dallimin në trajtimin e ankimuar si i arsyeshëm. Trajtimi i pabarabartë i parashikuar në LAVS mund të jetë justifikuar nga roli dhe statusi i dhënë për gratë në shoqërinë zvicerane në kohën e miratimit të ligjit në vitin 1948; megjithatë, Konventa është "instrument i gjallë" që duhet të interpretohet nën dritën e kushteve të jetës aktuale dhe perceptimeve publike mbizotëruese në shtetet demokratike sot. Më tej, referencat ndaj traditave, supozimeve të përgjithësuar, ose qëndrimeve sociale mbizotëruese të një vendi të caktuar janë të pamjaftueshme në ditët tona për të justifikuar dallimet në trajtim mbi bazën e seksit. Nga kjo rridhte që Qeveria nuk mund të mbështetej tek prezumimi që një bashkëshort ofron bazën financiare për bashkëshorten e tij (koncepti i "fituesit të bukës") për të justifikuar dallimet në trajtim të cilat e vënë një vejan në disavantazh në krahasim me një vejshë.

Gjykata po ashtu theksoi se Gjykata Federale zvicerane tashmë e kishte pranuar që dispozitat e LAVS ishin qartazi në kundërshtim me parimin e barazisë të cekur në Kushtetutën e Zvicrës, dhe se legjislacioni zviceran, edhe pse i vetëdijshëm për këtë mos-konformim, nuk e kishte përmirësuar atë pavarësisht nga përpjekjet në këtë drejtim.

Duke iu referuar në mënyrë më të hollësishme fakteve, Gjykata nuk pa se si kërkuesi do ta kishte pasur më të lehtë kthimin në tregun e punës në moshën 57-vjeçare, pas 16 vitesh jashtë tregut të punës, sesa një grua në të njëjtën situatë, ose përse përfundimi i pensionit do ta kishte prekur atë më pak sesa një vejshë në rrethana të ngjashme.

Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se, meqenëse nuk ishin dhënë "arsye me peshë shumë të madhe", Qeveria kishte dështuar të ofronte justifikim të arsyeshëm për dallimin në trajtim mbi bazën e seksit për të cilin ishte ankuar kërkuesi. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 14 i marrë së bashku me nenin 8. Megjithatë, Gjykata theksoi se ky përfundim nuk duhet të merrej si inkurajim për të hequr ose reduktuar pensionin korrespondues që u paguhet vejshave me qëllim që të zgjidhej pabarazia në trajtim që kishte gjetur ajo.

### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 5,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 6,380 euro për kosto dhe shpenzime.

*Reagimi i autoriteteve kroate ndaj një sulmi të dhunshëm homofobik ishte jo-efektiv dhe në shkelje të nenit 3 në lidhje me nenin 14 të Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN SABALIĆ K. KROACISË

(Kërkesa Nr. 50231/13)

**14 janar 2021**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1982 dhe jetonte në Zagreb. Më 13 janar 2010, ajo u sulmua fizikisht në një klub nate në Zagreb nga M.M. Raporti i policisë menjëherë pas sulmit thoshte: kërkueses "i ishte afruar një burrë i paidentifikuar i cili filloi të flirtonte me të por ajo e refuzoi në vazhdimësi. Pasi u mbyll klubi i natës, të gjithë njerëzit ishin duke qëndruar para klubit, dhe burri vazhdoi t'i bënte presion [kërkueses] që të shkonte me të. Kur ajo i tha atij që ishte 'lezbike', ai e rrëmbeu atë me të dy krahët e tij dhe e shtyri drejt murit. Më pas ai filloi ta godiste atë në tërë trupin dhe, kur ajo u rrëzua në tokë, ai vazhdoi ta shkelmonte. ..." M.M. gjithashtu bërtiti "Të gjithë/a ju duheni vranë!" dhe "Të q... lezbiken!" Kërkuesja pësoi lëndime të shumta në tërë trupin, dhe për këtë arsye u desh të mernte trajtim në spital.

Më 14 janar 2010, policia filloi procedurën për kundërvajtje në Gjykatën e Kundërvajtjes kundër M.M. për shkelje të paqes dhe rendit publik. M.M. u rrëfye duke i pranuar akuzat kundër tij. Nuk u morën prova të tjera, dhe kërkuesja nuk u informua në lidhje me procedurën. M.M. u gjet fajtor dhe u gjosit me 300 kuna kroate (afro 40 euro).

Më 29 dhjetor 2010, kërkuesja bëri një ankesë penale në Prokurorinë Bashkiake Shtetërore të Zagrebit ("Prokuroria e Shtetit") kundër M.M., pasi e kuptoi se policia nuk kishte hapur hetimet penale. Prokuroria e Shtetit e refuzoi ankesën: M.M. tashmë ishte ndjekur për kundërvajtje, prandaj ndjekja penale do të ishte në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*.

Më 26 tetor 2011, kërkuesja mori përsipër ndjekjen penale si prokurore ndihmëse në Gjykatën Bashkiake Penale të Zagrebit ("Gjykata Penale") kundër M.M. për akuzat e lëndimit të rëndë trupor në tentativë dhe sjelljes së dhunshme, të motivuara nga elementet e krimit të urrejtjes, dhe për veprën penale të diskriminimit. Ajo argumentoi se Prokuroria e Shtetit e kishte keqinterpretuar ligjin në lidhje me parimin *ne bis in idem*, dhe se çështja nuk ishte gjykuar

përfundimisht. Më tej, ajo argumentoi se procedura e kundërvajtjes nuk e kishte përmbushur detyrën e autoriteteve për të hetuar dhe ndjekur krimin e urrejtjes. Gjykata Penale e refuzoi aktakuzën e kërkueses. Vendimi u mbështet në apel nga Gjykata Krahinore më 9 tetor 2012.

Më 5 dhjetor 2012, kërkuesja bëri ankesë në Gjykatën Kushtetuese, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me detyrimin procedural të Shtetit për të hetuar në mënyrë efektive aktet e dhunës dhe krimet e urrejtjes, dhe duke u ankuar për mungesën e efektivitetit të autoriteteve vendase për t'i adresuar ankesat e saj në mënyrë efektive. Ajo gjithashtu argumentoi se autoritetet më të ulëta e kishin keqinterpretuar të drejtën përkatëse në lidhje me parimin *ne bis in idem* dhe kështu kishin gabuar në vlerësimin e tyre se çështja kishte qenë *res judicata*. Më 31 janar 2013, Gjykata Kushtetuese e deklaroi të papranueshme ankesën kushtetuese të kërkueses.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankuar për mungesën e një reagimi të përshtatshëm nga autoritetet vendase ndaj akteve të dhunës kundër saj, të motivuara nga orientimi i saj seksual. Ajo u mbështet në nenet 3, 8 dhe 14 të Konventës.

### Neni 3 në lidhje me nenin 14

Në përgjithësi, keqtrajtimi duhet të arrijë një shkallë minimale rreptësie për të hyrë brenda fushëveprimit të nenit 3. Keqtrajtimi që e arrin këtë shkallë minimale rreptësie zakonisht përfshin lëndime trupore faktike ose vuajtje intensive fizike apo mendore. Megjithatë, edhe në mungesë të këtyre aspekteve, kur trajtimi poshtëron ose ul poshtë një individ, duke treguar mungesë respekti për të ose duke dobësuar dinjitetin njerëzor të individit, ose ngjall ndjenja frike, ankthi ose inferioriteti të atilla që mund të thyejnë rezistencën morale dhe fizike të një individi, ai mund të karakterizohet si poshtëruar dhe mund të hyjë brenda ndalimit të parashikuar me nenin 3. Një trajtim diskriminues i tillë në parim mund të përbëjë trajtim poshtëruar brenda kuptimit të nenit 3, kur ai e arrin një shkallë të atillë rreptësisë që përbën fyerje për dinjitetin njerëzor. Gjykata theksoi se kjo është posaçërisht e vërtetë në rastet e krimeve të urrejtjes.

Duke marrë parasysh raportin e policisë të 13 janarit 2010, kishte prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin që sulmi kundër kërkueses ishte ndikuar nga orientimi i saj seksual. Prandaj, trajtimi që iu bë kërkueses dhe i cili drejtohej drejt identitetit të saj dhe dëmtonte integritetin dhe dinjitetin e saj pa tjetër që



duhet të ketë ngjallur tek ajo ndjenja frike, ankthi dhe pasigurie duke e arritur kështu pragun e kërkuar të rreptësisë për të hyrë brenda nenit 3 të Konventës.

Policia kishte ardhur menjëherë në vendin e ngjarjes dhe kishte bërë gjetjet fillestare, të cilat ishin tregues *prima facie* të dhunës së motivuar nga, ose të paktën e ndikuar nga, orientimi seksual i kërkueses. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, kjo kërkonte zbatimin efektiv të mekanizmave vendase të së drejtës penale në mënyrë që të ndriçoheshin motivet e mundshme të urrejtjes me tone të forta homofobike dhe të identifikoheshin dhe, nëse duhej, të ndëshkoheshin si duhej përgjegjësit.

Policia kishte detyrën të bënte ankesë penale në Prokurorinë e Shtetit, e cila ishte kompetente për të zhvilluar hetime të mëtejshme zyrtare rreth treguesve të krimit të dhunshëm të urrejtjes qoftë edhe në rastet e lëndimeve të lehta trupore. Policia dështoi ta bënte një ankesë të tillë.

Më tej, dënimi i M.M. në procedurën e gjykatës së kundërvajtjes ishte dukshëm jo-proporcional me peshën e keqtrajtimit të pësuar nga kërkuesja. Procedura nuk kishte adresuar në asnjë mënyrë elementin e krimit të urrejtjes tek sulmi fizik, dhe M.M. as nuk ishte akuzuar ose dënuar për ndonjë akuzë në lidhje me dhunën e motivuar nga diskriminimi. Një reagim i tillë nuk tregonte përkushtimin e Shtetit ndaj Konventës për të garantuar që keqtrajtimi homofobik të mos injorohet nga autoritetet përkatëse dhe për të ofruar mbrojtje efektive kundër akteve të keqtrajtimit të motivuar nga orientimi seksual i kërkueses.

Prokuroria e Shtetit dhe gjykatat penale kishin gjetur se dënimi përfundimtar i M.M. në procedurën e kundërvajtjes kishte krijuar një pengesë formale për ndjekjen e tij penale për krimin e dhunshëm të urrejtjes mbi bazën e parimit *ne bis in idem*. Megjithatë, neni 4 § 2 i Protokollit Nr. 7 cakton një kufi mbi zbatimin e parimit, duke lejuar shprehimisht Shtetin që ta rihapë një çështje kur pikaset një defekt themelor në procedurë. Këtu, si dështimi për të hetuar motivet e urrejtjes pas sulmit të dhunshëm, ashtu edhe dështimi për të marrë në konsideratë këto motive gjatë përcaktimit të dënimit për krimet e dhunshme të urrejtjes, ishin përbërës të këtyre "defekteve themelore".

Autoritetet vendase e kishin shkaktuar vetë situatën në të cilën ato, duke hapur pa nevojë procedurën jo-efektive të kundërvajtjes, kishin prishur mundësinë për zbatimin e duhur të dispozitave përkatëse dhe kritereve të së drejtës penale vendase. Më pas, ato kishin dështuar ta zgjidhnin situatën e kontestuar, megjithëse nuk mund të thuhet se kishte pasur pengesa *de jure* për ta bërë një gjë të tillë.

Duke hapur procedurën jo-efektive të kundërvajtjes dhe, për pasojë, duke gabuar me ndërprerjen e procedurës penale mbi baza formale, autoritetet vendase dështuan të zhvillonin në mënyrë të përshtatshme dhe efektive detyrimin e tyre procedural sipas Konventës në lidhje me sulmin e dhunshëm kundër kërkueses, motivuar nga orientimi i saj seksual.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 10,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 5,200 euro për kosto dhe shpenzime.

*Diskriminimi i pajustificuar seksual duke i refuzuar një punonjëseje benefitet e punësimit që i takojnë një gruaje shtatzënë e cila ka kaluar nëpër procedurën in vitro pak para punësimit shkelën nenin 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN JURČIĆ K. KROACISË

(Kërkesa Nr. 54711/15)

**4 shkurt 2021**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1975 në Rijekë të Kroacisë. Më 17 nëntor 2009 ajo bëri procedurën e fertilizimit *in vitro* ("IVF"), pas së cilës mjeku i rekomandoi që të bënte pushim. Dhjetë ditë më pas, kërkuesja hyri në marrëdhënie pune me kompaninë N. ("kompania"). Kompania e kishte selinë afër Splitit, rreth 360 kilometra larg vendbanimit të kërkueses. Kërkuesja u regjistrua më 11 dhjetor 2009 si punonjëse e siguruar e Fondit Kroat për Sigurime Shëndetësore ("Fondi").

Më 14 dhjetor 2009 mjeku i kërkueses konstatoi se procedura IVF kishte qenë e suksesshme, dhe e informoi kërkuesen që asaj i duhej të bënte pushim, për shkak të komplikimeve të lidhura me shtatzaninë. Kështu, asaj iu parashkrua një periudhë pushimi mjekësor. Më 28 dhjetor 2009 kërkuesja bëri kërkesë për kompensim të rrogës gjatë pushimit të saj mjekësor për shkak të komplikimeve të lidhura me shtatzaninë.

Më 16 shkurt 2010, Fondi rishqyrtoi statusin e sigurimeve shëndetësore të kërkueses duke e refuzuar kërkesën e saj për sigurime dhe kompensim të rrogës gjatë pushimit të saj mjekësor. Fondi debatoi se kur kërkuesja kishte nisur punën ajo kishte qenë e paaftë nga aspekti mjekësor për ta bërë punën e saj, sepse ajo kishte bërë IVF dhjetë ditë më përpara. Prandaj, Fondi konsideroi se punësimi i kërkueses ishte fiktiv dhe synonte vetëm përfitimet financiare.

Kërkuesja e kontestoi këtë vendim para Zyrës Qendrore të Fondit, duke argumentuar se ajo nuk kishte pasur asnjë arsye që të humbiste mundësinë për të hyrë në punë, meqenëse ajo ishte ndier mirë pas procedurës IVF dhe nuk kishte pasur se si ta dinte nëse implantimi kishte qenë i suksesshëm apo jo. Ky pohim i saj u vërtetua nga një raport i specialistit të gjinekologjisë dhe obstetrikës i datës 3 mars 2010. Zyra Qendrore e rrëzoi apelin, dhe po kështu edhe Gjykata e Lartë Administrative, pranë së cilës kërkuesja apeloj më pas.

Paskësaj kërkuesja bëri ankesa pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Ombudspersonit për Barazinë Gjinore. Ombudspersoni i lëshoi një paralajmërim Fondit se vendimi i këtij të fundit kishte shkelur ndalimin e trajtimit më pak të favorshëm mbi baza të shtatzanisë, dhe se kjo përbënte diskriminim mbi bazat e seksit. Më 22 prill 2015, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën e kërkueses si të pabazuar.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua se ndaj saj ishte bërë diskriminim, si grua shtatzënë e cila kishte bërë procedurën IVF, kur asaj i ishte hequr statusi i punonjësës së siguruar, në kundërshtim me nenin 14 i lexuar së bashku me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

### Neni 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

Neni 14 ishte i zbatueshëm në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1. Neni 14 ofron mbrojtje kundër trajtimit të diferencuar, pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të individëve në situata të ngjashme. Për qëllimet e nenit 14, trajtimi i diferencuar është diskriminues në qoftë se ai nuk synon një qëllim legjitim, ose në qoftë se nuk ka një marrëdhënie proporcionaliteti mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Kërkueses iu refuzua statusi i punonjësës së siguruar dhe një benefit i lidhur me punësimin, mbi bazën se punësimi i saj ishte deklaruar si fiktiv për shkak të shtatzanisë së saj. Një vendim i tillë mund të merrej vetëm në lidhje me një grua. Prandaj, një vendim i tillë përbënte trajtim të diferencuar mbi bazën e seksit. Qeveria argumentoi se ky diferencim në trajtim ishte i justifikuar, në mënyrë që të mbroheshin burimet publike nga keqpërdorimi mashtrues, dhe për hir të stabilitetit të tërësishëm të sistemit shëndetësor. Megjithatë, shtatzania e një gruaje nuk mund të konsiderohej sjellje mashtruese, dhe detyrimet financiare që kishte Shteti gjatë shtatzanisë së një gruaje në vetvete nuk mund të përbënin arsye të mjaftueshme për të justifikuar trajtimin e diferencuar mbi bazën e seksit.

Autoritetet përkatëse e kishin pasur për detyrë të shqyrtonin statusin e sigurimeve shëndetësore të kërkueses sipas ligjeve të aplikueshme, me dyshimin që kërkuesja kishte lidhur marrëveshjen e punësimit vetëm me qëllim që të mund të merrte benefitet e lidhura me punësimin. Megjithatë, një shqyrtim i tillë në praktikë shpesh vinte në shënjestër gratë shtatzëna. Gratë të cilat kishin lidhur kontratë pune në një fazë të avancuar të shtatzanisë së tyre ose me familjarë të afërt automatikisht ishin futur në kategorinë e punonjësëve "të dyshimta". Një qasje e tillë në përgjithësi ishte problematike.

Për shkak se mjeku i saj kishte rekomanduar që ajo të merrte pushim dhjetë ditë pas procedurës IVF, autoritetet kishin arritur në përfundimin se kërkuesja kishte qenë e paaftë për punë në datën e lidhjes së kontratës së punës. Në mënyrë të veçantë, ato ishin mbështetur tek fakti se kërkueses i ishte dashur të punonte në selinë qendrore të punëdhënësit, e cila ndodhej larg vendbanimit të saj, dhe se udhëtimi në gjendjen e saj paraqet rreziqe për fertilizimin e suksesshëm. Në parim, edhe kur gatishmëria e një punonjësi/eje për të punuar ishte parakusht për realizimin e duhur të një kontrate pune, mbrojtja e ofruar për gratë gjatë shtatzanisë nuk mund të varej nga fakti nëse prania e saj në punë gjatë shtatzanisë ishte thelbësore për funksionimin e duhur të punëdhënësit të saj, ose nga fakti se ajo kishte pengesa të përkohshme në kryerjen e punës për të cilën ishte punësuar. Për më tepër, futja e masave për mbrojtjen e shtatzanisë ishte thelbësore për të mbështetur parimin e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim.

Duke arritur në përfundimin se, për shkak të procedurës IVF, kërkuesja kishte qenë e paaftë nga aspekti shëndetësor për të fituar vendin e punës në fjalë, autoritetet vendase kishin lënë të kuptohej se ajo nuk ishte dashur ta pranonte kontratën e punës deri sa të ishte konfirmuar shtatzania e saj. Ky përfundim ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të drejtën vendase dhe me të drejtën ndërkombëtare.

Ato që u thanë më lart ishin të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kërkuesja ishte diskriminuar mbi bazën e seksit të saj. Megjithatë, Gjykata e pa të nevojshme të vinte në pah disa faktorë shtesë, të cilët e kishin bërë trajtimin e diferencuar edhe më të theksuar: 1) kërkuesja kishte paguar kontribute të rregullta në skemën e sigurimeve shëndetësore gjatë katërmbëdhjetë viteve të përvojës së mëparshme të punës; 2) kërkuesja nuk kishte pasur se si ta dinte, kur kishte hyrë në marrëdhënie pune, nëse procedura IVF kishte qenë e suksesshme apo jo, dhe as nuk kishte mundur ta dinte nëse shtatzania e saj e ardhshme, nëse ishte shtatzanë, do të kishte pasur komplikime që kërkonin pushim mjekësor për një periudhë të zgjatur kohore; 3) autoritetet kishin dështuar të shpjegojnë që kërkuesja mund të kishte lidhur me vetëdije një kontratë mashtruese punësimi, pa e ditur fare nëse ajo do të mbetej shtatzënë apo jo, posaçërisht duke pasur parasysh se ajo nuk kishte pasur asnjë detyrim ligjor për të raportuar faktin që ajo kishte bërë procedurën IVF ose që mund të ishte shtatzënë në kohën e lidhjes së kontratës. Në qoftë se një grua pyetet nëse është shtatzanë apo jo, ose në qoftë se një grua detyrohet ta raportojë një fakt të tillë në momentin e punësimit, një gjë e tillë përbën diskriminim të drejtpërdrejtë mbi bazën e seksit; 4) autoritetet kishin arritur përfundimin e tyre pa vlerësuar nëse kërkuesja tashmë kishte filluar të zhvillonte detyrat e saj për punëdhënësin, as nuk kishin kërkuar të konstatojnë nëse procedura IVF kërkonte

mungesën e saj në punë për arsye shëndetësor. Po ashtu, nuk kishte asnjë tregues që gratë që bënin procedurën IVF në përgjithësi nuk ishin në gjendje të punonin gjatë periudhës së trajtimit të fertilitetit ose gjatë shtatzanisë; 5) Gjykata shprehu shqetësimin që përfundimi i autoriteteve vendase kishte lënë të kuptohej se gratë nuk duhet të punojnë ose të kërkohen punë gjatë shtatzanisë. Stereotipe të tilla gjinore paraqesin pengesa të mëdha në arritjen e barazisë së vërtetë gjinore, një prej synimeve madhore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës. Konsiderata të tilla jo vetëm që ishin gjetur se shkelnin të drejtën vendase, por njëkohësisht ishin në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore.

Rrjedhimisht, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1. Refuzimi për të punësuar ose për të njohur benefitet e lidhura me punësimin të një gruaje shtatzënë për shkak të shtatzanisë së saj përbënin diskriminim të drejtpërdrejtë mbi bazën e seksit, gjë që nuk mund të justifikohet me interesat financiare të Shtetit. Dallimi në trajtimin e kërkueses, si grua që kishte mbetur shtatzënë përmes IVF, nuk kishte qenë objektivisht i justifikuar as i nevojshëm.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 7,500 euro për dëme jomateriale dhe 1,150 euro për kosto dhe shpenzime.

*Disa pasazhe të një vendimi të gjykatës italiane të apelit  
shkelën të drejtën e viktimës së supozuar të dhunës mbi baza  
gjimore për respekt të jetës private dhe personale*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN J. L. K. ITALISË

(Kërkesa Nr. 5671/16)

**27 maj 2021**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja, J. L., ishte e lindur në vitin 1986 dhe jetonte në Scandicci, në rajonin e Toskanës në Itali. Në kohën e ngjarjeve, ajo ishte studente e historisë së artit dhe dramës.

Në korrik të vitit 2008, kërkuesja bëri ankesë pranë autoriteteve italiane ku pretendonte se ishte viktimë e përdhunimit në grup që kishte ndodhur pas një organizimi të mbajtur në një mbrëmje, në Firence të Italisë më 25 korrik 2008. Ajo pretendoi se në fund të mbrëmjes, në të cilën ajo ishte ftuar nga njëri prej sulmuesve të supozuar, L.L., ajo ishte detyruar të kryente marrëdhënie seksuale në një makinë me shtatë burra gjatë kohës që ishte nën efektin e alkoolit.

Në janar të vitit 2013, Gjykata e Firences dënoi gjashtë prej shtatë burrave për bërjen e një individi në gjendje dobësie fizike dhe psikologjike që të vepronte ose të kryente akte të natyrës seksuale (vepër e dënueshme sipas Nenit 609 *bis* 1, i marrë së bashku me Nenin 609 *octies* të Kodit Penal italian). Të gjashtë burrat u shpallën të pafajshëm për një akuzë të dhunës seksuale (e dënueshme sipas Nenit 609 *bis* 1). Burri i shtatë u shpall i pafajshëm për të dyja akuzat.

Gjyqtari i shkallës së parë refuzoi t'i linte gazetarët e pranishëm në sallë që të filmonin procedurën, ndërsa procesverbalit i gjyqit tregon se gjyqtari kishte ndërhyrë disa herë për të ndaluar avokatët mbrojtës nga bërja e pyetjeve të cilat kërkuesja i kishte shtjelluar përpara, pyetje që nuk ishin relevante, ose ishin të një natyre tepër personale. Gjithashtu, gjyqtari kishte lejuar një pushim të shkurtër për t'i lejuar kërkueses që ta merrte veten.

Gjashtë burrat e dënuar bënë një apel, i cili u dëgjua nga Gjykata e Apelit e Firences ("Gjykata e Apelit"), e cila i shpalli të pafajshëm gjashtë burrat në qershor 2015. Gjykata e Apelit deklaroi se të pandehurit duhet të liroheshin sepse nuk mund të sqarohet elementi material i veprës së dhunës seksuale, e karakterizuar

nga abuzimi i gjendjes së inferioritetit të viktimës. Gjykata e Apelit konsideroi se mospërputhjet e shumta të vëna në dukje nga gjykata e shkallës së parë në tregimin e kërkueses lidhur me ngjarjet e dëmtonin besueshmërinë e saj në tërësi. Për atë arsye, ajo konsideroi se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar në bërjen e asaj që e quajti vlerësim të fragmentuar të deklaratave të ndryshme të kërkueses dhe në pranimin e besueshmërisë së saj në lidhje me disa prej fakteve.

Në korrik 2015, kërkuesja i kërkoi prokurorisë publike italiane që të bënte një apel mbi pika të ligjit, ku të kontestoheshin arsyet e dhëna në vendimin e Gjykatës së Apelit. Prokuroria publike refuzoi ta bënte këtë, kështu që vendimi mori formë të prerë.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja pretendoi se autoritetet italiane, gjatë hetimeve dhe procedurave penale, kishin dështuar të mbronin të drejtën e saj për jetë private dhe integritet personal, në shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Më tej, ajo pretendoi se ndaj saj kishte pasur diskriminim mbi baza të seksit, duke thënë se shfajësimi i sulmuesve të saj të supozuar dhe qëndrimi negativ i autoriteteve kombëtare gjatë procedurave penale mund t'i atribuohet njëanshmërisë seksiste, në shkelje të nenit 14 i marrë së bashku me nenin 8 të Konventës.

### Pranueshmëria

Qeveria parashtrori se kërkuesja nuk e plotësonte statusin e 'viktimës' për qëllimet e nenit 8 të Konventës. Gjykata theksoi se ky parashtrim në thelb kishte lidhje me pyetjen nëse ishte bërë sulm kundër integritetit personal të kërkueses dhe të drejtës së saj për respekt të jetës private. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi ta shqyrtonte këtë kundërshtim krahas themeleve substanciale të ankesës.

### Neni 8

Kërkuesja bëri disa parashtrës në lidhje me të drejtat e saj sipas nenit 8, kryesisht për shkak të 'ndërhyrjes së vazhdueshme dhe të pajustificuar' në jetën e saj private nga autoritetet gjatë hetimeve dhe procedurave penale, në shkelje të detyrimeve pozitive sipas nenit 8 për ta mbrojtur atë si viktimë femër e dhunës seksuale. Ajo gjithashtu argumentoi se vendimi i Gjykatës së Apelit reflektonte një koncept 'të ngushtë dhe të vjetëruar' të dhunës seksuale, në shkelje të parimeve të cekura në jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës.



Gjykata theksoi se kërkuesja nuk po pretendonte që zhvillimi i hetimeve ishte karakterizuar nga mangësi dhe vonesa të dukshme, ose që autoritetet kishin dështuar të merrnin masat e hetimeve gjyqësore. Çka donte të demonstronte ajo ishte se mënyra se si ishin zhvilluar hetimet dhe gjyqi kishin qenë traumatizuese për kërkuesen, dhe se sjellja e autoriteteve ndaj saj kishte shkelur integritetin e saj personal. Gjykata theksoi se ajo u ankua, në mënyrë të veçantë, për (a) mënyrën se si ajo ishte marrë në pyetje gjatë hetimeve dhe procedurave penale; dhe (b) ajo kontestoi argumentet mbi të cilat ishin bazuar gjyqtarët për marrjen e vendimit të tyre në këtë çështje.

Gjykata theksoi se neni 8 cakton detyrime pozitive për miratimin e dispozitave penale për kriminalizimin dhe ndëshkimin e faktiv të akteve seksuale jo-konsensuale, dhe për zbatimin e atyre dispozitave në praktikë me anë të hetimeve dhe ndjekjes penale. Më tej, në kontekstin e procedurave penale, mund të merreshin masa mbrojtëse të veçanta për të mbrojtur një viktimë, përfshirë kujdesin e veçantë për viktimën gjatë procedurave penale me qëllim të mbrojtjes nga viktimizimi sekondar. Çështja para Gjykatës ishte nëse kërkueses i takonte mbrojtja efektive e të drejtave të saj si viktimë e supozuar, apo nëse mekanizmat hetimore dhe prokuroriale në të drejtën penale italiane ishin kaq të mangëta në këtë rast sa që kishin shkelur detyrimet pozitive të Qeverisë sipas nenit 8.

Sa i përket zhvillimit të hetimeve penale paraprake, Gjykata konsideroi se nuk kishte pasur qëndrime të parespektueshme ose frikësuese nga ana e autoriteteve, dhe se pyetjet që i ishin drejtuar kërkueses kishin qenë relevante dhe kishin pasur për qëllim të përftonin një rikonstruktiv të ngjarjeve sipas argumenteve të saj dhe këndvështrimit të saj, dhe duke lejuar përgatitjen e një dosjeje hetimore të plotë. Duke pasur parasysh se është përvojë e vështirë, Gjykata nuk arriti në përfundimin se mënyra e intervistimit e kishte ekspozuar kërkuesen ndaj traumave të pajustificuara ose ndaj ndërhyrjeve joproporcionale në jetën e saj intime dhe private.

Në lidhje me marrjen në pyetje nga mbrojtja, mënyra se si intervistohet një viktimë e supozuar e veprave seksuale duhet të vendosë një ekuilibër të drejtë mes mbrojtjes së integritetit personal të saj dhe të drejtës për t'u dëgjuar. Gjykata theksoi se avokati mbrojtës i të pandehurve nuk kishte hezituar të dëmtonte besueshmërinë e kërkueses, duke i bërë pyetje rreth jetës së saj familjare, orientimit seksual dhe zgjedhjeve intime, nganjëherë në mënyra që nuk kishin lidhje me faktet. Megjithatë, ajo theksoi se gjyqtari i shkallës së parë vendosi të mos linte gazetarët që të hynin në sallë për të filmuar procedurën, dhe ndërhyri për ta ndaluar avokatin mbrojtës nga bërja e pyetjeve të panevojshme ose personale pa lidhje me faktet, si dhe i lejoi kërkueses një pushim të shkurtër për ta rimarrë veten.

Kështu, ndërkohë që Gjykata qe dakord se procedurat ishin përvojë e hidhur për kërkuesen, ajo nuk mund t'ua vishte shqetësimin e shkaktuar autoriteteve publike që ndoqën penalisht çështjen, as nuk konsideroi se integriteti personal i kërkueses nuk ishte mbrojtur siç duhet gjatë gjyqit.

Në lidhje me përmbajtjen e vendimeve gjyqësore, Gjykata nuk ndërmori vlerësimin e fakteve *per se*, meqenëse kjo pjesë ishte jashtë kompetencës së saj. Sidoqoftë, Gjykata nënvizoi disa seksione të vendimit të Gjykatës së Apelit të cilat, sipas mendimit të saj, ishin të pajustificuara, "zhgënjyese dhe pa vend".

Gjykata veçoi si problematike: (i) referencat ndaj të brendshmeve të kuqe "të shfaqura" nga kërkuesja gjatë mbrëmjes kur ndodhën ngjarjet; (ii) komentet lidhur me biseksualitetin e saj, marrëdhëniet dhe lidhjet seksuale rastësore që kishte pasur para ngjarjes, sidomos komentet rreth "jetës devijuese" të saj; (iii) pikëpamjes së Gjykatës së Apelit që kërkuesja kishte një "qëndrim ambivalent ndaj seksit", posaçërisht duke pasur parasysh vendimet e saj artistike (siç ishte pjesëmarrja e saj në një film krahas L.L., njërit prej të pandehurve, në rolin e një prostitute, pak muaj para ngjarjes); dhe (iv) vërejtjet e Gjykatës së Apelit në lidhje me vendimin e kërkueses për të bërë ankesë për të "denoncuar" të pandehurit dhe për të mohuar "një moment brishtësie dhe dobësie që ishte i hapur për kritika".

Gjykata konsideroi që argumentet dhe konsideratat e mësipërme të dhëna nga Gjykata e Apelit nuk kishin qenë as relevante për vlerësimin e besueshmërisë së kërkueses, çështje e cila mund të ishte shqyrtuar nën dritën e gjetjeve të shumta objektive të hetimeve, e as vendimtare në përcaktimin e çështjes. Rrjedhimisht, ajo arriti në përfundimin që nuk mund të konsiderohej se ndërhyrja në jetën private dhe imazhin e kërkueses ishte e justifikuar nga nevoja për të mbrojtur të drejtën e të pandehurve për t'u mbrojtur në gjyq.

Detyrimet pozitive të ngërthyera në nenin 8 për të mbrojtur viktimat e supozuara të dhunës me bazë gjinore gjithashtu i caktonin Shtetit detyrën për të mbrojtur imazhin, dinjitetin dhe jetën private të viktimës, përfshirë me anë të mos-zbulimit të informacioneve dhe të dhënave personale të palidhura me çështjen. Rrjedhimisht, liria gjyqësore e shprehjes duhet të kufizohet nga detyrimi për të mbrojtur imazhin dhe jetën private të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata iu referua raporteve të OKB-së dhe GREVIO (organ i pavarur ekspert, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës Shtëpiake) në lidhje me eliminimin e diskriminimit ndaj grave në Itali, duke ardhur në

përfundimin se këto raporte tregonin vazhdimin e stereotipeve në lidhje me rolin e grave në shoqërinë italiane dhe rezistencën e asaj shoqërie ndaj kauzës së barazisë gjinore. Më tej, gjuha dhe argumentet e përdorura nga Gjykata e Apelit paraqisnin paragjykime rreth rolit të grave në shoqërinë italiane, dhe me gjasë pengonin mbrojtjen efektive të të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore, pavarësisht nga ekzistenca e kornizës së duhur ligjore në Itali.

Më tej, Gjykata shtoi se ndjekja penale dhe ndëshkimi luajnë rol thelbësor në reagimin institucional ndaj dhunës me bazë gjinore dhe në luftimin e pabarazisë gjinore. Prandaj, është e rëndësishme thelbësore që autoritetet gjyqësore të shmangin (i) rikrijimin e stereotipeve gjinore në vendimet gjyqësore, (ii) minimizimin e dhunës me bazë gjinore, dhe (iii) ekspozimin e grave ndaj "viktimizimit sekondar" duke përdorur gjuhë "moralizuese dhe që të bën të ndihesh në faj" e cila i dekurajon viktimat nga besimi tek sistemi gjyqësor.

Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin që, edhe pse autoritetet italiane ishin përpjekur të siguroheshin që hetimet dhe procedurat gjyqësore të zhvilloheshin në një mënyrë që ishte në përputhje me detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 të Konventës, Gjykata konsideroi se të drejtat dhe interesat e kërkuases sipas nenit 8 nuk ishin mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme, duke pasur parasysh formulimin e vendimit të shpallur nga Gjykata e Apelit e Firences. Duke e refuzuar parashtrimin e Qeverisë se kërkuësja nuk ishte e kualifikuar për të pasur statusin e viktimës, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### Neni 14

Gjykata, duke pasur parasysh arsyetimin dhe përfundimet që arriti në lidhje me nenin 8, e konsideroi të panevojshme të shqyrtonte nëse kishte pasur shkelje të nenit 14.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuases dëmshpërblim në shumën 12,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 1,600 euro për kosto dhe shpenzime.

*Reagimi i autoriteteve ndaj incidenteve të dhunës shtëpiake që ndodhën para gjuajtjes fatale të djalit të viktimës, nga bashkëshorti dhe abuzuesi i saj, përmbushën detyrimet pozitive që dalin nga neni 2*

## **VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KURT k. AUSTRIË**

(Kërkesa Nr. 62903/15)

**15 qershor 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, znj. Senay Kurt, ishte e lindur në vitin 1978 dhe jetonte në Unterwagram. Ajo u martua me E në vitin 2003, dhe patën dy fëmijë, A dhe B, të lindur në vitet 2004 dhe 2005 respektivisht.

Në korrik 2010, kërkuesja raportoi në polici që burri i saj e kishte rrahur. Ajo pretendoi se kjo kishte shumë vite që ndodhte. Sipas s. 38a të Ligjit për Policinë e Sigurisë, autoritetet e njoftuan kërkuesen, me anë të një fletëpalosjeje, për mundësinë e marrjes së një urdhri të përkohshëm për kufizim distance. Filluan procedurat penale, dhe E u dënua në janar 2011 për lëndim trupor dhe për bërjen e kërcënimeve të rrezikshme.

Kërkuesja bëri kërkesë për divorc më 22 maj 2012. Në të njëjtën ditë, ajo e raportoi E-në në polici për përdhunim dhe për bërjen e kërcënimeve të rrezikshme tre ditë më përpara. Ajo raportoi se burri i saj i ishte rikthyer varësisë së tij ndaj bixhozit në shkurt 2012. Më përpara ai i kishte thënë asaj se, po qe se ai i rikthehej bixhozit, ajo mund ta linte atë. Duke menduar për ndarjen e mundshme, sjellja e dhunshme e E ishte intensifikuar që nga marsi 2012, duke përfshirë kërcënimet pothuaj të përditshme ("do të të vras", "do t'i vras fëmijët tanë para syve të tu", "do t'i lëndo fëmijët e vëllait tënd në qoftë se më kthejnë në Turqi", dhe "do të var veten para derës së prindërve të tu") dhe duke arritur kulmin me përdhunimin e datës 19 maj 2012. Policia bëri fotografi, zhvilloi hetime online, dhe kontrolloi regjistrin e armëve të zjarrit. Të gjitha palët, përfshirë fëmijët, u morën në pyetje nga policia, e cila lëshoi një urdhër pengimi dhe mbrojtjeje në përputhje me s. 38a të Ligjit për Policinë e Sigurisë.

Më 25 maj 2012, E shkoi në shkollën e A dhe B, dhe i kërkoi mësuesit të A-së nëse mund të fliste me djalin e tij vetëm për vetëm, për t'i dhënë ca para. Mësuesi i A-së, i cili në atë kohë nuk dinte asgjë rreth situatës së tyre familjare, më pas e

gjeti A-në në bodrumin e shkollës me plumb në kokë. Motra e tij, B, qe dëshmitare e të shtënave por nuk u lëndua. Më vonë atë ditë, E u gjeti i vdekur në makinën e tij, pasi kishte kryer vetëvrasje me armë zjarri. Policia mori në pyetje disa dëshmitarë, përfshirë kërkuesen dhe B-në.

Më 11 shkurt 2014, kërkuesja nisi procedurat për përgjegjësi zyrtare. Ajo pretendoi se E duhet të ishte mbajtur në paraburgim më 22 maj 2012 mbi bazën e faktit se kishte ekzistuar rreziku real dhe i afërt që ai do të kryente sërish vepra penale kundër familjes së tij. Pretendimi i saj u rrëzua më 14 nëntor 2014 nga Gjykata Rajonale e St Pölten e cila deklaroi se, duke marrë parasysh informacionet në dispozicion të autoriteteve në atë kohë, nuk kishte pasur rrezik të afërt për jetën e A-së. Kërkuesja apeloi, pa sukses, para Gjykatës së Apelit të Vjenës dhe Gjykatës Supreme. Kjo e fundit e mori vendimin e saj më 16 qershor 2015.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua se autoritetet vendase kishin dështuar të vepronin në pajtueshmëri me detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 2 për të mbrojtur jetën e djalit të saj. Ajo më tej u ankua se ajo ishte diskriminuar për shkak se ishte grua, në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Një Dhomë e Gjykatës gjeti, më 4 korrik 2019, se nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 në aspektin substancial. Ajo qe dakord me gjykatat vendase që, duke u bazuar tek informacionet në dispozicion në atë kohë, autoritetet kishin arritur në përfundimin se urdhri i pengimit dhe mbrojtjes do të ishte i mjaftueshëm për mbrojtjen e kërkueses dhe fëmijëve të saj. Në lidhje me mungesën e një kornize rregullatore që mundëson një urdhër të tillë për objektet shkollore të fëmijëve, Dhoma gjeti se nuk kishte pasur asnjë rrezik të dallueshëm për jetën e djalit të kërkueses kur ai ndodhej në shkollë. Çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkueses.

### Neni 2

Kërkuesja argumentoi se parimet e çështjes *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>[332]</sup> zbatoheshin në situatat ku ndodhnin incidente, ndërsa situata e saj e abuzimit të vazhdueshëm kërkonte një vlerësim nga aspekti i kontekstit të ndjeshëm siç ishte zbatuar nga Gjykata në çështjet *Talpis k. Italisë*,<sup>[333]</sup> dhe *Volodina k. Ruisë*.<sup>[334]</sup> Dallimi kryesor që bëri ajo ishte mes kërcënimeve statike dhe kërcënimeve që

[332] *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1998, nr. 23452/94.

[333] *Talpis k. Italisë*, vendimi i 2 marsit 2017, nr. 41237/14.

[334] *Volodina k. Ruisë*, vendimi i 9 korrikut 2019, nr. 41261/17 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

u intensifikuan me kalimin e kohës, ku dhuna shtëpiake kundër saj hyri në këtë kategorinë e fundit, prandaj ishte e nevojshme të merrej në konsideratë konteksti në zhvillim e sipër. Ajo u ankua se përpjekjet e autoriteteve kishin qenë të fokusuara tek të mbrojturit e saj, duke neglizhuar rrezikun që i kanosej fëmijëve të saj. Duke pasur parasysh listën e gjatë të faktorëve të rrezikut për të cilët ajo i kishte informuar autoritetet, ato kishin dështuar të merrnin masat e nevojshme parandaluese, siç ishte paraburgosja e E. Më tej, ajo parashtroi se autoritetet kishin dështuar të merrnin parasysh kontekstin specifik të dhunës shtëpiake dhe se policia kishte dështuar të përdorte një instrument specifik për vlerësimin e rrezikut në rastet e dhunës shtëpiake.

Dhoma e Madhe dëgjoi parashtrime nga ndërhyrës të shumtë të palës së tretë, përfshirë Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës Shtëpiake (GREVIO), Qendra Evropiane e Avokimit për të Drejtat e Njeriut (EHRAC) dhe Barazia Tani, Shoqata Federale e Qendrave Austriake për Mbrojtjen nga Dhuna, si dhe grupe të tjera më të vogla. GREVIO, si organi i mandatuar për të monitoruar Konventën e Stambollit, parashtroi se të kuptuarit gjinor e dhunës shtëpiake (sipas Konventës së Stambollit) mund të arrihej vetëm në qoftë se autoritetet kombëtare të ngarkuara me detyrën e parandalimit të veprave përkatëse dhe mbrojtjen e viktimave merrnin parasysh natyrën specifike të dhunës shtëpiake.

Gjykata përsëriti testin nga çështja *Osman* në lidhje me detyrimet pozitive të Shteteve nga neni 2. Për të dalë në pah detyrimi pozitiv, duhet të konstatohet se autoritetet e kanë ditur, ose do të duhej ta kishin ditur, në kohën relevante, se ekzistonte rreziku real dhe i afërt ndaj jetës së një individi të identifikuar nga aktet kriminale të një pale të tretë, dhe se ato dështuan të merrnin masat që kishin në dorë të cilat, nëse gjykohet me arsye, mund të ishte pritur se do ta kishin shmangur atë rrezik. Jo të gjitha rreziqet e pretenduara për jetën i japin shkas detyrimit të Shtetit për të marrë masa parandaluese. Më tej, çdo analizë e këtij testi duhet të marrë parasysh si përshtatshmërinë e vlerësimit, ashtu edhe masat parandaluese të marra.

Gjykata konsideroi detyrimet e ndryshme pozitive që mund të dalin nga neni 2 në kontekstin e dhunës shtëpiake:

*Nëse autoritetet kanë vepruar menjëherë pas pretendimeve për dhunë shtëpiake*

Autoritetet duhet të veprojnë menjëherë, dhe me zell të veçantë, në reagimin e tyre ndaj pretendimeve për dhunë shtëpiake. Dështimi për ta bërë këtë do ta

dëmtonte ankesën dhe do të krijonte një situatë mosndëshkimi. Gjykata theksoi se nuk kishte vonesa tek çështja në fjalë. Më tej, policia e shoqëroi kërkuesen për në shtëpi pasi ajo e raportoi burrin e saj, për ta mbrojtur atë nga çfarëdo lloj reagimi prej tij. Njëri prej policëve ishte kishte trajnim special për rastet e dhunës shtëpiake. Kështu, autoritetet treguan zellin e veçantë që kërkohet në reagimin e tyre të menjëhershëm pas pretendimeve të kërkueses.

### *Cilësia e vlerësimit të rrezikut*

Autoritetet kanë për detyrë të zhvillojnë vlerësimin e rrezikut të fatalitetit të mundshëm, i cili është autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës. Dy kushtet e para kanë të bëjnë me kërkesën që autoritetet të shohin përtej perceptimit të rrezikut nga ana e viktimës. Ndërkohë që perceptimi i tyre është i rëndësishëm, autoritetet nuk duhet të mbështeten vetëm tek deklaratat e viktimës. "Gjithëpërfshirja" ka të bëjë me përdorimin e listave kontrolluese dhe instrumenteve të standardizuara për vlerësimin e rrezikut për të garantuar një analizë të plotë. Në fund, kriteri i veprimit të menjëhershëm, sipas testit *Osman*, i detyron autoritetet të marrin në konsideratë tipare të veçanta të rasteve të dhunës shtëpiake, siç është tendenca për t'u shpeshtuar me kalimin e kohës.

Në rastin konkret, Gjykata konsideroi se vlerësimi i rrezikut ishte zhvilluar në mënyrë autonome dhe proaktive. Policia mori në pyetje të gjitha palët e përfshira ditën kur mori raportin e kërkueses, kërkueses iu bë ekzaminimi mjekësor, dhe policia më pas zhvilloi kërkime online për të dhëna lidhur me urdhrat e mëparshëm për distancë dhe mbrojtje, si dhe për urdhrat e kufizimit dhe pengimit të lëshuar kundër E. Policia gjeti që ai kishte një dënim të mëparshëm për dhunë shtëpiake, dhe ndaj tij ishte lëshuar një urdher pengimi dhe mbrojtjeje dy vite më përpara. Instrumenti i vlerësimit të rrezikut ishte i thellë, dhe shqyrtonte faktorë madhorë të rrezikut, përfshirë rrethanat e përdhunimit, historiku i dhunës dhe sjelljes personale të E, si dhe faktin që nuk kishte armë zjarri të regjistruara në emër të E. Rrjedhimisht, autoritetet kishin demonstruar se ato e kishin marrë parasysh siç duhej kontekstin e dhunës shtëpiake në çështjen në fjalë.

Duke u kthyer tek kërcënimet, Gjykata theksoi se autoritetet nuk i kishin anashkaluar kërcënimet për vdekje që E i kishte bërë ndaj kërkueses. Prokurori publik u informua siç duhej në lidhje me kërcënimet, gjë që i mundësoi atij që të merrte hapat hetimore të mëtejshme dhe të fillonte procedurën penale. Kështu, Gjykata gjeti se vlerësimi i rrezikut nga autoritetet në lidhje me kërkuesen i plotësonte kriteret e të qenit autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës.

*Nëse autoritetet e kanë ditur, ose duhet që ta kishin ditur, se ekzistonte rreziku real dhe i afërt ndaj jetës së djalit të kërkueses*

Pasi konstatohet, mbi bazën e informacioneve në dispozicion të autoriteteve në kohën relevante, se ekziston rrezik real dhe i afërt ndaj jetës, aktivizohet detyrimi pozitiv për të ndërmarra masa operacionale. Përshtatshmëria e masave të marra është e lidhur ngushtë me instrumentet ligjore në dispozicion të autoriteteve. Këtu përfshihet ekzistenca e masave parandaluese siç janë shërbimet e koordinuara mbështetëse për viktimat e dhunës shtëpiake. Çdo masë parandaluese që merret duhet të jetë proporcionale.

Në lidhje me çështjen e paraburgimit, Gjykata theksoi se, megjithëse pjesa e dytë e nenit 5 § 1 (c) parashikon një bazë të veçantë për paraburgimin e pavarur nga ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm që një person ka kryer veprë, kjo nuk lejon një politikë të përgjithshme të parandalimit të drejtuar kundër individëve që perceptohen si të rrezikshëm nga autoritetet. Për të justifikuar paraburgimin sipas kësaj dispozite, autoritetet duhet të tregojnë në mënyrë bindëse që personi në fjalë sipas të gjitha gjasave do të kishte qenë i përfshirë në veprën konkrete dhe specifike, sikur të mos ishte ndaluar kryerja e saj me anë të paraburgimit.

Mbi bazën e provave të ditura për autoritetet në kohën relevante tek çështja në fjalë, autoritetet arritën në përfundimin se kërkuesja rrezikohej nga dhuna e mëtejshme dhe lëshuan një urdhër pengimi dhe mbrojtjeje kundër E sipas s. 38a të Ligjit për Policinë e Sigurisë. Gjykata konsideroi se bërja e një vlerësimi të ndarë të rrezikshmërisë në lidhje me fëmijët nuk do ta kishte ndryshuar situatën, meqenëse ato përfitonin të njëjtën mbrojtje si nëna e tyre, në formën e urdhrit për pengim dhe mbrojtje.

Gjykata pati kritika rreth peshës që iu dha sjelljes së qetë të burrit të kërkueses para policisë, gjë që mund të jetë çorientuese në kontekstin e dhunës shtëpiake dhe nuk duhet të jetë vendimtare gjatë vlerësimit të rrezikut. Megjithatë, ajo nuk konsideroi se ky faktor ishte i mjaftueshëm për të ndryshuar përfundimin se fëmijëve nuk u kanosej rreziku për vdekje. Kështu, Gjykata që dakord me Qeverinë se, mbi bazën e asaj që dihej në atë kohë, nuk kishte tregues të ndonjë rreziku real dhe të afërt të dhunës së mëtejshme kundër djalit të kërkueses jashtë zonave që përfshinte urdhri i pengimit.



### *Përfundim*

Në tërësi, Gjykata gjeti se autoritetet kishin treguar zellin e veçantë që kërkohet në reagimin e tyre ndaj pretendimeve të kërkuases për dhunën shtëpiake. Vlerësimi i rrezikut që zhvilluan ato ishte autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës ka, sado që i nixti ato të lëshonin urdhrin për pengim dhe mbrojtje, nuk tregoi rrezik real dhe të afërt të fatalitetit ndaj djalit të kërkuases. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 2.

### Neni 14

Kërkuesja u ankua se, duke dështuar ta mbronte atë nga dhuna shtëpiake, Shteti kishte bërë diskriminim ndaj saj si grua, në shkelje të nenit 14. Megjithatë, duke qenë se kërkuësja nuk e bëri këtë ankesë para Gjykatës deri në kohën e parashtrësës së saj para Dhomës së Madhe, kjo u paraqit jashtë kufirit kohor gjashtë-mujor që parashikon neni 35 § 1. Si e tillë, ankesa e kërkuases sipas nenit 14 u deklarua e papranueshme.

*Nuk ka shkelje të nenit 4 të Protokollit Nr. 7 për duplikimin e procedurave në kontekstin e dhunës shtëpiake*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN E GALOVIĆ K. KROACISË

(Kërkesa Nr. 45512/11)

**31 gusht 2021**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Miljenko Galović, ishte shtetas kroat i lindur në vitin 1957. Mes tetorit 2006 dhe nëntorit 2008, ai u gjet fajtor për pesë vepra kundërvajtëse të dhunës shtëpiake, sipas Ligjit për Mbrojtje kundër Dhunës Shtëpiake, nga Gjykata e Kundërvajtjes e Zagrebit. Këto incidente përfshinë vepra kundër bashkëshortes së tij, djalit dhe dy vajzave të tij, ku njëri prej fëmijëve ishte i mitur. Më 17 nëntor 2008, kërkuesi u dënua me tridhjetë ditë burgim për ofendim verbal të gruas dhe vajzës së tij, ku ai kërcënoi që do ta vriste gruan dhe i shkaktoi asaj lëndime në kokë. Gjykata e Kundërvajtjes e tërhoqi dënimin e mëparshëm të tij me kusht dhe caktoi një dënim me 112 ditë burgim në total.

Më tej, ndaj kërkuesit u grit aktakuzë në Gjykatën Penale Komunale të Zagrebit. Aktakuza përfshinte katër vepra për dhunë shtëpiake dhe një vepër për neglizhencë dhe abuzim të fëmijës siç përkufizohet në Kodin Penal, të kryera gjatë periudhës mes shkurtit 2005 dhe nëntorit 2008. Më 14 korrik 2009, kërkuesi u gjet fajtor për këto akuza dhe u dënua me një dënim kumulativ pesë vjet burg.

Më tej, kërkuesi bëri kërkesë për rishikimin e vendimit, e cila u pranua nga Gjykata Supreme dhe iu rikthye Gjykatës Komunale. Më 12 shkurt 2010, Gjykata Komunale e njoftoi kërkuesin dhe avokatin mbrojtës të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare se seanca e apelit ishte caktuar për datën 16 shkurt 2010. Kërkuesi u ankua se katër ditë paralajmërim nuk ishin të mjaftueshme që ai të përgatiste mbrojtjen dhe të kontaktonte me avokatin. Seanca e apelit u zhvillua ashtu siç ishte planifikuar, por kërkuesi dhe avokati i caktuar sipas detyrës zyrtare nuk qenë të pranishëm.

Më 17 shkurt 2010, kërkuesi bëri një kërkesë për rishikimin e vendimit të datës 16 shkurt 2010. Ai argumentoi, *inter alia*, që atij nuk i ishte dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, as ai vete e as avokati i tij nuk ishin ftuar të merrnin pjesë në seancë, dhe që dënimi i marrë përbënte dënim të dytë për të njëjtën vepër. Më 27 prill 2010, Gjykata Supreme e rrëzoi kërkesën për rishikim

dhe pretendimin se kërkuesi ishte dënuar dy herë për veprën e kundërvajtjes së datës 17 nëntor 2008 në procedurat e aktakuzës kundër tij.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se gjatë procedurave vendase ai nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, dhe se nuk kishte mundur të mbrohej as personalisht e as përmes avokatit, në kundërshtim me Nenin 6 §§ 1 dhe 3(b) dhe (c). Më tej, ai argumentoi se atij nuk i ishte dhënë mundësia të merrte pjesë në procedurën e tij, në kundërshtim me Nenin 6 §§ 1 dhe 3(c). Ai gjithashtu u ankua se ai ishte gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, në shkelje të nenit 4 të Protokollit Nr. 7.

### Neni 6

Gjykata i pa ankesat e kërkuesit në lidhje me të drejtën e tij për kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të drejtën e përfaqësimit ligjor si të lidhura ngushtë, dhe i shqyrtoi çështjet bashkë sipas Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (b) dhe (c). Kërkuesi u ankua se paralajmërimi katër ditë para seancës së tij të apelit ishte i pamjaftueshëm për të që të përgatiste mbrojtjen dhe të merrte avokat. Gjykata deklaroi se ai tashmë i kishte përdorur shërbimet e avokatit të tij të zgjedhur dhe kishte pasur kohë të mjaftueshme për mbrojtje, duke pasur parasysh që kërkuesi tashmë e kishte paraqitur mbrojtjen e tij para gjyqtarit hetues, në gjyq para gjykatës së shkallës së parë, dhe në tri parashtresa të tjera të bëra me shkrim nga mbrojtja. Për më tepër, gjykatat vendase i kishin dhënë kërkuesit mundësi të mjaftueshme për të angazhuar një avokat tjetër. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (b) dhe (c).

Në lidhje me mungesën e kërkuesit në seancën e gjykatës së apelit, kërkuesi argumentoi që kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për t'u mbrojtur personalisht. Gjykata doli në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3(c) në linjë me çështje të tjera të ngjashme gjyqësore më parë kundër Kroacisë.

### Neni 4 i Protokollit Nr. 7

Kërkuesi u ankua se ai ishte dënuar dy herë për të njëjtën vepër me vendimet e Gjykatës së Kundërvajtjes dhe Gjykatës Komunale. Gjykata vlerësoi nëse kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit Nr. 7 në lidhje me faktin nëse procedurat ishin të natyrës penale, nëse veprat për të cilat kërkuesi ishte ndjekur penalisht ishin të njëjtat, dhe nëse kishte pasur duplikim të procedurave.

Sa i përket faktit nëse procedurat ishin të natyrës penale, Gjykata tha se edhe procedurat për kundërvajtje, edhe procedurat në lidhje me aktakuzën ishin të natyrës "penale" për qëllimet e nenit 4 të Protokollit Nr. 7.

Për të vendosur nëse dy veprat ishin "të njëjta", Gjykata u përqendrua në shqyrtimin e fakteve që mund të përbënin rrethana faktike konkrete në lidhje me të njëjtin të pandehur të cilat janë pazgjydhshëmrisht të lidhura së bashku dhe përdoren për të siguruar dënimin ose për të nisur procedura penale. Fillimisht kërkuesi u dënua në procedurën e kundërvajtjes në lidhje me pesë incidente të ndara të dhunës shtëpiake, përfshirë incidentin e nëntorit 2008. Më pas, Shteti nisi procedurën e aktakuzës, e cila përfshinte katër vepra të dhunës shtëpiake gjatë periudhës mes shkurtit 2005 dhe nëntorit 2008, duke mbuluar kështu të njëjtën periudhë kur ishin kryer veprat e kundërvajtjes. Gjykata shënoi se, ndërkohë që procedura e aktakuzës i përmendi konkretisht faktet e incidentit të nëntorit 2008, procedura gjithashtu përmbante fakte shtesë të papërfshira në procedurën e kundërvajtjes, siç ishte dhuna shtëpiake kundër vajzës dhe djalit të kërkuesit. Vetë fakti që procedura e aktakuzës përfshinte incidentin e nëntorit 2008 ishte provë e vazhdimësisë së sjelljes së kërkuesit, që ishte sanksionuar shumë herë në procedurën e kundërvajtjes dhe tani kishte arritur pragun e peshës së atillë që konsiderohej në kuadër të aktakuzës. Rrjedhimisht, Gjykata pranoi se faktet në procedurën e aktakuzës përfshinin fakte identike me faktet e procedurës së kundërvajtjes.

Gjykata më tej shqyrtoi nëse kishte pasur duplikim të procedurave, duke shënuar që neni 4 i Protokollit Nr. 7 në vetvete nuk i përjashton procedurat e dyfishta në qoftë se plotësohen disa kushte të caktuara. Këto kushte përfshijnë mos-duplikimin e gjyqit ose ndëshkimit dhe që procedurat të jenë "mjaftueshëm afër të lidhura në thelb dhe në kohë". Faktorët materialë për të përcaktuar nëse ka pasur lidhje mjaftueshëm të afërt në thelb përfshijnë: nëse procedurat e ndryshme kanë synuar qëllime dhe adresime plotësuese të ndërsjella, *in concreto*, aspekte të ndryshme të sjelljes së pahijshme sociale, nëse procedura e dyfishtë ka qenë pasojë e parashikueshme e të njëjtës sjellje të pandëshkuar, nëse procedura përkatëse është zhvilluar në mënyrë të atillë që ka shmangur disavantazhe të tjera të duplikimit të procedurave, dhe nëse sanksioni i vendosur në procedurën e parë të formës së prerë është marrë parasysh në procedurën e fundit të formës së prerë, siç është një mekanizëm për të siguruar që çdo dënim i caktuar të jetë proporcional.

Gjatë shqyrtimit të këtyre kushteve dhe faktorëve, Gjykata përsëriti se Shtetet kanë detyrimin pozitiv sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës që të ofrojnë dhe të mbajnë një kornizë ligjore të përshtatshme për mbrojtje kundër akteve

të dhunës shtëpiake. Ajo vërejtë se dhuna shtëpiake rrallëherë është incident i izoluar që ndodh vetëm një herë, dhe zakonisht përfshin forma të ndërlidhura të abuzimit fizik, psikologjik, seksual, emocional, verbal dhe financiar ndaj një anëtarë/eje të afërt të familjes apo partneri/eje që shkojnë përtej rrethanave të një rasti individual. Ri-ndodhja e episodeve të njëpasnjëshme të dhunës brenda një marrëdhënieje personale ose në rrethe të mbyllura përfaqëson kontekstin dhe dinamikën e veçantë të dhunës shtëpiake. Gjykata riafirmoi se dhuna shtëpiake duhet të kuptohet si formë e veçantë e veprave të vazhdueshme në të cilat incidentet individuale janë pjesë të një tabloje më të gjerë.

Duke pasur parasysh këtë, Gjykata afirmoi procesin e dyfishtë të integruar që ka zbatuar Shteti për të rregulluar dhunën shtëpiake. Procesi i parë u zhvillua për të ndëshkuar një akt të vetëm të dhunës shtëpiake, i cili nuk përbëri ndonjë veprë tjetër penale. Ky u sanksionua si veprë e kundërvajtjes me qëllim të reagimit të shpejtë ndaj një incidenti. Procesi i dytë u zhvillua për të ngritur akuza penale për dhunë shtëpiake, e cila është veprë e vazhduar, me qëllim të adresimit të dhunës së vazhdueshme në mënyrë gjithëpërfshirëse. Gjykata i ka këto dy procese si të tilla që janë në interes të përgjithshëm të reagimit të shpejtë dhe të duhur ndaj dhunës shtëpiake.

Gjykata gjeti se procedurat e dyfishta duhet të kishin qenë të parashikueshme për kërkuesin. Duke pasur parasysh sjelljen e dhunshme të vazhdueshme të kërkuesit ndaj anëtarëve të familjes së tij, ishte e parashikueshme që kjo sjellje do të ngërthente pasoja si procedura e kundërvajtjes si dhe procedura penale për sjelljen e vazhduar dhe të përsëritur të dhunës shtëpiake.

Gjykata gjithashtu arriti në përfundimin që kërkuesi nuk kishte pësuar disavantazh në duplikimin e procedurave. Gjykata penale kishte marrë parasysh në mënyrën e duhur vendimet e gjykatës së kundërvajtjes, për shembull duke zgjedhur të dëgjonte edhe një herë disa dëshmitarë të caktuar. Kjo siguroi se të drejtat e kërkuesit nga neni 6 ishin mbrojtur nga Shteti. Më tej, të dy procedurat e kundërvajtjes dhe procedura e aktakuzës kishin zbatuar parimin e deduksionit, duke siguruar që dënimet e caktuara për kërkuesin të ishin proporcionale me peshën e veprës në fjalë.

Në fund, Gjykata e vuri kohën e zhvillimit të procedurave të dyfishta në kontekstin e veçantë të dhunës shtëpiake, duke theksuar nevojën që sistemet e të drejtës penale vendase të merreshin në mënyrë efektive me veprat individuale dhe agregate të dhunës shtëpiake. Këtu, Shteti kishte ndërhyrë në të dy incidentet e ndara dhe në veprën e vazhduar të dhunës shtëpiake, dhe çfarëdo disavantazhi

për kërkuesin në këto procedura paralele është i papërfillshëm. Gjykata u bind që procedurat e dyfishta ishin mjaftueshëm të lidhura në kohë sa të formonin një tërësi koherente dhe proporcionale. Kjo i mundësoi Shtetit që të ndëshkonte aktet individuale të kryera nga kërkuesi dhe vazhdën e sjelljes së tij në mënyrë efektive, proporcionale dhe zbindëse.

Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit Nr. 7.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 1,500 euro në lidhje me dëme jomateriale.

*Mungesa e hetimeve efektive për aktet e dhunës në kontekstin e dhunës shtëpiake ishte në kundërshtim me nenin 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN VOLODINA k. RUSISË (Nr. 2)

(Kërkesa Nr. 40419/19)  
**14 shtator 2021**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja, znj. Valeriya Igorevna Volodina, ishte shtetase ruse e lindur në vitin 1985. Në gusht të vitit 2018 ajo ndryshoi me ligj emrin e saj, që do të thotë se emri në këtë kërkesë nuk ishte më emri që ajo përdorte.

Në nëntor të vitit 2014 kërkuesja hyri në një marrëdhënie me S., shtetas i Azerbajxhanit. Pas ndarjes së tyre në vitin 2015, S. e kërcënoi atë me vdekje ose lëndime trupore; ai e rrëmbeu dhe e sulmoi atë shumë herë. Kërkuesja bëri ankesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në *Volodina k. Rusisë*, ku Gjykata gjeti se autoritetet vendase kishin dështuar që ta mbronin atë nga aktet e përsëritura të dhunës në kundërshtim me nenin 3, dhe kishin dështuar të merrnin masat e duhura për të luftuar diskriminimin gjinor kundër grave në kundërshtim me nenin 14.<sup>[335]</sup>

Në qershor 2016, kërkuesja u ankua në polici se emri i saj, të dhënat e saj personale, dhe fotografi intime të saj ishin përdorur për krijimin e profileve të rreme në media sociale. Aty ishin shtuar si 'miq' fëmijët e klasës së djalit të saj 12-vjeçar dhe mësuesi i tij. Vëllai i saj kishte dhënë deklaratë në polici, ku kishte raportuar që S. e kishte pranuar se kishte hyrë tinëz në llogarinë e kërkueses dhe kishte dërguar mesazhe të turpshme prej llogarisë së saj. Policia pretendoi se nuk kishte mundur ta gjente vendndodhjen e S.

Më 7 nëntor 2016, policia refuzoi të hapte procedura penale me arsyetimin se informacionet ishin bërë publike në media sociale dhe jo në media/shtyp. Prokurori mbikëqyrës e vuri mënjanë vendimin si të paligjshëm meqenëse S. nuk ishte intervistuar. Më 2 maj 2017, policia përsëri refuzoi të hapte procedura penale, duke thënë se nuk kishte tregues që S. i kishte mbledhur ose shpërndarë ato informacione. Më 1 shkurt 2018, juristi mbikëqyrës e anuloi vendimin dhe

---

[335] *Volodina k. Rusisë*, vendimi i 9 korrikut 2019, kër. nr. 41261/17 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

udhëzoi policinë që ta gjente dhe ta intervistonte S., për të kontrolluar pajisjet e tij elektronike dhe thirrjet e tij telefonike drejtuar kërkueses. Më 6 mars 2018, policia nisi hetimet penale.

Në shkurt, mars dhe shtator 2018, në VKontakte dhe në Instagram u shfaqën profile të tjera të rreme në emrin e kërkueses. Profilet përmbanin fotografitë e saj intime dhe të dhënat e saj personale. Më 13 gusht dhe 19 shtator 2018, kërkuesja u ankua në polici që S. i kishte dërguar asaj kërcënime me vdekje përmes mediave sociale dhe mesazheve në internet. Më 3 janar 2019, policia refuzoi të hapte çështje penale me arsyetimin se kërcënimet nuk kishin qenë "reale". Më 28 shtator 2018, kërkuesja bëri kërkesë në hetuesi për një urdhër që ndalonte forma të caktuara të sjelljes. Më 18 tetor 2018, hetuesi e refuzoi kërkesën e saj me arsyetimin se masa mund të zbatohet vetëm për të dyshuarit në "rrethana të jashtëzakonshme". Vendimi i konfirmua në apel.

Më 12 dhjetor 2018, kërkuesja u ankua në Gjykatën e Rrethit se policia nuk i ishte përgjigjur raportimit të saj për faktin se ajo kishte gjetur një pajisje gjurmuese në çantën e saj para dy vitesh. Më 26 dhjetor 2018, Gjykata nuk e gjeti policinë fajtores. Në shkurt 2019, apeli i saj kundër këtij vendimi u rrëzua.

Në janar 2019, policia i pezulloi hetimet për profilet e rreme në media sociale. Vendimi u konfirmua si i ligjshëm nga Gjykata Rajonale në gusht 2019. Më 14 shtator 2019, policia refuzoi të hapte hetimet penale për pajisjen gjurmuese, duke thënë se nuk kishte prova objektive që e inkriminonin S. Më 14 tetor 2020, policia e mbylli çështjen penale në lidhje me profilet e rreme në media sociale, megjithëse policia kishte konstatuar që S. i kishte krijuar profilet e rreme me emrin e kërkueses dhe kishte publikuar fotografi të saj nudo pa pëlqimin e saj. Më 13 tetor 2020, S. paraqiti një mocion për t'i ndërprerë procedurat për shkak të vjetërsimit të lëndës. Mocioni u pranua.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesja parashtroi se ajo kishte qenë viktimë e akteve të përsëritura të dhunës online, përfshirë pornografi për hakmarrje, ngacmime në internet, dhe ndjekje e padëshiruar në internet. Ajo u ankua që autoritetet ruse kishin dështuar të përmbushnin detyrimet e tyre pozitive sipas nenit 8 të Konventës për të garantuar respektimin e jetës së saj private duke ofruar mbrojtje efektive kundër dhunës online, duke parandaluar dhunën e mëtejshme dhe duke zhvilluar hetime efektive.



## Neni 8

Koncepti i jetës private sipas nenit 8 përfshin detyrimin pozitiv të Shtetit për të mbrojtur integritetin fizik dhe psikologjik të një personi, edhe kur rreziku vjen nga individët privatë. Aktet e dhunës në internet, ngacmimet në internet, dhe shtirja e të qenit dikush tjetër me qëllime keqdashëse janë kategorizuar si forma të dhunës kundër grave, forma të cilat mund të dëmtojnë integritetin fizik dhe psikologjik të grave. Në kontekstin e dhunës shtëpiake, shpesh ndodh që partnerët janë me gjasë kryesit e akteve të ndjekjes së padëshiruar në internet ose vëzhgimit të padëshiruar. Shtetet kanë detyrimin pozitiv që të konstatojnë dhe të zbatojnë efektivisht një sistem ndëshkimi të të gjitha formave të dhunës shtëpiake dhe të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për viktimat.

Publikimi jo-konsensual i fotografive intime të kërkueses, krijimi i profileve në media sociale ku kinse ishte ajo vetë, dhe gjurmimi i saj me pajisje GPS pa dyshim që e sollën kërkuesen brenda kuadrit të nenit 8. Këto akte kishin ndërhyrë në gëzimin nga ajo të jetës së saj private, duke shkaktuar ankth, shqetësim dhe pasiguri. Çështja kryesore për t'u përcaktuar ishte nëse autoritetet, pas informimit rreth ndërhyrjes tek të drejtat e saj, i kishin kryer detyrimet e tyre sipas nenit 8 për të marrë masa të mjaftueshme për t'i dhënë fund asaj ndërhyrjeje dhe për ta ndaluar që të ndodhte sërish.

Gjykata së pari shqyrtoi nëse Shteti kishte një kornizë ligjore të përshtatshme për ta mbrojtur kërkuesen nga aktet e dhunës në internet, të fokusuar konkretisht tek mënyra se si korniza ligjore ishte zbatuar në rastin e kërkueses. Gjykata kishte konstatuar më parë tek *Volodina k. Ruisë* se korniza ligjore ekzistuese në Rusi nuk i përmbushte kriteret e ngërthyera në detyrimet pozitive të Shtetit për të ngritur dhe për të zbatuar në mënyrë efektive një sistem që ndëshkon të gjitha format e dhunës shtëpiake.

Gjykata konsideroi se korniza ligjore ekzistuese u jepte autoriteteve ruse mundësinë për të hetuar aktet e dhunës në internet viktimë e të cilave ishte kërkuesja. Megjithatë, ajo theksoi se Rusia ishte një prej vendeve të pakta të mbetura mes Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës legjislativi i së cilës nuk përmbante masa për mbrojtjen kundër dhunës shtëpiake, siç janë urdhrat për "kufizim" ose "mbrojtje". Mekanizmi i të drejtës vendase në këtë Shtet nuk përfshinte monitorim rigoroz të pajtueshmërisë së kryesit me kushtet e një urdhri pengues që mund të garantonte sigurinë e viktimës nga rreziku i abuzimit të përsëritur. Përveç kësaj, Gjykata gjeti se urdhrat penalë të Shtetit që ndalonin sjellje të caktuara nuk ofronin mbrojtje të mjaftueshme për viktimat e dhunës

shtëpiake në situatën e kërkueses. Gjykata i zbatoi gjetjet e saj në çështjen e parë *Volodina* tek çështja e tanishme, duke arritur në përfundimin se autoritetet shtetërore nuk kishin menduar në asnjë moment se çka mund të bëhej dhe çka duhet të bëhej për ta mbrojtur kërkuesen nga dhuna e përsëritur online. Reagimi i autoriteteve shtetërore ishte dukshëm i pamjaftueshëm, dhe për shkak të mosveprimit të tyre dhe dështimit për të marrë masa penguese, ato kishin lejuar që kërcënimet, ngacmimet dhe sulmet ndaj kërkueses nga ana e S. të vazhdonin pa u ndëshkuar.

Më pas Gjykata vlerësoi mënyrën se si autoritetet kishin zhvilluar hetimet për raportimet e kërkueses. Hetimet efektive duhet të jenë të shpejta dhe të thella, ku autoritetet duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar prova. Në rastet e dhunës shtëpiake kërkohet zell i veçantë, ku gjatë zhvillimit të procedurave në vend duhet pasur parasysh natyra specifike e dhunës shtëpiake. Hetimet për profilet e rreme në media sociale dhe shpërndarjen e fotografive intime të kërkueses rezultuan me ngritjen e vetëm një akuze penale gati dy vjet pasi që kërkuesja i kishte raportuar profilet e rreme për herë të parë. Para kësaj, policia kishte dashur ta hiqte qafe rastin me nxitim për arsye formale, duke cituar mungesë juridiksioni ose mungesë veprë penale në vend që të bënte përpjekje reale dhe serioze për të konstatuar rrethanat e ankesave të kërkueses. Gjykata theksoi se Shtetet janë përgjegjëse për vonesat, pavarësisht nëse ato shkaktohen nga sjellja e autoriteteve gjyqësore apo nga mangësitë strukturore në sistemin gjyqësor.

Gjykata e rrëzoi argumentin e Qeverisë se vonesa në hetimet e çështjes së kërkueses kishte qenë për shkak se S. nuk ishte në dispozicion për marrje në pyetje. Gjykata sugjeroi që autoritetet policore duhet të kishin shfrytëzuar mundësitë e tyre për bastisje, dhe njëkohësisht duhet të kishin vepruar në mirëbesim për të siguruar prova forensike për veprat e pretenduara, përfshirë identifikimin e numrave të telefonit dhe adresave të internetit që ishin përdorur për të krijuar profilet e rreme dhe për të shkarkuar fotografitë e kërkueses. Vonesa dy-vjeçare në hapjen e hetimeve rezultoi me humbje kohe dhe dëmtoi mundësitë e autoriteteve për të siguruar prova në lidhje me aktet e dhunës në internet.

Hetimet që u zhvilluan nga viti 2018 e tutje nuk ishin të shpejta e as të plota. Gjykata kritikoi ritmin e ngadalshëm të hetimeve, të cilat morën gati një vit për të përfunduar informacione rreth adresës në internet të llogarive të rreme dhe dy vjet për të intervistuar kërkuesen. "Hulumtimet para-hetimore" për vepra të tjera, siç ishte pajisja gjurmuese e gjetur në çantën e kërkueses, nuk rezultuan me hapjen e ndonjë çështjeje penale. Gjithashtu autoritetet dështuan të hetonin kërcënimet

me vdekje që iu bënë kërkueses në gusht dhe shtator 2018. Ashtu si edhe në çështjen e parë *Volodina*, Gjykata gjeti se policia e rriste në mënyrë arbitrare pragun e provave të kërkuara për hapjen e procedurave penale, duke pretenduar se kërcënimet me vdekje duhet të ishin "reale dhe specifike" në mënyrë që të niste ndjekja penale. Më tej, autoritetet dështuan të shqyrtonin se si këto incidente mund të kishin lidhje me sulmet fizike që kërkuesja gjithashtu i kishte raportuar.

Ritmi i ngadalshëm i hetimeve nga autoritetet rezultoi me vjetërsimin e lëndës dhe me ndërprerjen e çështjes penale. Gjykata riafirmoi se shkeljet në zhvillimin e hetimeve efektive mund të gjenden atëherë kur procedurat përfundojnë me parashkrim duke lejuar që kryesit t'i ikin përgjegjësisë. Duke dështuar në zhvillimin e procedurave me zellin e kërkuar, Gjykata gjeti se Shteti mbante përgjegjësi për dështimin në garantimin që kryesit e akteve të dhunës në internet të silleshin para drejtësisë. Mos-ndëshkimi hidhte dyshime mbi aftësinë e makinerisë së Shtetit për të prodhuar efekt pengues të mjaftueshëm për të mbrojtur gratë nga dhuna në internet.

Gjykata gjeti që, megjithëse Shteti e kishte kornizën ligjore për të ndjekur penalisht aktet e dhunës në internet, viktimë e të cilave ishte kërkuesja, mënyra se si autoritetet e kishin trajtuar çështjen – kryesisht mosdashja për të hapur çështjen penale dhe ritmi i ngadalshëm i hetimeve – zbulonte dështimin për plotësimin e detyrimeve të tij pozitive. Rrjedhimisht, Gjykata gjeti shkelje të nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 7,500 euro në lidhje me dëme jomateriale, përveç 5,386.46 euro për kosto dhe shpenzime.

*Kërkuesja roje burgu raportoi kolegët meshkuj që prekën në mënyrë të papërshtatshme të burgosurat femra dhe pësoi bullizëm për shkak të sinjalizimit – autoritetet vendase dështuan të zbatonin siç duhej kornizën ligjore në shkelje të nenit 8*

## **VENDIMI NË ÇËSHTJEN ŠPADIJER K. MALIT TË ZI**

(Kërkesa Nr. 31549/18)

**9 nëntor 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1978, dhe jetonte në Podgoricë të Malit të Zi. Që nga shtatori 1998, ajo punoi si roje burgu në Institutin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Në kohën relevante, ajo mbulonte pozitën e shefes së turnit në burgun e femrave. Në janar 2013, kërkuesja raportoi pesë kolegë të saj për sjellje të turpshme në punë gjatë natës së vitit të ri. Siç u konstatua më vonë gjatë procedurës disiplinore, dy roje meshkuj kishin hyrë në burgun e femrave dhe njëri prej tyre kishte pasur “kontakte fizike” me dy të burgosura.

Pas raportimit të saj, kërkuesja pati incidente të bullizmit dhe ngacmimit në punë, për shembull një kolege e pështyu dhe tha “ja ku është kurva e ndyrë, sikur të dobësohej nja 50 kile ndoshta do të dukej e pranueshme”. Më tej, disa incidente ndodhën jashtë punës, siç ishte rasti kur makina e saj u godit dhe u dëmtua. Në gusht 2013, kërkuesja i kërkoi punëdhënësit të saj që të hapte procedurën për ta mbrojtur atë nga bullizmi, duke u ankuar për ofendimet dhe poshtërimet e vazhdueshme në punë të cilat asaj po i shkaktonin probleme shëndetësore. Në shtator 2013, ajo i kërkoi autoritetit të inspeksionit, menaxhmentit të burgut dhe ndërmjetësit përgjegjës për procedurat e bullizmit në punë që ta trajtonin kërkesën e saj. Më 6 nëntor 2013, ndërmjetësi e rrëzoi kërkesën e saj si të pabazuar.

Më 20 nëntor 2013, kërkuesja nisi procedurën civile kundër punëdhënësit të saj, duke u ankuar se incidentet e bullizmit kishin shkelur integritetin e saj personal dhe profesional. Më 10 shkurt 2015, një javë para se gjykata vendase të merrte vendim për procedurën civile, kërkuesja u mësy nga një sulmues që e goditi disa herë në qafë, shpinë, bërryl dhe kofshë, dhe i tha “kujdes çfarë po bën”. Më 19 shkurt 2015, Gjykata e Shkallës së Parë mori vendim kundër kërkueses në procedurë civile. Gjykata konsideroi se ngjarjet e ankmuara nuk përbënin bullizëm sepse u mungonte shpeshësia e kërkuar. Ky vendim u konfirmua nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Supreme, respektivisht. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi apelin kushtetues të kërkueses.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u ankua sipas neneve 3 dhe 6 të Konventës për shkelje të integritetit të saj psikologjik të shkaktuar nga bullizmi aktiv dhe pasiv në punë, dhe për dështimin e autoriteteve vendase për ta mbrojtur atë nga kjo situatë. Megjithatë, për shkak të karakterizimit nga Gjykata të pretendimeve faktike dhe argumenteve ligjore, Gjykata e shqyrtoi çështjen sipas nenit 8 të Konventës.

### Neni 8

Gjykata riafirmoi se objekti thelbësor i nenit 8 është mbrojtja e individëve kundër ndërhyrjes arbitrare nga autoritetet publike. Gjithashtu ka detyrime pozitive shtesë të ngërthyer në të drejtën për jetë private, ku përfshihet marrja e masave në sferën e marrëdhënieve mes vetë individëve. Koncepti i jetës private përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të personit, kështu që Shtetet kanë për detyrë ta mbrojnë integritetin fizik dhe moral të një individi nga personat e tjerë. Për të siguruar pajtueshmërinë me këtë detyrim, Shtetet duhet të ngrenë dhe të zbatojnë një kornizë ligjore të përshtatshme që ofron mbrojtje kundër akteve të dhunës nga individët privatë, përfshirë në kontekstin e ngacmimit në punë. Gjykata konsideroi se sinjalizimi nga ana e kërkueses e sjelljes së paligjshme të pretenduar të punëdhënësit të saj/tij kërkonte mbrojtje të veçantë në rrethana të caktuara.

Gjykata theksoi se e drejta vendase përkatëse parashikonte mundësitë që kërkuesja të kërkonte mbrojtje kundër ngacmimit në punë. Nuk kishte tregues se ato mundësi ishin në thelb të papërshtatshme ose të pamjaftueshme për të ofruar mbrojtjen e duhur kundër incidenteve të ngacmimit. Megjithatë, këto zgjidhje ekzistuese duhet të funksionojnë në praktikë.

Gjykata së pari shqyrtoi procedurat e nisura nga kërkuesja. Gjykata gjeti se procedura e ndërmjetësimit nuk ishte në pajtueshmëri me ligjet përkatëse, meqenëse ajo procedurë as nuk filloi e as nuk përfundoi brenda afateve kohore statutore. Më tej, ndërmjetësi e kishte tejkaluar kompetencën e tij statutorë duke shqyrtuar nëse kërkesa e kërkueses ishte e bazuar, sepse nuk kishte asnjë ligj që e autorizonte atë për ta bërë një gjë të tillë. Në lidhje me padinë civile, kërkuesja nuk mori mbrojtje sepse gjykatat kërkuan prova të incidenteve çdo javë për gjashtë muaj. Pavarësisht nga fakti se Shteti Kontraktues gëzon hapësirë vlerësimi gjatë ngritjes së mekanizmit mbrojtës për ngacmimin në vendin e punës, Gjykata e gjeti qasjen të pamjaftueshme. Ankesat për bullizëm duhet të shqyrtohen thellësisht sipas secilit rast, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta dhe kontekstin e secilit

rast. Mund të ketë rrethana ku incidentet janë më të rralla, por prapë se prapë përbëjnë bullizëm, ose anasjelltas.

Gjykata po ashtu theksoi se praktika gjyqësore relevante në Malin e Zi ishte e pakët dhe nuk ishte e vendosur sa i përket elementit të shpeshhtësisë së ndodhjes së bullizmit që kërkohet për të ngritur padi. Megjithëse incidentet e ndodhura në rastin e kërkueses mund të mos kenë përbërë bullizëm, gjykatat vendase shqyrtuan vetëm disa prej incidenteve, ndërkohë që shumë incidente të tjera të ankimuara mbetën të pashqyrtuara. Gjykata theksoi dështimin e autoriteteve për të marrë parasysh kontekstin e padisë së kërkueses, ku pretendohet se aktet e ngacmimit ndodhën si pasojë e faktit që ajo raportoi aktivitetet e paligjshme të kolegëve të saj, me qëllim që t'ia mbyllnin gojën asaj dhe ta ndëshkonin atë. Sipas Gjykatës, detyrimi pozitiv i Shteteve nga neni 8 për t'i zbatuar efektivisht ligjet kundër ngacmimeve serioze merrte rëndësi të veçantë kur një ngacmim i tillë mund të ishte i nxitur nga aktivitetet e "sinjalizimit".

Përveç incidenteve në punë, makina e kërkueses ishte dëmtuar, dhe ajo ishte sulmuar nga një sulmues i cili e kishte goditur atë në qafë dhe në shpinë. Korniza ligjore penale përkatëse në vend ofronte mbrojtje të mjaftueshme ndaj sulmeve të tilla. Megjithatë, Gjykata gjeti se prokurori i shtetit nuk kishte marrë vendim për më shumë se tetë dhe gjashtë vjet, respektivisht, në lidhje me ankesat penale të kërkueses, duke e penguar kështu kërkuesen që të bënte padi private. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk iu referua fare dështimit të prokurorit për të trajtuar ankesat penale të kërkueses.

Për sa u tha më lart, Gjykata konsideroi që mënyra se si ishin zbatuar mekanizmat civile dhe penale, posaçërisht mungesa e vlerësimit të të gjitha incidenteve në fjalë dhe dështimi për të marrë parasysh kontekstin potencial të sinjalizimit, kishte qenë defekte. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të detyrimeve pozitive të Shtetit sipas nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkueses 4,500 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 1,000 euro për kosto dhe shpenzime.

*Dështimi për të mbrojtur një grua gjeorgjiane nga dhuna shtëpiake e kryer nga ish-partneri i saj, i cili përdori pozitën e tij si polic për mosndëshkim për sjelljen e tij, dhe dështimi për të zhvilluar hetime efektive për vrasjen e saj shkelën aspektet procedurale dhe substanciale të nenit 2 në lidhje me nenin 14*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN A DHE B k. GJEORGJISË

(Kërkesa Nr. 73975/16)

**10 shkurt 2022**

### 1. Faktet kryesore

Kërkesja e parë, A, e lindur në vitin 1972, ishte nëna e C, një grua e lindur në vitin 1994 e cila u vra në vitin 2014 nga partneri i saj, D, pas lindjes së djalit të tyre, kërkesi B, në vitin 2013.

Në vitin e ditëlindjes së saj të shtatëmbëdhjetë, C u rrëmbye për martesë nga D, një polic me të cilin ajo bashkëjetoj prej dhjetorit 2011 deri në qershor 2012. Pas episodeve të abuzimit shtëpiak, C, e cila ishte dy-muajshe shtatzënë me B, u kthye në shtëpinë e prindërve të saj. Pas ngacmimeve të vazhdueshme kundër saj dhe familjes së saj, C bëri shumë ankesa në polici kundër D. Megjithatë, D i referua statusit të tij si polic duke thënë se ai do t'i shmangej ndëshkimit për sjelljen e tij. Pas një zënke në lidhje me pagesat për fëmijën në vitin 2013, D e rrahu C në shtëpinë e prindërve të saj. U kontaktua policia, dhe tre policë, të gjithë shokë të D, arritën në vendin e ngjarjes dhe nuk e penguan atë që të ndërhynte tek intervista e C. Njëri prej policëve i tha C se rrahja e grave ishte e zakonshme. Pa intervistuar D, policët hartuan një raport të pasaktë të incidentit, duke mos bërë asnjë përpjekje për ta ndaluar D kur ai e detyroi C ta firmoste duke e kërcënuar se do ta vriste. Pas intervistës, njëri polic kërcënoi se do ta gjobiste C sikur ajo t'i kontaktonte ata sërish pa arsye të vlefshme, sepse ata ishin të zënë me çështje më serioze dhe nuk kishin kohë për të humbur me zënka të vogla familjare.

Në vitin 2014, pas një interviste me autoritetet hetimore në lidhje me episode të reja të dhunës shtëpiake, C-së iu afrua D i cili kishte qenë duke e ndjekur në rrugë, dhe pasi filloi të zihet përsëri me të ai e qëlloi pesë herë nga afër me pistoletën e tij të shërbimit, duke e vrarë në vend. Pas kësaj u hap çështja penale kundër D, i cili në mbrojtje të tij pretendoi se kishte qenë vrasje nderi. Më 17 prill 2015, D u gjet fajtor për vrasje me paramendim të një anëtareje të familjes dhe u dënua me njëmbëdhjetë vjet burgim. Dënimi nuk iu referua rolit të mundshëm të diskriminimit të bazuar në gjini në kryerjen e krimin.

Paralelisht me procedurat penale kundër D, kërkesit nisën dy veprime ligjore, ku i pari kishte të bënte me ankesa penale që kërkonin zgjidhje për dështimin e autoriteteve për të mbrojtur C. Pavarësisht nga kërkesat e shumta pranë autoriteteve, kërkesit morën përgjigje shumë të pakta për ankesat e tyre, ku u informuan vetëm që hetimet penale për neglizhencën e policëve ende vazhdonin. Veprimi i dytë kishte të bënte me një padi civile kundër Ministrisë së Brendshme dhe Zyrës së Kryeprokurorit Publik, ku kërkohej kompensim për dëmet e shkaktuara nga mungesa e masave të marra për t'i dhënë fund sjelljes së dhunshme të D. Më 24 korrik 2015, një vendim i Gjykatës së Qytetit të Tbilisit e lejoi pretendimin pjesërisht dhe u dha kërkesve kompensim (afro 7000 euro) për mungesën e hetimeve të përshtatshme të incidenteve që përfshinin C.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkesit u ankuan se autoritetet vendase kishin shkelur nenin 14 të Konventës (ndalimi i diskriminimit) i marrë së bashku me nenet 2 (e drejta e jetës) dhe 3 (ndalimi i torturës) duke dështuar të mbronin C nga dhuna shtëpiake dhe të zhvillonin hetime penale efektive mbi rrethanat që kontribuan në vdekjen e saj.

### Pranueshmëria

Gjykata gjeti se çështja duhet të shqyrtohej si nga aspekti substancial ashtu edhe nga ai procedural i nenit 2 në lidhje me nenin 14. Më tej, ajo tha se çështja nëse kërkesit e kishin humbur apo jo statusin e viktimës mbi bazën e rezultatit të procedurave në vend ishte e lidhur me çështjen e efektivitetit të hetimeve dhe duhet të shqyrtohej me themelet e ankesës.

### Neni 2 në lidhje me nenin 14

Duke pasur parasysh pretendimet e kërkesve që dështimi i dyfishtë i autoriteteve – mungesa e mbrojtjes së të afërmes së tyre nga dhuna shtëpiake dhe mungesa e hetimeve efektive për mosveprimet e autoriteteve ligjzbatuese – rridhte nga njohja e pamjaftueshme nga ana e tyre e dukurisë së diskriminimit kundër grave, Gjykata vendosi t'i vinte ankesat në një test të dyfishtë simultan sipas nenit 2 i marrë në lidhje me nenin 14. Ajo theksoi se çështja nuk kishte të bënte drejtpërdrejt me veprimet e dhunshme të D por me përgjigjen e autoriteteve, ose mungesën e saj, ndaj veprimeve të tij dhe ndaj ankesave të C dhe familjes së saj para dhe pas vrasjes së saj.



Duke marrë parasysh së pari aspektin procedural të nenit 2, Gjykata theksoi se në çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e zyrtarëve shtetërorë për vdekjet që ndodhin si pasojë e neglizhencës së pretenduar, neni 2 jo domosdoshmërisht kërkon ekzistencën e një zgjidhjeje të së drejtës penale në çdo rast. Megjithatë, në rrethana të jashtëzakonshme vetëm hetimet penale efektive do të mund të përmbushnin detyrimin procedural pozitiv, p.sh. kur ka humbje ose rrezikim të jetës për shkak të sjelljes së një autoriteti publik që ka shkuar përtej gabimit të të gjykuarit ose pakujdesisë.

Duke marrë parasysh detyrimet substanciale të Shtetit sipas neneve 2 dhe 14, Gjykata theksoi se dështimi i një Shteti për të mbrojtur gratë nga dhuna shtëpiake shkel të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë para ligjit dhe se ky dështim nuk është e thënë se duhet të jetë i qëllimshëm. Pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues që krijon një klimë që çon në dhunë shtëpiake do të përbënte shkelje të nenit 14.

Duke iu kthyer fakteve të çështjes, Gjykata gjeti se mosveprimi dhe neglizhenca e autoriteteve ka shkuar përtej një gabimi të thjeshtë të të gjykuarit ose pakujdesisë, duke pasur parasysh se kjo ishte një prej arsyeve kryesore përse abuzimi shtëpiak u lejua që të përshkallëzohej duke kulminuar me vrasjen e C. Autoritetet e dinin, ose duhet ta kishin ditur nivelin e lartë të rrezikut me të cilin përballej ajo sikur ato të mos i kryenin detyrat e tyre siç duhej. Prandaj, kur mendohen zgjidhjet e ndryshme, më të përshtatshmet ishin hetimet penale kundër policëve dhe prokurorëve publikë. Megjithatë, autoriteti hetimor kompetent as nuk bëri përpjekje për të përcaktuar përgjegjësinë nga ana e policëve për dështimin e tyre për të reaguar si duhej ndaj incidenteve të shumta të dhunës së bazuar në gjini, e as nuk e vlerësoi të nevojshme t'u jepte kërkuësve statusin e viktimës. Nuk u hap asnjë hetim disiplinor mbi mosveprimin e pretenduar të policëve, dhe nuk u ndërmor asnjë hap për të trajnuar policët në fjalë se si të reagojnë siç duhet në rastet e pretendimeve për dhunë shtëpiake në të ardhmen. Sa u përket prokurorëve publikë, nuk u mor asnjë përgjigje e vetme – kërkuësit në mënyrë të përsëritur u përpoqën por nuk arritën të merrnin informacione nga autoritetet hetimore në lidhje me këtë aspekt të ankesës së tyre penale.

Duke pasur parasysh treguesit për diskriminimin e mundshëm të bazuar në gjini si i tillë që ishte pjesë e reagimit të ligjzbatuesve dhe faktin që ata e lejuan kryesin e pretenduar që të merrte pjesë në marrjen në pyetje të viktimës së abuzimit të pretenduar shtëpiak, ekzistonte një nevojë urgjente për të zhvilluar hetime domethënëse mbi reagimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe mosveprimin të tyre. Fakti që kryesi i pretenduar i dhunës së abuzimit ishte vetë pjesëtar i zbatimit

të ligjit, dhe që gjatë kërcënimeve të tij kundër viktimës dhe familjes së saj ai e përmendte këtë fakt dhe atë që ai e konsideronte pandëshkueshmëria e tij, e bënin nevojën e hetimeve të duhura edhe më urgjente.

Në fund, Gjykata gjithashtu theksoi pamjaftueshmërinë e zgjidhjes së ofruar nga ndjekja penale e kryesit dhe procedurat civile të hapura nga kërkuesit. Gjyqi dhe dënimi i D nuk përfshiu ekzaminimin e rolit të mundshëm të diskriminimit të bazuar në gjini në kryerjen e krimit, dhe ndërkohë që ishte pa dyshim pozitive që gjykatat vendase e njohën dështimin e autoriteteve ligjzbatuese për të marrë masa për t'i dhënë fund diskriminimit të bazuar në gjini dhe për të mbrojtur jetën e C, ato nuk e përfshinë pyetjen nëse toleranca zyrtare e incidenteve të dhunës shtëpiake mund të ishte kushtëzuar nga e njëjta njëanshmëri gjinore. Kështu, kishte pasur shkelje të aspektit procedural të nenit 2 i lexuar në lidhje me nenin 14.

Duke marrë parasysh aspektin substancial të nenit 2, Gjykata theksoi se në këtë rast ishte e qartë se ekzistonte një situatë e gjatë e dhunës shtëpiake, e cila pa dyshim që ka të bëjë me afërsinë e rrezikut tek viktima. Policia dështoi të tregonte zellin e duhur të veçantë dhe bëri dështime të mëdha në punën e saj, si mbledhja e pasaktë, e paplotë e madje edhe e shtrembëruar e provave dhe mos-përpjekja për të zhvilluar një analizë të duhur të faktorëve të mundshëm që nxisnin dhunën. Mangësitë në mbledhjen e provave si reagim ndaj një incidenti të raportuar të dhunës shtëpiake mund të rezultojnë me nënvlehtësimin e nivelit të dhunës së kryer në realitet, mund të kenë efekte dëmtuese për hapjen e hetimeve penale, e madje edhe mund të dekurajojnë viktimat e abuzimit shtëpiak, të cilat tashmë janë shpesh nën trysinë e shoqërisë, nga raportimi i një familjari të dhunshëm tek autoritetet në të ardhmen.

Autoritetet vendase relevante nuk i shfrytëzuan masat e përkohshme kufizuese në lidhje me abuzuesit e pretenduar, të cilat i përmbante korniza legjislative. Viktima nuk u këshillua asnjëherë nga policia në lidhje me të drejtat e saj procedurale dhe masat mbrojtëse që ajo kishte në dispozicion. Ndërkohë që autoritetet ligjzbatuese ishin krejtësisht të vetëdijshme se D ishte duke përdorur attribute të ndryshme të pozitës së tij si polic për të bërë abuzime kundër C, jo vetëm që policia nuk i dha fund atij demonstrimi të mosndëshkimit dhe arbitraritetit, por përkundrazi e lejoi abuzuesin e pretenduar që të merrte pjesë në marrjen në pyetje të viktimës së tij, dhe pak kohë më pas e promovoi abuzuesin në një rang më të lartë policor. Gjykata e gjeti këtë aspekt të çështjes posaçërisht shqetësues, meqenëse Shtetet Anëtare pritet të jenë edhe më të rrepta gjatë hetimit dhe ndëshkimit të zyrtarëve të vet ligjzbatues për kryerjen e krimeve të rënda, sepse është në rrezik jo vetëm çështja e përgjegjësisë penale individuale të kryesve, por edhe detyra e Shtetit për

të luftuar çdo formë të mosndëshkimit që mund të kenë zyrtarët falë pozitës së tyre, dhe për të ruajtur besimi publik dhe respektin për sistemin e zbatimit të ligjit.

Prandaj, Gjykata iu referua çështjes si një shembull i gjallë që tregon se si mosveprimi zyrtar ndaj dhunës shtëpiake mund të krijojë një klimë që çon në përhapjen e episodeve të diskriminimit të bazuar në gjini, dhe vendosi se kishte pasur shkelje të detyrimeve pozitive substanciale sipas nenit 2 të Konventës i lexuar në lidhje me nenin 14.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesve 35,000 euro për dëme jomateriale.



Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer - Programi i Shtetit të së Drejtës SEE dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në publikim jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimin zyrtar të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.